

AFATET DHE ZBATIMI I TYRE NË PROCEDURËN PENALE NË KOSOVË

Naser Sopjani

Dorëzuar

Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në

SHKENCA JURIDIKE, me profil E DREJTË PUBLIKE, për marrjen e
gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Bashkim Zahiti (LL.M)

Numri i fjalëve: 68.028.

Tiranë, 2019

PËRMBAJTJA

DEKLARATË E AUTORËSISË.....	VII
ABSTRAKT	VIII
ABSTRACT	X
SHKURTESAT	XII
LISTA E FIGURAVE DHE TABELAVE	XIV
KAPITULLI I.....	1
1. HYRJE	1
1.1 Qëllimi i punimit: Studimi i afateve dhe zbatimit të tyre në procedurën penale.....	1
1.2. PYETJET KËRKIMORE DHE HIPOTEZA	3
1.3 Metodologjia.....	4
1.4 Struktura	5
KAPITULLI II.....	8
2. ASPEKTE TË SË DREJTËS NË KOSOVË, BAZA LIGJORE NDËRKOMBËTARE DHE KUSHTETUESE E AFATEVE NË PROCEDURËN PENALE.....	8
2.1. ASPEKTE HISTORIKE TË SË DREJTËS NË KOSOVË.....	8
2.1.1. Sistemi i drejtësisë nën misionin e UNMIK-ut dhe EULEX-it.....	9
2.2. ASPEKTE JURIDIKE LIDHUR ME AFATET	23
2.3. INSTRUMENTET NDËRKOMBËTARE QË LIDHEN ME PËRCAKTIMIN DHE ZBATIMIN E AFATEVE	26
2.3.1. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut.....	28
2.3.2. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e Saj	29
2.3.3. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e Saj	31
2.3.4. Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare	32

Afatet dhe zbatimi i tyre në procedurën penale në Kosovë

2.3.5.	Konventa për të Drejtat e Fëmijës	33
2.4.	PËRCAKTUESHMËRIA E AFATEVE DHE ZBATIMI I TYRE SIPAS KUSHTETUTËS SË KOSOVËS	34
2.4.1.	Afatet lidhur me privimin e personit nga liria.....	35
2.4.2.	Nxjerrja e aktvendimit mbi ndalimin e personit të arrestuar	35
2.4.3.	Vendosja gjyqësore lidhur me privimin nga liria	36
2.4.4.	Afati për përfundimin e çështjes nga gjykatat.....	38
2.5.	PËRFUNDIME.....	39
KAPITULLI III.....		42
3.	AFATET DHE ZBATIMI I TYRE SIPAS KODIT TË PROCEDURËS PENALETË KOSOVËS	42
3.1.	AFATET LIDHUR ME PRIVIMIN E PERSONAVE NGA LIRIA.....	42
3.1.1.	Arrestimi.....	43
3.1.2.	Ndalimi	45
3.1.3.	Aplikimi i masave të sigurisë.....	48
3.1.4.	Afatet lidhur me urdhërarrestin	63
3.2.	AFATET E PARASHKRIMIT TË NDJEKJES PENALETË DHE EKZEKUTIMIT TË SANKSIONEVE PENALETË	65
3.2.1.	Afatet lidhur me institutin e parashkrimit.....	65
3.2.2.	Mosparashkrimi i veprave penale të caktuara.....	66
3.2.3.	Parashkrimi i ndjekjes penale	67
3.2.4.	Parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve.....	74
3.3.	AFATET LIDHUR ME VEPRIME TË CAKTUARA PROCEDURALE GJATË FAZËS PARAPENALETË.....	78
3.3.1.	Masat e marra para fillimit të procedurës penale.....	78
3.3.2.	Marrja e deklaratave në procedurën paraprake.....	84
3.3.3.	Afatet lidhur me ekspertizat gjyqësore	85
3.3.4.	Shkatërrimi i mostrave	86

Afatet dhe zbatimi i tyre në procedurën penale në Kosovë

3.3.5.	Zbatimi i kontrollit.....	87
3.4.	AFATET E TRAJTIMIT TË PASURISË GJATË PROCEDURËS PENALE	90
3.4.1.	Ngjirja e përkohshme e aseteve nga ana e prokurorisë	90
3.4.2.	Ngjirja e aseteve nga ana e gjykatës.....	91
3.4.3.	Shqyrtimi gjyqësor mbi urdhrin ndalues	92
3.4.4.	Sekuestrimi i përkohshëm	92
3.4.5.	Kthimi i sendeve të sekuestruara përkohësisht.....	93
3.4.6.	Konfiskimi i përkohshëm	94
3.4.7.	Urdhri për masat e përkohshme të sigurimit të pasurisë.....	95
3.4.8.	Përfshirja apo mospërfshirja në aktakuzë e pasurisë që është objekt i konfiskimit.	96
3.4.9.	Pasuria që i nënshtrohet automatikisht konfiskimit.....	96
3.5.	AFATET GJATË FAZËS SË HETIMIT PENAL	98
3.5.1.	Shqyrtimi i detyrueshëm i lëndës	98
3.5.2.	Afatet lidhur me kallëzimin penal, fillimin, pezullimin dhe pushimin e hetimit penal	100
3.6.	AFATET GJATË FAZËS SË GJYKIMIT PENAL.....	117
3.6.1.	Seancat paragjyqësore	118
3.6.2.	Seancat gjyqësore	122
3.6.3.	Afatet lidhur me urdhrin ndëshkimor	130
3.6.4.	Çështja në rigjykim	131
3.7.	AFATET GJATË USHTRIMIT TË MJETEVE JURIDIKE	134
3.7.1.	Mjetet e rregullta juridike	135
3.7.2.	Mjetet e jashtëzakonshme juridike.....	138
3.8.	PËRFUNDIME.....	143

Afatet dhe zbatimi i tyre në procedurën penale në Kosovë

KAPITULLI IV.....	155
4. AFATET DHE ZBATIMI I TYRE SIPAS KODIT TË DREJTËSISË PËR TË MITUR	155
4.1. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË KODIT TË DREJTËSISË PËR TË MITUR	155
4.2. Arrestimi dhe ndalimi	156
4.3. Paraburgimi.....	157
4.3.1. Rishqyrtimi i paraburgimit.....	158
4.4. Seanca përgatitore.....	159
4.4.1. Njoftimi i mbrojtjes për procedurën përgatitore.....	159
4.5. Procedura e ndërmjetësimit	160
4.6. Shqyrtimi gjyqësor	160
4.7. Përpilimi i vendimit gjyqësor.....	162
4.8. Ankesa ndaj vendimit gjyqësor.....	162
4.9. Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit.....	162
4.10. PËRFUNDIME	165
KAPITULLI V	167
5. AFATET LIDHUR ME KOMPENSIMIN E PERSONAVE TË ARRESTUAR APO TË DËNUAR PA ARSYE DHE REHABILITIMIN E TË DËNUARVE.....	167
5.1. Paraqitja e kërkesës për kompensim dëmi i personave të arrestuar apo dënuar pa arsye 168	
5.1.1. Kompensimi i dëmit	168
5.2. Rehabilitimi i të dënuarve	170
5.2.1. Shlyerja e dënimit nga evidenca-Rehabilitimi ligjor.....	170
5.2.2. Shlyerja e dënimit nga evidenca-Rehabilitimi gjyqësor.....	172
5.2.3. Shlyerja e dënimit në rastet kur organi administrativ nuk vepron	173
5.4. PËRFUNDIME.....	175
KAPITULLI VI.....	176

6. ROLI DHE NDIKIMI I INSTITUCIONEVE TË NDRYSHME NË ZBATIMIN E AFATEVE PROCEDURALE	176
6.1. GJKATA KUSHTETUESE E KOSOVËS	176
6.1.1. Paraqitja e kërkesës	177
6.1.2. Afati për kthimin në gjendjen e mëparshme	178
6.1.3. Procedimi i kërkesës së paraqitur	179
6.2. KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS	181
6.2.1. Njësia për shqyrtimin e performancës gjyqësore	183
6.3. ZYRA E PROKURORIT DISIPLINOR	185
6.4. KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS	187
6.5. AVOKATI I POPULLIT	188
6.6. MEDIA DHE SHOQËRIA CIVILE	191
6.6.1. Kallxo.com	192
6.6.2. Instituti i Kosovës për Drejtësi	194
6.6.3. Organizata Çohu	198
6.7. PËRFUNDIME	201
KAPITULLI VII	202
7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	202
7.1. Përfundimet	202
7.2. Rekomandimet:	205
REFERIMET	206
SHTOJCA	227

DEKLARATË E AUTORËSISË

Me përgjegjësi deklaroj se ky studim-punim i doktoraturës është rezultat i punës sime, është punë origjinale dhe nuk është plagjiaturë.

Punimi nuk përmban asnjë material të shkruar nga askush tjetër përveç meje, çdo burim është i cituar dhe i referuar në mënyrë besnike dhe deri më tani nuk është prezantuar asnjëherë për vlerësim para ndonjë komisioni.

©Autori

ABSTRAKT

Qëllimi i këtij studimi është paraqitja e afateve dhe zbatimi i tyre gjatë zhvillimit të procedurës penale në Kosovë. Kjo bëhet me qëllim të paraqitjes sa më të saktë të kohës brenda të cilës subjektet në procedurë duhet të ndërmarrin, mund të ndërmarrin apo nuk duhet të ndërmarrin veprimet e caktuara procedurale. Afatet që duhet zbatuar dalin nga e drejta materiale dhe procedurale e që gjejnë zbatim të drejtpërdrejt në procedurën penale.

Zbatimi i drejtë i ligjit dhe mosshkelja e afateve ligjore, garantojnë sundim të ligjit, rend ligjorë dhe kushtetutës, respektim të plotë të të drejtave dhe lirive të njeriut si baza kryesore e rendit juridik të Kosovës.

Duke qenë se veprimet gjyqësore prekin dhe cënojnë të drejtat dhe liritë e njeriut të cilat duhet të mbrohen me fanatizëm, kushtetuta e vendit me të gjitha marrëveshjet dhe institucionet ndërkombëtare trumbeton se veprimet procedurale duhet të kryhen në afat.

Andaj, studimi synon të nxjerr në pah faktin se procesi penal në Kosovë kalon çdo ditë nëpër sfida të ndryshme dhe afatet përkundër asaj që janë të përcaktuara shkelen nga zbatuesit e ligjit, me apo pa qëllim.

Afatet interpretohen në mënyra të ndryshme nga zbatuesit e ligjit, duke krijuar konfuzitet dhe dilema të cilat më së shpeshti shkojnë në dëm të personave që janë subjekt i procesit, e shumë rallë në favor të tyre.

Studimi nxjerr përfundime se moszbatimi i afateve vjen si rezultat i mosnjohurisë, mosinterpretimit të duhur dhe të drejtë të ligjit, por edhe nga neglizhenca e pa/qëllimshme.

Sistemi i drejtësisë duhet të shtrëngojë mbikqyrjen e prokurorisë dhe gjykatës dhe ata që nuk respektojnë dhe zbatojnë afatet të kenë edhe ndjekje penale, sepse maksima latine

“ignorantia legis neminem excusat” nuk vlen vetëm për një kategori të caktuar të njerëzve, por për të gjithë.

Pa dyshim që do të shfaqen pengesa gjatë këtij punimi, por jam i vetëdijshëm që kjo punë e imja solide do vazhdohet edhe nga të tjerët. Puna më e mirë do të ishte që ekspertët e fushës juridike të përgatisin një komentari të detajuar, ku për secilën dispozitë të kodit penal dhe procedural të jepen shembuj me raste konkrete. Secili paragraf i ligjit material dhe procedural të mbështetet me rast praktik dhe në këtë mënyrë të mos kishte dilema të tilla.

Në fund, shoqëria civile dhe mediat kanë rol të dyfishtë në raport me ndikimin e tyre në sistemin prokurorial e gjyqësor për një proces të drejtë dhe në afat. Njëri rol është pozitiv kur ka të bëjë me shtytjen që sistemi të kryej veprimet në afat, e tjetri është negativ kur ka të bëjë me krijimin e paragjyimit në opinion të të qenit fajtor në fazën e procesit gjyqësor.

Fjalët kyçe: Afat, Kodi penal, Kodi i procedurës penale, Parashkrim, Kosovë.

ABSTRACT

The purpose of this study is to present deadlines and their implementation during the conduct of criminal proceedings in Kosovo. This is done in order to provide as accurate as possible the time within which the subjects in the procedure should undertake, undertake or not undertake certain procedural actions. The deadlines to be applied derive from material and procedural law that are directly applicable in criminal proceedings.

The proper implementation of the law and non-violation of legal deadlines guarantee the rule of law, legal order and constitution, full respect for human rights and freedoms as the main base of the Kosovo legal system.

The country's constitution with all international agreements and institutions trumpets that, since judicial actions affect and violate human rights and freedoms that need to be protected with fanaticism, procedural actions must be taken within the deadline.

Therefore, the study aims to highlight the fact that the criminal process in Kosovo passes through different challenges every day, and the deadlines are well defined, violated by law enforcers, with or without purpose.

Deadlines are interpreted differently by law enforcers, creating confusion and dilemma, and most often these dilemmas go to the detriment of the persons who are subject to the process, and very rarely in their favor.

The study concludes that non-implementation of deadlines comes as a result of ignorance, lack of proper and unjust interpretation of the law, but also of unintentional or deliberate negligence.

The justice system should tighten the oversight of the prosecution and the judiciary, and those who do not respect and enforce deadlines also have prosecution because the Latin

maskima "ignorantia legis neminem excusat" is not valid for a particular category of people but for all .

Undoubtedly, there will be obstacles in this work, but I am aware that this solid work will be continued by other lawyers as well. Better work would be for legal experts to prepare a detailed commentary, where examples and concrete cases are provided for each provision of the criminal and procedural code. Each paragraph of the substantive and procedural law was based on a practical case, and thus there were no such dilemmas.

Finally, civil society and the media have a dual role in relation to their impact on the prosecutorial and judicial system for a fair and timely process. One role is positive when it comes to pushing the system to carry out actions in time, and the other is negative when it comes to creating a bias in the opinion of being guilty before the court process is completed.

Key words: Deadline, Criminal Code, Criminal Procedure Code, Limitation, Kosova.

SHKURTESAT

AAPSK	Agjencisë për Administrim të Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar
AP	Avokati i Popullit
DUDNJ	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
D.K.R	Departamenti për Krime të Rënda
D.P.	Departamenti i Përgjithshëm
EULEX	Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit
FDHK	Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
GJK	Gjykata Kushtetuese
INTERPOL	Organizata më e madhe e Policisë Ndërkombëtare
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KRK	Kushtetuta e Republikës së Kosovës
KPK	Kodi Penal i Kosovës
KPPK	Kodi i Procedurës Penale i Kosovës
KPRSH	Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
KPPRSH	Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë
KPPRK	Komentari i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës
KEMDLTHNJP	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokolet e saj
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
KFOR	Trupa e Armatosur e Bashkësisë Ndërkombëtare nën komandën e NATOS
KGJPK	Këshilli gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës
KNDCPP	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokolet e saj

KKKEMPK	Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare
LMPDKPRK	Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës
LAPSK	Ligjit për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar
LKPK	Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
NJSHPGJ	Njësia për shqyrtimin e performancës gjyqësore
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretari të Përgjithshëm i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara
RoLLO	Zyra Ndërlidhëse e Sundimit të Ligjit e vendosur nga UNMIK
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
ZPD	Zyra e Prokurorit Disiplinor

LISTA E FIGURAVE DHE TABELAVE

<i>Tabela 1-</i>	<i>Paraqitja tabelare e afateve të parashkrimit të ndjekjes penale.....</i>
<i>Tabela 2-</i>	<i>Afatet e parashkrimit të ekzekutimit të dënimit, dënimeve plotësuese dhe masat e trajtimit të detyrueshëm</i>
<i>Tabela 3-</i>	<i>Paraqitja e afateve të vazhdimit të paraburgimit</i>
<i>Tabela 4-</i>	<i>Afati i paraqitjes së mjeteve të rregullta juridike</i>
<i>Tabela 5-</i>	<i>Afati i paraqitjes së mjeteve të jashtëzakonshme juridike</i>
<i>Tabela 6-</i>	<i>Afatet e parashkrimit të ekzekutimit të dënimit për të mitur</i>
<i>Tabela 7-</i>	<i>Parashkrimi i shqyrtimit të lëndëve dhe ekzekutimit të dënimeve 2001/2013 në gjykatat themelore dhe degët e tyre</i>
<i>Figura 1-</i>	<i>Paraqitja e afateve lidhur me ndalimin e personit të arrestuar</i>
<i>Figura 2-</i>	<i>Paraqitja e afateve lidhur me caktimin e masës së sigurimit</i>
<i>Figura 3-</i>	<i>Afatet ligjore në një proces të rregullt gjyqësor</i>

KAPITULLI I

1. HYRJE

1.1 Qëllimi i punimit: Studimi i afateve dhe i zbatimit të tyre në procedurën penale

Të jemi në shekullin 21 e të flasim për sistemin gjyqësor në aspekt të afateve ligjore, sidomos me përcaktueshmërinë se si dhe sa është një afat i caktuar për ndërmarrjen apo mos ndërmarrjen e ndonjë veprimi procedural janë disa arsye të mëdha.

Së pari është ajo që çdo ditë sistemi i drejtësisë ballafaqohet me shkeljen e afateve ligjore të cilat janë të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

Përcaktueshmëria e afateve ligjore në kod në njërën anë, e moszbatueshmëria e tyre në praktikë në anën tjetër është problematikë e madhe dhe dërgon mesazh jo të mirë për ata që janë apo mund të jenë subjekt-palë në procedurë.

E para, ka të bëjë me atë se me shkeljen e afateve ligjore shkelen drejtpërdrejtë të drejtat dhe liritë themelore në njeriut.

E dyta, tregon se sistemi i drejtësisë tregon pasiguri, se zbatuesit e ligjit nuk kanë njohuri të duhura, nuk lexojnë apo nuk dëshirojnë “të lodhin” veten me hapjen dhe analizën e literaturës, e kjo shpie në vendime të padrejta dhe të varura.

E treta, moszbatimi i afateve krijon dilema në interpretim të drejtë të dispozitave ligjore për afatet në mes palëve në procedurë dhe në këtë mënyrë gjykata mund ta humb rolin e saj të arbitrit të drejtë.

E katërta, ka të bëjë me injorancën e institucionit dhe të mosrespektuarit e afateve ligjore, paprekshmëria e tyre karshi qytetarit dhe mospasja e asnjë pasoje për mosrespektim apo moszbatim të drejtë të afatit.

E pesta, ka të bëjë me atë që pasiguria juridike lind nga joprofesionalizmi dhe dalin vendime jounike nga i njëjti institucion për çështje të njëjta, varësisht se kush është zbatues i ligjit.

Studimi në qendër të tij do të ketë trajtimin e aspektit dogmatik dhe interpretues të dispozitave ligjore që përcaktojnë afatet në kodin e procedurës penale të Kosovës. Do të ketë trajtimin e dispozitave kryesore të Kushtetutës së Kosovës, Marrëveshjeve dhe Instrumentet Ndërkombëtare si detyrime ligjore për zbatuesit e ligjit në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut.

Krahasimet juridike dhe legjislative me vendet tjera janë bërë në aspekte krahasimore, në përgjithësi në aspektin teorik të disa situatave të caktuara me Shqipërinë, Gjermaninë, Slloveninë, e deri te vendi i largët Filipine, në raport me ndonjë afat të veçantë procedural, që është shumë dallues apo i njëjtë me legjislacionin tonë. Në përgjithësi mund të themi se afatet dhe çështjet që lidhen me afatet janë të ngjajshme apo edhe të njëjta.

Punimi nxjerr pohimin se dispozitat ligjore që përcaktojnë afatet kanë nevojë të qartësohen më mirë, në masë më të madhe, të ilustrohen situatat konkrete me raste praktike dhe në harmoni me qëndrimet e Institucioneve të Shtetit, Prokurorisë dhe Gjykatës, të cilat duhet të jenë identike.

Synimi i këtij punimi është që ai të mund të shfrytëzohet nga të gjithë ata që merren me drejtësinë penale, ata që preken nga drejtësia penale, që të kemi një drejtësi “të drejtë”, e cila drejtësi është e tillë vetëm nëse është në kohë.

Afatet duhen parë dhe zbatuar njësojë nga të gjithë, nga secili prizëm që shikohet dhe preket, ai duhet të reflektojë njësojë për të gjithë.

1.2. PYETJET KËRKIMORE DHE HIPOTEZA

Pyetjet kryesore që shtrohen në këtë punim janë:

- 1/. Gjatë procedures penale, a interpretohen drejtë dhe njëjtë dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me afatet?
- 2/. A ekziston një sistem i mirëfillt mbikqyrës i zbatueshmërisë së afateve?

Pyetje tjera:

- 1/. Ku qëndron problemi i moszbatimit të drejtë të afateve nga Prokuroria dhe Gjykata?
- 2/. Si duhet të veprohet që të kemi interpretim dhe zbatim të drejtë të afateve nga palët në procedurë?
- 3/. A duhet të kenë ndjekje penale prokurorët dhe gjyqtarët që ashiqare shkelin afatet?

Hipoteza është:

Në Republikën e Kosovës afatet në procedurën penale nuk zbatohen drejtë nga Prokuroria dhe Gjykata dhe mungon një sistem efikas mbikëqyrës i zbatueshmërisë.

1.3 Metodologjia

Që të arrihet caku i synuar për të trajtuar subjektin e tezës që ka të bëjë me afatet dhe zbatimin e tyre në procedurën penale janë përdorur disa metoda të punës.

Nisur nga ajo që tema fillimisht ka karakter identifikimi të afateve, pastaj interpretimin dhe analizën e tyre, është përdorur metoda dogmatike, juridike, e analizës dhe metoda e hulumtimit të rasteve të veçanta. Rastet e veçanta janë trajtuar me qëllim të analizës sa më drejtë të çështjeve të caktuara të cilat kanë nevojë për interpretim, për shkak të ndonjë paqartësi të mundshme të normës dhe zbatueshmërisë së saj.

Po ashtu, është përdorur metoda historike për të trajtuar sistemin juridik në Kosovë por edhe për të trajtuar bazën juridike ndërkombëtare dhe kushtetuese të afateve. Pasi rastet e trajtuara në punim, që kanë të bëjnë me mënyrën se si janë duke u zbatuar dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me afatet, sidomos nga zbatuesit e tij, ka sjell në detyrim që të përdoret edhe metoda statistikore. Kjo përmes paraqitjes së numrit të lëndëve të cilat si pasojë e kalimit të afateve kanë sjellë ndërmarrjen e veprimeve të ndryshme procedurale apo pengimin e ndërmarrjes së veprimeve procedurale, sidomos në rastet e parashkrimit të ndjekjeve penale, pushimeve të procedurave, ekzekutimit të dënimeve etj.

Në këtë dizertacion të doktoraturës është përdorur literaturë e larmishme, literaturë e studiuesve dhe penalistëve të ndryshëm, analizë e rasteve gjyqësore, analizë e raporteve zyrtare, udhëzimeve dhe rekomandimeve të institucioneve kredibile vendore dhe ndërkombëtare. Është shfrytëzuar interneti si burimi thelbësor në kohën e digjitalizimit botëror, si burim dhe metodë bazë e kërkim-hulumtimit.

Për shkak të natyrës së temës, metoda e intervistave apo anketës nuk është aplikuar, por janë shfrytëzuar rezultatet e intervistave dhe anketave të kryera nga organizatat e ndryshme dhe shoqëria civile që i kanë shfaqur dhe publikuar në internet dhe medie të ndryshme.

Referimet e bëra janë paraqitur në mënyrë besnike dhe sipas natyrës së temës, është vlerësuar si mënyra më e mirë e prezantimit të saj, mënyra praktike e studimit dhe orientimit të lexuesit, Stilin Çikago.

1.4 Struktura

Punimi është i shtrirë në shtatë kapituj të ndarë, e që në tërësinë e saj janë në harmoni me rrugëtimin e subjektit.

Kapitulli i parë- në formë të hyrjes do të paraqiten qëllimet kryesore të temës dhe arsyet e studimit të afateve dhe zbatimit të tyre gjatë një procesi gjyqësor penal në Republikën e Kosovës. Janë dy pyetje kryesore kërkimore dhe tre pyetje tjera ndihmëse, dhe është një hipotezë e dyzuar e cila do ta përcjell punimin për verifikim. Ky kapitull përmban edhe vetë strukturën dhe metodologjinë kërkimore e cila është shfrytëzuar në punimin e doktoraturës.

Kapitulli i dytë- përmban në vete paraqitjen historike të së drejtës në Republikën e Kosovës në periudha të ndryshme, përmban aspekte të përgjithshme juridike të afateve dhe bazën juridike të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare që kanë zbatueshmëri të drejtpërdrejt në Kosovë. Në këtë kapitull trajtohet edhe baza juridike kushtetuese e Kosovës si akti më i lartë juridik dhe trajtimi është bërë mbi bazën e respektimit të parimeve më të mira të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Në kapitullin e tretë- janë të paraqitura të drejtat elementare që kanë të bëjnë me afatet dhe zbatimin e tyre, për veprimet që prekin të drejtat elementare të njeriut, siç është afati lidhur me privim e personit nga liria, siç është arrestimi, ndalimi, masat e sigurisë, ankesat ndaj masave të sigurisë, kohëzgjatja e tyre si para ashtu edhe pas ngritjes së aktakuzës etj. Ky kapitull përmban edhe analizën juridike që lidhet me institutin e parashkrimit të ndjekjes penale, ashtu edhe të parashkrimit të ekzekutimit të sanksioneve penale.

Po ashtu, në këtë pjesë janë të sistemuara edhe afatet që lidhen me disa veprime parapenale, siç janë masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, marrja e deklaratave në procedurë paraprake, çështja e ekspertizave gjyqësore, çështja e kontrollimeve të personave dhe objekteve. Afatet dhe zbatimi i tyre gjatë fazës së hetimit penal që lidhen me kallëzimin penal, fillimin, pezullimin dhe pushimin e hetimit penal. Në këtë pjesë trajtohet edhe aktakuza në aspektin kohor si akti me të cilin një çështje penale paraqitet para gjykatës dhe mbi të cilën një çështje penale do të zgjidhet apo pret të zgjidhet. Po ashtu, trajtohet edhe çështja e pasurisë e cila është objekt i çështjes gjyqësore, ngrirja e aseteve dhe e urdhrave

ndalues të pasurisë, çështja e konfiskimit dhe sekuestrimit të pasurisë. Trajtohen afatet që lidhen me procedurën gjatë gjykimit penal, me shqyrtimin fillestar, me kërkesën për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, me afatet e fillimit të shqyrtimit kryesor, ndërprerjes, rifillimit dhe përfundimit të procesit gjyqësor. Po ashtu, veprime tjera procedurale që lidhen me procesin gjyqësor, siç janë dërgimi i ftesave, përpilimi dhe dorëzimi i procesverbaleve, shpallja dhe përpilimi i aktgjykimit. Ky kapitull përmban materien kryesore të punimit, ku trajtohen edhe çështja e afateve që lidhen me mjetet juridike që mund të ushtrohen ndaj vendimeve gjyqësore, si atyre të rregullta ashtu edhe atyre të jashtëzakonshme.

Kapitulli i katërt- trajton afatet dhe aspekte juridike që kanë të bëjnë me Kodin e Drejtësisë për të Mitur dhe afatet procedurale që lidhen me rastet penale në të cilat janë të përfshirë të miturit. Trajtohen dallimet që ka legjislacioni në mes të miturve dhe të rriturve, siç janë rastet e arrestimit, paraburgimit, procedura gjyqësore, ankimimi e deri te çështjet që lidhen me ekzekutimet e dënimeve.

Kapitulli i pestë- trajton afatet lidhur me çështjet që dalin pas përfundimit të një rasti penal të përfunduar me vendim të formës së prerë. Këtu hyjnë procedurat e rehabilitimit të të dënuarit, si përmes kompensimit të të arrestuarve apo të dënuarve pa arsye, ashtu edhe procedura e shlyerjes së dënimeve nga evidenca sipas afateve të përcaktuara ligjore.

Kapitulli i gjashtë- trajton rolin dhe ndikimin e institucioneve publike në Kosovë, po ashtu edhe të organizatave joqeveritare dhe medieve në punën e gjyqësorit. Këtu trajtohet roli i Gjykatës Kushtetuese, Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial, Avokatit të Popullit etj, të gjitha në aspekt të afateve dhe mbikëqyrjes-kontrollës institucionale të organeve zbatuese të tyre, dhe pikës orientuese të qytetarit për sigurimin e të drejtave të tyre të shkelura.

Kapitulli i shtatë- është kapitulli i fundit ku janë të përmbledhura përfundimet dhe rekomandimet kryesore që ka sjell punimi, bashkë me referimet dhe shtojcat e shfrytëzuar për punim.

Duke qenë se tema e punimit ka qenë e natyrës më shumë praktike dhe interpretuese, shfrytëzimi i materialeve dhe burimeve të literaturave është zgjedhur me kujdes të madh në drejtim të orientimit të punimit drejt gjetjes së përgjigjeve të duhura të punimit.

Pasqyrimi dhe identifikimi i pengesave në raport me afatet dhe zbatimin e tyre më së miri paraqiten me raste praktike të jurisprudencës. Për këtë arsye, pavarësisht numrit të madh të rasteve penale që mund të jenë për të njëjtat problem ligjore dhe praktike, janë shfrytëzuar vetëm disa sosh, të cilat janë vlerësuar si më shumë identifikuese dhe prezantuese.

Në këtë mënyrë, shtrimi i çështjes dhe trajtimi i saj pasqyrohet mjaftueshëm.

KAPITULLI II

2. ASPEKTE TË SË DREJTËS NË KOSOVË, BAZA LIGJORE NDËRKOMBËTARE DHE KUSHTETUESE E AFATEVE NË PROCEDURËN PENALE

2.1. ASPEKTE HISTORIKE TË SË DREJTËS NË KOSOVË

Kosova si shtet i pavarur dhe sovran edhe pse i krijuar me 17 shkurt 2008, në aspektin e zhvillimit të së drejtës penale dhe procedurale ka traditë shumë më të hershme.

Profesori i së drejtës penale Dr. Ismet Salihu, në punimet e tij ka paraqitur pasqyrën e historikut të së drejtës që nga periudhat e mëhershme, si të asaj feudale, në mes dy luftërave botërore, periudhës së Jugosllavisë në të cilën Kosova ishte Krahinë Autonome dhe deri në periudhën e Kodifikimit të Kodit Penal në vitin 2003, pas përfundimit të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në vitin 1999.

“Model nismëtar për përpilimin e kodit penal të Kosovës ka shërbyer Kodi penal i Federatës së Bosnjë e Hercegovinës. Mirëpo, gjatë punës shumëvjeçare, nga Kodi penal i Bosnjë e Hercegovinës, kryesisht ka mbetur vetëm struktura, ngase Kodi penal i Kosovës në vijim të punës u përpilua sipas koncepteve, modeleve dhe solucioneve konkrete të kodeve penale të shteteve bashkëkohore të Evropës Perëndimore, posaçërisht të Kodit penal të Gjermanisë, Zvicrës, Francës dhe Italisë...janë pranuar edhe disa institute dhe zgjidhje parimore dhe konkrete nga legjislacioni penal i Anglisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës...dhe nga kodi penal i Shqipërisë,

Kroacisë dhe Sllovenisë...nga Statuti i Tribunalit të Hagës dhe Statuti i Gjykatës së Përhershme Penale Ndërkombëtare...’’¹

Kurse sa i përket aspektit procedural, mund të themi se ka kaluar në të njëjtat sfida dhe problematika historike që ka kaluar shoqëria jonë. Ashtu si kodi penal, i ashtuquajtur Kodi i përkohshëm penal i Kosovës, në të njëjtën periudhë kohore është kodifikuar edhe kodi i procedurës penale në vitin 2003. Ky kod hyri në fuqi më 6 prill 2004 dhe ai definitivisht shkëputi vazhdimësinë e legjislacionit juridik të mëparshëm të ish federatës jugosllave sa i përket lëmisë procedurale penale.²

Sistemi i drejtësisë që aplikohet në Kosovë ka sistem të përzier, akuzator me inkuizitor. Duke qenë se Kosova ka kaluar në situata të ndryshme historike, me shumë të drejtë juristët kanë vlerësuar se këto kalime nga një sistem në sistemin tjetër nëpër rrjedhat e historisë do të shkaktojnë probleme në sistemin juridik të vendit.

Andaj, “është me rëndësi që marrëdhëniet e ndërtuara të normës së re të jenë në përputhje me principet themelore, me qëndrimet e sistemit juridiko-penal në fuqi dhe me linjën e përgjithshme politike kriminale”³.

2.1.1. Sistemi i drejtësisë nën misionin e UNMIK-ut dhe EULEX-it

2.1.1.1 Misioni i UNMIK-ut

Kosova fitoi lirinë në qershor të vitit 1999 kur u çlirua nga okupimi shekullor serb. Lufta e UÇK-së e ndihmuar edhe nga NATO-ja bëri që forcat dhe strukturat e dhunshme të instaluar deri në atë kohë në Kosovë, t’i mbledhinin plaçkat dhe të largoheshin nga Kosova njëherë e përgjithmonë.

Menjëherë në Kosovë u vendos një mision ndërkombëtar i quajtur UNMIK, që e kishte për qëllim krijimin e një administrate të përkohshme në Kosovën e dalur nga lufta. Këshilli i

¹ Më gjerësisht: Salihu, Ismet, E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2003, f.118.

² Hajdari, Azem, Procedura penale, Komentar, Prishtinë, 2010, f.23.

³ Milutinović, Milan, Politika Kriminale, Prishtinë, 1987, f.251.

Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, me 10 qershor 1999 e miratoi rezolutën 1244 dhe vendosi në Kosovë administratën ndërkombëtare, me qëllim të krijimit dhe vëzhgimit të krijimit të sistemit shtetëror në Kosovë dhe atë për të gjithë qytetarët e saj. Në këtë aspekt, rëndësi të madhe i kanë dhënë krijimit të një sistemi ligjor të mirëfillt, si ndër bazat kryesore të krijimit të mekanizmave për garantimin e strukturave të një shteti të ri të sapo dalur nga lufta që do formohej. Për këtë u ngarkua Sekretari i Përgjithshëm që përmes përfaqësuesit special të tij (PSSP), të cilit i'u dhanë kompetencat legjislative dhe ekzekutive në Kosovë për të ndërtuar institucionet.

Në këtë aspekt, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara ka obliguar sekretarin e përgjithshëm të saj që të bëjë raportime të rregullta për punën e UNMIK-ut në Kosovë.

Që nga ditët e para të raportimit, siç është raporti i datës 12 korrik 1999, i evidentuar me S/1999/799 ai i është drejtuar Këshillit të Sigurimit, duke i paraqitur një njoftim të përgjithshëm të situatës së sistemit gjyqësor në Kosovë dhe nevojës emergjente të ndërmarrjes së hapave konkret në këtë çështje.

Saktësisht në pjesën e tretë të raportit, Çështjet gjyqësore, në pikën 66 të tij fillon me *“Ekziston një nevojë urgjente për të ndërtuar sundimin e mirëfillt të ligjit në Kosovë, duke përfshirë rivendosjen e menjëhershme të një gjyqësori të pavarur, të paanshëm dhe shumëetnik”*⁴.

Në këtë aspekt, përkundër asaj nevoje të identifikuar dhe që është e domosdoshme për çdo shtet, hapat që janë ndërmarrë kanë qenë jo të efektshëm dhe jo me kohë, duke qenë shumë të ngadalshëm.

Në të njëjtin raport ceket se nga ana e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë është gjetur një gjendje jo e mirë. *“Nga 756 gjyqtarë dhe prokurorë në Kosovë, vetëm 30 kanë qenë shqiptarë”*⁵, kur kemi pasur një vend me dominim të popullësisë shqiptare.

Problemet shkaktoheshin edhe për arsye se Trupa e Armatosur e bashkësisë ndërkombëtare e quajtur KFOR bënte arrestime të shumta dhe shfaqej nevoja për të trajtuar këto çështje nga njerëzit profesionist të cilët mungonin.

⁴ Report of the Secretary-general on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo for Security Council, S/1999/779, 12 July 1999, f.13.

⁵ Po aty, f.14.

Në kuadër të kësaj problematike dhe këtij parashikimi, konfirmohet se UNMIK-u do të ketë një zyre për çështjet gjyqësore në kuadër të cilës do të mbuloheshin katër fusha kryesore të përgjegjësisë:

“administrimi i gjykatave; shërbimet e prokurorisë dhe burgjet; zhvillimin e politikave ligjore; rishikimi dhe hartimi i legjislacionit, sipas nevojës, për qëllimin dhe synimin e UNMIK-ut; dhe vlerësimi i cilësisë së drejtësisë në Kosovë, duke përfshirë kërkesat e trajnimeve”⁶.

Për ta evituar këtë gjendje të gjetur, nga ana e UNMIK-ut është filluar me emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kështu pothuaj në fillim janë emëruar 36 gjyqtarë dhe 13 prokurorë të të gjitha etniteteve dhe është krijuar një gjykatë apeli AD HOC që do të shërbente si gjykatë e lartë derisa të krijohej Gjykata Supreme.

Kështu, në qershor të vitit 1999 është hapur Gjykata e Qarkut në Prishtinë në kuadër të ashtuquajturës “sistem emergjent gjyqësor” dhe kështu u bë edhe “hapja e e gjykatave edhe në katër qytete tjera të Kosovës, e mbështetur nga gjykatat mobile”⁷. Qytetet në të cilat u hapen gjykatat ishin Prizreni, Peja, Gjilani dhe Mitrovica.

PSSP-ja brenda gjirit të saj kishte krijuar enkas një zyre për çështje ligjore që kishte për detyrë aspektet që kishin të bënin me sistemin gjyqësor kosovar në përgjithësi.

Në këtë vazhge të angazhimeve të krijimit të një sistemi gjyqësor, u arrit që në Kosovë “në fund të vitit 1999, sistemi emergjent i drejtësisë kishte 301 gjyqtarë dhe prokurorë dhe 238 gjyqtarë porotë”⁸.

UNMIK-u, duke marrë parasysh se në Kosovë në periudhat e ndryshme kohore legjislacioni ishte ndryshuar shumë, sidomos nga ana e pushtetit serb i cili kishte përpiluar

⁶ Po aty.

⁷ Hasani, Fejzullah, Konferenca ndërkombëtare e kryetarëve të gjykatave Supreme të Evropës Qendrore dhe Juglindore, Fjalimi “Reformimi i sistemit të drejtësisë në Kosovë”, Mal i Zi, qershor 2013. (http://www.gjykatasupreme-ks.org/repository/docs/23.06.13_81287.pdf, qasur me datë 15 shkurt 2015).

⁸ KCSS, Rithemelimi dhe reformimi i sistemit të drejtësisë në Kosovë 1999-2011, Analizë Kontesti, Prishtinë, 2011, f.10. http://www.qkss.org/repository/docs/RI-THEMELIMI_DHE_REFORMIMI_I_SISTEMIT_T%C3%8B_DREJT%C3%8BSIS%C3%8B_N%C3%8B_KOSOV%C3%8B_105208.pdf, qasur me datë 15 shkurt 2015.

ligje të veçanta diskriminuese ndaj etnive tjera, ai tenton të bërë krijimin e një baze ligjore për të evituar pikërisht diskriminimet e tilla.

Që në rregulloren e parë të saj, në Rregulloren 1999/1 të datës 25 qershor 1999, në nenin 3 përcakton se:

“ligjet e Kosovës të cilat kanë qenë në fuqi në territorin e saj para datës 24 mars 1999 do të vazhdojnë të zbatohen në Kosovë nëse nuk bien në kundërshtim me standartet e përmendura në nenin 2”⁹ të rregulloreve në fjalë. Ku neni 2 i kësaj rregulloreje përcakton se “të gjithë personat që marrin përsipër detyra publike ose mbajnë funksione publike në Kosovë, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre duhet t’i respektojnë standardet e pranuar ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të mos diskriminojnë asnjë person për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, bindjes politike ose bindjeve të tjera, origjinës kombëtare, etnike apo sociale, shoqërimit me një komunitet kombëtar, pasurisë, lindjes ose të një statusi tjetër”.

Pas kësaj rregulloreje, UNMIK-u në 12 dhjetor 1999 nxori rregulloren tjetër 1999/24, për ligjin në fuqi, përmes të cilës përcakton saktësisht ligjet e zbatueshme dhe zgjeron njëkohësisht burimet ligjore. Kështu që, neni 1 i kësaj rregulloreje përcakton si më poshtë se:

“1.1 Ligji në fuqi në Kosovë përfshin:

(a) Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to dhe

(b) Legjislacionin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989.

Në rast konfliktesh do të mbizotërojnë rregulloret dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to.

1.2. Në qoftë se një gjykatë e juridiksionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjislacionit, konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjislacioni i përcaktuar në paragrafin 1.1 të kësaj rregulloreje, por mbulohet nga një ligj tjetër në

⁹ Rregullorja UNMIK nr.1999/1, 25 qershor 1999.

fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues dhe është në përputhje me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, atëherë gjykata, organi ose personi, si përjashtim, e zbaton atë ligj.

1.3. Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, të gjithë personat me detyra publike ose që mbajnë pozita publike duhet të respektojnë standardet e njohura ndërkombëtare të të drejtave të njeriut siç pasqyrohen veçanërisht në:

- (a) Deklaratën universale të të drejtave të njeriut të 10 dhjetorit 1948;*
- (b) Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut të 4 nëntorit 1950 dhe Protokollet e saj;*
- (c) Marrëveshjen ndërkombëtare për të drejtat qytetare dhe politike të 16 dhjetorit 1966 dhe protokollet e saj;*
- (d) Marrëveshjen ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore të 16 dhjetorit 1966;*
- (e) Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial të 21 dhjetorit 1965;*
- (f) Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave të 17 dhjetorit 1965;*
- (g) Konventën kundër torturës dhe keqtrajtimit çnjerëzor dhe poshtërues apo degradues ose ndëshkues të 17 dhjetorit 1984;*
- (h) Konventën ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve të 20 dhjetorit 1989.*

1.4 Asnjë person, i cili ushtron detyra publike apo mban ndonjë pozitë publike në Kosovë nuk lejohet të diskriminojë ndonjë person tjetër për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, bindjes politike ose bindjeve të tjera, origjinës kombëtare, etnike apo sociale, shoqërimit me një komunitet kombëtar, pasurisë, lindjes ose të ndonjë statusi tjetër. Në procedurat penale, i pandehuri përfiton nga dispozita më e favorshme e ligjit penal në fuqi që nga data 22 mars 1989 deri në ditën e nxjerrjes së kësaj rregulloreje.

1.5 Dënimi me vdekje hiqet”.¹⁰

Në të njëjtën ditë, UNMIK-u nxjerr Rregulloren nr.1999/25 me të cilën shfuqizohet neni 3 i Rregullorës nr.1999/1, e cila e ka përcaktuar se Rregullorja nr.1999/24 e datës 12 dhjetor 1999 *“konsiderohet të ketë hyrë në fuqi më 10 qershor 1999”*¹¹.

Në raportin pasues të Sekretarit të Përgjithshëm të datës 16 shtator 1999 është paraparë se gjatë tetorit 1999 do të rishikohej dhe kompletohej legjislacioni, si ai material dhe ai procedural për tu harmonizuar me *“rregullat dhe standartet e të drejtave ndërkombëtare të njeriut, rezolutën 1244 (1999) dhe rregulloret e UNMIK-ut. Në këtë rishikim do të jenë të përfshirë edhe profesionistët ligjor të Kosovës”*¹².

Kështu, nga ana e UNMIK-ut, në periudhën kohore, prej *“qershorit 1999 dhe shtatorit 1999, PSSP ka emëruar gjithsej pesëdhjetë e pesë gjyqtarë dhe prokurorë publikë. Përbërja etnike ishte me sa vijon: 42 shqiptarë të Kosovës, 7 serbë të Kosovës, 4 myslimanë të Kosovës, 1 turk i Kosovës dhe 1 rom i Kosovës”*¹³.

Në vazhdimësi u tentua të krijohet infrastrukturë e nevojshme njerëzore në zbatimin e drejtë të ligjit dhe kryerjes së procedurave gjyqësore, me plotësimin edhe të standarteve të komuniteteve në Kosovë. *Në gusht 2000, PSSP emëroi 125 gjyqtarë të tjerë, 309 gjyqtarë porotë dhe 17 prokurorë publikë.*¹⁴

UNMIK-u pastaj me Rregulloren 1999/7 me datë 7 shtator 1999 ka rregulluar mënyrën e emërimit dhe shkarkimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Kështu që përmes konkursit publik që është bërë janë zgjedhur gjyqtarë dhe prokurorë dhe sipas planifikimeve të tyre është menduar që ai numër të arrij në 400 veta.¹⁵

¹⁰ Rregullorja UNMIK nr.1999/24, datë 12 dhjetor 1999.

¹¹ Rregullorja UNMIK nr.1999/25, datë 12 dhjetor 1999.

¹² Report of the Secretary-general on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo for Security Council , S/1999/787, 16 September 1999. (<http://www.unmikonline.org/SGReports/S-1999-779.pdf>, qasur me datë 21 mars 2013).

¹³ <http://www.osce.org/sq/kosovo/13054>, qasur me datë 25 mars 2013.

¹⁴ Po aty.

¹⁵ Më gjerësisht, shiko: Report of the Secretary-general on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo for Security Council , S/2000/177, f.24, 3 mars 2000. (<http://www.unmikonline.org/SGReports/S-2000-177.pdf>, qasur me datë 21 mars 2013).

Planifikimet e UNMIK-ut, duke u thirrur në respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe në drejtim të vendosjes së një shteti ligjor, ishte krijimi i një gjykate të krimeve të luftës dhe krimeve etnike.¹⁶

Në këtë aspekt, problemet e dukshme ndëretnike të dalura pas një lufte të armatosur dhe me shumë viktima, bashkësia ndërkombëtare nuk e ka paraparë që mund të arrihet një pajtim në mes etnive, sidomos duke marrë në vlerësim siç i thonin Eksodit të serbëve të Kosovës, duke vlerësuar se pajtim nuk do arrihet në Kosovë, *“deri sa të dyshuarit për krime të rënda, sidomos të krimeve të luftës të sillen para drejtësisë”*¹⁷.

U vendosen numër i caktuar i gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, ku deri me datë 18 shtator 2000, në gjykatat e qarkut të Kosovës ishin emëruar shtatë gjyqtarë dhe tre prokurorë, prej Finlandes, Francë, Gjermani, Poloni, Rumani, Suedi, Britani e Madhe, Irlandë e Veriut dhe Shtetet e Bashkuara.

*“Është planifikuar të kemi 12 gjyqtarë dhe 5 prokurorë ndërkombëtar”*¹⁸, kështu raporton sekretari i përgjithshëm për këshillin e sigurimit të Kombeve të Bashkuara duke u njoftuar nga përfaqësuesi special në Kosovë Bernard Kushner.

Në prill 2001, u krijuan edhe Institucionet përgjegjëse për mbarëvajtjen e gjykatave dhe prokurorive, siç është Këshilli gjyqësor dhe prokurorial i Kosovës (KGJPK), Njësia e Inspektimit Gjyqësor etj.

Por prapë se prapë, autoritetin përfundimtar lidhur me emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve nga detyra e kishte PSSP-ja.¹⁹

Rezoluta 1244 ishte e *“bazuar kryekëput në Marrëveshjen e Rambujesë, sipas së cilës ruhet sovraniteti dhe integriteti territorial i ‘Republikës Federative të Jugosllavisë’*²⁰ në bazë të së cilës u krijua edhe korniza kushtetuese e cila hyri në fuqi me 15 maj 2001.

¹⁶ Më gjerësisht shiko: Report of the Secretary-general on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo for Security Council , S/2000/538, faqe 24, 6 qershor 2000. (<http://www.unmikonline.org/SGReports/S-2000-538.pdf>, qasur me datë 21 mars 2013).

¹⁷ Po aty, f.24.

¹⁸ Më gjerësisht shiko: Report of the Secretary-general on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo for Security Council , S/2000/878, 18 shtator 2000. (<http://www.unmikonline.org/SGReports/S-2000-878.pdf>, qasur me datë 21 mars 2013).

¹⁹ Më gjerësisht shiko: KCSS, Rithemelimi dhe reformimi i sistemit të drejtësisë në Kosovë 1999-2011, Analizë Kontesti, Prishtinë, 2011. http://ëëë.qkss.org/repository/docs/RI-THEMELIMI_DHE_REFORMIMI_I_SISTEMIT_T%C3%8B_DREJT%C3%8BSIS%C3%8B_N%C3%8B_KOSOV%C3%8B_105208.pdf, qasur me datë 18 nëntor 2014).

Në këtë Kornizë Kushtetuese u parapa edhe sistemi gjyqësor, ku Pjesa e Katërt e saj, e shihte krijimin e gjykatave dhe prokurorive vendore nën autoritetin përzgjedhës të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP).

Aty është paraparë ekzistimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, pra, ishte paraparë krijimi i sistemit gjyqësor në tërësi.

Kjo kornizë kushtetuese ka pasur përparësi edhe ndaj Kuvendit, ku decidivisht thuhet se:

“në rast mospajtimi në mes kësaj Kornize Kushtetuese dhe çdo ligji të Kuvendit, përparësi ka kjo Kornizë Kushtetuese”²¹.

Në këtë kuadër, çështja e ndjeshme që kishte të bënte me minoritetet pakicë, në veçanti dhe kryesisht serbët, për të cilët “duhej” bërë inkurajim i madh që ata të bëheshin pjesë e sistemit të drejtësisë, PSSP-ja e kishte marrë për obligim që këtë çështje ta zgjidhte përmes bisedimeve me qeverinë Serbe.

Në parim ishte arritur një marrëveshje në korrik të vitit 2002 në mes të PSSP dhe Ministrit Serb të Drejtësisë, duke siguruar që autoritetet e Republikës Federale të Jugosllavisë do të inkurajonin kandidatët Serbë që të paraqesin aplikimet e tyre për shërbim në sistemin gjyqësor të Kosovës dhe se Qeveria e Serbisë do të garantonte të drejtat e pensioneve dhe sigurimeve shoqërore.²²

Kjo marrëveshje ishte planifikuar të bëhej duke anashkaluar në tërësi autoritetet shqiptare.

²⁰ Sopjani, Enver, Përmbledhje aktesh ndërkombëtare për Kosovën 1999-2004, Prishtinë, 2005, f.11.

²¹ UNMIK/REG/2001/9, 15 MAY 2001, Regulation No.2001/9 On a constitutional framework for provisional self-government in Kosovo, Chapter 14, Final Provisions, 14.1 (www.unmikonline.org/regulations/2001/reg09-01.htm, date 21 mars 2013).

²² KCSS, Rithemelimi dhe reformimi i sistemit të drejtësisë në Kosovë 1999-2011, Analizë Kontesti, Prishtinë, 2011, f.16-17; http://www.qkss.org/repository/docs/RI-THEMELIMI_DHE_REFORMIMI_I_SISTEMIT_T%C3%8B_DREJT%C3%8BSIS%C3%8B_N%C3%8B_KOSOV%C3%8B_105208.pdf, qasur me datë 18 nëntor 2014.

2.1.1.2. Misioni i UNMIK-ut pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës

Edhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, UNMIK-u në Kosovë ka vazhduar së ekzistuari dhe raportuari në mënyrë të rregullt në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës hyrë në fuqi në qershor 2008, e ka përcaktuar se shqyrtimi gjithpërfshirës që ka të bëjë me përshtatshmërinë e kandidatëve për emërim të përhershme si për gjyqtarë ashtu edhe për prokurorë në Kosovë duke e përcaktuar se *“do të vazhdojë të bëhet në pajtim me Urdhëresën Administrative 2008/2²³ dhe nuk do të ndikohet nga përfundimi i mandatit të UNMIK-ut, ose nga hyrja në fuqi e kësaj Kushtetutë”²⁴.*

Pra, edhe pse Kosova ishte e shpallur e lirë, ajo prapë se prapë dhe faktikisht në aspektin ligjor-juridik nuk ishte në tërësi e tillë.

Tani UNMIK-u, tërë dosjet që ka pasur nën hetim i ka dorëzuar tek EULEX-i ku dhe për këtë ka deklaruar se tani përgjegjësia do të kalojë tek ky institucion i ri ndërkombëtar. UNMIK-u i ka dorëzuar te EULEX-i të gjitha rastet përveç një rasti penal dhe katër rasteve civile, për shkak se gjatë këtij procesi *“transferimi do të ndikonte negativisht në të drejtat e njeriut dhe efikasitetin gjyqësor”²⁵.*

Në këtë mënyrë, tani e tutje EULEX-i do të jetë përgjegjës për të gjitha rastet, kurse rastet tjera të përfunduara nga UNMIK-u janë arkivuar në gjykatat vendore dhe transferi i tyre nga UNMIK-u në EULEX përfundoi në qershor të vitit 2009.

Edhe pas kësaj kohe, UNMIK-u luante një rol të caktuar në shkëmbimin e kërkesave të ndryshme me karakter ndërkombëtar me shtetet të cilat nuk e kishin njohur pavarësisë së Kosovës, duke bashkëpunuar me INTERPOL-in, pastaj me Tribunalin e Hagës, Mjekësinë Ligjore lidhur me personat e zhdukur dhe eskumimet e gjetjeve mortore.

²³ Udhëzimi Administrativ 2008/2 e datës 17 janar 2008, që ka të bëjë me zbatimin e rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/25 mbi kornizën rregullative për sistemin e drejtësisë në Kosovë.

²⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, neni 150, par.1.

²⁵ Më gjerësisht shiko: Report of the Secretary-general on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo for Security Council , S/2009/300, 10 qershor 2009.

Raportet e UNMIK-ut me Serbinë kanë vazhduar të jenë të mira edhe pas kësaj kohe dhe roli i saj ka qenë shumë i vogël në shkëmbim të ndërsjelltë të informatave me karakter ndërkombëtarë, të këtyre dy shteteve të pavarura.

Kështu psh. nga janari 2010 deri më datën 6 prill 2010, dmth rreth tre muaj kur është raportuar nga ana e SP të OKB-së, *“Ministria e Drejtësisë së Kosovës ka bërë më shumë se 1000 kërkesa të drejtpërdrejta për ndihmë juridike në Ministrinë e Drejtësisë së Serbisë, dhe të cilat kanë mbetur pa përgjigje”*²⁶.

Ky transferim i dosjeve dhe materialeve hetimore nga UNMIK-u tek EULEX-i është bërë në bazë të një marrëveshje të nënshkruar në mes të këtyre dy Institucioneve me datë 12 dhjetor 2008.²⁷

UNMIK-u në vazhdimësi ka raportuar në Këshillin e Sigurimit lidhur me situatën në Kosovës dhe duke përcjellur situatën edhe në aspektin e Drejtësisë. Deri me datë 25 mars 2013, bazuar në çasjen në faqen online të UNMIK-ut shihet se janë dërguar njëzet raporte të rregullta.

Në këto raportime të rregullta zënë një vend gati kryesorin edhe rastet penale ndaj personave zyrtarë, të profileve të larta. Nga ana e UNMIK-ut potencohen rastet kryesore që kanë ndodhur në periudha të ndryshme.

Ta marrim për shembull vetëm vitin 2012, ku në Këshillin e Sigurimit janë dërguar katër raporte të tilla nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e UNMIK-ut në Kosovë, vend kyç zënë rastet e arrestimeve, paraburgimeve, pushimit të hetimeve, konfirmimit të aktakuzave lidhur me rastet e korrupsionit dhe të krimit të organizuar.

Kështu, në raportin e 14 shkurtit, S/2013/72, përmendet rasti kur prokurori i EULEX-it i Zyrës së Prokurorisë Speciale të Kosovës ka ngritur akuzë kundër anëtarit të parlamentit të Kosovës Fatmir Limaj dhe gjashtë persona tjerë në cilësi të bashkëpunëtorëve të tij për vepra penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

²⁶ Më gjerësisht shiko: Report of the Secretary-general on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo for Security Council , S/2010/169, 6 prill 2009.

²⁷ Më gjerësisht shiko: Report of the Secretary-general on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo for Security Council , S/2009/149, 17 mars 2009.

Po në këtë raport, përmendet edhe konfirmimi i aktakuzës kundër katër personave, ndër ta edhe dy ish ministrave të Kulturës, Astrit Haraqija dhe Valton Beqiri. Të dytë të akuzuar për shpërdorim të detyrës zyrtare apo autorizimit, akuzë e bërë nga ana e prokurorit vendor. Pastaj, është raportuar se për vepër të njëjtë penale akuzohet edhe ish Sekretari i Përhershëm i Ministrisë së Shëndetësisë Ilir Tolaj, ndaj të cilit me datë 28 dhjetor nga ana e gjyqtarit të EULEX-it të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë është refuzuar ndërprerja e paraburgimit. Kundër Ilir Tolat gjykimi ka filluar me 10 janar 2013.²⁸

Në këto raporte, të cilat padyshim se ndikojnë në masë të madhe në shtetet anëtare të Këshillit të Sigurimit, e kështu në të ardhmen e Kosovës në njohje dhe anëtarësim në këto mekanizma, raportimet e tilla ku paraqiten njerëzit kyç të shtetit të Kosovës të zhytur në krim, krijojnë përceptim negativ të saj.

Është paraqitje e keqe kur Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës është arrestuar lidhur me vepër penale të korrupsionit dhe krimit financiar dhe pastaj edhe ndaj Drejtorit të Doganave është konfirmuar aktakuza për disa vepra të korrupsionit.²⁹

Rasti i Guvernatorit pastaj ka rezultuar se ka qenë pa prova materiale dhe i njëjti është shpallur i pafajshëm nga gjyqtarë të EULEX-it në dhjetor 2011 dhe që është konfirmuar në janar 2012.³⁰

Njëjtë është edhe rasti i Drejtorit të Doganave që është shpallur i pafajshëm në maj 2012.³¹

Por, padyshim që raportimet e tilla nga ana e UNMIK-ut kanë ndikuar negativisht në arenën ndërkombëtare.

Pastaj kontrollimet në Ministrinë e Shëndetësisë për vepra korruptive dhe arrestimi i zyrtarëve të saj në vendet e punës, ndër ta edhe Sekretarit të Përhershëm Ilir Tolaj, gjykimi kundër Minsitrit për Komunitete dhe Kthim Slavisha Petković, akuza kundër ish ministrit të Shëndetësisë Bujar Bukoshi, Telekomunikacionit Fatmir Limaj, të Kulturës Astrit Haraqija dhe Valton Beqiri, gjyqtarëve e avokatëve, arrestimi për korrupsion i vetë udhëheqësit të Shefit të Task Forcës Antikorrupsion Nazmi Mustafi, të krijuar enkas për

²⁸ Më gjerësisht shiko: Report of the Secretary-general on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo for Security Council , S/2013/72, 4 shkurt 2013.

²⁹ Më gjerësisht shiko: Report of the Secretary-general on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo for Security Council , S/2010/562, 29 tetor 2010.

³⁰ <https://kallxo.com/gjnk/hashim-rexhepi-i-lire/>, qasur me datë 14 janar 2012.

³¹ <https://kallxo.com/gjnk/huruglica-e-rafuna-te-pafajshem/>, qasur me datë 17 maj 2012.

luftimin e korrupsionit etj, pra udhëheqësve kryesorë të Institucioneve të Kosovës, medomos tek bota e qytetëruar do të ketë jehonë shumë negative dhe do të paraqitet nevoja e madhe që Misioni i EULEX-it është shumë i nevojshëm që të jetë akoma në Kosovë, për ta përkrahur, monitoruar dhe trajnuar stafin vendor pikërisht në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, e sidomos lidhur me konfiskimin e pasurisë së rrjedhur dhe fituar me vepër penale.³²

Andaj edhe në këto momente, nëse shikohet tani në faqen zyrtare të UNMIK-ut në internet, pikërisht në faqen e zbatimit të ligjit del se UNMIK-u krahas EULEX-it në Kosovë, vepron. Ai në fillim pas pavarësisë, përveç detyrës që ka pasur në fillim të ndihmoj-lehtësoj rrugën misionit të ri EULEX në Kosovë i cili u vendos në dhjetor 2008, tani ka riformuar komponentët e saj përkatëse në Zyrën ndërlidhëse të sundimit të ligjit (RoLLO) dhe zyrën e këshilltarit të lartë të Policisë.

Në këtë pikë, *“RoLLO monitoron aktivitetet në fushën e sundimit të ligjit dhe vazhdon të përmbush funksione të caktuara të domosdoshme që as EULEX-i e as Institucionet e Kosovës nuk janë në gjendje t’i ushtrojnë”*³³.

2.1.1.2. Misioni i EULEX-it

EULEX Kosova ka filluar në vitin 2008 si misioni civil më i madh në kuadër të Politikës së Përbashkët të Bashkimit Evropian për Siguri dhe Mbrojtje.³⁴

Këshilli i Sigurimit fillimisht e kishte përcaktuar që ky mision të kishte mandat fillestar prej dymbëdhjetë (12) muaj, i vazhdueshëm edhe më tutje, vetëm nëse *Këshilli i Sigurimit vendos ndryshe*³⁵.

³² Më gjerësisht shiko: Report of the Secretary-general on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo for Security Council , S/2012/72 datë 31 janar 2012, S/2012/275 datë 27 prill 2012, S/2012/603 datë 3 gusht 2012, S/2013/72 datë 4 shkurt 2013.

³³ Më gjerësisht shiko: <http://www.unmikonline.org/Pages/rollo.aspx>, qasur me datë 20 shkurt 2015.

³⁴ <https://www.eulex-kosovo.eu/?page=1,60>, qasur me datë 21 dhjetor 2016.

³⁵ COUNCIL JOINT ACTION 2008/124/CFSP of 4 February 2008 on the European Union Rule of Law Mission in Kosovo, EULEX KOSOVO, Official Journal of the European Union, Bruksel, 2008, (1). https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/WEJointActionEULEX_EN.pdf, qasur me datë 13 shkurt 2010.

Misioni i EULEX-it në Kosovë është përcaktuar në Planin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP datë 4 shkurt 2008 për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX Kosova, në nenin 2.

Në kuadër të detyrave të tjera, që kishin të bënin me asistimin në ngritjen dhe forcimin e institucioneve të vendit, ishte edhe detyra e saj në forcimin dhe zbatimin e ligjit. Deklarata e misionit shprehet në këtë mënyrë:

EULEX KOSOVA do të ndihmojë institucionet e Kosovës, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë tjera të zbatimit të ligjit në progresin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies dhe më tej zhvillimin dhe forcimin e një sistemi të drejtësisë, policisë dhe shërbimit doganorë multietnikë, të pavarur dhe duke siguruar që këto institucione të jenë të lira nga ndërhyrjet politike dhe t'i përmbahen standardeve të njohura ndërkombëtarisht dhe praktikave të mira evropiane për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX KOSOVË.³⁶

Këtë mandat që kishte deri në këtë kohë, pas dhjetë viteve, nga qershori 2018 EULEX ka bërë reduktimin e kompetencave dhe angazhimeve të tij. Deri në këtë kohë EULEX merrej edhe me hetimin e gjykimin e rasteve penale dhe kishte detyra të gjëra ekzekutive, pra, ishte i pajisur edhe me fuqi ekzekutive³⁷.

Pas kësaj kohe, përmes Vendimit të Këshillit (CFSP) 2018/856 datë 8 qershor 2018, me të cilin është ndryshuar Plani i Përbashkët 2008/124/CFSP dhe është përcaktuar se misioni do të ketë mandat përfundimtar deri në datën 14 qershor 2020.³⁸

Përveç mbështetjes që bëjnë në fushat e caktuara, EULEX akoma bënë menaxhimin e programit të tij për mbrojtjen e dëshmitarëve³⁹ dhe ndihmon Dhomat e Specializuara në

³⁶ COUNCIL JOINT ACTION 2008/124/CFSP of 4 February 2008 on the European Union Rule of Law Mission in Kosovo, EULEX KOSOVO, Official Journal of the European Union, Bruksel, 2008, n.2.

³⁷ Sopjani, Enver, Roli politiko-ushtarak dhe policor i bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë nga viti 1999, A ka "dështuar me sukses" bashkësia ndërkombëtare?, Prishtinë, 2011, f.191.

³⁸ Më gjerësisht: COUNCIL DECISION (CFSP) 2018/856 of 8 June 2018 amending Joint Action 2008/124/CFSP on the European Union Rule of Law Mission in Kosovo (EULEX KOSOVO), Official Journal of the European Union, Bruksel, 2008.

³⁹ <https://www.eulex-kosovo.eu/?page=1,16>, qasur me datë 13 shkurt 2018.

Hagë lidhur me krimet që lidhen me luftën e fundit, duke ndihmuar Prokurorinë e Specializuar për këto lëndë.

Raste penale nga qershori 2018 nga ana e EULEX nuk trajtohen, vetëm se monitorohen ato të cilat kanë qenë në trajtim derisa janë dorëzuar te gjyqtarët vendorë dhe ndonjë rast tjetër të veçantë që vlerësohet si kriter për rrugëtimin e Kosovës drejt Evropës.⁴⁰

⁴⁰ <https://www.eulex-kosovo.eu/?page=1,16>, qasur me datë 13 shkurt 2018.

22. ASPEKTE JURIDIKE LIDHUR ME AFATET

Çdo gjë në jetë është e kufizuar në kohë.

Juristët, në rastin tonë ata penalistë që merren me zbatimin e procedurës penale e kanë të qartë që veprimet procedurale lidhen me faktorin kohë. Me atë që veprimi i caktuar mund të merret, duhet të filloj, duhet të përfundoj apo e kundërta, nuk mund të merret para apo pas afatit të caktuar, nuk duhet të filloj para apo pas afatit, nuk mund të përfundoj para apo pas afatit.

Sa është e rëndësishme ekzistimi i afateve dhe se kush është më së shumti përgjegjës për moszbatim të afateve, i referohemi dispozitave të caktuara ligjore dhe se kush janë ata që kanë për detyrim zbatimin e tyre.

Zbatimi i afateve në procese gjyqësore ka të bëjë me atë se a kemi të bëjmë me vonesa apo jo. Në rast se *“vonesat janë të dukshme, i atribuohen Shtetit dhe janë të shmangshme, mund të cenojnë të drejtën e palëve për një gjykim të drejtë, duke përfshirë edhe të drejtën për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm”*.⁴¹

Kjo është edhe arsyeja që ligjvënësi e ka vënë detyrimin që ka gjykata ndër të tjera ta bëjë edhe trajtimin e asaj që *“çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor”*.⁴²

Kodi i ri i procedurës penale përcakton afate të qarta lidhur me procedurat, pjesërisht për shkak të nevojës për më shumë qartësi dhe pjesërisht për shkak se neni 6 i KEDNJ-së përcakton që procedura penale duhet të përfundohet brenda një afati të arsyeshëm kohor.⁴³ Afat në kuptimin procedural është koha (intervali) brenda të cilit duhet të ndërmerret një veprim procedural.⁴⁴

⁴¹ Drejt drejtësisë, *Analizë e procesit civil në gjykatat e rretheve gjyqësore*, OSCE, Shqipëri, 2013, f.8.

⁴² Ligji nr.03/L-199 për Gjykatat i Kosovës, Prishtinë, 2010, n.7, p.2.

⁴³ Smibert, Jon, Udhëzues për Kodin e Procedurës Penale të Kosovës dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Departamenti I Drejtësisë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Zyra e Zhvillimit dhe Trajnimit të Prokurorëve Tejoqeanik, Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë, 2013, f.26..

⁴⁴ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep, E drejta e Procedurës Penale, Prishtinë, 2016, f. 176.

Pra, janë pika të paracaktuara në kohë me të cilat pika duhet përfundojë veprimi i caktuar⁴⁵, gjegjësisht në të cilën është e ndaluar të ndërmerret aktiviteti konkret procedural, sepse ai mund të ndërmerret vetëm pas kalimit të afatit.⁴⁶

Qëllimi i përcaktueshmërisë së afateve është që e drejta e cila synohet të arrihet-realizohet në procedurë penale të kryhet në kohë sa më të shkurtër të mundshme dhe në atë mënyrë të garantohen të drejtave e personave në proces, si atyre ndaj të cilëve zhvillohet procedura, ashtu edhe në mundësinë e realizimit të të drejtave të të dëmtuarve.

Është detyrë e organeve që zhvillojnë procedurë penale që të kujdesen që veprimet e ndërmarra në përputhshmëri me afatet e përcaktuara të mos rrezikojnë në asnjë mënyrë interesat e personave të pandehur...ekonomizimi procedural nuk guxon të reflektohet në dëm të konstatimit të të vërtetës materiale.⁴⁷

Shpesh herë mosrespektimi i afateve sjell pasoja të mëdha edhe në rezultatin përfundimtar të çështjeve penale, e shpesh edhe vjen deri te dështimi i çështjes dhe triumfit të drejtësisë. Në këto raste, çështja juridike mund të jetë e peshës së vogël, por më se shumti është në rastet më të rënda.

Një ndër sfidat e hulumtimit e të zbulimit të krimeve të luftës është edhe rrethana se me kalimin e kohës gjurmët e krimeve zbehen, madje edhe zhduken.⁴⁸

Në procedurën penale ekzistojnë dy ndarje të afateve procedurale. Të parat janë të ashtuquajtura afatet ligjore që janë të përcaktuara saktë nga ana e ligjvënësit dhe të dytat janë afatet e caktuara nga organi që zhvillon procedurën në bazë të autorizimeve të tyre, nevojës dhe natyrës së çështjes, afatet gjyqësore.

Afatet prekluzive⁴⁹ janë pikërisht afatet ligjore të përcaktuara brenda të cilave mund të kryhen veprimet e caktuara dhe ato veprime janë të lidhura drejtpërdrejt me afate.

⁴⁵ Galbraith, Jean, "Deadlines as Behavior in Diplomacy and International Law" (2015). *Faculty Scholarship. Paper 1560*. F.2.

⁴⁶ Sijerçiq-Çolliq, Hajrija & Halilović, Haris, E drejta e procedurës penale, me vështrim të posaçëm në procedurën penale të Kosovës, /Prishtinë, 2007, f.92. <https://aab-edu.net/uploads/docs/librat/E%20Drejta%20e%20Procedures%20Penale-%20Prof.%20dr.%20sc.%20Hajrija%20Sijer%C3%A7iq%20%E2%80%93%20%C3%87olliq-%20Mr.%20sc.%20Haris%20Halilović.pdf>, qasur me datë 29 mars 2016.

⁴⁷ Hajdari, Azem, E drejta e Procedurës Penale, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2014, f. 65.

⁴⁸ Instituti për hulumtimin e krimeve të luftës, "Sfidat e hulumtimit të krimeve të luftës në Kosovë 1998-1999, përmbledhje e punimeve të konferencës ndërkombëtare Prishtinë 16 dhjetor 2011, Prishtinë, 2013, f.96.

Ligjvënësi ka përcaktuar detyrime që duhet të ndërmarrin palët në proces, ashtu edhe organi që udhëheq procesin që lidhen drejtpërdrejtë me afatin.

Afati ka të bëjë me kalimin e kohës⁵⁰ së caktuar, e brenda asaj kohe të caktuar e cila ka kaluar, veprimi i ndërmarrë apo mosveprimi që është dasht të ndërmerret, dikton krijimin apo shuarjen e ndonjë të drejtë.

Në gjuhën juridike njihet edhe afati paritiv, që më shumë përdoret në procedurën civile, e ka të bëjë me afatin e përmbushjes vullnetare të detyrimit. Në procedurën penale, afatet e përcaktuara me vendim gjyqësor për dorëzimin e sendit të marrë në posedim apo afati i pagesës së gjobës etj, përmbushja vullnetare e atij detyrimi llogaritet se është bërë brenda afatit paritiv.

Në literaturë njihen edhe disa ndarje tjera të afateve, siç janë afatet prekluzive të cekura më lartë, *“joprekluzive, afate të rrepta dhe të thjeshta”*⁵¹.

Derisa afatet prekluzive janë të atilla që nuk mund të zgjaten, mund të quhet edhe afate të rrepta, afatet joprekluzive janë ato afate të cilat mund të zgjaten.⁵²

Në këtë mënyrë, *me lëshimin e tyre humbet e drejta për aktivitetin e caktuar procedural*⁵³.

Pra, pasojat mund të jenë të ndryshme për palët në procedurë dhe personat tjerë të involvuar në forma të ndryshme.

Afatet e caktuara janë paraparë sipas situatave të ndryshme procedurale dhe atë prej 6, 24 dhe 48 orësh; 3, 8, 15 ditë; 1, 2, 3, 5 e 6 muaj dhe 1, 2 ose 3 vjet, kështu që afatet llogariten në orë, ditë, muaj dhe vite.⁵⁴

⁴⁹Ligji nr.8116 i Kodit të Procedurës Civile I Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1996, n.145.

⁵⁰ Lidhur me termin kohë kanë shkruar autorë të ndryshëm, ndër ta: Hoxha, Dorina, Koha dhe e Drejta Penale, *Disertacioni i Doktoraturës*, Tiranë, 2003. <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2013/08/Dorina-Hoxha.pdf>, qasur me datë 11 shkurt 2013.

⁵¹ Hajdari, Azem, Procedura Penale, Komentar, Prishtinë, 2010, faqe 194.

⁵² Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep, E drejta e Procedurës Penale, Prishtinë, 2016, f. 176.

⁵³ Sijerçiq-Çoliq, Hajrija & Halilović, Haris, E drejta e procedurës penale, me vështrim të posaçëm në procedurën penale të Kosovës, /Prishtinë, 2007, f.92.

⁵⁴ Susuri, Besim, Mosrespektimi i afateve dhe efikasiteti i procedurës penale, *Justica, Revistë shkencore, Viti III, nr3-2011*, Prishtinë, 2011, f.21.

23. INSTRUMENTET NDËRKOMBËTARE QË LIDHEN ME PËRCAKTIMIN DHE ZBATIMIN E AFATEVE

Afatet dhe zbatimi i tyre duke qenë çështje që lidhet drejtpërdrejt me të drejtat e njeriut, atëherë është e domosdoshme që të flasim edhe për këto të drejta në rrafshin ndërkombëtar, duke kaluar rrafshin kombëtar.

Puna për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individit në nivelin ndërkombëtar, ka filluar në shekullin e nëntëmbëdhjetë, kur filloi të konsiderohej si e kundërligjshme robëria si dhe kur filloi puna për të përmirësuar gjendjen e të sëmurëve dhe të plagosurve gjatë kohës së luftës.⁵⁵

Në këtë çasje, shtetet e para që kanë proklamuar drejtësinë kanë krijuar edhe Gjykata të veçanta që kanë pasur të bëjnë pikërisht me ndarjen e drejtësisë në raport me shkeljen e të drejtave të njeriut, e që rastet më të shpeshta kanë të bëjnë me afatet, si në rastet kur janë tejkaluar afatet e caktuara apo edhe atëherë kur nuk janë zbatuar fare.

Kur flasim për Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut në Strasburg, duhet kupruar se jurisdikcioni i saj është i detyrueshëm dhe si i tillë pranohet nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, por edhe nga shtetet që nuk janë akoma pjesë e Evropës, siç është edhe Kosova. Kjo gjykatë është edhe instrumenti kryesor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ku në rastet e ushtrimit të ankesave në këtë gjykatë, përveç se mund të kemi situata që kërkojnë zgjidhje për rastet e afateve nga shtetet anëtare edhe vetë ankesa e tillë duhet të ushtrohet brenda afatit të caktuar ligjor, e që ky afat është gjashtë muaj pas shfrytëzimit të mjeteve juridike brenda shtetit të caktuar.

Duhet shterruar të gjitha mjetet e brendshme, pastaj t'i drejtohet Gjykatës Evropiane brenda afatit gjashtë muaj.⁵⁶

⁵⁵ Të drejtat e njeriut në administrimin e drejtësisë, Një doracak mbi të drejtat e njeriut për gjykatësit, prokurorët dhe avokatët/Human rights in administration of justice: A manual on human rights for Judges, Prosecutors and Lawyers, Prishtinë, 2002, f.2-3.

⁵⁶ Më gjerësisht: Kuptimi i të drejtave të njeriut, Doracak mbi arsimimin për të drejtat e njeriut, Qendra Evropiane e Trajnimit dhe Hulumtimit për të Drejtat e Njeriut dhe Demokraci, Grac, 2003, f.50.

Duke qenë se të drejtat dhe liritë e njeriut në Kosovë garantohen edhe me kushtetutë, ajo ka përcaktuar se marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare ⁵⁷ janë të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës.

Zbatueshmëria e tyre shkon deri në atë nivel sa që në rast të dilemave-konflikteve ligjore ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve Publike të Kosovës ato të kenë përparësi.

Kjo çështje ka të bëjë me vlerësimin e të mirës dhe të duhurës, *“vlera këto që duhet të respektohen jo pse Kosova është e interesuar të integrohet në BE, por për arsye se janë esenciale për zhvillimin demokratik të një shoqërie me një mirëqenie sociale”*⁵⁸.

Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës janë të listuar disa marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare të cilat zbatohen në Kosovë, saktësisht në nenin 22:

- “(1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;*
- (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;*
- (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;*
- (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;*
- (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;*
- (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;*
- (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;*
- (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.”*

⁵⁷ Më gjerësisht: Qerimi, Qerimi & Istrefi, Remzije & Sylejmani, Flakron, *Përmbledhje e marrëveshjeve dhe instrumenteve ligjore ndërkombëtare*, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH dhe Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK), Prishtinë, 2016.

⁵⁸ Zahiti, Bashkim I., *E drejta Evropiane*, Bot.III, Prishtinë, 2013, f. 207.

Për këtë arsye, është e nevojshme që së paku në mënyrë përshkruese të paraqiten afatet që kanë të bëjnë me procesin gjyqësor në këto marrëveshje dhe institucione ndërkombëtare. Në këtë punim do të paraqiten vetëm ato marrëveshje dhe institucione të cilat ndërlidhen me afatet në proceset gjyqësore.

2.3.1. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ) 1948⁵⁹, në tërë përmbajtjen e saj nuk përmend askund në mënyrë të drejtëpërdrejtë ndonjë afat ligjor që ka të bëjë me gjykimin. Por ajo kuptohet në mënyrë të tërthortë, pikërisht për atë se njëra prej të drejtave themelore të njeriut e përcaktuar edhe në këtë deklaratë, është edhe e drejta për gjykim të drejtë.⁶⁰

Gjykimi i drejtë në vete ndërthen edhe përcaktueshmërinë e afateve për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara dhe respektimin e tyre.

Vetëm në këtë mënyrë mund të themi se kemi të bëjmë me gjykim të drejtë.

Mund të themi se të gjitha kushtetutat e botës⁶¹, që janë të orientuara nga demokracia kanë inkorporuar dispozitat e DUDNJ-së.

⁵⁹ Brown, Gordon (Ed.), *The Universal Declaration of Human Rights in the 21st Century: A Living Document in a Changing World*. Cambridge, UK: Open Book Publishers, 2016. <http://dx.doi.org/10.11647/OBP.0091>, f.1.

⁶⁰ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Gjenevë, 1948, n.10. <http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/AUniversalDeclarationHumanRightsfinal.pdf>, qasur me datë 20 mars 2015.

⁶¹ Si rast ilustrativ kemi Indonezinë, andaj Shiqo: Faiz, Mohamad, Pan, *The Protection of Civil And Political Rights by The Constitutional Court of Indonesia*, Indonesia Law Review, 2016, f.176.

2.3.2. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollat e saj

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollat e saj (KEMDLTHNJP) e përcakton se:

“Çdo person i arrestuar duhet të informohet brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë që ai e kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me çdo akuzë që i bëhet”⁶².

Është detyrim që çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të nenit 5, duhet të dërgohet menjëherë përpara një gjykatësi.⁶³

I arrestuari ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm derisa qëndron në arrest apo i njëjti duhet të lirohet në gjykim e sipër.

Konventa parasheh në detaje mënyrën se si duhet të veprohet me personat e privuar nga liria, personat e arrestuar.

Në paragrafin 3 të nenit 6, ndër të tjera është përcaktuar se personi i arrestuar:

“a) të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij; b) t’i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;”⁶⁴

Sipas Konventës, çdo person i arrestuar ka të drejtë të ankohet, të ushtrojë ankesë në gjykatën kompetente dhe gjykata duhet të vendosë në afat sa më të shkurtër për

⁶² Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollat e saj, 1950, neni 5, par.2. http://www.pp.gov.al/web/ekstra29_2008_789.pdf, qasur me datë 20 mars 2015.

⁶³ Po ashtu: Darpö, Jan, *Principle 10 and Access to Justice*, Elgar Encyclopedia of Environmental Law – Principles of Environmental Law, Volume VI., Uppsala, Sæden, 2017, f.9.

⁶⁴ Fletorja zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Botimi i Qendrës së Publikimeve, *Akte të papublikuara të vitit 1996*, Tiranë, 2008, f.5. (http://www.pp.gov.al/web/ekstra28_2008_788.pdf, qasur me datë 17 mars 2015).

ligjshmërinë e privimit nga liria. Gjykata Evropiane⁶⁵ në raport me të drejtën në liri dhe siguri, neni 5 par.1 dhe 6 par.4, trumbeton që gjykatat nacionale duhet të jenë të prira që prezumimi i pafajësisë të dominoj krahas prezumimit të të qenit në liri.

Ajo deklaron se:

“në rastet kur pritet një vendim, kërkohet një vendim i shpejtë që përcakton ligjshmërinë e paraburgimit, pasi i pandehuri duhet të përfitojë plotësisht nga parimi i prezumimit të pafajësisë. Gjykata kritikoi kohën e tepërt të marrë nga gjykatat për shqyrtimin e kërkesës për lirim si dhe vonesat e shkaktuara nga gjykatat më të ulëta”⁶⁶.

Nëse vlerësohet se arrestimi-burgimi është i kundërligjshëm, nga ana e gjykatës ai duhet të lirohet menjëherë me urdhër gjyqësor. Kjo sepse gjykata është ajo që e vlerëson ligjshmërinë dhe ndanë drejtësinë.

Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në nenin 6, Gjykimi i drejtë, siguron të drejtën e njeriut për një gjykim të drejtë dhe atë në kohë të arsyeshme.

Koncepti i gjykimit të drejtë dhe të paanshëm përbëhet nga shumë elemente. Esenca e kësaj të drejtë qëndron në drejtësi, paanshmëri, e hapur ndaj publikut, në kohë të arsyeshme, nga gjykatë e pavarur dhe e paanshme e ngritur sipas ligjit.

Pra, këtë dispozitë e kemi të inkorporuar në kushtetutën tonë, afati i arsyeshëm dhe kjo dispozitë ligjore gjenë zbatim në punën e gjykatave kushtetuese të çdo vendi, por edhe të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.

KEMDLTHNJP përcakton edhe detyrimet shtesë që dalin në raport me afatet ligjore që kanë të bëjnë me rastin kur akuzohet personi i caktuar.

⁶⁵ Shiko për gjykatën: Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Ministria e Drejtësisë, Prishtinë, 2015, f.810-818.

⁶⁶ The AIRE, The case law of the European Court of human rights with respect to Albania up until the end of 2015/Qendra AIRE, Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me Shqipërinë deri në fund të 2015, Faqe 8; <https://sudovi.me/podaci/vrhs/dokumenta/2578.pdf>, qasur me datë 11 maj 2016.

Kjo ka të bëjë me të drejtën në informim në afat sa më të shkurtër për natyrën e akuzës, për shkakun e akuzës.

Po ashtu, këtu kemi të bëjmë edhe me dhënien e afatit-kohës së mjaftueshme apo të përshtatshme të akuzuarit për ta bërë përgatitjen e mbrojtjes së tij.⁶⁷

2.3.3. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj (KNDCPP), në shtete të ndryshme quhet edhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.⁶⁸ Në nenin 9 përcakton se çdo person i arrestuar *menjëherë* në momentin e arrestimit duhet të informohet për arsyet e arrestimit.

Po ashtu, afati *menjëherë* vlen edhe për njoftimin me akuzën e ngritur kundër personit të caktuar.

Në mënyrë të njëjtë janë edhe afatet që kanë të bëjnë me paraqitjen e të arrestuarit para gjykatësit apo siç thuhet edhe para “*ndonjë zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për ushtrimin e funksioneve gjyqësore*”⁶⁹ afati i arsyeshëm.

Kjo konventë, lidhur me gjykimin e çështjes e përcakton afatin ligjor brenda të cilit duhet të zhvillohet procedura, e ajo brenda afatit *të arsyeshëm* nëse është personi i arrestuar apo mundësia që i njëjti të lirohet në liri derisa të gjykohej.

KNDCPP e deklaron mundësinë që ndaj vendimeve lidhur me vendosjen nën arrestim të personave, është e garantuar e drejta e tyre që të ankohen ndaj atyre vendimeve për privim nga liria.

⁶⁷ Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, 1950, neni 5, par.3, a), b) (http://www.pp.gov.al/web/ekstra29_2008_789.pdf, qasur me datë 20 mars 2015.

⁶⁸ Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj, 1976, (<http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/ACovenantCivilPoliticalRights.pdf>, qasur me datë 20 mars 2015.

⁶⁹ Të drejtat e njeriut dhe zbatuesit e ligjit, Broshurë mbi të drejtat e njeriut për Policinë, OSCE, F.12. <http://www.kosovopolic.com/repository/docs/drejtat.pdf>.

Afati lidhur me trajtimin e ankesës nga ana e gjykatës kompetente është i përcaktuar përmes shprehjes “*pa vonesë*”.⁷⁰

2.3.4. Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare

Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (KKKEMPK), është parashikuar e domosdoshme që të inkorporohet në Kushtetutën tonë, për shkak se në Kosovë çështja e pakicave kombëtare ka qenë delikate. Evropa e kishte parë shumë mirë se çka kishte ndodhur në Republikën Serbe pas nënshkrimit të marrëveshjes së Dejtonit me datë 18 shkurt 1996, ku aty ishin shkelur të gjitha të drejtat e njeriut, duke mos pasur proces të rregullt gjyqësor, përfshirë qasjen në avokat gjatë fazës së hetimit, e sidomos arrestimet mbi baza etnike.⁷¹

Kjo delikatesë ka qenë sidomos në periudhën e parë të pasluftës 1999, e në rastin e shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, Kosova është dashtë të dëshmojë se ajo është e përkushtuar në ruajtjen e të drejtave njeriut, e në veçanti të drejtave të pakicave.

KKKEMPK krahas të drejtave që ju takojnë të gjithë personave, e të cilat ju takojnë edhe pakicave, në veçanti e ka parë të nevojshme që të gjithë të:

*“angazhohen të garantojnë të drejtën e çdo personi që i përket një pakice kombëtare për t’u informuar menjëherë, në një gjuhë që ai/ajo e kupton, mbi arsyet e arrestimit të tij/saj, dhe për natyrën dhe shkakun e çdo akuze kundër tij/saj, dhe për të mbrojtur veten e tij/saj në këtë gjuhë”*⁷²

⁷⁰ Po aty, par.9.

⁷¹ Fionnuala N. Aolain, *The Fractured Soul of the Dayton Peace Agreement: A Legal Analysis*, 19 Mich. J. Int’l L. 957 (1998), f.998.

⁷² Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, 1993, n.10,p.3. <http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/AConventionAlbanian.pdf>, qasur me datë 21 mars 2015.

Republika e Kosovës ka nxjerr edhe ligj të veçantë për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Kështu, LMPDKPRK-ja ripotencon se e drejtë elementare e pakicave që nga momenti i arrestimit është që *menjëherë* të njoftohen për arsyet e arrestimit në gjuhën e tyre. Pra, afati për njoftim është menjëherë.⁷³

2.3.5. Konventa për të Drejtat e Fëmijës

Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF)⁷⁴, në nenin 37 të saj lidhur me arrestimin, ndalimin dhe burgimin e fëmijëve ka sanksionuar se një gjë e tillë, duhet të bëhet në afat sa më të shkurtër.

Lidhur me ankesën ndaj masave të tilla ndaj fëmijëve, arrestimi, ndalimi apo burgimi, është përcaktuar që gjykata duhet të veprojë me urgjencë.

Për këtë KDF-ja, të privuarit nga liria i jepet e “*drejta të sfidojë vendimin për heqjen e lirisë përpara një gjykate ose një autoriteti tjetër kompetent, të pavarur dhe të paanshëm si dhe për një vendim të shpejtë për çdo rast të tillë*”⁷⁵.

Në nenin 40 të KDF-së janë të përcaktuara afatet që kanë të bëjnë me të drejtat tjera gjyqësore.

Fëmiu menjëherë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë duhet të njoftohet për akuzat e ngritura kundër tij.

Çështja e tij gjyqësore duhet të trajtohet pa vonesë nga ana e gjykatave, duke pasur prioritet integriteti dhe dinjteti i fëmiut që është subjekt procedural.

⁷³ Ligji nr.03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, 2008, neni 4, par.4.4.

⁷⁴ Kombet e Bashkuara në vitin 1989 ishte miratuar njëzëri nga shtetet anëtare, përveç dy shteteve SHBA dhe Somalia. Më gjerësisht: Gadda, Andressa, *Rights, Foucault and power: A critical analysis of the United Nation Convention on the Rights of the Child*, Edinburgh Working Papers in Sociology No. 31, University of Edinburgh, January 2008, f.2.

⁷⁵ Konventa për të Drejtat e Fëmijës, 1990, neni 37 (d).

24. PËRCAKTUESHMËRIA E AFATEVE DHE ZBATIMI I TYRE SIPAS KUSHTETUTËS SË KOSOVËS

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në vete ka inkorporuar parimet⁷⁶ më të mira që kanë të bëjnë drejt respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Në dispozitat themelore të saj është përcaktuar se qëllimi i Republikës së Kosovës është që të qeveriset në mënyrë demokratike dhe demokracia në vete ngërthen edhe respektimin e plotë të ligjit përmes punës së pavarur dhe të drejtë të institucioneve të veta legislative, ekzekutive dhe gjyqësore.

KRK-ja në nenin 3 par. 2 të saj flet për parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe për të drejtat që janë të pranura ndërkombëtarisht.

Për një proces të drejtë ligjor, KRK-ja i jep rëndësi afateve dhe respektimin e tyre, se pa respektim të tyre nuk do të kemi respektim të të drejtave dhe lirive të njeriut.

KRK, në nenin 31 par.2 detyron që:

“Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm. ”.

Të gjitha kushtetutat e botës⁷⁷ demokratike kanë pritjet e tyre për të pasur një sistem të aftillë që mos të stërzgjatën proceset dhe barra i bie shtetit për këtë.⁷⁸

⁷⁶ William's, Paul R, Procesi i hartimit të Kushtetutës, *Prezantim në Tryeza e rrumbullakët e parlamentarëve dhe ekspertëve për çështjet kushtetuese*, Public International Law & Policy Group, Prishtinë, 2006, f.34.

⁷⁷ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1998, ndryshuar 2007 dhe 2008, neni 42, par.2.

⁷⁸ “Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë të tillë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme.” (*shiko*: Vendimi nr.76 i Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, date 4.12.2017, <http://qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202017/Fletore%202020/VENDIM%20I%20GJK%20nr.%2076,%20date%204.12.2017.pdf>, qasur me datë 15.01.2018.

2.4.1. Afatet lidhur me privimin e personit nga liria

2.4.1.1 Njoftimi për arsyet e privimit nga liria dhe të drejtat tjera

Neni 29 i KRK-së, e Drejta e Lirisë⁷⁹ dhe Sigurisë, përcakton detyrimin se kur personi privohet nga liria, ai duhet që menjëherë të njoftohet për arsyet e privimit.

Afati kohor është i përcaktuar me “*menjëherë*” dhe në këtë mënyrë nuk është është në pyetje ora, dita, por është momenti i privimit nga liria.

Këtu mund të kuptojmë edhe momentin para privimit nga liria, konkretisht momenti kur vendoset të privohet nga liria.

Në të njëjtën mënyrë është i përcaktuar edhe afati që ka të bëjë me të drejtën e të njoftuarit për të drejtat tjera të të arrestuarit, të drejta që i garanton ligji. Edhe në këtë rast afati kohor është “*menjëherë*” dhe këto afate vlejnë edhe për të akuzuarit, siç është përcaktuar në nenin 30.

2.4.2. Nxjerrja e aktvendimit mbi ndalimin e personit të arrestuar

KRK-ja detyron zbatuesit e ligjit, në këtë rast prokurorinë edhe pse nuk përmendet decidivisht, që në afat sa më të shkurtër⁸⁰, por neni 29 par.2 e ka përcaktuar “*sa më shpejtë që të jetë e mundshme*” të nxjerrin njoftimin me shkrim lidhur me privimin nga liria.

Në këtë rast njoftimi me shkrim është vetë Aktvendimi mbi ndalimin e personit të arrestuar. Siç do të flasim më poshtë, Kodi i Procedurës Penale e ka përcaktuar afatin kohor prej gjashtë (6) orë për nxjerrje të aktvendimit me shkrim dhe dorëzim te personi i privuar nga liria-arrestuar.

⁷⁹Macovei, Monica, E drejta për lirinë dhe sigurinë e personit, *Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Manuallet e të drejtave të njeriut, Nr.5*, Strasburg, 2002, F.9.

⁸⁰Më gjerësisht: Macovei, Monica, E drejta për lirinë dhe sigurinë e personit, *Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Manuallet e të drejtave të njeriut, Nr.5*, Strasburg, 2002.

Kjo do të thotë që ligjvënësit afatin kushtetues “sa më shpejtë që të jetë e mundshme” në kodin e procedurës penale e barabartë me gjashtë (6) orë.

Për këtë arsye, është përcaktuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut se një "arrestim" ose "ndalim" për të qenë i ligjshëm “duhet të përcaktohet në dritën jo vetëm të ligjit të brendshëm, por edhe të tekstit të Konventës, parimet e përgjithshme të mishëruara në të dhe qëllimi i kufizimeve të lejuara nga Neni 5 § 1”⁸¹.

2.4.3. Vendosja gjyqësore lidhur me privimin nga liria

Neni 5 “1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, përveçse në rastet e mëposhtme dhe në përputhje me procedurat e parashikuara me ligj: (...)”⁸²

Personat e privuar nga liria, në rastet kur ato privime bëhen pa urdhra-leje paraprake të gjykatës, siç janë arrestimet në flagrancë, arrestimet gjatë zhvillimit të hetimeve të veprave penale etj. personat e tillë duhet të dërgohen para gjykatës.

Dërgimi i tyre para gjykatës kompetente bëhet me qëllim që për ato arrestime të vendoset nga gjykata e cila e ka rolin e arbitrit të paanshëm dhe të pavarur⁸³.

Gjykata duhet të vendos për këtë çështje brenda afatit kohor i cili nuk mundet të kalojë më shumë se dyzet e tetë (48) orë nga momenti kur personi i cili është arrestuar është sjellë para gjykatës, konkretisht dyzet e tetë (48) orë nga momenti kur përfundon seanca dëgjimore për të vlerësuar ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e kërkesës së prokurorisë për caktimin a jo të masës së sigurisë.

⁸¹ Robert KERR against the United Kingdom, The European Court of Human Rights (Third Section), Application no. 40451/98, sitting on 7 December 1999.

⁸² Udhëzues rreth nenit 5 të Konventës, e Drejta për lirinë dhe për sigurinë personale, Këshilli i Evropës, 2014, f.5.

⁸³ Gjykatat e Republikës së Shqipërisë, *Ekzistenca e Gjykatave, Faqja zyrtare*: <http://www.gjykata.gov.al/sistemi-i-drejt%C3%ABsis%C3%AB/p%C3%ABrgjegj%C3%ABsit%C3%AB-e-gjykat%C3%ABs/ekzistenca-e-gjykatave/>, qasur me datë 15 janar 2019.

Gjykata është i vetmi organ që duhet të vendos se personi i privuar nga liria të mbahet edhe më tutje i tillë apo duhet të lihet i lirë. Një periudhë ndalimi konsiderohet në parim si “e rregullt” në qoftë se bazohet në një vendim gjyqësor.⁸⁴

Çështja lidhur me përkufizimin e asaj se çfarë periudhe kohore duhet të jetë “*menjëherë*” për ta paraqitur të arrestuarin para gjykatë për të vendosur, kemi qëndrime të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Qëndrimet janë të atilla që termi “*menjëherë*”, sipas jurisprudencës së Komitetit për të Drejtat e Njeriut duhet “*të përcaktohet në secilin rast veç e veç*” dhe periudha prej arrestimit të një akuzuari dhe kohës kur ai sillet para një autoriteti gjyqësor “*nuk duhet t’i kalojë disa ditë...në mungesë të një arsytimi për një shtyrje për katër ditë para sjelljes së autorit pranë një autoriteti juridik*”⁸⁵. Në këtë mënyrë, në raste të tilla kemi të bëjmë me shkelje të të drejtave të njeriut.

Rasti *Delijorgji kundër Shqipërisë*, vendimi datë 25 prill 2015, për shkelje të dispozitave të nenit 5.4 të Konventës, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka mbajtur qëndrimin se:

*“në rastet kur pritet një vendim, kërkohet një vendim i shpejtë që përcakton ligjshmërinë e paraburgimit, pasi i pandehuri duhet të përfitojë plotësisht nga parimi i prezumimit të pafajësisë. Gjykata kritikoi kohën e tepërt të marrë nga gjykatat për shqyrtimin e kërkesës për lirim si dhe vonesat e shkaktuara nga gjykatat më të ulëta, të cilat kishin dështuar në zbatimin e vendimit të Gjykatës së Lartë në këtë drejtim”*⁸⁶

⁸⁴ Udhëzues rreth nenit 5 të Konventës, e Drejta për lirinë dhe për sigurinë personale, Këshilli i Evropës, 2014, f.10.

⁸⁵ Të drejtat e njeriut në administrimin e drejtësisë, Një doracak mbi të drejtat e njeriut për gjykatësit, Prokurorët dhe Avokatët, Human Rights in Administration of Justice: A manual on human rights for Judges, Prosecutors and Lawyers, Prishtinë, 2002, f.186.

⁸⁶ *Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me Shqipërinë deri në fund të 2015-es*; Përgatitur nga Qendra AIRE në bashkëpunim me zyrën e Agjentit Qeveritar të Shqipërisë para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; AIRE Centre, (Advice on Individual Rights in Europe). <http://sudovi.me/podaci/vrhs/dokumenta/2578.pdf>; qasur me datë 15 qershor 2016.

2.4.4. Afati për përfundimin e çështjes nga gjykatat

Kushtetuta lidhur me afatin kohor për fillimin dhe përfundimin e procesit gjyqësor e ka lënë të hapur, në atë mënyrë që përpiluesit e ligjit të përcaktojnë ato, sipas rrethanave të ligjshme.

Afat për fillimin e gjykimit Kushtetuta e ka përcaktuar me terminologjinë “*një afati të arsyeshëm*” dhe atë që secili qytetar gëzon të drejtën për një gjykim të drejtë në afat të arsyeshëm. Ky përcaktim kushtetues është vënë me nenin 31. Frazën “*një afati të arsyeshëm*” e kanë inkorporuar edhe kushtetutat tjera nacionale⁸⁷, e që i referohen nenit 6 të Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut⁸⁸.

Andaj, çështja e vonesave dhe trajtimit të lëndëve në gjykata edhe nga ana e gjykatës Kushtetuese është shpesh temë trajtimi në bazë të ankesave të palëve të interesit. Gjykimi që bënë gjykata Kushtetuese për rastet kur konstatohet se ka pasur tejkalim të afateve ligjore, zvarritje të procedurës, krijon një situatë paradoksale pasi që gjykata në një mënyrë kufizohet vetëm në konstatimin e shkeljes, pasi nuk mund të urdhëroj rigjykim ose të shfuqizoj atë vendim, pasi në këtë situatë do të kishim një vonesë të sërishme të të gjithë procesit.⁸⁹

Nuk mjafton vetëm të përmendet koha e arsyeshme⁹⁰, por duhet edhe të zbatohet në praktikë. E drejta për gjykim të shpejtë, dmth brenda një kohë të arsyeshme.⁹¹

Lidhur me afatet që lidhen me procesin gjyqësor do të flitet në vijim të këtij punimi, në mënyrë detaje, ashtu siç është e rregulluar në Kodin e Procedurës Penale.

⁸⁷ Shiko: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 42, pika 2.

⁸⁸ Më gjerësisht: Raporti i Veçantë, Për situatën e krijuar nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, Republika e Shqipërisë, Avokati i Popullit, pa vend dhe vit botimi. https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti_i_vecante.pdf, qasur me datë 31 maj 2019.

⁸⁹ Gruda Përparim, E drejta për një process të rregullt ligjor në Kushtutën e Kosovës, Revistë Shkencore JURIDICA, Prishtinë, 2015, f.52.

⁹⁰ European judicial systems Efficiency and quality of justice, CEPEJ Studies N°20, Edition 2014 (2012 Data), Council of Europe, f.189.

⁹¹ Protecting witnesses of serious crime, Council of Europe, September 2006, f.15.

2.5. PËRFUNDIME:

I. Disa përfundime që lidhen me aspektet historike të së drejtës në Kosovë:

- ✚ Model nismëtar për përpilimin e kodit penal të Kosovës ka shërbyer Kodi penal i Federatës së Bosnjë e Hercegovinës, ku pastaj ka mbetur vetëm struktura e tij, ngase në vijim u përpilua sipas koncepteve, modeleve dhe solucioneve të kodeve penale të shteteve bashkëkohore të Evropës Perëndimore, Kodit penal të Gjermanisë, Zvicrës, Francës, Italisë, disa institute dhe zgjidhje parimore dhe konkrete nga legjislacioni penal i Anglisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i Shqipërisë, Kroacisë, Sllovenisë, nga Statuti i Tribunalit të Hagës dhe Statuti i Gjykatës së Përhershme Penale Ndërkombëtare.
- ✚ Sistemi i dretësisë që aplikohet në Kosovë ka sistem të përzier, akuzator me inkuizitor.
- ✚ Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, me 10 qershor 1999 e miratoi rezolutën 1244 dhe vendosi në Kosovë administratën ndërkombëtare ndër më kryesorja krijimi i një sistemi ligjor të mirëfillt.
- ✚ Rregullorja e parë e UNMIK nr.1999/1 datë 25 qershor 1999 e ka përcaktuar se ligjet e Kosovës të cilat kanë qenë në fuqi në territorin e saj para datës 24 mars 1999 do të vazhdojnë të zbatohen në Kosovë nëse nuk bien në kundërshtim me standartet ndërkombëtare.
- ✚ Në qershor të vitit 1999 është hapur Gjykata e Qarkut në Prishtinë në kuadër të ashtuquajtures “sistem emergjent gjyqësor”, pastaj Prizreni, Peja, Gjlani dhe Mitrovica e mbështetur nga gjykatat mobile.
- ✚ EULEX Kosova ka filluar në vitin 2008 si misioni civil më i madh në kuadër të Politikës së Përbashkët të Bashkimit Evropian për Siguri dhe Mbrojtje dhe do të ndihmojë institucionet e Kosovës, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë tjera të zbatimit të ligjit në progresin e tyre.
- ✚ Përveç mbështetjes që bënë në fushat e caktuara, EULEX akoma bënë menaxhimin e programit të tij për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe ndihmon Dhomat e

Specializuara në Hagë lidhur me krimet që lidhen me luftën e fundit, duke ndihmuar Prokurorinë e Specializuar për këto lëndë. Nga qershori 2018 nga ana e EULEX raste penale nuk trajtohen, vetëm monitorohen ato të cilat kanë qenë në trajtim derisa janë dorëzuar te gjyqtarët vendorë dhe ndonjë raste tjetër të veçantë që vlerësohet si kriter për rrugëtimin e Kosovës drejt Evropës.

II. Disa përfundime të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare:

- ✚ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, në tërë përmbajtjen e saj nuk përmend askund në mënyrë të drejtëpërdrejt ndonjë afat ligjor që ka të bëjë me gjykimin, por ajo kuptohet nga përcaktimi i nenit 10 - ***Secili ka të drejtë plotësisht të barabartë për gjykim të drejtë.***
- ✚ Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokolet e saj, neni 5, par.2 –

Çdo person i arrestuar duhet të informohet brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë që ai e kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me çdo akuzë që i bëhet.

Nenin 6- siguron të drejtën e njeriut për një gjykim të drejtë dhe atë në kohë të arsyeshme dhe kjo dispozitë është inkorporuar në kushtetutën tonë, ***afati i arsyeshëm***. Kjo dispozitë ligjore gjenë zbatim në punën e gjykatave papranueshese të çdo vendi, por edhe të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.

- ✚ Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokolet e saj në nenin 9 përcakton se çdo person i arrestuar ***menjëherë*** në momentin e arrestimit duhet të informohet për arsyet e arrestimit, akuzën, dërgimin para organit të caktuar dhe ankesat duhet të trajtohen ***pa vonesë***.
- ✚ Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, neeni 10- ***garantojnë të drejtën e çdo personi që i përket një pakice kombëtare për t'u informuar menjëherë, në një gjuhë që ai/ajo e kupton, mbi arsyet e arrestimit të tij/saj dhe për natyrën dhe shkakun e çdo akuze kundër tij/saj dhe për të mbrojtur veten e tij/saj në këtë gjuhë...***

Konventa për të Drejtat e Fëmijës, neni 37- arrestimi, ndalimi dhe burgimi i fëmijëve duhet të bëhet në afat sa më të shkurtër dhe çdo herë duhet të kemi *vendim të shpejtë për çdo rast të tillë*.

III. Nga trajtimi teorik i afateve kohore që kanë të bëjnë me aspekte procedurale gjyqësore në proceset penale, të cilat janë përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, do paraqes disa nga përfundimet më kryesore:

✚ Neni 3, p.2 i KK: *Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm...*

✚ Neni 24 - përcakton se të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe se gëzojnë të drejten e mbrojtjes së barabartë ligjore.

✚ Neni 29 - përcakton detyrimin se, kur personi privohet nga liria ai duhet **menjëherë** të njoftohet për arsyet e privimit.

✚ Neni 29, p.2 - përcakton:

Sa më shpejtë që të jetë e mundur të nxirret vendimi me shkrim mbi ndalimin e personit të privuar nga liria.

Çdokush që privohet nga liria pa urdhër të gjykatës, brenda dyzet e tetë (48) orësh duhet të dërgohet përpara gjyqtarit, i cili vendos për paraburgimin ose lirimin e tij/saj, jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë nga momenti kur personi i privuar është sjellë para gjykatës.

✚ Neni 31 - Çështja gjyqësore duhet të fillojë dhe të përfundojë brenda *një afati të arsyeshëm*.

KAPITULLI III

3. AFATET DHE ZBATIMI I TYRE SIPAS KODIT TË PROCEDURËS PENALE TË KOSOVËS

3.1. AFATET LIDHUR ME PRIVIMIN E PERSONAVE NGALIRIA

Duke qenë se privimi i personave nga liria është shumë i shpeshtë dhe ndodh çdo ditë për vepra të ndryshme penale, ligjvënësit kanë përcaktuar disa kritere, kushte, sadopak që mund të jenë minimale, ato janë të detyrueshme për tu plotësuar para se të ndodh privimi i personit nga liria.

E drejta në liri nuk është e drejtë absolute⁹² dhe kjo për shkak se kjo e drejtë vihet në diskutim kur është në pyetje interesi i përgjithshëm.

Në sistemet ligjore demokratike, privimi nga liria në mënyrë tipike është masë parandaluese për të siguruar që drejtësia të mos pengohet nga ata që mund të jenë subjekt, palë në procedurë.⁹³

Kodi i procedurës penale i Kosovës i ka mëshiruar kërkesat e tilla në nenin 192, por fatkeqësisht zbatuesit janë ata që i shpërfillin ato kërkesa.

Kjo padyshim sjell atë që, krahas këtij veprimi procedural është e shpeshtë edhe shkelja e të drejtave tjera të tyre.

Shkeljet e kryera nga organet e ndjekjes përveç bazës ligjore, ndodhin edhe për shkak të shkeljes së afateve. E aq më tepër, këto veprime lidhur me afatet nga ana e gjykatave shpesh kalojnë pa u ndaluar, në përgjithësi jo për shkak të interpretimit të ngushtë të dispozitave ligjore por me qëllim të drejtpërdrejt të tyre.

⁹² Më gjerësisht: <https://www.coe.int/sq/web/echr-toolkit/le-droit-a-la-liberte-et-a-la-surete>, qasur me datë 11 nëntor 2018.

⁹³ Macken, Claire, Preventive detention and the right of personal liberty and security under the International Covenant on Civil and Political Rights, 1966, Adelaide Law Review, School of Law, The University of Adelaide, SA, 2005, f.2.

Kjo për shkak se mosnjohja e ligjit nuk do të thotë se kemi përjashtim nga përgjegjësia penale⁹⁴ apo si e përcakton Kodi ynë penal në nenin 26 par.3 kur flet për lajthimin juridik. Në një formë, parimi ligjor, maksimat latine “*ignorantia iuris nocet*”⁹⁵, “*ignorantia legis neminem excusat*”⁹⁶ apo “*ignorantia juris non excusat*”⁹⁷ sido që ta quajmë ka synimin kryesor që prezumon faktin që secili duhet ta njoh ligjin, e sidomos ata që janë të thirrur të zbatojnë ligjin nuk janë të amnistuar në asnjë formë nga përgjegjësia penale, përkundrazi. Është me rëndësi të ceket edhe parimi i detyrueshëm ligjor i përcaktuar pikërisht në nenin 161 të KPPK-së:

“e drejta e të pandehurit për liri dhe siguri përcakton prezumimin në favor të qëndrimit në liri; privimi nga liria sipas këtij kapitulli urdhërohet nga gjykata vetëm nëse prokurori i shtetit paraqet prova nga ky kapitull që mbipeshojnë prezumimin nga nën-paragrafi 1.1. të këtij paragrafi”.

3.1.1. Arrestimi

E drejtë ekskluzive për të arrestuar personin është e policisë⁹⁸, përveç rasteve të përcaktuara⁹⁹ që kanë të bëjnë me arrestimin në flagrancë nga neni 162 i KPPK-së. Arrestimi si veprim i cili kryhet në momentin e privimit nga liria të personit të caktuar, ngërthen në vete momentin kur personi është privuar nga liria e lëvizjes së lirë. Situata *in*

⁹⁴ Ligji Nr.7895 i Kodit Penal të Republikës Së Shqipërisë, Tiranë, 1995, n.4.

⁹⁵ Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Ministria e Drejtësisë, Prishtinë, 2015, f.87.

⁹⁶ Grabowski, Andrzej, Juristic Concept of the Validity of Statutory Law: A Critique of Contemporary Legal Nonpositivism, *Springer Science & Business Media*, London, 2013, f.531.

⁹⁷ Imbrisevic, Miroslav, Why is (Claiming) ignorance of the law no excuse?, Why is (Claiming) Ignorance of the Law no Excuse? *Review Journal of Political Philosophy* 8, 2010.

<https://philpapers.org/archive/IMBWIC.pdf>, qasur me datë 12 shtator 2017.

⁹⁸ Ligji nr.04/L-076 për Policinë, Prishtinë, 2012, n.18, n.20.

⁹⁹ <https://www.justice.gc.ca/eng/rp-pr/other-autre/wyntk.html>, qasur me datë 24 shtator 2017.

flagranti ekziston kur një person është parë nga policia ose dikush tjetër në momentin e ndërmarrjes së veprimeve me të cilat kryhet vepra penale.¹⁰⁰

Arrestimi është momenti kur personi i caktuar është privuar nga mundësia e të vepruar lirisht. Momenti kur atij i thuhet se nuk mund të largohet nga vendi i caktuar, se ai duhet të pret derisa organi shtetëror të vendos më tutje. Arrestimi mund të bëhet edhe në flagrancë dhe në atë moment, menjëherë është e pamundur që në mënyrë automatike t'i lëshohet ndonjë vendimi i shkruar mbi arrestin.

Pra, flagrancia ka të bëjë me arrestimin në momentin kur dikush është zënë është duke kryer një vepër penale dhe ka raste në praktikë që flagrancën gabimisht e kanë vlerësuar edhe si masë sigurie.¹⁰¹

Rast ilustrativ mund të jetë momenti kur në ora 10:00, nga një hapësirë e caktuar shoqërohen në polici një numër i madh njerëzish për marrjen e informatave për ndonjë rast penal, për të cilin ata mund të dinë apo ta kenë kryer. Shoqërimi i personave në polici mund të bëhet me prangosje apo me duar të lira, varësisht prej rrethanave. Gjatë kohës sa ata qëndrojnë në polici dhe nga ata merren informata të rëndësishme për çështjen, mund të vlerësohet se të gjithë duhet të lirohen në shtëpi përveç dy personave. Në ora 14:00 lirohen të gjithë përveç dy personave ndaj të cilët do të vendoset që të ndalohen.

Nuk ka ndonjë formë zyrtare që do të plotësohet vetëm për arrestimin e personit sepse, në raste të tilla do të pasojë ndalimi, me atë që arrestimi dhe ndalimi në fakt “*motivohet me shkakun ligjor për paraburgim*”¹⁰².

Forma që i lëshohet personit të privuar nga liria është forma për ndalimin e personit të arrestuar dhe nuk ka ndonjë formë tjetër. Ashtu që edhe nëse personi është privuar nga liria, por nuk është ndaluar, atij nuk i lëshohet ndonjë vendim i shkruar.

¹⁰⁰ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, Kodi i procedurës penale i Republikës së Kosovës, Komentar, Bot.I, Prishtinë, 2014, f.441.

¹⁰¹ “Vendimi nr. 489, datë 12.12.2000 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë Kolegji i tërheq vëmendjen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës, e cila e ka konsideruar arrestimin në flagrancë si masë sigurimi. Një masë e tillë sigurimi nuk njihet nga Kodit të Procedurës Penale, por arrestimi në flagrancë është veprim me iniciativë i organit procedues që konfirmohet i ligjshëm ose jo nga gjykata.”- http://www.ligjet.com/kodi_proc_penale/pjesa_i/titulli_v/kreu_iii/neni_251, qasur me datë 23 prill 2015.

¹⁰² Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep, E drejta e Procedurës Penale, Prishtinë, 2013, f.199.

Derisa paraburgimi paraqet kufizimin e lirisë në bazë të vendimit gjyqësor të mbështetur në shkakun ligjor (kufizim faktik dhe juridik), arresti dhe, parimisht, ndalimi paraqesin kufizim faktik të lirisë, që motivohet gjithashtu nga shkakun ligjor për paraburgim, por arresti dhe ndalimi për kohë më pak se gjashtë orë, për personin e autorizuar nuk imponojnë marrje të aktvendimit formal për kufizim të tillë të lirisë.¹⁰³

3.1.2. Ndalimi

Çështja e ndalimit në praktikë shpesh ka keqkuptime në raport me atë se ndalimi a ka të bëjë me veprimin që ndodh pas arrestimit apo me veprimin që i prin arrestimit. Kjo shpesh has dilema edhe në mes të juristëve. Edhe pse ligjvënësi e ka përcaktuar se menjëherë pas arrestimit, e jo më vonë se gjashtë (6) orë, prokurori i shtetit është i detyruar të nxjerr Aktvendimin mbi ndalimin e personit të arrestuar. Po ashtu, e ka përcaktuar se ai vendim duhet t'i dorëzohet personalisht personit të arrestuar për ta nënshkruar.

Edhe pse kodi ynë procedural nuk e ka përcaktuar taksativisht se një kopje të vendimit duhet dhënë menjëherë të ndaluarit¹⁰⁴, ajo ndodh në praktikë, sepse ekziston edhe e drejta në ankesë për ndalimin e personit të arrestuar.

Në vendim, ndër të tjera paraqitet saktë koha e arrestimit¹⁰⁵. Koha e arrestimit që shënohet në Aktvendim duhet të llogaritet koha kur është privuar personi nga liria, e jo koha kur është vendos që personi të ndalohej.

Edhe pse ndalimi është e drejtë ekskluzive e prokurorisë, ku vendimi për ndalim lëshohet nga prokurori, ndodh jo rrallë që ankesat për ndalim i adresohen policisë.

¹⁰³ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.65.

¹⁰⁴ RAPORT mbi situatën e të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria në komisariatet e policisë së shtetit, në institucionet e paraburgimit dhe të ekzekutimit të vendimeve penale dhe në spitalet psikiatrike, Monitorimet janë realizuar gjatë periudhës Korrik 2015 – Janar 2016, Komiteti shqiptar i Helsinkit, Pa vend dhe vit botimi, f.35 (<http://www.ahc.org.al/wp-content/uploads/2016/12/raport-te-drejtat-e-njeriut.pdf>, qasur me datë 23 maj 2017).

¹⁰⁵ Si 104, f.445.

Kështu, Raporti i Avokatit të Popullit të Republikës së Shqipërisë ka konstatuar se gjatë vitit 2012 ka pasur shtim të dhunës fizike dhe psikologjike nga punonjësit e Policisë së Shtetit.¹⁰⁶

Nëse personi i cili është arrestuar/privuar nga liria në ora 10:00, e për të cilin arrestim prokuroria në ora 14:00 merr vendimin që ta mbajë të ndaluar të arrestuarin, në aktvendim duhet të shënohet ora 10:00 si kohë e saktë e arrestimit e jo ora 14:00.

Në praktikë shpesh ndodh që nuk shënohet saktë momenti i arrestimit, por shënohet momenti kur merret vendimi mbi ndalimin.¹⁰⁷

Pasi t'i jepet në dorëzim aktvendimi mbi ndalimin, personi i ndaluar ka të drejtë që të ankohet ndaj atij vendimi dhe atë në afatin ligjor brenda 24 orëve, te gjyqtari i procedurës paraprake.

Meqenëse i ndaluari është privuar nga liria, prokurori i shtetit duhet të sigurojë që ankesa e paraqitur realisht t'i jetë dorëzuar gjyqtarit të procedurës paraprake i cili duhet të vendosë për ankesë.¹⁰⁸

A shfrytëzohet kjo e drejtë në praktikë? Mund të themi se janë raste shumë të rralla sepse brenda të njëjtit afat që dërgohet ankesa te gjykata nga ana e të ndaluarit, dërgohet po ashtu edhe kërkesa e prokurorisë për caktim të masës së sigurimit. Edhe pse shumë rrallë ushtrohet kjo e drejtë, përgjigjet janë refuzuese nga ana e gjykatës.

Nëse prokuroria vlerëson se personi i arrestuar duhet të mbahet i privuar nga liria edhe më tutje, ajo duhet të bëjë kërkesë të veçantë të cilën duhet ta dërgojë në gjykatë për të kërkuar

¹⁰⁶ Doracaj, Bledar, Vështrim i përgjithshëm në mekanizmin kundër torturës dhe trendi i tij në vitet e fundit, *The Heritage*, Revistë Shkencore, Universiteti Ndërkombëtar i Strugës, Nr.11/2013, Strugë, 2013, f.287.

¹⁰⁷ Zakonisht kjo është metodë për të cilën e përdorin policia, jo rrallë me rekomandim të prokurorisë, për shkak të krijimit të rrethanave të përshtatshme për procedimin e mëtejshëm të rastit para gjykatës. Sepse, në rast se kemi të bëjmë me privim nga liria në ora 05:00 e mëngjesit, atëherë prokuroria është e lidhur dhe e kushtëzuar me afatin ligjor 24 orësh për të paraqitur kërkesën me shkrim në gjykatë për masën e sigurisë që kërkon ajo. Andaj, nëse në aktvendim do të shënohej ora më vonë, psh, të shënohet ora 08:00 e mëngjesit, do të jetë më e përshtatshme për prokurorinë që të dorëzojë kërkesën e saj në orar të rregull të punës dhe të fitojë kohë më shumë. Por, tani në praktikë, prokuroria dhe gjykata kanë "gjetur" një mënyrë të re komunikimi në mes tyre, duke dërguar kërkesën përmes e-mailit në adresën e gjyqtarit edhe pas orës 01:00 e natës dhe me këtë veprim ata pretendojnë se kanë respektuar afatin ligjor. Kjo mënyrë komunikimi në mes prokurorisë dhe gjykatës, nuk vlen edhe për të pandehurin dhe mbrojtësin, e që në këtë rast Gjykata është duke luajtur rolin jo të një organi autonom dhe të pavarur, por përkrahës i akuzës. Rast i tillë është: PPRKR.nr.134/2019 i datës 21.05.2019, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimëve të Rënda.

¹⁰⁸ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.445.

masën e caktuar të sigurisë. Ky detyrim ligjor është i përcaktuar edhe me Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, hyrë në fuqi 1976, neni 9:

*“Çdo person i arrestuar ose i ndaluar për shkak të një veprë penale duhet të nxirret, pa vonesë, përpara një gjykatësi ose ndonjë zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për ushtrimin e funksioneve gjyqësore dhe duhet të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet. Ndalimi i personave të cilët presin të gjykoen nuk duhet të jetë rregull i përgjithshëm, por lirimi mund të kushtëzohet me garanci për të siguruar daljen e të interesuarit para gjyqit, në cilëndo fazë tjetër të procedurës gjyqësore, dhe po qe se paraqitet nevoja, edhe për ekzekutimin e gjykit”*¹⁰⁹.

Aktvendimi mbi ndalimin e personit të arrestuar ka fuqi, vlenë, zgjatë, jo më më shumë se dyzet e tetë (48) orë nga momenti i arrestimit.

I gjithë ky proces lidhur me vendosjen e asaj se a duhet liru apo i duhet vazhduar arresti personit duhet të përfundojë në afatin kohor prej dyzetë e tetë (48) orëve prej momentit të arrestimit. Në këtë mënyrë e ka përcaktuar Kodi i procedurës penale të Kosovës në nenin 164 çështjen e ndalimit të personit të arrestuar.

Përndryshe, pasi kemi të bëjmë me situatën që lidhet me afatin për paraqitjen e personit të arrestuar para gjykatës brenda njëzet e katër (24) orëve dhe afatin për vendosjen brenda njëzet e katër (24) orëve prej momentit të paraqitjes para gjykatës, juristët këtë situatë e quajnë si *paraburgim provizor për të cilin konsiderojmë se duhet të krijohet baza juridike për vazhdim të kufizimit të lirisë me një aktvendim i përkohshëm i cili do të kishte efekt deri te nxjerrja e aktvendimit për paraburgim*¹¹⁰.

¹⁰⁹<http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/ACovenantCivilPoliticalRights.pdf>, qasur me datë 4 shkurt 2015.

¹¹⁰ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.446.




Figura 1: Paraqitja e afateve lidhur me ndalimin e personit të arrestuar.

3.1.3. Aplikimi i masave të sigurisë

Prokuroria, pasi ka bërë ndalimin e personit të arrestuar dhe pasi ka vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat e përcaktuara në dispozitat e nenit 161 të KPPK-së dhe pasi vlerëson se personi duhet të vazhdojë të qëndrojë i privuar nga liria, ai bënë kërkesë për caktim të masës së sigurimit.

Për rrjedhojë, personi që i nënshtrohet një urdhri të tillë duhet të dëgjohet, të gëzojë cilësinë e të akuzuarit dhe duhet t'i bëhen të ditura motivet e kërkesës së masës së arrestit.¹¹¹

¹¹¹Skenderaj, Klodian & Hoxha, Artan, Perspektivat e legjislacionit procedural penal shqiptar në kuadrin e integritetit në Bashkimin Europian, Revista Shkencore “Politikja”, nr.1, SHQIPËRIA DHE EVROPA NË NJË KËNDVËSHTRIM POLITIK, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Tiranë, Pa vit botimi, f.130. <http://fshs-ut.edu.al/wp-content/uploads/2015/02/Politikja-1-Revista.pdf#page=121>, qasur me datë 11 shtator 2017.

Duke qenë se prokuroria vlerëson faktin se nëse i arrestuari i ndaluar qëndron në liri mund të pengojë zhvillimin e papengesë të procesit apo faktin se ai mund të mos jetë i pranishëm në proces, atëherë ajo duhet të bëjë kërkesë për caktimin e masës së caktuar të sigurimit.

Në asnjë mënyrë “*paraburgimi nuk mund të jetë obligativ dhe as i karakterit punitiv (ndëshkues)*”¹¹².

Pra, nuk mund të merret si një tregues i fajit dhe sa është shkalla e tij.¹¹³

Për këto arsye çështja e masave të sigurisë përmes paqartësive që shfaqen në rastin e aplikimit të tyre ndrehin shqetësime të mëdha për një shtet i cili sundohet nga ligji.¹¹⁴

Kërkesa për caktimin e masës së caktuar të sigurisë ushtrohet brenda afatit ligjor njëzetë e katër (24) orë nga momenti i arrestimit të personit.

Brenda kësaj kohë prej njëzetë e katër (24) orë kërkesa duhet të jetë dorëzuar në gjykatën të e cila kërkon aprovimin e kërkesës për masë. Këtë e përcakton paragrafi 7 i nenit 164 të KPPK-së.

Lidhur me këtë kërkesë të prokurorisë do të vendoset nga gjyqtari i procedurës paraprake në seancë dëgjimore. Seanca dëgjimore duhet të mbahet brenda afatit prej dyzet e tetë (48) orëve prej momentit të arrestimit, situatë e cila është e përcaktuar në paragrafin e 10 të të njëjtit nen.

Kjo i bie që, në rastin kur kërkesa e ushtruar brenda njëzetë e katër (24) prej momentit të arrestimit, atëherë seanca dëgjimore në gjykatë do të mbahet më së largu në afatin prej njëzet e katër (24) orëve prej momentit kur ka arritur kërkesa e prokurorisë në gjykatë. Gjithsesi, fillimi i seancës dëgjimore në gjykatë për caktimin a jo të masës së sigurimit nuk duhet të kalojë afati dyzetë e tetë (48) orë prej momentit të arrestimit.¹¹⁵

¹¹² Instituti Gjyqësor i Kosovës, Doracaku i gjyqtarëve për procedurën penale, Prishtinë, 2015, f.81.

¹¹³ Musaraj, Jonida, “Çështje të aksesit në drejtësi dhe të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm në kuadrin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Përvoja shqiptare në vështrim të krahasuar”, Punim i doktoraturës, Tiranë, 2016, f.35. <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2017/03/JONIADA-MUSARAJ-DISERTACION-P%C3%8BR-MBROJTJEN-E-GRAD%C3%8BS-SHKENCORE-DOKTOR.pdf>, qasur me datë 19 gusht 2018.

¹¹⁴ Professional Training Series No.9, Human Rights in the Administration of Justice: A Manual on Human Rights for Judges, Prosecutors and Lawyers, United Nation, New York and Geneva, 2003, f.180. https://books.google.com/books?id=bD-eRFjTPzAC&pg=PP1&source=kp_read_button#v=onepage&q&f=false, qasur me datë 19 maj 2018.

¹¹⁵ Shiko më gjerësisht: Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.442-457.

Të njëjtin afat e kemi edhe në Shqipëri, ku theksohet se personi të cilit i është hequr liria, duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirimin e tij që nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim.¹¹⁶

3.1.3.1. Aktvendimi për masën e sigurisë

Gjykata, që në hapjen e seancës dëgjimore duhet që fillimisht sipas detyrës zyrtare të vlerësojë afatshmërinë se kërkesa për caktim të masës a është ushtruar brenda afatit ligjor. Kjo është arsyeja që në procesverbalin e gjykatës shënohet *“koha e saktë e arrestimit dhe koha kur është sjellë personi te gjyqtari i procedurës paraprake”*¹¹⁷.

Nëse brenda afatit prej njëzet e katër (24) orëve nuk është dorëzuar kërkesa për caktimin e masës së sigurimit nga ana e prokurorisë, ajo kërkesë e paraqitur pas afatit duhet të refuzohet menjëherë si e ushtruar pas afatit ligjor.

Një gjë e tillë do të duhet të bëhej pa u futur në seancë dëgjimore, gjatë vlerësimit parapak të kërkesës dhe afatshmërisë së tij, gjë e cila në praktikë mund themi se nuk ndodh fare. Në raste kur kërkesa është ushtruar pas afatit, në mënyrë automatike personi i arrestuar/ndaluar duhet të lirohet, *menjëherë*.¹¹⁸

E drejtë tjetër që lidhet me afat është edhe rasti i caktimit të avokatit mbrojtës për personin e arrestuar në rast se ai nuk ka caktuar.

Nëse personi i arrestuar nuk angazhon mbrojtës brenda 24 orësh nga momenti kur është informuar për atë të drejtë apo nëse deklaron se nuk do ta angazhon mbrojtësin, atëherë gjykata ia angazhon mbrojtësin ex officio (zyrtarisht).¹¹⁹ Kjo situatë është e përcaktuar në nenin 188 paragrafi 4 i KPPK-së.

¹¹⁶ Dervishi, Albert & Selita, Arjan, E drejta e Policisë, Tiranë, 2004, f.143.

¹¹⁷ Doracaku i Gjyqtarëve për procedurën penale, Instituti Gjyqësor i Kosovës, Prishtinë, 2015, f.84.

¹¹⁸ Më gjerësisht: Raporti i monitorimit të gjykatave 2016, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) dhe Interneës Kosova (I/KS), Prishtinë, 2016. (<https://kallxo.com/wp-content/uploads/2017/05/BIRN-RAPORTI-I-MONITORIMIT-TË-GJYKATAVE-2016.pdf>), qasur me datë 21 mars 2018.

¹¹⁹ Sijerçiq-Çolliq, Hajrija & Halilović, Haris, E drejta e procedurës penale, me vështrim të posaçëm në procedurën penale të Kosovës, Prishtinë, 2007, f.83.

Janë disa masa të sigurimit të pranisë së të pandehurit, e Kodi ynë i procedurës penale në nenin 173 i ka përcaktuar në këtë mënyrë: thirrja, urdhërarresti, premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin, ndalimi për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar, paraqitja në stacionin policor, dorëzania, arresti shtëpiak, diversioni dhe paraburgimi. Nga të gjitha këto nëntë (9) masat, ajo e paraburgimit është më e rënda e përcaktuar në KPPK.

Ai duhet vlerësuar tamam si “*privim i përkohshëm nga liria e personit që është subjekt i procedurës*”¹²⁰ e jo si dënim i parakohshëm, si dënim i paragjykuar.

Fatkeqësisht kjo është edhe masa më e shpeshtë që kërkohet nga prokuroria dhe që aplikohet nga gjykata.

Për këtë arsye, në këtë punim kur po flasim për afatet që lidhen me masat e sigurimit, do të paraqesim afatet që kanë të bëjnë me masën e paraburgimit.

Të njëjtat afate vlejnë edhe për masat tjera të sigurimit. Paraburgimi zgjatë derisa ekzistojnë kushtet sipas të cilave është caktuar.¹²¹

Siç e cekim më lartë, gjykata është e lidhur me afatin prej dyzet e tetë (48) orëve që të fillojë seancën dëgjimore lidhur me kërkesën e prokurorisë për caktim apo jo të masës së paraburgimit.

Seanca dëgjimore mund të zgjatë me orë të tëra, varësisht prej numrit të personave të arrestuar dhe ndërlikueshmërisë së rastit penal dhe nuk ka mundësi që të vendos në afatin prej dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i arrestimit.

Por gjithsesi, gjykata vendimin e saj lidhur me kërkesën e prokurorisë për masën e sigurisë duhet të vendos brenda dyzet e tetë (48) orëve prej momentit kur përfundon seanca dëgjimore, siç është përcaktuar me KPPK, neni 164, par.11 apo siç ceket në Kushtetutën e Kosovës në nenin 29 par.2, prej momentit kur është sjell personi i privuar nga liria para gjykatës.

Mund të vijmë në përfundim se ndalimi i personit të arrestuar, parimisht mund të zgjat më së shumti nëntëdhjetë e gjashtë (96) orë.

¹²⁰ Council of Europe, Protecting witnesses of serious crime/ Këshilli i Evropës, Mbrotjtja e dëshmitarëve të krimeve të rënda, shtator 2006, f.323.

¹²¹ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.484.

Duke qenë se paraburgimi është masë shumë më kufizuese se vetë dënimi, Kosova në legjislacionin e vetë e ka bërë inkorporimin e kohës së kaluar në paraburgim në ditët e burgimit¹²². Kosova një ditë paraburgim e barason me një ditë burgim¹²³.

Në nenin 79 par.4 të KPK-së është përcaktuar se “*një (1) ditë paraburgim, një (1) ditë heqje lirie, një (1) ditë burgim, dhe njëzet (20) euro të dënimit me gjobë barazohen për qëllime të llogaritjes sipas këtij neni*”.¹²⁴

Andaj, duke pasur në konsideratë se të drejtat e të paraburgosurit në raport me të burgosurin janë shumë më të kufizuara, me të drejtë duhet të ndërhyhet edhe në legjislacionin tonë që këtë situatë ta rregullojë në të njëjtën mënyrë siç e ka Shqipëria, e cila një ditë paraburgim e barasvlerëson me një ditë e gjysmë burgim.¹²⁵

¹²²Salihu, Ismet, E drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme, Prishtinë, 2003, f.519.

¹²³Kodi Penal i Sllovenisë, n.56, Kodi Penal i Kroacisë, n.63. Kodi penal i Gjermanisë, n.51, Kodi Penal i Zvicrrës n.51 etj.

¹²⁴Këshilli Gjyqësor i Kosovës është institucioni i cili merret me kompensimin e dëmit të personave të dënuar ose të arrestuar pa arsye. Është e çuditshme edhe në rastin e kompensimit të dëmit, e që bëhet vetëm për rastet e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak, e jo për masat tjera të sigurisë, siç janë lajmërimi në polici, konsifkimi i dokumenteve të udhëtimit etj, llogaritja e lartësisë së dëmit bëhet në mënyrë të padrejtë. Këtu kemi llogaritjen e një ditë paraburgimi me 15 euro dhe atë, në emër të dëmit material/fitimin e humbur nëntë (9) euro në ditë kurse në emër të dëmit jomaterial/moral gjashtë (6) euro në ditë. Për këtë: Udhëzimi Administrativ (04/2015) nr.01/656, datë 10.11.2015 për zbatimin e procedurës për kompensimin e dëmit për personat e dënuar osë të arrestuar pa arsye.

¹²⁵Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, n.57.




Figura 2: Paraqitja e afateve lidhur me caktimin e masës së sigurimit.

Raste praktike:

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda në rastin penal PPR.nr.143/2015, për veprën penale nga neni 422 të KPK-së, ka nxjerr Aktvendim me të cilin i ka caktuar paraburgimin një profesori universitar në bazë të një kërkesë të prokurorisë të ushtruar jashtë afatit ligjor.

Kërkesa edhe pse ka qenë e ushtruar në kundërshtim me përcaktimin ligjor të dispozitave të nenit 164 par.7 të KPPK-së, gjyqtari i procedurës paraprake nuk ka marrë në konsideratë as zyrtarisht e as me kërkesën e palës mbrojtëse shkeljen e kësaj dispozite.¹²⁶

¹²⁶ Në të njëjtën mënyrë ka vepruar edhe Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, ku me Aktvendimin PPR.nr.925/2107 të datës 07.12.2017 nuk ka dhënë asnjë konstatim lidhur me

Kundër këtij vendimi mbrojtja ka ushtruar ankesë në gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e cila përmes Aktvendimit PN.1.nr.1102/2015, datë 30 qershor 2015, ka konstatuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsytet lidhur me pretendimin e mbrojtjes se kërkesa është paraqitur pas afatit ligjor.

Ajo, përveç konstatimit nuk ka reaguar në evitimin e asaj shkelje. Fatkeqësisht kjo ndodh edhe në vende tjera, zakonisht në vendet ku demokracia është e brishtë.

Kjo me të drejtë mund të konstatohet se ndodh në sistemet “*autoritare ku të drejtat e të dyshuarit nuk konsiderohen si një pjesë e rëndësishme e kodit penal por ofrojnë autoritet joproporcional për aparatin e sigurisë si lejimi i provave minimale, gjë që rezulton me një hetim të pabalancuar dhe përfundon me dështimin e gjykimit*”¹²⁷.

Gjykata e apelit është dashtë që përveç konstatimit se kërkesa për paraburgim ka qenë apo nuk ka qenë brenda afatit ligjor, të vendos lidhur me privimin nga liria të një qytetari.

Ajo në mënyrë automatike është dashtë t’ia ndërpres paraburgimin qytetarit, e jo siç ka vepruar në këtë rast duke e lënë në paraburgim.

Nuk është dashur të mjaftohet me kthimin e çështjes në rivendosje kur kemi pasur të bëjmë me shkelje kaq flagrante të të drejtave të njeriut.

3.1.3.2. Ankesa ndaj masës së sigurisë

Prej momentit të caktimit të ndonjë mase të sigurisë nga ana e gjykatës me vendim gjyqësor, palët e pakënaqura kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë ndaj atij vendimi.¹²⁸

Afati për paraqitjen e ankesës kundër Aktvendimit mbi caktimin e masës së sigurimit është njëzet e katër (24) orë¹²⁹ prej momentit të pranimit të vendimit nga ana e palës.

pretendimet e mbrojtjes se kemi të bëjmë me kërkesë për caktim të paraburgimit të paraqitur nga Prokuroria jashtë afati ligjor. Ajo nuk ka paraqitur asnjë gërmë me të cilën do të konstatonte se kërkesa e Prokurorisë ka qenë e afatshme dhe se pretendimet e mbrojtjes nuk qëndrojnë. Në këtë rast penal, kërkesa e Prokurorisë për caktim të paraburgimit PP/II.nr.219/17 e datës 07.12.2017 është dorëzuar me datën 07.12.2017 në 13:52 kurse arrestimi është llogaritur që është bërë me datën 06.12.2017 ora 13:00.

¹²⁷ Reza, Bhata, Ibnu, Arbitrary Arrest and Detention: Excuses for Emergency Conditions and Terrorism, *Human Rights and the Indonesian Security Sector*: 2009, Almanac, Gjenevë, 2009, f.183.

¹²⁸ Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës nr.ref.:RK 1044/17, datë 1 mars 2017.

¹²⁹ Më gjerësisht: Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.495-497.

Kur paraqitet ankesa nga pala e pakënaqur, i paraburgosuri apo mbrojtësi në rastet e caktimit të masës së sigurimit apo prokurori në rastet e refuzimit të kërkesës për caktim të masës, një kopje e ankesës i dorëzohet palës tjetër.

Kopja e ankesës i dorëzohet me qëllim që t'i jepet mundësia të ushtrojë përgjigjen në ankesë e cila duhet të bëhet brenda afatit ligjor njëzet e katër (24) orë nga momenti i pranimi të ankesës.

Neni 189 par.3 i KPPK e përcakton se lidhur me ankesën e ushtruar gjykata e shkallës së dytë, në këtë rast Gjykata e Apelit duhet të vendos brenda dyzet e tetë (48) orëve, prej momentit kur ajo paraqitet në gjykatë.

Duke qenë se ankesa paraqitet në gjykatën në të cilën është marrë vendimi i kundërshtuar, atëherë teknikisht nëse llogaritet rrugëtimi i saj, del se do kalojnë edhe javë derisa të trajtohet ankesa dhe të vendoset nga gjykata e Apelit.¹³⁰

Kjo për shkak se e drejta në ankesë e palës që është njëzet e katër (24) orë prej momentit të marrjes së aktvendimit, e derisa e njëjta të kthehet në gjykatën e njëjtë kalojnë të paktën dyzetë e tetë (48) orë.

Derisa ankesa i dërgohet palës kundërshtare kalojnë të paktën edhe dyzet e tetë (48) orë apo shtatëdhjetë e dy (72) orë tjera. Edhe ajo përgjigje në ankesë duhet të paraqitet në gjykatën e cila e ka nxjerr vendimin, shembull Gjykata në Gjilan.

Gjykata e kompletion lëndën dhe e dërgon në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e që kjo të paktën do të bëhet pas njëzet e katër (24) orëve tjera shtesë.

Prej momentit të arritjes së ankesave në Gjykatën e Apelit, aty fillon të ecë afati prej dyzet e tetë (48) orëve për të vendosur mbi ankesën.

Duke llogaritur se janë vetëm pesë ditë pune javore, atëherë vendosja mbi ankesën do të ndodh në javën e dytë të punës, pasi të ketë kaluar të paktën një javë e plotë.

¹³⁰ "...48 për qind të avokatëve që iu përgjigjën pyetësorit theksuan se kur paraqesin ankesë në Gjykatën e Apelit ndaj vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake për paraburgimin e klientit të tyre, Gjykata e Apelit "shpesh" nuk arrin të merr vendim brenda 48 orëve pas ushtrimit të ankesës dhe 60 për qind e prokurorëve janë përgjigjur njëjtë. Në fund, 57 për qind e gjyqtarëve janë përgjigjur se Gjykata e Apelit "herë pas here" ose "shpesh" nuk arrin ta përmbush afatin. Raporti i Konsoliduar i KGJK-së konfirmon se këto afate nuk respektohen në ankesa" (Raport i OSCE, Shqyrtimi i Zbatimit të Kodit të Procedurës Penale në Kosovë, Prishtinë, qershor 2016, faqe 32- <https://www.osce.org/sq/kosovo/243981?download=true>, qasur me date 02.08.2016).

Dihet mirëfilli se secili institucion afatet i llogarit prej momentit kur ankesa arrin te ata.¹³¹

3.1.3.3. Mbikëqyrja e masës së sigurimit-paraburgimit

Duke qenë se gjyqtari i procedurës paraprake apo gjyqtari i çështjes¹³² është personi që mbikëqyrë paraburgimin, te ai kanë të drejtë të ankohen i paraburgosuri apo mbrojtësi i tij. Ankesa/kërkesa për çështjet lidhur me paraburgimin mund të bëhen në çdo kohë dhe lidhur me këtë, është përcaktuar afati kohor që gjykata të mbajë seancë dëgjimore¹³³ për ankesat në fjalë.

Por, pasi që për gjykatën nuk është detyrimisht që të mbajë seancë dëgjimore, një gjë e tillë ndodh shumë rrallë në praktikë.

Këto ankesa kanë të bëjnë me ligjshmërinë e paraburgimit apo edhe kushtet në të cilat i paraburgosuri qëndron dhe që vlerësohen se nuk ofrojnë kushte të mjaftueshme për të paraburgosurin.

Këtu mund të vijnë në konsideratë ndryshimi i arsyeve dhe rrethanave prej momentit kur është caktuar paraburgimi, zbulimi i fakteve të reja që do të ndikonin në qëndrimin e gjykatës, llojet e sëmundjeve të ndryshme dhe nevoja për tretman të caktuar mjekësor, gjendja ekonomike e familjare dhe transferimi në ndonjë qendër paraburgimi më afër familjes. Po ashtu mund të jetë rrezikimi i jetës të të paraburgosurit nga persona tjerë të paraburgosur etj.

Në këtë mënyrë, gjykata e ka një afat ligjor për të mbajtur seancë dëgjimore për ta trajtuar ankesën/kërkesën për vlerësimin e ligjshmërisë¹³⁴ së paraburgimit, lidhur me mbikëqyrjen e paraburgimit.

Afati ligjor për të trajtuar ankesën është më së largu shtatë (7) ditë nga pranimi i saj dhe gjykata duhet të vendos se a do të refuzojë kërkesën, a do të vlerësojë në seancë apo do të

¹³¹ Aktvendimi i Gjykatës së Apelit PN.1nr.2391/18, datë 13 dhjetor 2018, në bazë të ankesës së mbrojtësit të dates 03 dhjetor 2018.

¹³² Më gjerësisht: Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.501-503.

¹³³ Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës nr.565/13, datë 19 shtator 2013.

¹³⁴ Udhëzues rreth nenit 5 të Konventës, e Drejta për lirinë dhe për sigurinë personale, Këshilli i Evropës, 2014, f.8.

mbetet kërkesa pa përgjigje. Gjykatës në këtë pikë i është lënë në diskrecion dhe vlerësim të lirë të saj sipas nenit 192 par.3 dhe 7 të KPPK-së.

Këtë situatë juristët po e shohin se “*Fakti se i paraburgosuri ose mbrojtësi i tij në çdo kohë mund të kërkojnë nga gjyqtari që të vendosë për ligjshmërinë e paraburgimit, paraqitja një pas një e kërkesës do të paraqiste pengesë për zhvillim efikas të procedurës*”¹³⁵.

Në praktikë, të shumtën e rasteve nga ana e gjykatës nuk caktohet dhe nuk mbahet kjo seancë që ka të bëjë me vlerësimin e ligjshmërisë së paraburgimit dhe kërkesat e tilla mbesin vetëm në letër.

3.1.3.4. Kohëzgjatja e masave të sigurisë-paraburgimit

Ligjvënësi e ka përcaktuar periudhën kohore më të gjatë që gjykata mund të caktojë masën e sigurisë ndaj personit të arrestuar. KPPK-ja në nenin 190 par.1 ka përcaktuar se gjykata mund të caktojë më së shumti masën e sigurisë për periudhën kohore një (1) muaj nga dita kur është arrestuar personi.¹³⁶

Në rastet e caktimit të paraburgimit kur kemi të bëjmë me ndihmën juridike ndërkombëtare e cila rregullohet me ligj të veçantë, me Ligjin për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, afatet janë më të gjata se ato që rregullohen me kodin procedural penal.

Ky ligj e ka përcaktuar se “*dhe para pranimit të kërkesës për ekstradim, personi i kërkuar mund të arrestohet dhe paraburgoset për një periudhë maksimale prej dyzet (40) ditësh...*”¹³⁷.

Rast i tillë i paraburgimit për qëllim ekstradimi për në SHBA është rasti i 82 vjeçarit për vepër penale të lidhur me prostitucion.¹³⁸

¹³⁵ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.504.

¹³⁶ Rast ilustrativ për caktimin e paraburgimit në kohëzgjatje 15 ditë: Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë: Shqyrtim dhe analizë gjithëpërfshirëse e brengave të mbetura, OSCE, Prishtinë, 2010, f.12. <https://www.osce.org/sq/kosovo/41808?download=true>, qasur me datë 7 maj 2015.

¹³⁷ LBJNÇP, Prishtinë, 2013, neni 22.

¹³⁸ <https://indeksonline.net/82-vjecari-nga-gjakova-qe-mund-te-ekstradohet-ne-shba-per-shkak-te-prostitucionit/>, qasur me datë 18 qershor 2019.

Ashtu si caktimi i masës së sigurisë e cila bëhet në bazë të kërkesës të prokurorisë edhe vazhdimi i masës bëhet në bazë të kërkesës-propozimit të prokurorisë.

Kjo kërkesë apo siç thuhet propozim, duhet të paraqitet te gjyqtari i caktuar para skadimit të masës së sigurimit.

Kërkesës-propozimit për të vazhduar masës e sigurimit të cilën e bënë prokurori i shtetit, mund t'i paraprijë edhe kërkesa për vazhdim të masës të ushtruar nga i dëmtuari apo mbrojtësi i viktimave.

Këto dy kategori kanë të drejtë të propozojnë-kërkojnë nga prokurori që ai të paraqes kërkesën për vazhdim të masës në gjykatë. Edhe në këtë rast, kemi një afat ligjor të detyruar për tu zbatuar nga ana e gjykatës.

Dispozitat e kodit të procedurës kanë përcaktuar afatin ligjor brenda të cilit duhet të njoftohet i pandehuri dhe mbrojtësi për kërkesën-propozimin e prokurorisë për vazhdim të masës së sigurisë. Ky afat është të paktën tri (3) ditë¹³⁹ para se masa e sigurisë të skadojë.

A ndodh një gjë e tillë në praktikë? Përgjigja është se të shumtën e rasteve njoftimi për propozimin e masës së sigurisë i dorëzohet palëve bashkë me vendimin e marrë të gjykatës, si pozitiv ashtu edhe negativ¹⁴⁰.

Lidhur me kohëzgjatjen e masave të sigurisë, KPPK-ja ka përcaktuar dy grupe afatesh. Afatet ligjore që aplikohen gjatë fazës së zhvillimit të hetimit që është periudha para ngritjes së aktakuzës dhe afatet ligjore që aplikohen pasi të përfundojnë hetimet që është periudha pasi të ngritet aktakuza dhe lënda kalon në gjykatë.

Kufizimet kohore për paraburgim janë përcaktuar në afate strikte përtej të cilave paraburgimi nuk mund të zgjasë, pavarësisht a është arritur qëllimi i tij apo jo.¹⁴¹

¹³⁹ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.480-481.

¹⁴⁰ Njoftimi Gjykatës Themelore në Prishtinë, DKR, PPRKR.nr.17/19, datë 3 qershor 2019.

¹⁴¹ Si në 137, f.498.

Rast praktik:

Gjykata Themelore në Prishtinë, me datën 3 qershor 2019 Departamenti për Krime të Rënda (D.K.R.) ka lëshuar Njoftimin lidhur me kërkesën e Prokurorisë për vazhdimin e masës së sigurimit, në të cilin thuhet se:

Ju njoftojmë se Prokurori i shtetit i Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, me propozimin PP.I.nr.244/2018 të 31.05.2019, ka ushtruar kërkesë për vazhdimin e masës së paraburgimit kundër të pëndehturit E.Sh.”¹⁴²

Ky njoftim i është dorëzuar të paraburgosurit me datën 06 qershor 2019 në Qendrën e Paraburgimit në Prizren.

Këtu shihet se nga momenti i paraqitjes së propozimit-kërkesës së prokurorisë datë 31 maj 2019 e deri datën 06 qershor 2019 kur është njoftuar i paraburgosuri kanë kaluar gjashtë (6) ditë.

Njoftimi është pranuar me datën 06 qershor 2019, kurse aktvendimi për vazhdimin e paraburgimit është pranuar nga i paraburgosuri me datën 07 qershor 2019, që dmth nuk ka pasur asnjë mundësi të dhënies së përgjigjes dhe pretendimeve tjera të mbrojtjes në raport me propozimin-kërkesën e prokurorisë.

3.1.2.4.1. Masa e sigurimit-paraburgimit para ngritjes së aktakuzës

Ligjvënësi ka përcaktuar se në paraburgim personi i caktuar mund të mbahet më së shumti katër (4) muaj para ngritjes së aktakuzës. Ky afat vlen për rastet kur kemi të bëjmë me vepra penale, dënueshmëria e të cilave është më pak se pesë (5) vjet burgim.

Për veprat penale, dënueshmëria e të cilave është më shumë se pesë (5) vjet burgim, masa e sigurimit-paraburgimit mund të zgjatet më së shumti tetë (8) muaj.

¹⁴² Njoftimi i Gjyqtarit të procedurës paraprake, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PPRKR.nr.17/19, datë 31 maj 2019.

Këto afate vlejné për rastet të cilat parimisht janë të rëndomta, sepse në rastet tjera të vlerësuara si të jashtëzakonshme, sidomos për procedura lidhur me veprat penale të dënueshme më së paku pesë (5) vjet burgim; kur rasti është i ndërlikuar i cili ka më shumë se dhjetë të pandehurë, me aktivitet të organizuar kriminal, veprat penale të korrupsionit, hetimet të cilat kërkojnë prova të shumta mjeko-ligjore, analiza kontabiliteti apo bashkëpunime ndërkombëtare, paraburgimi mund të zgjatë më së shumti dymbëdhjetë (12) muaj, e jashtë çdo rrethane më së shumti tetëmbëdhjetë (18) muaj. Këto rrethana janë të përcaktuara në nenin 190 të KPPK-së.¹⁴³

Në të gjitha rrethanat e cekura më lartë, nëse arrihet periudha kohore tetëmbëdhjetë (18) muaj dhe nuk ngritet aktakuza, i pandehuri lirohet nga paraburgimi.¹⁴⁴

Askund në dispozitat e procedurës penale nuk kemi të përcaktuar ndonjë afat ligjor që rregullon mënyrën e vazhimit të paraburgimit.

Lidhur me atë se pas muajit të parë të paraburgimit, për tu vazhduar paraburgimi duhet të kemi kërkesë dhe aktvendim vazhdues të përcaktuar saktë se edhe sa muaj duhet ta vazhdohet.

Nuk kemi të përcaktuar afat ligjor që thotë se duhet të vazhdohet një muaj, dy apo tre muaj. Në këtë mënyrë është përcaktuar vetëm afati përfundimtar i paraburgimit.

Në praktikë kemi vazhdimin të paraburgimeve prej një (1), dy (2) apo katër edhe (4) muaj përnjëherë.

3.1.2.4.2. Masa e sigurimit-paraburgimit pas ngritjes së aktakuzës

Derisa afatet ligjore për kohëzgjatjen e masës së paraburgimit janë të përcaktuara për fazën para ngritjes së aktakuzës, ligjvënësi një gjë të tillë nuk e ka bërë në rastet pas ngritjes së aktakuzës.

Derisa nuk është e përcaktuar asnjë afat ligjor se sa mund të zgjatë masa e sigurisë pas ngritjes së aktakuzës, në këtë frymë, paraburgimi mund të zgjatë deri në përfundim të

¹⁴³ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.499-500.

¹⁴⁴ Po aty, f.500.

procesit gjyqësor. Kjo çështje ka mbetur në diskrecion dhe vlerësim të vetë gjyqtarit të çështjes, për të vlerësuar se a qëndrojnë edhe më tutje arsyet e caktimit dhe vazhdimit të paraburgimit. Për secilin vazhdim të masës së paraburgimit, pala ka të drejtë të ushtrojë ankesë¹⁴⁵ dhe afatet janë të njëjta si për rastet e paraburgimit në fazën para ngritjes së aktakuzës.

3.1.2.4.3. Masa e sigurimit-paraburgimit pas shpalljes së aktgjykimit

Pasi të përfundojë një proces gjyqësor në një çështje penale, ai do të kurorëzohet me aktgjykimin i cili do të shpallet menjëherë pas përfundimit të procesit. Siç e kemi cekur më herët në punim, më së largu tre (3) ditë pas përfundimit të procesit gjyqësor do të bëhet shpallja e tij.

Në këtë rast është e përcaktuar se si të veprohet kur kemi çështjen e paraburgimit, kur personi i akuzuar shpallet fajtor dhe i shqiptohet dënim me burgim të paktën prej pesë (5) viteve apo edhe më pak. Neni 367 par.2 i KPPK-së e ka përcaktuar se kur kemi shpallje të dënimit me të paktën pesë (5) vite burgim apo më shumë, masa e sigurisë-paraburgimit i vazhdohet të gjykuarit nëse ka qenë në paraburgim, ose, nëse ka qenë në liri i caktohet masa e paraburgimit.

Në raste të tjera, të dënimit më pak se pesë vite, paraburgimi caktohet apo vazhdohet vetëm në rast se ekzistojnë kushtet për caktim të paraburgimit, e siç u cekë më lartë, çështje në diskrecion të gjykatës.¹⁴⁶

Paraburgimi është obligatorë edhe në procedurë ndaj të miturve, kur është shqiptuar dënimi me burg prej pesë ose më shumë vitesh. Kjo për arsye se në

¹⁴⁵ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.496-497.

¹⁴⁶ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, DKR, PKR.nr.162/17, datë 19 korrik 2017. Në këtë rast, katër të akuzuar për veprën penale shtytja për kryerjen e veprave terroriste në tentativë, nga neni 141 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, ku janë gjykuar nga 3 vite deri 4 vite e 6 muaj, të njëjtëve i është vazhduar paraburgimi deri në plotfuqishmërinë e Aktgjykimit por jo më shumë se dënimi i shqiptuar.

Kodin e drejtësisë për të mitur nuk ka dispozitë të posaçme e cila do ta rregullonte në mënyrë tjetër këtë çështje. - neni 5 i KDM.¹⁴⁷

Themi se i lihet në diskrecion të gjykatës, por duhet të merret parasysh se gjykata në këto rrethana duhet të bëjë vlerësimin se “janë plotësuar kushtet e përcaktuara me nenin 187 par. 1.” që kanë të bëjnë me caktimin e paraburgimit.

	Dënueshmëria	Dënueshmëria		
	deri pesë (5) vjet	mbi pesë (5) vjet		
PARA	4 muaj	8 muaj	12 muaj	18 muaj
aktakuzës				
PAS aktakuzës	Mund t’i vazhdohet	Mund t’i vazhdohet		
PAS	E	I caktohet/I vazhdohet		
aktgjykimit	papërcaktuar			

Tabela 3: Paraqitja e afateve të vazhdimit të paraburgimit.

Raste praktike:

- 1/. Gjykata Themelore në Mitrovicë, Gjyqtarët Ndërkombëtar të EULEX-it, me datën 21 janar 2016 në rastin penal kundër Oliver Ivanović (ministër i Serbisë në Kosovë) për veprën penale Krime lufte të kryera ndaj popullatës civile shqiptare me datën 14 prill 1999, e kanë dënuar me nëntë (9) vjet burgim. Edhe pse ishte detyrim ligjorë që i

¹⁴⁷ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.857.

gjykuari të shkonte në paraburgim, i njëjti është lënë në masën e sigurimit- arrest shtëpiak.¹⁴⁸

Pas ankesës së ushtruar nga ana e prokurorit të shtetit kundër arrestit shtëpiak, gjykata e Apelit të gjykuarit ia ka caktuar paraburgimin deri në plotfuqishmërinë e tij.¹⁴⁹

- 2/. Gjkata Themelore në Mitrovicë, Gjyqtarët Ndërkombëtar të EULEX-it, me datën 27 maj 2015, në rastin penal kundër Sami Lushtakut dhe Sylejman Selimit (Pjesëtarë të UÇK-së), për veprën penale Krime lufte, duke i dënuar me dymbëdhjetë (12) vjet burgim dhe gjashtë (6) vjet burgim. Atyre iu ka vazhduar paraburgimi.¹⁵⁰
- 3/. Gjkata e Apelit në Prishtinë, 2 Gjyqtarë të EULEX-it dhe një vendor, me datën 19 nëntor 2017, në rastin penal kundër E.S. për veprën penale Shtytje në Vrasje të Rëndë dhe Detyrim i dënuar me dënim unik afatgjatë 37 vjet burgim, në seancë të apelit i është zëvendësuar masa e sigurimit, nga ajo e paraburgimit në të cilën kishte qenë në masën e arrestit shtëpiak.¹⁵¹

3.1.4. Afatet lidhur me urdhërarrestin

Duke qenë se Urdhërarresti është masë për të siguruar praninë e personit në procedurë, për të penguar atë të rikryej veprën penale dhe që procedura të zhvillohet pa pengesë edhe kjo masë ka disa afate me rëndësi që duhet zbatuar.

Kjo masë ka efekt për periudhën kohore prej një viti apo siç thotë ligjvënësi me dispozitën e nenit 175 të KPPK-së¹⁵², se masa skadon në mesnatën e ditës së treqind e gjashtëdhjetë e pestë (365) nga dita e lëshimit të urdhërarrestit.

Pasi të kalojë një vit, e nëse nuk përtrihet urdhërarresti, ai do të jetë i paefektshëm dhe i pazbatueshëm.

¹⁴⁸ <http://www.eulex-kosovo.eu/?page=2,10,378>, qasur me datë 16.10.2016.

¹⁴⁹ FDHK- Kosovë-Raporti për vitin 2016, *“Koha Kalon, Drejtësia për krime lufte zbehet”*, përgatitur nga Anka Kurteshi-Hajdari, Prishtinë, 2017, f.46.

¹⁵⁰ <http://www.eulex-kosovo.eu/?page=2,10,228>, qasur me datë 25 shkurt 2017.

¹⁵¹ Aktvendimi i Gjykatës së Apelit nr.PAKR 1/2017 (Pkr.nr.218/14 GjTh Prishtinë), datë 19 nëntor 2017.

¹⁵² Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.466.

Kjo situatë vlen për rastet kur gjyqtari nuk e përcakton shprehimisht në aktvendim afatin e kalimit të efektit të urdhërarrestit.

Bazuar në këtë dispozitë ligjore, gjyqtari e ka të drejtën që urdhrin për arrest ta lë me afat të hapur, ashtu siç ndodh shpesh në praktikë kur thuhet “*Këtë Urdhërarrest ka për ta ekzekutuar Policia e Kosovës- Stacioni Policor Qendra në Prishtinë, dhe i njëjti do të vlejë derisa i pandehuri të arrestohet dhe të sillet para gjykatës*”¹⁵³.

¹⁵³ Urdhërarresti i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda, PPRKR.nr.119/18, datë 19 korrik 2018.

3.2. AFATET E PARASHKRIMIT TË NDJEKJES PENALE DHE EKZEKUTIMIT TË SANKSIONEVE PENALE

3.2.1. Afatet lidhur me institutin e parashkrimit

Parashkrimi do të thotë vjetërsimi i mundësisë së ndjekjes penale apo i ekzekutimit të dënimit të shqiptuar. *"Parashkrimi" është termi që zbatohet në praktikën me të cilën shteti vendos se ka kaluar një periudhë e gjatë kohe që nga kryerja e krimi apo edhe nga dënimi, në mënyrë që shoqëria të mos ketë më interes për atë krim. Pasi kjo periudhë kohore të kalojë, krimi i kryer nuk mund të dënohet, madje edhe kur kryesi është gjetur. Sa më serioz të jetë krimi apo sa më i ashpër dënimi, aq më e gjatë është periudha e parashkrimit.*¹⁵⁴

Në këto raste, janë të përcaktuara disa afate ligjore kohore të cilat me kalimin e tyre krijohen rrethana të reja. Ato rrethana janë të atilla që për organet dhe palët në procedurë shkaktajnë përfundimin, pamundësimin e ndërmarrjes së mëtejme të çfarëdo veprimi procedural.

Vjetërsimi ndodh për shkak të kalimit të kohës së caktuar të përcaktuar me ligj.

Siç thotë edhe penalisti ynë prof.dr. Ismet Salihu, me kalimin e kohës as ndjekja penale e as ekzekutimi s'do ta arrijnë efektin e vet, as në aspektin e preventivës individuale e as gjenerale, e vetë gjendja nën presion e personit është mjaft dënim i madh.¹⁵⁵

Afatet ligjore që kanë të bëjnë me këto institute, me parashkrimin e ndjekjes penale dhe parashkrimin e ekzekutimit të dënimit janë të përcaktuara në Kodin penal të Kosovës.

¹⁵⁴ Guillén, Margarita & Lareu, Victoria, María & Pestoni, Carmela & Salas, Antonio & Carracedo, Angel, Ethical-legal problems of DNA databases in criminal investigation, *Journal of Medical Ethics* 2000, f.269. <https://jme.bmj.com/content/medethics/26/4/266.full.pdf>, qasur me datë 29 prill 2017.

¹⁵⁵ Salihu, Ismet, E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2003, f.559.

3.2.2. Mosparashkrimi i veprave penale të caktuara

Ligjvënësit e kanë përcaktuar se jo cilado ndjekje penale apo cilado ekzekutim i dënimit mund të parashkruhet. Kjo ka të bëjë pikërisht me veprat e përcaktuara në nenin 111 të KPK-së, për të cilat nuk ka parashkrim.

Neni 111 i KPK-së ka përcaktuar në mënyrë decitive se nuk kemi parashkrim atëherë kur janë në pyetje veprat penale që kanë të bëjnë me gjenocid, me krime të luftës dhe me krime kundër njerëzimit.¹⁵⁶

Kjo është kategoria e parë e veprave penale që nuk parashkruhen.

Kategori e dytë për mosparashkrim, janë edhe ato vepra penale të cilat janë të përcaktuara nga e drejta ndërkombëtare si vepra që nuk parashkruhen.¹⁵⁷

E treta ka të bëjë për veprën penale të vrasjes së rëndë, e cila gjithashtu nuk parashkruhet. Shqipëria parasheh rrethana më ndryshe se Kosova, ku nuk njih institutin e kalimit të dyfishit të afatit apo si i themi në praktikë në Kosovë, parashkrimi absolut.¹⁵⁸

Në përgjithësi mund të themi se shtetet e ndryshme e kanë përcaktuar se parashkrimi nuk arrihet në rastet kur është paraparë dënimi me burgim të përjetshëm kurse për vepra tjera parashkrimi maksimal është 25 vjet¹⁵⁹, si parashkrim i duhur¹⁶⁰.

Shumica e vendeve të rajonit për vrasjen e rëndë nuk e shohin mundësin e parashkrimit¹⁶¹.

¹⁵⁶ Shiko: Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Ministria e Drejtësisë, Prishtinë, 2015, f.133-134.

¹⁵⁷ Si 152, f.567.

¹⁵⁸ Kodi penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.7895, date 27.1.1995, botuar dhjetor 2014, neni 66, 67 dhe 68).

¹⁵⁹ Kodi Penal i Filipineve, 2016, Seksioni 28, p.1.

[https://www.doj.gov.ph/files/cc/Criminal_Code_September-2014\(draft\).pdf](https://www.doj.gov.ph/files/cc/Criminal_Code_September-2014(draft).pdf), qasur me datë 21 maj 2018.

¹⁶⁰ Kodi Penal i Sllovenisë, 2008, n.90. file:///C:/Users/dell/Downloads/Slovenia_CC_2008_en.pdf, qasur me datë 21 maj 2018.

¹⁶¹ Kodi Penal i Gjermanisë, 2013, Seksioni 78. https://www.gesetze-im-internet.de/englisch_stgb/englisch_stgb.html, qasur me datë 21 maj 2018.

3.2.3. Parashkrimi i ndjekjes penale

Instituti i parashkrimit të ndjekjes penale është përcaktuar në nenin 99 të KPK-së, i cili Kod ka hyrë në fuqi tani në vitin 2019.

Për çështje krahasimore me kodin e kaluar penal i cili ka përcaktuar institutin e parashkrimit në nenin 106, në vazhdim do të paraqesim afatet që kanë qenë të përcaktuara me kodin e kaluar, e që kanë qenë afate më të shkurtëra, e për të cilat afate me kalimin e tyre ndjekja penale nuk ka mundur të merret:

1.1. tridhjetë (30) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me burgim të përjetshëm; dispozitë e cila ka mbetur e njëjtë me kodin e ri.

1.2. njëzetë (20) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se dhjetë (10) vjet burgim; dispozitë e cila ka mbetur e njëjtë me kodin e ri.

1.3. dhjetë (10) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se pesë (5) vjet burgim; dispozitë që tani ka ndryshuar dhe nga periudha kohore dhjetë (10) vjet tani është pesëmbëdhjetë (15) vjet.

1.4. pesë (5) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se tre (3) vjet burgim; dispozitë e cila tani është dyfishuar, ku tani afati është dhjetë (10) vjet.

1.5. tre (3) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim; dispozitë e cila tani është dyfishuar, ku tani afati është gjashtë (6) vjet.

1.6. dy (2) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme deri në një (1) vit burgim ose me dënim me gjobë; dispozitë e cila tani është dyfishuar, ku tani afati është katër (4) vjet.

Ligjvënësi e ka përcaktuar mënyrën e llogaritjes së afatit të parashkrimit për rastet kur kemi kryerjen e veprës penale, për të cilën vepër është paraparë më shumë se një dënim. Në këto raste afati i parashkrimit përcaktohet sipas dënimit më të rëndë të përcaktuar për atë vepër penale.

Në këtë mënyrë, zgjatjen e afatit të parashkrimit të ndjekjes penale nga ligjvënësi, e vlerësojë se nuk i kontribon ndjekjes penale, por i kontribon komoditetit të organeve ndjekëse, në këtë rast prokurorisë dhe neglizhencës së tyre.¹⁶²

3.2.3.1. Fillimi, ndërprerja dhe kalimi i dyfishit të afatit të parashkrimit të ndjekjes penale

Duke qenë se parashkrimi është institut me rëndësi të madhe, i cili prek dhe detyron drejtpërdrejt palët në ndërmarrjen apo ndërprerjen e veprimeve të caktuara, është me rëndësi të analizohen disa aspekte të veçanta.

Është fjala për momentin se kur fillon të llogaritet apo të rrjedhë afati i parashkrimit. Është fjala për momentin kur ndërpritet afati i parashkrimit dhe nuk llogaritet ajo periudhë në afat parashkrues. Dhe është fjala për momentin se çka ndodh nëse kalon dyfishi i afatit të parashkrimit të përcaktuar në dispozitat e kodit penal të Kosovës.

Në vazhdim do flasim për secilën rrethanë veç e veç.

3.2.3.1.1. Fillimi i parashkrimit të ndjekjes penale

Se kur fillon llogaritja e afatit të parashkrimit të ndjekjes penale është përcaktuar në nenin 100 të KPK-së.

Janë përcaktuar tri raste të cilat kanë të bëjnë me saktësimin e momentit të fillimit të llogaritjes së afatit të parashkrimit.

E para, është përcaktuar se afati i parashkrimit fillon të llogaritet prej ditës kur është kryer vepra penale. Pra, prej momentit kur është kryer vepra penale, *përkatesisht kur kryesi ka vepruar ose ka qenë i obliguar të veprojë*¹⁶³

¹⁶² Të njëjtin qëndrim e mbajnë shumë jurist, ndër ta: <https://telegrafi.com/gjyqtari-hoti-zgjatja-e-afatit-te-parashkrimit-nuk-e-ben-sistemin-me-efikas-video/>, qasur me datë 27 korrik 2018.

¹⁶³ Salihu, Ismet, E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, 2003, Prishtinë, f.560.

E dyta, është atëherë kur kemi të bëjmë me pasojat të cilat shkaktohen më vonë, pas momentit të veprimit dhe ato pasoja janë elemente përbërëse të veprës penale. Në rastet ku pasojat paraqiten më vonë, afati i parashkrimit do të llogaritet nga koha e shfaqjes së pasojës.

E treta, është atëherë kur kemi të bëjmë me vepra penale të cilat janë kryer ndaj personave që janë nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet. Këto janë raste të veçanta dhe afati i fillimit të parashkrimit do të llogaritet prej ditës kur viktimat e mbush moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare.

Në rastin konkret nuk ka qenë kontestues fakti se e dëmtuara e mitur në kohën e kryerjes së veprës penale i ka pasur 16 vite, 10 muaj e 14 ditë, ndërsa me datë 20.01.2013 e njëjta e ka mbushur moshën 18 vjeçe, prandaj në kuptim të dispozitës së lartcekur afati i parashkrimit fillon të rrjedh që nga kjo datë.¹⁶⁴

Duke qenë se vepra penale mund të kryhet edhe atëherë kur ajo ngelet në tentativë, mbetet pa u kryer, te këto vepra penale do të arrihet parashkrimi në mënyrën e njëjtë se si do të parashkruhej edhe nëse vepra penale e cila do të ishte kryer.

Këtu afatet e parashkrimit janë njëlloj si për veprën penale të kryer.¹⁶⁵

Raste të veçanta janë edhe disa raste tjera penale, që në shikim të parë mund të keqinterpretohet koha e fillimit të parashkrimit. Është fjala për veprën penale të uzurpimit të pronës së paluajtshme, ku afati i parashkrimit rrjedh nga dita e lëshimit-lirimit të pronës, e jo nga dita kur është uzurpuar prona.

Pastaj, duke qenë se kemi të bëjmë edhe me vepra penale të cilat cilësohen si vepra penale të vazhduara, atëherë në këto raste parashkrimi do të jetë i ndarë, në atë mënyrë që “*gryketa me aktgjykim do të vendos për refuzimin e akuzës për veprën penale për të cilën ka arritur parashkrimi, ndërsa për pjesën tjetër do të vendos në mënyrë meritore*”¹⁶⁶.

¹⁶⁴ Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Pml.nr.195/2016, datë 26 shtator 2016.

¹⁶⁵ Elezi, Ismet; Kaçupi, Skënder; Haxhia, R. Maksim, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2006, f.285.

¹⁶⁶ Doracaku i Gjyqtarëve për procedurën penale, Instituti Gjyqësor i Kosovës, Prishtinë, 2015, f.166.

3.2.3.1.2. Ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale

Ligjvënësi e ka paraparë se afati i parashkrimit nuk rrjedh çdo herë prej momentit kur është kryer vepra penale apo kur ekzistojnë rrethanat e cekura, të përshkruara si më lartë.

Dispozitat e nenit 100 kanë përcaktuar disa rrethana të cilat nuk janë domosdo të vetmet rrethana të cilat ndërprejnë rrjedhjen e afatit të parashkrimit.

Këto rrethana janë të listuara në këtë mënyrë, por siç thotë ligjvënësi:

“pa u kufizuar në rrethanat e mëposhtme:

3.1. kur kryesi është jashtë Republikës së Kosovës dhe kjo shkakton vonesa në procedurë;

3.2. kur kryesi kërkohet me urdhërarrest;

3.3. kur Kryeprokurori i Shtetit, në pajtim me Kodin e Procedurës Penale, përpaket të sigurojë dëshmi jashtë Republikës së Kosovës; ose

3.4. gjatë kohës sa zgjatë procedura për pranimin e fajësisë.”

Kodi Penal i Sllovenisë mund të themi se është shumë i ngjajshëm me Kodin Penal të Kosovës sa i përket parashkrimit dhe çështjeve që lidhen me të.

Mund të themi se edhe mënyra e radhitjes së dispozitave është e ngjajshme, për mos thënë gati identike.¹⁶⁷

Pavarësisht se ka shumë rrethana që e ndërprerë parashkrimin, prapë se prapë gjyqësori nuk është duke arritur që të jetë azhur dhe t'i “shfrytëzojë” këto benefite ligjore dhe prapë se prapë gjyqësori po jetë i amnistuar për “dembelinë” e tyre.

Për këtë edhe monitorimi që bëhet në mënyrë sistematike nga shoqëria civile, del me të vetmin konstatim të saktë se “*ende nuk kemi parë që ndonje gjykatës të jetë thirrur ose të ketë dhënë përgjegjësi për këtë*”¹⁶⁸.

¹⁶⁷ Kodi Penal i Sllovenisë, 2008, n.90-95. file:///C:/Users/dell/Downloads/Slovenia_CC_2008_en.pdf, qasur me datë 21 maj 2018.

¹⁶⁸ Raporti vjetor i monitorimit të gjykatave 2011, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese – BIRN, Prishtinë, 2012, f.6.

Për sa i përket parashkrimit të lëndëve penale, disa herë është potencuar se hetimet për gjyqtarët që kanë lejuar vjetërsimin e lëndëve kanë filluar nga ana e Zyrës së Prokurorit Disiplinor (ZPD), pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), “por asnjë hetim nuk ka rezultuar me shkarkimin e tyre”.¹⁶⁹

Në bazë të këtyre rrethanave kuptohet se parashkrimi ndërpritet nëse kryesi nuk gjendet në Republikën e Kosovës dhe i njëjti është i paarritshëm për organet, kur ndaj kryesit të veprës penale është lëshuar urdhërarresti dhe i njëjti është në kërkim, kur janë duke u zhvilluar hetime nga ana e Prokurorisë dhe çështja është në procedim e sipër për të siguruar dëshmi përmes ndihmës juridike ndërkombëtare nga jashtë Republikës së Kosovës.

Si rrethanë e listuar është e përcaktuar edhe koha gjatë të cilës kryesi është në negociata për pranimin e fajësisë për veprën penale dhe këto negociata nuk e ndërprejnë afatin e parashkrimit.

Afati i parashkrimit ndërpritet edhe me ndërmarrjen e cilitdo veprim në drejtim të veprës penale të kryer. Si veprim i tillë mund të jetë, marrja e deklaratave, aplikimi i masave të fshehta, autorizimet e caktuara dhënë policisë për veprime konkrete apo të përgjithshme, kërkesa për ndihmë juridike, kërkesa për ekzaminime etj.

Rast i tillë që ndërprehet parashkrimi është edhe marrja në pyetje e vetë parashtruesit të kallëzimit penal edhe pa filluar hetimi formal.¹⁷⁰

Në paragrafin 4 të kësaj dispozite është e përcaktuar edhe rrethana kur afati i parashkrimit nuk ndërpritet nëse vepra penale nuk ndiqet për se nuk ka kërkesë apo autorizim për ta bërë ndjekjen nga ana e shtetit të huaj.

Rrethanë tjetër e veçantë e cila e ndërprente afatin e parashkrimit është edhe kryerja e veprës të re penale nga ana e kryesit.

Dmth, nëse kryesi e kryen ndonjë vepër penale gjatë kohës që është duke u llogaritur afati i parashkrimit, ai ndërpritet. Në këto raste është kusht që vepra penale e kryer duhet të jetë për nga pesha e njëjtë apo më e rëndë se vepra për të cilën është duke u llogaritur afati i parashkrimit.

¹⁶⁹ Raport Monitorues: Parashkrimi i Ndjekjes Penale dhe Parashkrimi i Ekzekutimit të Dënimeve në Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës në vitet 2001-2013, Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet, ÇOHU, Prishtinë, 2014, f.10.

¹⁷⁰ Aktvendimi i Gjykatës së Apelit e Kosovës PAKR 442/13 datë 02.04.2014.

Me rastin e vlerësimit nëse vepra penale është e njëjtë apo më e rëndë se ajo që është kryer më parë, vendimtar është dënimi i paraparë në ligj për atë vepër.¹⁷¹

Këto janë rrethanat të cilat e ndërprejnë afatin e parashkrimit, janë veprime që e përtrijnë afatin e parashkrimit.

Për këto rrethana të listuara ligjvënësi prapë ka lënë opsione të hapura edhe për raste tjera të cilat e ndërprejnë parashkrimin, e të cilat përcaktohen varësisht prej rastit të caktuar.

3.2.3.1.3. Kalimi i dyfishit të afatit të parashkrimit të ndjekjes penale

Duke qenë se ligjvënësi qëllimin kryesor e ka që kryesi i veprës penale të mos shpëtojë pa u dënuar, i ka përcaktuar rrethanat e ndërprerjes së parashkrimit të ndjekjes penale.

Aparati ndjekës është favorizuar në raport me të pandehurin, e që në realitet në këtë mënyrë edhe vepron kundër parimit të prezumimit të pafajësisë. Me ndërmarrjen e veprimeve sado të thjeshta të jenë ato ndërprejnë parashkrimin.

Edhe pse shpesh prokuroria kryen veprime që proceduralisht s'kanë ndonjë rëndësi apo vlerë provuese të veçantë, ai veprim ndërpreu afatin e parashkrimit.

Veprimet më të shpeshta që ndërmarrin prokuroria janë përsëritja e autorizimeve gjenerale që i jepen policisë, pa pasur asnjë udhëzim konkret.

Si veprime më me vlerë do të ishin lëshimi i urdhëresave konkrete, urdhërarrestet apo letërrreshtimet ndërkombëtare¹⁷².

Arsyet e parashkrimit ndërlidhen me mungesën e ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme ligjore për ndjekjen penale qoftë nga Policia e Kosovës, po ashtu nga prokuroritë përkatëse.¹⁷³

¹⁷¹ Salihu, Ismet, E drejta penale, Pjesa e Përgjithshme, Prishtinë, 2003, f.562.

¹⁷² Aktvendimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Pn.nr.164/2017, datë 7 mars 2017.

¹⁷³ KORRUPSIONI NË KOSOVË 5: Raport vlerësues periodik mbi efikasitetin e sistemit prokurorial në zbatimin e planit të veprimit për rastet e korrupsionit, Instituti i Kosovës për Drejtësi, 2015, f.80 e tutje. <https://klicks.org/wp-content/uploads/2015/06/KORRUPSIONI-NE-KOSOVE-5-25-qershor-2015.pdf>, qasur me datë 22 maj 2018.

Prapë se prapë, ligjvënësi e ka përcaktuar se në pafundësi nuk mund të pritët ndërmarrja e veprimeve të ndryshme e të cilat ndërpresin afatin e parashkrimit.

Në këtë mënyrë, nëse kalohet dyfishi i afatit të parashkrimit të ndjekjes penale, ndjekja penale ndalohet automatikisht. Kjo është e përcaktuar në paragrafin 8 të të njëjtit nen.

Në praktikë, kalimi i dyfishit të këtij afati për ndjekje penale quhet edhe parashkrim absolut i ndjekjes penale.

Kështu p.sh. nëse për ndonjë vepër penale është paraparë se parashkrimi shkaktohet pas pesë vjetëve, atëherë parashkrimi absolut paraqitet pas skadimit të dhjetë vjetëve.¹⁷⁴

Edhe pse ligjërisht një cilësim i tillë është i panevojshëm, sepse parashkrimi është parashkrim dhe nuk ka të bëjë as me relativen e as me absoluten, ai term “*absolut*” përdoret nga gjykata, nga prokuroria dhe nga palët.

Është me rëndësi të ceket në këtë punim Kosova duke qenë vend i dalur nga okupimi dhe institucionet janë ngritur nga themelet, herë më brumë të dorës së parë e më shumë me huazime dhe përkthime jo adekuate, ka ndodhur që personat e akuzuar kanë kaluar në situata jo të zakonshme, e që janë lidhur edhe me çështjen e zbatimit të gjuhës zyrtare në Kosovë.

Situata të tilla kanë sjellë dilema se parashkrimet e kanë arritur apo nuk kanë arritur, pikërisht mbi bazën e asaj se cila gjuhë duhet të dominojë mbi tjetrën, gjuha shqipe, gjuha angleze apo serbe.

Pra, ka pasur paqartësi dhe dilema edhe në raport me gjuhen kur nuk ka pasur përputhje të dispozitave ligjore në mes gjuhëve, në rastet kur pala e akuzuar ka qenë shqipfolës kurse gjyqtari ka qenë anglezfolës dhe janë krijuar çështje diskutabile pikërisht për çështjen e parashkrimit.

Në këtë situatë “*Gjykata e Apelit konstaton se versionet e gjuhës në Nenin 90 (1.6)(dispozita e parashkrimit sipas Kodit penal që ka qenë në fuqi) të KPPK-së janë thelbësisht të ndryshme... Kështu, ekziston skadimi i parashkrimit absolut më së largu në qershor të vitit 2013...Gjykata e Apelit e ndryshon aktgjykimin e shkallës së parë dhe e hedh poshtë akuzën e prokurorisë..*”¹⁷⁵

¹⁷⁴ Salihu, Ismet, E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2003, f.563.

¹⁷⁵ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë PAKR.nr.157/15, datë 28 maj 2015.

Dënueshmëria e veprës penale sipas KPK-së	Afati i Parashkrimit me kodin e ri penal 2019	Afati i parashkrimit me kodin e kaluar
Burgim i Përjetshëm	30 vjet	30 vjet
Burgim mbi 10 vjet	20 vjet	20 vjet
Burgim mbi 5 vjet	15 vjet	10 vjet
Burgim mbi 3 vjet	10 vjet	5 vjet
Burgim mbi 1 vjet	6 vjet	3 vjet
Burgim deri 1 vjet	4 vjet	2 vjet
Burgim me gjobë	4 vjet	2 vjet

Tabela 1: Paraqitja tabelare e afateve të parashkrimit të ndjekjes penale.

3.2.4. Parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve

Ashtu si instituti i parashkrimit të ndjekjes penale edhe instituti i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit është përcaktuar në Kodin Penal të Kosovës. Afate të njëjta të parashkrimit janë parashikuar edhe për ekzekutimin e dënimit.¹⁷⁶

Në dispozitat e nenit 101 të KPK-së, përcaktohen afatet që kanë të bëjnë me parashkrimin, për të cilat afate ekzekutimi i dënimit nuk mund të bëhet nëse kalohen ato afate. Kjo situatë mund të ndodhë nëse dënimi nuk ka filluar të ekzekutohet apo nëse ekzekutimi i tij është ndërprerë.¹⁷⁷

Janë të përcaktuara në mënyrë decitive se dënimet nuk mund të ekzekutohen nëse kalojnë:

“ 1.1. tridhjetë (30) vjet nga dënimi me burgim të përjetshëm;

1.2. njëzetë (20) vjet nga dënimi me mbi dhjetë (10) vjet burgim;

¹⁷⁶ ИЗВЕШТАЈ од спроведеното истражување за појавите на сексуална злоупотреба и сексуална експлоатација на децата, НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ, одделение за заштита на правата на децата, Скопје/ RAPORT nga hulumtimi i realizuar për dukurinë e abuzimit seksual dhe eksploatimit seksual të fëmijëve/ AVOKATI I POPULLIT, Seksioni për mbrojtjen e fëmijëve, Shkup, 2012, f.90.

¹⁷⁷ Salihu, Ismet, E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2003, f.563.

- 1.3. dhjetë (15) vjet nga dënimi me mbi pesë (5) vjet burgim;*
- 1.4. pesë (10) vjet nga dënimi me mbi tri (3) vjet burgim;*
- 1.5. tri (6) vjet nga dënimi me mbi një (1) vit burgim; dhe*
- 1.6. dy (4) vjet nga dënimi me burgim deri në një (1) vit apo dënimi me gjobë.”*

Në mënyrë të njëjtë si në rastin e parashkrimit të ndjekjes penale edhe ekzekutimi ka pësuar ndryshime me kodin aktual.

Pra, në krahasim me kodin e vjetër, janë rritur afatet e parashkrimit, ku në rastin e dënimit mbi pesë vite ku afati ka qenë dhjetë (10) është bërë pesëmbëdhjetë (15), kurse pjesa tjetër është dyfishuar, nga tri (3) është bërë gjashtë (6) dhe nga dy (2) është bërë katër (4), për dënimin me burgim deri një (1) vij apo dënim me gjobë.

Kurse, në nenin 102 të KPK-së, janë përcaktuar afatet e parashkrimit të ekzekutimit të dënimeve plotësuese dhe masave të trajtimit të detyrueshëm.

Për dënimet plotësuese dhe masën e trajtimit të detyrueshëm nuk ka ndryshime me kodin e ri penal.

Për dënimet plotësuese afati i parashkrimit të ekzekutimit është pesë (5) vjet nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit, kurse për masën e trajtimit të detyrueshëm afati i parashkrimit është tre (3) vjet plotfuqishmëria e aktgjyqimit.

Situata të veçanta janë kur kemi zëvendësimin e dënimit me gjobë në dënim me burgim, atëherë në këto situata afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit do të llogaritet nga koha kur ka marrë formën e prerë dënimi me gjobë.¹⁷⁸

Ky mendim juridik është nxjerr për shkak të një Qëndrimi Parimor që e njëjta gjykatë me datën 10 shtator 2012¹⁷⁹ kishte nxjerr lidhur me kohën e llogaritjes së parashkrimit, i cili qëndrim kishte konstatuar se afati i parashkrimit rrjedh prej kohës kur aktvendimi i fundit të merr formën e prerë.

¹⁷⁸ Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës nr.219/2015, datë 10 korrik 2015.

¹⁷⁹ Qëndrim Parimor I Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 314/12, datë 10 shtator 2012.

3.2.4.1. Fillimi, ndërprerja dhe kalimi i dyfishit të afatit të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit

Edhe te parashkrimi i ekzekutimit të dënimit ligjvënësi e ka përcaktuar se kur fillon të rrjedhë afati i parashkrimit, i ka përcaktuar rastet se kur ndërprehet afati i parashkrimit dhe po ashtu edhe rastet se çka ndodh nëse kalon dyfishi i afatit të parashkrimit.

3.2.4.1.1. Fillimi i afatit të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit

Afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit fillon të llogaritet nga momenti kur aktgjykimi e merr formën e prerë.

Në rastet kur kemi të bëjmë me ekzekutimin e dënimeve alternative të cilat janë revokuar, atëherë parashkrimi fillon nga dita kur vendimi mbi revokimin e dënimit e merr formën e prerë, apo thënë *është bërë i plotfuqishëm*¹⁸⁰.

Në rastet kur kemi të bëjmë me dënime të cilat zbuten për shkak të institutit të faljes, si afat për të llogaritur parashkrimin do të merret dënimi i ri.

Situatë që ka të bëjë me parashkrim është edhe rasti kur kemi të bëjmë me zbutje të dënimit sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik. Llogaritja e afatit të parashkrimit do të bëhet duke marrë për bazë dënimin fillestar.

3.2.4.1.2. Ndërprerja e afatit të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit

Në KPK, neni 101 paragrafi 2, është e paraparë një situatë e cila përcakton në mënyrë decitive se “*Parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve ndërpritet kur personi i dënuar nuk paraqitet ose nuk dorëzohet për mbajtjen e dënimit me burgim*”.

¹⁸⁰ Salihu, Ismet, E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2003, f.563.

Legjislacionet e vendeve të ndryshme kanë përciptime të ndryshme, disa janë si kodi ynë penal¹⁸¹, e disa të tjera nuk e njohin këtë institut në raport me ekzekutimin e dënimit.¹⁸²

Nëse shihet kjo dispozitë ligjore, atëherë do të ishte e panevojshme përcaktimi i mundësisë ligjore lidhur me parashkrimin e ekzekutimit të dënimit.

Shteti duhet të ketë mekanizma me të cilët bënë ekzekutimin e dënimeve, ashtu që mosparaqitja vullnetare në vuajtje të dënimit si veprim i vetëm të mos bëjë ndërprerjen e parashkrimit.

Pikërisht kjo dispozitë gjenë përgjigje në dispozitën vazhduese, nenin 103 paragrafi 2 i KPK-së që ka të bëjë me atë që parashkrimi nuk rrjedh në rastet “kur sipas ligjit ekzekutimi i dënimit nuk mund të fillohet”.

Raste tjera të cilat përcaktojnë se ndërprehet afati i ekzekutimit të dënimit janë: ndërmarrja e çfarëdo veprimi nga organi kompetent me qëllim të arritjes së ekzekutimit, siç janë veprimet operative për arrestim, kërkesat ndërkombëtare etj.

Në një vendim gjyqësor, pikërisht mbi këtë bazë është konstatuar se:

“Sipas nenit 107, par. (6) të KPRK-së së vitit 2013, ecja e afatit të parashkrimit është ndërprerë dhe në bazë të nenit 107, par. (7) të KPRK-së së vitit 2013 pas ndërprerjes ka filluar rishtas. Rrjedhimisht, kur ndjekja penale për këtë vepër penale ka filluar më 4 shkurt 2011, nuk kishte skaduar akoma afati i parashkrimit relativ të veprës penale (Kodi i procedurës penale i kaluar).¹⁸³

Në këto raste është përcaktuar se me ndërprerjen e afatit të parashkrimit, krijohet afati i ri i parashkrimit. Në këto raste, koha e cila ka kaluar para ndërprerjes nuk llogaritet.¹⁸⁴

Pra, edhe këtu afati i parashkrimit fillon të ecë rishtas.¹⁸⁵

¹⁸¹ Kodi Penal i Republikës së Sllovenisë, 2008, neni 92.

<https://www.wipo.int/edocs/lexdocs/laws/en/si/si045en.pdf>, qasur me datë 14 janar 2019.

¹⁸² http://ligjet.info/kodipenal/pjesa_i/kreu_viii/neni_68, qasur me datë 14 janar 2019.

¹⁸³ Aktvendimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë PAKR nr.442/13, datë 2 prill 2014.

¹⁸⁴ Salihu, Ismet, E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2003, f. 562.

¹⁸⁵ Po aty.

3.3. AFATET LIDHUR ME VEPRIME TË ÇAKTUARA PROCEDURALE GJATË FAZËS PARAPENALE

3.3.1. Masat e marra para fillimit të procedurës penale

Gjatë hetimit dhe zhvillimit të procedurave që kanë të bëjnë me rastet penale, nuk është e lehtë për organet e ndjekjes që të sigurojnë provat materiale lidhur me veprën penale të kryer apo të supozuar që është kryer. Ligjvënësi i ka paraparë disa veprime parapenale që prokuroria mund t'i ndërmarrë për të siguruar prova edhe para se formalisht të fillojë hetimin.¹⁸⁶

Këtu është fjala për aplikimin e masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, të cilat aplikohen pasi plotësohen disa kritere bazë.

Kriteret bazë kanë të bëjnë me dënueshmërinë e tyre-sanksionin penal të përcaktuar për veprën penale që dyshohet, por edhe për vet veprat penale të përcaktuara, pavarësisht dënueshmërisë.

Në këtë mënyrë, është e përcaktuar se në rastet kur prokurori i shtetit ka dyshim të bazuar se, e para, është kryer vepër penale për të cilën vepër dënueshmëria fillon prej pesë (5) e më shumë vite ose, e dyta, për veprat të cilat janë të listuara në nenin 90 të KPPK-së.

Derisa e dyta ka të bëjë me veprat penale të përcaktuara në Kodin penal të Kosovës dënueshmëria e të cilave minimumin nuk e kanë së paku/prej pesë (5) vite burgim, ajo ka të bëjë me kriterin që veprat penale duhet të kryhen në lidhje me terrorizëm, korrupsion apo krim të organizuar. Edhe kjo kategori e veprave penale, është e listuar.

Lidhur me këto masa, janë të përcaktuara afatet e caktuara të cilat duhet të respektohen, sidomos nga prokuroria dhe policia, por edhe nga gjykata.

Në shumicën e hulumtimeve të siguruara, në praktikë këto masa vlerësohen të atilla që paraqesin rrezik nëse publikohen gjatë fazës së hetimit. Rreziku vlerësohet se ka të bëjë me dëshmitarët, të dëmtuarit apo edhe policinë.

¹⁸⁶ Qarkore lidhur me masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit i Gjykatës Supreme të Kosovës nr.12/2015, datë 12 janar 2015.

3.3.1.1. Afatet lidhur me aplikimin e masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit

Masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit janë masa që aplikohen në procesin penal, me qëllim të sigurimit të provave materiale që kanë të bëjnë me veprën dhe kryesin penal.

Disa nga masat lëshohen nga prokurori e disa lëshohen nga gjykata, e në rastet kur masat nuk lëshohen në pajtim me ligjin ato do të jenë të kundërligjshme dhe nuk mund të përdoren si prova në procedurë.¹⁸⁷

Meqenëse bëhet fjalë për masat të cilat dukshëm prekin themelet e të drejtave dhe liritë e qytetarit edhe zbatimi i tyre supozon plotësimin paraprak të kërkesave të caktuara me të cilat limitohet zbatimi i tyre vetëm në rastet kur marrë kushtimisht, në mënyrë tjetër nuk është e mundur të zhvillohet hetimi penal, ose zbatimi i tyre ngërthen vështirësi të mëdha në vete.¹⁸⁸

KPPK-ja në nenin 87 paragrafi 1 parasheh dymbëdhjetë (12) masa të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit: vëzhgim i fshehtë fotografik ose me video, monitorim i fshehtë i bisedave, kontrollim i dërgesave postare, përgjimi i telekomunikimeve dhe duhet të përdoret Lexuesi – IMSI – Identifikimi Ndërkombëtar i Shfrytëzuesit Mobil, përgjim i komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik, dërgim i kontrolluar i dërgesave postare, shfrytëzim i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes, blerje e simuluar e ndonjë sendi, stimulim i veprës së korrupsionit, hetim i fshehtë, regjistrim i thirrjeve telefonike dhe zbulim i të dhënave financiare.

Këto masa prekin drejtpërdrejtë privatësinë dhe të drejtat elementare të njeriut, që mund të jenë subjekt i hetimit, por edhe që mund të ndërlidhen me hetimin pa qenë palë e drejtpërdrejt.

Për këtë arsye, është e përcaktuar se këto masa duhet të aplikohen shumë rrallë, gjë e cila në praktikë është e kundërt, duke u aplikuar shpesh e më shpesh.

¹⁸⁷ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, DKR P.nr.322/09 (P.nr.45/13), datë 18 tetor 2013.

¹⁸⁸ Sijerçiq-Çoliq, Hajrija & Halilović, Haris, E drejta e procedurës penale, me vështrim të posaçëm në procedurën penale të Kosovës, Prishtinë, 2007, f.134.

Andaj, gjykata duhet të vlerësojë se përgjimi i telekomunikeve a është i nevojshëm për hetimin e veprës së caktuar.¹⁸⁹

Në këtë mënyrë, afatet për të filluar, zgjatur apo përfunduar aplikimin e këtyre masave është i rëndësishëm së veçantë.

3.3.1.2. Urdhri i përkohshëm i prokurorisë

Afatet për të ndërmarrë veprimet e caktuara lidhur me masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit mund t'i ndajmë në dy faza.

Faza e parë ka të bëjë me afatin e lëshimit të urdhërave të përkohshëm të cilët lëshohen nga ana e prokurorisë dhe këta urdhëra kanë karakter urgjent. Derisa ata urdhëra kanë karakter urgjent, njëkohësisht kanë efekt të përkohshëm.

Këtu vijnë në konsideratë afatet ligjore që kanë të bëjnë me kohën e konfirmimit të masave me shkrim nga gjyqtari i procedurës paraprake.

Afati për një veprim të tillë është tri (3) ditë prej ditës së lëshimit të urdhërit, në të kundërtën urdhri do të jetë i paligjshëm.

Sipas nenit 91 paragrafi 1 i KPPK-së, nëse nuk kemi konfirmim brenda këtij afati, atëherë masa e zbatuar është me urdhër pa efekt dhe rezultatet e masës vlerësohen se janë të paligjshme dhe nuk mund të shfrytëzohen si prova në procesin penal.

Në këtë mënyrë, konfirmimi do ta bëjë edhe vlerësimin me shkrim të ligjshmërisë së urdhrit të përkohshëm.¹⁹⁰

¹⁸⁹ Kursani, Shpend, Përgjimi ligjor i telekomunikimeve në Kosovë: Implikimet për sigurinë, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, Prishtinë, 2011, f.8.
http://www.qkss.org/repository/docs/Pergjimi_ligjor_i_telekomunikimeve_486450.pdf, qasur me datë 15 shtator 2018.

¹⁹⁰ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.278.

3.3.1.3. Fillimi i zbatimit të urdhrave

Urdhërat që aplikohen duhet të zbatohen.

Ligjvënësi e ka përcaktuar se urdhri duhet të fillojë të zbatohet menjëherë, e më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë prej momentit të lëshimit të urdhrit konkret, dmth *jo më vonë se 15 ditë pas dhënies së tij*¹⁹¹

Neni 93 paragrafi 1 i KPPK-së, vë në dijeni se në rast se urdhri nuk fillon të zbatohet brenda këtij afati, atëherë do të vlerësohet se urdhri është duke u zbatuar pa vendim gjyqësor.¹⁹²

Afat i njëjtë është edhe detyrimi ligjor që ka personi i autorizuar për të raportuar te prokurori apo gjyqtari, varësisht se kush e ka lëshuar urdhrin për rezultatin e zbatimit të urdhërit.

Urdhri për zbatim të cilësdo masë të fshehtë dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit kërkon që pjesëtarët e autorizuar ligjor të policisë gjyqësore të dërgojnë raport për zbatimin e urdhrit, nëpunësit të legjislacionit i cili e ka dhënë autorizimin në intervale prej 15 ditësh¹⁹³ nga dita e dhënies së urdhrit.

3.3.1.4. Periudha e aplikimit të masave

Neni 92 paragrafi 1 i KPPK-së, lidhur me masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit ka paraparë se ato nuk mund të aplikohen më gjatë se gjashtëdhjetë (60) ditë prej datës së lëshimit të urdhrit gjyqësor.

Ky afat është kushtëzimi i parë lidhur me afatin se për çfarë periudhe kohore mund të lëshohet një urdhër.

Në praktikë më së shpeshti aplikohet masa e përgjimit të telekomunikimeve të telefonave celularë dhe gjatë përgjimit të numrit të caktuar të personit të dyshuar i cili është subjekt i hetimit, përgjohen edhe persona tjerë të cilët nuk kanë qenë cak hetimi, por bisedat e tyre

¹⁹¹ Sijerçiq-Çolliq, Hajrija & Halilović, Haris, vep.cit., f.143.

¹⁹² Si në 188, f.283-284.

¹⁹³ Sijerçiq-Çolliq, Hajrija & Halilović, Haris, vep.cit., f.141.

vlerësohet me rëndësi për hetuesit. Shpesh kjo sjellë edhe shkeljen e të drejtave të njeriut në masë të madhe, përmes përgjimeve edhe të bisedave private.¹⁹⁴

Në këto raste, mund të përgjohen edhe ata numra, por gjithsesi duhet të sigurohen urdhra shtesë të urdhrit paraprak-bazë, në të kundërtën provat e siguruara do të vlerësohen si të papranueshme nga ana e gjykatës.¹⁹⁵

Kohëzgjatja e atij urdhri të siguruar tani është e kufizuar deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë, e i cili urdhër mund të ripërtërihet deri në nëntëdhjetë (90) ditë (*Neni 92, par.6.3.*).

3.3.1.5. Zgjatja e aplikimit të masave

Ligjvënësi i ka përcaktuar disa afate të mundshme për zgjatjen e masave.

Është e përcaktuar se shumica e masave mund të zgjaten më së shumti deri në gjashtëdhjetë (60) ditë dhe mundësia e ripërtirjes së urdhërit brenda afatit prej treqindgjashtëdhjetë (360) ditë¹⁹⁶ prej momentit e lëshimit të urdhrit (*neni 94, par.2*).

Këto afate kanë të bëjnë në rastet kur masat aplikohen në vende publike, masa me karakter më publik. Sepse, masat që aplikohen në vende private, siç është përgjimi i telekomunikimeve kanë afate më të shkurtëra.

Në të njëjtin nen dhe paragraf është përcaktuar po ashtu se urdhrat për masa mund të zgjaten deri në gjashtëdhjetë (60) ditë, kurse ripërtëritja mund të bëhet edhe për gjashtëdhjetë (60) ditë të tjera.

Fatkeqësisht, që nga kohërat e telefonave të parë sistemi shtetëror ka bërë përgjime përtej nevojës ligjore.¹⁹⁷

¹⁹⁴ Shiko: Bedi, Monu, The curious case of cell phone location data: Fourth amendment doctrine mash-up, Northwestern University Law Review, 2015.

https://scholarlycommons.law.northwestern.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1231&context=nulr_online qasur me datë 22 qershor 2017.

¹⁹⁵ Aktgjykimi Gjykatës së Apelit në Prishtinë PAKR.347/13, datë 18 gusht 2015. [https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/\(2015.08.18\)_JUD_-_N.D._et_al.\(CoA\).ALB.pdf](https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/(2015.08.18)_JUD_-_N.D._et_al.(CoA).ALB.pdf), qasur me datë 24 prill 2017.

¹⁹⁶ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.285.

¹⁹⁷ Herbert Kraus, The Nuremberg Trial of the Major War Criminals: Reflections after Seventeen Years, 13 DePaul L. Rev. 233 (1964), f.234.

<https://via.library.depaul.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=3350&context=lae-review>, qasur me datë 24 janar 2015.

3.3.1.6. Njoftimi i personit i cili ka qenë nën masë

Të gjithë personat që i janë nënshtruar masave apo janë prekur gjatë aplikimit të masave, pas përfundimit të masave duhet të njoftohen se kanë qenë nën masa të tilla.

Këta persona që duhet të njoftohen janë: i akuzuari, personat tjerë që nuk janë të akuzuar por kanë qenë nën masa, personat që kanë jetuar apo që kanë poseduar hapsirën private që ka qenë nën masa.

Edhe pse nuk është e përcaktuar saktë se në çfarë kohe duhet të bëhet njoftimi, ajo supozohet se duhet të bëhet sa më parë që të jetë e mundur, më së largu dymbëdhjetë (12) muaj pasi që masa ka përfunduar. Ky afat është paraparë në nenin 96 të KPPK-së.¹⁹⁸

Këtë njoftim e bënë prokurori i shtetit me shkrim, njëkohësisht duke e njoftuar edhe për të drejtën që ai ka për ushtrim të padisë në gjykatën kompetente. Në këtë rast fillon të llogaritet afati prej gjashtë (6) muajve nga data e njoftimit, për ushtrimin e padisë së kompensimit.

Njoftimi bëhet edhe me qëllim që personat e tillë të kenë mundësinë të ushtrojnë të drejtën e tyre për t'iu drejtuar gjykatës për të vlerësuar ligjshmërinë e aplikimit të masave të caktuara.

Kështu që afati për kërkesë të tillë është deri në dy (2) javë pas njoftimit për masën e caktuar. Varësisht se cilat masa janë aplikuar, e të cilat kanë mundur të jenë në vazhdimësi apo të jenë të aplikuara kohë pas kohe, afati rrjedh prej momentit kur ka përfunduar masa e fundit. Ky afat është gjashtë (6) muaj te shumica e masave, sidomos atyre me karakter më privat.

Ligjvënësi e ka paraparë se çdo vonesë në mosnjoftim me kohë duhet të aprovet me urdhër të veçantë të gjyqtarit. Kur ekziston mundësa që kushtet për njoftim të mos përmbushen as në të ardhmen, gjykata mund të aprovojë lejimin për shtyrje të përhershme të njoftimit.¹⁹⁹

¹⁹⁸ Udhëzim i Zyrës së Kryeprokurorit të shtetit lidhur me zbatimin e nenit 96 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës për masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit, A.nr.442/2015, datë 22 tetor 2015.

¹⁹⁹ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.289.

3.3.2. Marrja e deklaratave në procedurën paraprake

Si veprim procedural me rëndësi është edhe marrja e deklaratës në procedurë paraprake nga ana e dëshmitarëve, viktimat, ekspertët dhe i pandehuri.

Për të ekzistuar transparenca, e sidomos për tu respektuar afati kohor për një gjykim të arsyeshëm dhe në kohë, është përcaktuar se palëve duhet dhënë mundësia për të qenë të njoftuar për marrjen e këtyre deklaratave.²⁰⁰

Në këtë mënyrë palët do të kenë mundësi të paraqesin pretendimet e tyre, opinionet, ofrimin e provave, ndihmë në sigurimin e provave në afat të arsyeshëm, sidomos të atyre provave që më vonë nuk mund të sigurohen.

Për këtë arsye, është detyrim ligjorë, jo shprehje e vullnetit të lirë të prokurorit, që ai të njoftoj me shkrim mbrojtësin, të dëmtuarin dhe mbrojtësin e viktimave lidhur me datën, kohën dhe vendin e marrjes së deklaratës.

Pse ndodh kjo, një hulumtim i vitit 2013, ka treguar se prokurorët fare nuk mbajnë seancën e marrjes së deklaratës në procedurë paraprake, por ata i referohen praktikës së mëhershme.²⁰¹

Njoftimi i cekur më lartë duhet të bëhet të paktën pesë (5) ditë para se të merret deklarata.

Në rast se një njoftim i tillë nuk bëhet dhe është marrë deklarata, ligji iu mundëson palëve ta kundërshtojnë pranueshmërinë e asaj deklarate në fazat e mëtejme të procedurës, në shqyrtimin gjyqësor.²⁰²

Në atë mënyrë, deklarimi i caktuar nuk mund të ketë fuqinë e provës materiale dhe ky veprim zakonisht ndodh për shkak se organi i akuzës nuk respekton barazinë e palëve, frikësohet se lënda mund t'i devijohet në fazat e para të hetimit dhe me vetëdije i shmanget detyrimit ligjor që del nga dispozita e nenit 132 të KPPK-së.

²⁰⁰ Smibert, Jon, Udhëzues për Kodin e Procedurës Penale të Kosovës dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, *Departamenti i Drejtësisë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Zyra e Zhvillimit dhe Trajnimit të Prokurorëve Tejoqeanik, Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës*, Prishtinë, 2013, f.53-54.

²⁰¹ Shqyrtim i zbatimit të kodit të ri të procedurës penale në Kosovë, OSCE, qershor 2016, Prishtinë, f.23-24. <https://www.osce.org/sq/kosovo/243981?download=true>, qasur me datë 20 shkurt 2017.

²⁰² Shiko: Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.369.

Në praktikën aktuale gjyqësore të TPNJ-së konstatohet se provat e mbledhura ilegalisht në shkelje të ligjit vendor, në vetvete, nuk përbëjnë subjekt përjashtimi nga kategoria e provave.²⁰³

Këtë parim jo të drejtë është duke e pranuar tani Gjykata Speciale në Hagë, për krimet e luftës së Kosovës, që i bie edhe nëse kemi deklarata të marra në kundërshtim me ligjin, duke mos respektuar edhe afatet ligjore, të njëjtat do të pranohen për rastet që do të merret kjo gjykatë speciale.

3.3.3. Afatet lidhur me ekspertizat gjyqësore

Gjatë procedurës gjyqësore, pothuaj në secilin proces është e nevojshme kryerja e ekspertizave të natyrave të ndryshme.

Janë të nevojshme caktimi dhe angazhimi i ekspertëve të ndryshëm për dhënjen e ekspertizave të duhura, psh psikiatrike, psikologjike, ADN, Patologjike²⁰⁴, financiare²⁰⁵ etj për të siguruar prova dhe për të konstatuar një gjendje faktike që është objekt shqyrtimi. Është e përcaktuar se ekspertizat mund të bëhen që në fazën fillestare të procesit.

Kur eksperti caktohet nga ana e prokurorit, gjë e cila bëhet me vendim të posaçëm, atë vendim duhet dërguar palëve në proces (të pandehurit-mbrojtjes).

Vendimi i dërgohet palëve me arsyen që lidhur me zgjedhjen e ekspertit të caktuar²⁰⁶, të mund të paraqesin kundërshtimet e tyre palët.

Në pajtim me nenin 137 të KPPK-së, është përcaktuar edhe mënyra e kundërshtimit që mund të bëhet te gjyqtari i procedurës paraprake, i cili e ka për detyrim që në afatin prej dhjetë (10) ditësh të vendos për kundërshtimet e paraqitura.²⁰⁷

²⁰³ Manual për mbrojtjen penale ndërkombëtare, Praktikat e zhvilluara nga SHAM-TPNJ, Përgatitur në kuadrin e Projektit të Drejtësisë për Krime Luftës, Itali, 2011, f.99.

²⁰⁴ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, DKR P.nr.322/09 (P.nr.45/13), datë 18 tetor 2013.

²⁰⁵ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë, PAKR.nr.135/2013, datë 6 shkurt 2014.

²⁰⁶ Smibert, Jon, Udhëzues për Kodin e Procedurës Penale të Kosovës dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, *Departamenti i Drejtësisë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Zyra e Zhvillimit dhe Trajnimit të Prokurorëve Tejoqeanik, Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës*, Prishtinë, 2013, f.6.

²⁰⁷ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.380.

Neni 138 paragrafi 5 i KPPK-së ka treguar rrugën se si pas kryerjes së ekspertizave të caktuara, të njëjtat duhet t'i ofrohen palëve tjera, të paktën pesë (5) ditë para marrjes së deklaratës nga eksperti (*nëse ai do të merret në pyetje*) dhe jo më vonë se dhjetë (10) ditë pas pranimit të raportit.²⁰⁸

Duke qenë se ekspertizat mund të bëhen edhe nga ekspertët e caktuar dhe të paguar nga i pandehuri-mbrojtja edhe për ato ekspertiza duhet të njoftohen palët tjera.

Në këtë rast, ekspertiza duhet t'i ofrohet prokurorit të shtetit dhe atë në afat prej katërmëdhjetë (14) ditësh prej momentit kur ka përfunduar ekspertiza, sipas nenit 141 paragrafi 2.²⁰⁹

Siç po shihet, afati është më i gjatë për të njoftuar palën e kundërt në rastin e ekspertizës së kryer nga ana e mbrojtjes.

Kjo për shkak se prokuroria-akuza i ka mekanizmat e shtetit në duar dhe mund të veprojë me urgjencë në krahasim me të pandehurin-mbrojtjen.

3.3.4. Shkatërrimi i mostrave

Lidhur me ekspertizat afat me rëndësi është afati i shkatërrimit të mostrave të marra lidhur me ekzaminimet e lëndimeve trupore dhe ekzaminimet fizike.

Neni 144 paragrafi 9 i KPPK-së, përcakton afatin për shkatërrim e këtyre mostrave i cili është një (1) vit prej momentit kur është marrë aktvendimi përfundimtar në procedurë gjyqësore. Kjo dispozitë e detyron Ministrinë e Drejtësisë për ta bërë mbajtjen e mostrave²¹⁰

Kurse, për rastet që kanë të bëjnë me ekzaminime të ADN-së, afati i shkatërrimit të mostrave është menjëherë, dmth, me mundësinë e parë prej kur është kryer ekzaminimi.

²⁰⁸ Po aty, f.384-385.

²⁰⁹ Po aty, f.386-387.

²¹⁰ Po aty, f.395.

3.3.5. Zbatimi i kontrollit

Në secilin proces gjyqësor është e nevojshme të zbatohen kontrollime të ndryshme, me qëllimin kryesor- sigurimin e provave materiale.

Për të siguruar prova materiale, për të bërë arrestimin e personit të kërkuar, për të shpëtuar jetën e njerëzve shpesh bëhen kontrollime të shtëpive, lokaleve, hapsirave të ndryshme që mund të jenë prona publike dhe po ashtu prona private.

Për ndërmarrjen e këtyre kontrollimeve kërkohen leje të veçanta gjyqësore dhe ato leje lëshohen në periudha të caktuara kohore dhe kanë efekte të ndryshme juridike.

Lejet mund të jenë në formë të shkruara por edhe verbale.

Në këtë mënyrë, kontrollat që bëhen mund të jenë edhe pa leje të veçanta të shkruara, por që gjithmonë kërkohet që ato leje verbale të aprovohen në mënyrë retroaktive në formë të shkruar.

Dhe më kryesorja, çdo kontrollim është i kushtëzuar me faktorin afat/kohë.

3.3.5.1. Kontrolli me urdhër të shkruar

Urdhrat për kontrollim zakonisht lëshohen në fazën e hetimeve, procedurën paraprake, por rrallë herë, mund të lëshohen edhe gjatë procesit gjyqësor. Kontrolli zbatohet në pajtim me nenin 106 të KPPK-së.

Në fazën e hetimeve urdhri i lëshuar për kontrollim të cilin e lëshon gjyqtari i procedurës paraprake, është e përcaktuar që ai urdhër duhet të zbatohet brenda afatit prej dyzetë e tetë (48) orëve prej momentit të lëshimit të tij.²¹¹ Pra, afati ligjor është dy (2) ditë prej orës së lëshimit të urdhrit për tu zbatuar.

Është e përcaktuar koha/intervali kohor brenda të cilit afat duhet të zbatohet e që është intervali kohor nga ora 06 e mëngjesit deri 22 të mbrëmjes.

²¹¹ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.306.

Ligjvënësi e ka paraparë mundësinë edhe kur urdhrat e filluar në zbatim, nuk mund të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar kohor. Për këtë arsye është përcaktuar se këto afate mund të zgjaten.

Afatet e zbatimit të urdhrit të filluar mund të zgjaten në këtë mënyrë:

Kur kontrollimi ka filluar brenda afatit 06:00 deri 22:00, por që nuk ka mundur të përfundojë deri në ora 22:00, kontrollimi mund të vazhdojë derisa të përfundojë.

Kusht është që kontrolli të ketë filluar para orës 22:00. Ose ekzistojnë shkaqet e arsyeshme për bastisje edhe pa urdhrin e gjykatës apo nëse gjyqtari i procedurës paraprake vendos se shtyrja mund të sjell deri tek arratia e personit të kërkuar apo deri te shkatërrimi i gjurmëve dhe provave të veprës penale, prandaj për këtë arsye e lejon bastisjen jashtë kësaj periudhe kohore.²¹²

3.3.5.2. Kontrollimi pa urdhër të shkruar

Ka raste të arsyeshme dhe urgjente që është e pamundur të merret urdhër i shkruar nga gjykata për zbatim të kontrollit.

Këro raste janë të natyrës operative e që ka të bëjë sidomos me shpëtimin e jetës, atëherë kur mund të pritët rezistencë e armatosur etj.

Pastaj kemi rastet e arrestimit në kryerje e sipër të veprës penale/flagrancë të personit të kërkuar dhe të fshehur, e raste tjera.

Edhe pse për këto raste kontrollimet bëhen me urdhra verbal, prapë se prapë është e detyrueshme dhe kërkohet që ata urdhra verbal të mbulohen me shkrim, përmes aprovimit me fuqi retroaktive nga gjyqtari i cili e ka dhënë urdhrin verbal.

Neni 110 paragrafi 6 i KPPK-së, e ka përcaktuar detyrimin ligjor që ka policia për ta raportuar rezultatin e kontrollit te prokurori dhe gjyqtari kompetent.

²¹² Sijerçiq-Çolliq, Hajrija & Halilović, Haris, vep.cit., f.124.

Nëse policia ka ndërmarrë kontrollin pa urdhër me shkrim të gjykatës, ajo më së voni 12 orë pas kontrollit duhet t'ia paraqes raportin prokurorit publik dhe gjyqtarit të procedurës paraprake nëse është caktuar për rastin gjyqtari i procedurës paraprake.²¹³

Raporti i dërguar do të shërbej për sigurimin e aprovimit retroaktiv për kontrollimin e zbatuar dhe me të vetmen arsye që rezultati i kontrollimit, provat e siguruara të vlerësohen valide dhe të pranueshme në procesin gjyqësor.²¹⁴

Edhe pse nuk është e përcaktuar se brenda cilës kohë duhet të lëshohet urdhëri retroaktiv, ai supozohet se duhet të lëshohet menjëherë prej momentit kur dorëzohet raporti mbi kontrollimin.

3.3.5.2.1. Afatet për pritjen e avokatit

Personi ndaj të cilit zbatohet kontrolli me urdhër, njoftohet edhe për të drejtën e tij që ai ka për të njoftuar avokatin e tij për të qenë prezentë gjatë zbatimit të kontrollit.

Afati i pritjes së avokatit është më së shumti dy (2) orë prej momentit të njoftimit të personit për zbatim të kontrollit. Nëse brenda afati prej dy (2) orëve nuk arrin avokati, kontrollimi do të fillojë pa prezencë të tij. Kjo çështje është rregulluar në nenin 107 par.2 të KPPK-së.²¹⁵

Ky afat kohor prej dy (2) orëve për të pritur avokatin është i njëjtë me afatin që ka të bëjë në rastin e pritjes së avokatit për marrjen në pyetje të personit. Përveç se kjo situatë dallon, e që paragrafi 1 i nenit 171 e ka përcaktuar situatën kur kemi vonesë të avokatit i cili nuk arrin brenda afatit prej dy (2) orësh, i shtohet edhe një (1) orë tjetër pritjes së avokatit të dytë, të zgjedhur apo të caktuar zyrtarisht me shpenzime të shtetit.²¹⁶

Situatë e tillë nuk është në rastin e kontrollimit. Në rrethanat urgjente policia gjyqësore mund ta fillojë kontrollin edhe para kalimit të afatit për ardhjen e avokatit.²¹⁷

²¹³ Po aty, f.127.

²¹⁴ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.318.

²¹⁵ Po aty, f.310.

²¹⁶ Po aty, f.458.

²¹⁷ Sijerçiq-Çolliq, Hajrija & Halilović, Haris, vep.cit., f.124.

3.4. AFATET E TRAJTIMIT TË PASURISË GJATË PROCEDURËS PENALE

3.4.1. Ngrirja e përkohshme e aseteve nga ana e prokurorisë

Prokuroria e shtetit ka autorizimet ligjore që ajo të mund të lëshojë urdhra të caktuar me të cilët ajo mund të bëjë ndalimin e shitjes apo të shkëmbimit të pronësisë të ndërtesave, shtëpive, pasurive të paluajtshme, pasurisë së luajtshme apo ndonjë aseti tjetër.

Është e detyrueshme që sendet e përdorura ose të destinuara për përdorim në kryerjen e një veprë penale dhe/ose objektet me prejardhje nga një veprë penale duhet të konfiskohen.²¹⁸

Këta urdhra lëshohen në rastet kur ato objekte/asete janë përdorur në veprën penale, kur ato janë prova të veprës penale dhe kur ato janë fituar nga vepra penale.

KPPK, në nenin 264, paragrafi 3 dhe 4 e ka përcaktuar mundësinë e lëshimit të këtyre urdhrave të përkohshëm që kanë të bëjnë edhe me ndalimin e tërheqjes nga llogaria financiare:

“3. Çfarëdo llogarie financiare që i takon të pandehurit nën hetim, në të cilën mund të ketë mjete të cilat janë:

3.1. të ardhura nga vepra penale nën hetim; ose 3.2. përdorur në kryerjen e vazhdueshme të veprës penale nën hetim.

4. Urdhri i prokurorit të shtetit nga ky nen ka efektin e mëposhtëm:

*4.1. çdo bankë apo institucion financiar që pranon urdhrin nga ky nen menjëherë ndalon çfarëdo aktiviteti të mëtejshëm të llogarisë bankare të përshkruar në urdhrë. Banka nuk është përgjegjëse ndaj mbajtësit të llogarisë bankare për veprimet e saj në pajtim me urdhrin nga ky paragraf*²¹⁹.

Urdhri i përkohshëm për ngrirje të aseteve ka fuqi vepruese vetëm për shtatëdhjetë e dy (72) orë nga koha e lëshimit të tij.

²¹⁸ Udhëzimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit lidhur me veprimet e prokurorëve në lidhje me sendet e sekuestruara dhe të konfiskuara përkohësisht apo për pasurinë për të cilën është lëshuar urdhri për ngrirje, A.nr.4/2014, datë 14 janar 2014.

²¹⁹ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.695-696.

Pas kalimit të këtij afati, nëse nuk kemi urdhër të gjykatës, atëherë shfruqizohet në mënyrë automatike urdhri i përkohshëm.

Edhe pse është detyrim që në urdhër të shënohet koha e lëshimit dhe koha e skadimit të tij, në praktikë nuk ndodh shpesh.

Rasti i tillë është Urdhri për ngrirje të përkohshme të aseteve i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i përgjithshëm, PP/II,nr.3082/2017 datë 27.07.2017.

Ky urdhër, nuk e ka të shënuar kohën e lëshimit dhe kohën e skadimit të tij.²²⁰

3.4.2. Ngrirja e aseteve nga ana e gjykatës

Siç u cekë në pjesën e mësipërme, urdhrat për ngrirje të përkohshme të aseteve nga ana e prokurorisë janë të përkohshëm dhe kanë fuqi vepruese vetëm shtatëdhjetë e dy (72) orë nga koha e lëshimit të tij.

Këta urdhra, për të pasur fuqi veprimi edhe më tutje duhet që Prokuroria të kërkojë nga gjykata, pikërisht nga Gjyqtari i procedurës paraprake, që të lëshohet urdhër ndalues për secilin aset të përcaktuar në urdhrin e përkohshëm të tij.

Afati për të vendosur lidhur me këtë kërkesë të prokurorisë, është afati brenda të cilit ka fuqi veprimi urdhri i përkohshëm. Pra, nuk duhet të kalojë më shumë se shtatëdhjetë e dy (72) orë prej momentit të lëshimit të urdhrin deri në nxjerrjen e urdhrin nga ana e gjykatës. Këtë e rregullon nenin 265 i KPPK-së.

Ky urdhër i gjykatës ka fuqi veprimi për periudhën kohore tridhjetë (30) ditë nga koha e lëshimit të tij.

Edhe në këtë urdhër duhet të shënohet koha e saktë e lëshimit të tij dhe koha e saktë e skadimit.²²¹

²²⁰ Urdhëri për ngrirje të përkohshme të aseteve i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i përgjithshëm, PP/II,nr.3082/2017 e datës 27 korrik 2017.

²²¹ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.698.

3.4.3. Shqyrtimi gjyqësor mbi urdhrin ndalues

Pasi të caktohet urdhri ndalues, lindin edhe disa afate ligjore që kanë të bëjnë me mbajtjen e seancës lidhur me urdhrin ndalues.

Neni 265 paragrafi 8 i KPPK-së e përcakton që seanca shqyrtuese për të vendosur lidhur me urdhrin ndalues edhe për më tutje bëhet brenda afati prej tre (3) javësh²²² nga momenti i dorëzimit të urdhrit personit por edhe personave tjera që kanë interes në asetën e caktuar.

Në seancë do të trajtohen të gjitha argumentet e mundshme nga palët e interesuara dhe në rast se nga gjykata aprovohet kërkesa e prokurorisë për ndalim afatgjatë, gjykata lëshon urdhrin për ndalim afatgjatë, *“i cili zgjat deri në fund të gjykimit”*²²³.

Kundër këtij urdhri afati për të ushtruar ankesë është dhjetë (10) ditë nga momenti i lëshimit të urdhrit afatgjatë.

Neni 266 i KPPK-së e përcakton se në këto raste ankesa nuk e bënë pezullimin e ekzekutimit të urdhrit për ndalim afatgjatë.²²⁴

3.4.4. Sekuestrimi i përkohshëm

Sekuestrimi dhe konfiskimi në procedurën penale janë terme që përdoren në lidhje me marrjen e sendeve të caktuara/pasurisë. Sekuestrimi ka të bëjë me marrjen e përkohshme të sendeve, derisa konfiskimi ka të bëjë me marrjen e përhershme, përfundimtare të sendeve/pasurisë që kanë lidhje me veprën penale që është objekt trajtimi në një çështje penale.

Sipas Ligjit për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, *“Sekuestrim do të thotë marrja e përkohshme e sendit në bazë të vendimit të gjykatës apo organit kompetent, në pajtim me ligjin”*²²⁵.

²²² Po aty, f.698.

²²³ Udhëzimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit lidhur me veprimet e prokurorëve në lidhje me sendet e sekuestruara dhe të konfiskuara përkohësisht apo për pasurinë për të cilën është lëshuar urdhri për ngrirje, A.nr.4/2014, datë 14 janar 2014.

²²⁴ Si 220, f.699-700.

²²⁵ LAPSK nr.05/L-049, Prishtinë, 2016, n.2, p.1.7.

Kodi i procedurës penale i Kosovës e ka përcaktuar me kujdes se cilat sende mund të sekuestrohen gjatë një procesi penal.

Në KPPK, nenin 112 paragrafi 1, është cekur shumë qartë se “*Sendet që përkohësisht mund të sekuestrohen janë sende që mund të jenë prova gjatë një procedure penale, sende ose pasuri që kanë mundësuar kryerjen e veprës penale, ose sende që konsiderohen dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprës penale dhe për të cilat ligji parasheh sekuestrimin*”.

Këto sende të cilat mund të jenë të ndryshme, si armë, automjete, telefona, kompjuter, dokumente, para dhe pajisje tjera, të cilat zakonisht gjenden gjatë kontrollimit të personave dhe objekteve apo edhe arrestimeve të ndryshme.

Sipas deklaratës së drejtorit të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, të vitit 2018, “*vlera më e madhe e konfiskuar dhe e sekuestruar është pasuria e paluajtshme*”²²⁶.

Paragrafi 2 i nenit 112 të KPPK-së, e ka bërë kufizimin ligjor që sekuestrimi i përkohshëm që bëhet me urdhër të prokurorisë zgjat më së shumti pesë (5) ditë.

Prokuroria duhet të kërkojë nga gjykata nxjerrjen e urdhrit të caktuar për sekuestrim të përkohshëm.²²⁷

3.4.5. Kthimi i sendeve të sekuestruara përkohësisht

Është përcaktuar se sendet për të cilat nuk ka bazë ligjore për konfiskim të përhershëm duhet t’i kthehen pronarit të tyre legjitim.

Në Kodin e procedurës penale, afati se kur duhet të kthehen këto sende nuk është i përcaktuar në mënyrë decisive, por kjo nënkuptohet me atë që sa më parë që të jetë e mundur, prej momentit kur pushojnë arsyet për të cilat është bërë sekuestrimi i përkohshëm.

Ligji për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, e ka përcaktuar se “*pas pranimi të vendimit të plotfuqishëm të gjykatës nga paragrafi 1 i këtij neni, Agjencioni*”²²⁸,

²²⁶ <https://kallxo.com/qindra-miliona-euro-te-sekuestruara-dhe-konfiskuara/>, qasur me datë 15 nëntor 2018.

²²⁷ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.322.

pa shtyrje, e më së voni në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimi të vendimit të formës së prerë obligohet të kthejë pasurinë e sekuestruar’’²²⁹

Ka raste kur sendi i gjetur te personi i caktuar i përket ndonjë personi tjetër të panjohur.

Në raste të tilla lindin disa afate me rëndësi që kanë të bëjë me paraqitjen e njoftimit-afishimit në tabelën e shpalljeve në objektin e Komunës.

Neni 117 paragrafi 1 i KPPK-së, e ka përcaktuar se njoftimi qëndron një (1) vit në shpallje dhe nëse brenda asaj kohe nuk paraqitet pronari, atëherë sendi shitet.

Pra këtu paraqitet afat i caktuar që ka të bëjë me periudhën kohore të qëndrimit të njoftimit në vend publik.²³⁰

Pas përfundimit të këtij afati sendet e sekuestruara mund të shiten dhe parat e shitjes kalojnë në buxhetin e shtetit.

3.4.6. Konfiskimi i përkohshëm

Në rastet që kanë të bëjnë me sekuestrimin e përkohshëm të përcaktuar si më lartë, ligjvënësi e ka përcaktuar një afat të konsiderueshëm për prokurorinë që ka të bëjë me ushtrimin e kërkesës për masë të përkohshme të sigurimit.

Ky afat për të paraqitur këtë kërkesë është më së largu gjashtëdhjetë (60) ditë.

Afat i njëjtë është edhe kur kemi të bëjmë me konfiskimin e sendeve *që merren gjatë kontrollit*²³¹.

Në këto raste, siç u cekë më lartë, *ato mund të sekuestrohen për 5 ditë nga ana e prokurorit*²³².

²²⁸ Agjencioni do të thotë Agjencia për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar dhe detyrat e saj janë të përcaktuara qartë në nenin 4 të LAPSK nr.05/L-049.

²²⁹ LAPSK nr.05/L-049, Prishtinë, 2016, n.26, p.2.

²³⁰ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.329

²³¹ Smibert, Jon, Udhëzues për Kodin e Procedurës Penale të Kosovës dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, *Departamenti i Drejtësisë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Zyra e Zhvillimit dhe Trajnimit të Prokurorëve Tejoqeanik, Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë, 2013, f.47.*

²³² Më gjerësisht: Udhëzimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit lidhur me veprimet e prokurorëve në lidhje me sendet e sekuestruara dhe të konfiskuara përkohësisht apo për pasurinë për të cilën është lëshuar urdhri për ngrirje, A.nr.4/2014, datë 14 janar 2014.

Neni 268 i KPPK-së e ka përcaktuar se kërkesa duhet të paraqitet në gjykatë, e cila pastaj e cakton masën e përkohshme për sigurimin e pasurisë së sekuestruar/ konfiskuar.²³³

3.4.7. Urdhri për masat e përkohshme të sigurimit të pasurisë

Nga momenti i paraqitjes së kërkesës për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, gjyqtari i procedurës paraprake merr aktvendim mbi kërkesën për masë të përkohshme të brenda afatit prej katërmëdhjetë (14) ditëve nga koha e paraqitjes së kërkesës.

Ky afat vlen në rastet kur nga ana e palëve të interesuara nuk është paraqitur asnjë kundërshtim ndaj kërkesës së prokurorisë.

Në nenin 272 të KPPK-së, është përcaktuar se në rastin e paraqitjes së kundërshtimeve- ankesave të tilla, atëherë vendimi mund të nxirret edhe pas katërmëdhjetë (14) ditëve dhe atë me apo pa mbajtje të seancës shqyrtuese.²³⁴

Kërkesa e prokurorisë mund të aprovohet, por edhe mund të refuzohet. Në të dy rastet, lindin disa afate shtesë që kanë të bëjnë me sendet.

Të dy urdhrat brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve duhet t'i dërgohen Agjencisë për Administrim të Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar (AAPSK). Në këtë rast AAPSK ekzekuton urdhrat në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, *“e cila pastaj merr përgjegjësinë për menaxhimin e aseteve...”*²³⁵. Edhe ndaj këtyre urdhrave palët kanë të drejtë ankesë.

Edhe pse nuk është e përcaktuar në mënyrë decitive ky afat në dispozitën e nenin 273 par.4 të KPPK-së, kuptohet se afati është tre (3) ditë nga dita e dorëzimit të aktvendimi. Kjo, në bazë të dispozitës së nenit 409 të KPPK-së.

Ankesa shqyrtohet nga kolegji shqyrtues i të njëjtës gjykatë që e ka nxjerr vendimin.

²³³ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.706-707.

²³⁴ Po aty, f.713-714.

²³⁵ Udhëzimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit lidhur me veprimet e prokurorëve në lidhje me sendet e sekuestruara dhe të konfiskuara përkohësisht apo për pasurinë për të cilën është lëshuar urdhri për ngrirje, A.nr.4/2014, datë 14 janar 2014.

3.4.8. Përfshirja apo mospërfshirja në aktakuzë e pasurisë që është objekt i konfiskimit

Në rastin e ngritjes së aktakuzës nga ana e prokurorisë, ndodh që pasuria që ka qenë objekt i konfiskimit të jetë apo të mos jetë e përfshirë në aktakuzë.

Në rastin kur nuk është e përfshirë në aktakuza pasuria si objekt i konfiskimit, atëherë palët kanë të drejtë të kërkojnë nga gjykata lirin e pasurisë.

Afati për të paraqitur këtë kërkesë është para shqyrtimit të dytë gjyqësor dhe është përcaktuar në nenin 271 paragrafi 1 i KPPK-së.²³⁶

Ligjvënësi i ka përcaktuar edhe disa rrethana të tjera të cilat ndikojnë në atë që pasuria e cila nuk është e përfshirë në aktakuzë të mos i lirohet palës.

Këto raste kanë të bëjnë me atë kur pasuria mund të jetë objekt i ndonjë procedure tjetër të konfiskimit, kur ajo mund të jetë provë në shqyrtim gjyqësor, kur është në një proces tjetër e i cili akoma nuk ka ngritje të aktakuzës.

Në këto raste nga gjykata pezullohet kthimi i pasurisë palës kërkuese.

Neni 274 i KPPK-së, ka paraparë disa afate tjera që kanë të bëjnë me kërkesën për lirim të pasurisë, e që është gjashtë (6) muaj për të përsëritur kërkesën për kthim pasurie në rastin kur nuk është ngritur aktakuza.

Në raste të tilla prokurorisë i jepet edhe një afat prej tre (3) muajsh për të vendosur në kërkesë për lirim pasurie dhe këto vlerësohen si rrethana të jashtëzakonshme.²³⁷

3.4.9. Pasuria që i nënshtrohet automatikisht konfiskimit

KPPK në nenin 282 paragrafi 1 ka paraparë se pasuria që është “*qenësisht e rrezikshme ose e paligjshme i nënshtrohet **automatikisht konfiskimit**, pa marrë parasysh gjetjet e gjyqtarit të vetëm gjykues ose trupit gjykues lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit. Poseduesi, shfrytëzuesi ose i pandehuri nuk ka të drejtë ankese*”²³⁸.

²³⁶ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.718.

²³⁷ Po aty, f.719.

²³⁸ Po aty, f.731-733.

Pra, për raste të tilla nuk ka nevojë për asnjë urdhër të veçantë për konfiskim apo sekuestrim të caktuar.

Këtu vjen në shprehje vetëm afati ligjor që ka të bëjë me njoftimin e prokurorit të shtetit brenda njëzetë e katër (24) orëve nga momenti kur është shkatërruar pasuria e rrezikshme. Për sqarim, pasuri e tillë që i nënshtrohet automatikisht konfiskimit janë armët, kimikalet e ndryshme, parat etj.²³⁹

²³⁹ Më gjerësisht: Udhëzimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit lidhur me veprimet e prokurorëve në lidhje me sendet e sekuestruara dhe të konfiskuara përkohësisht apo për pasurinë për të cilën është lëshuar urdhri për ngrirje, A.nr.4/2014, datë 14 janar 2014.

3.5. AFATET GJATË FAZËS SË HETIMIT PENAL

Kodi i Procedurës penale në nenin 104 paragrafi 1, ka përcaktuar se hetimi fillohet me aktvendim të prokurorit të shtetit, në të cilin përveç elementeve tjera që përmban, është edhe koha e fillimit të hetimit.²⁴⁰

Koha/afati e/i fillimit të hetimit ka rëndësi të madhe në çështjen penale, sepse, ajo gjatë tërë fazës së procedurës sjellë pasoja të ndryshme procedurale, e që e dirigjojnë shpesh, përveç rrjedhjes së procedurës por edhe përfundimin e tërë çështjes.

Pikërisht në bazë të kohës së përcaktuar lidhur me fillimin e hetimit, që është kusht i detyrueshëm për tu shënuar drejtë në Aktvendim, dalin edhe detyrimet tjera.

Detyrimet tjera që dalin kanë të bëjnë me afatin për shqyrtimin e detyrueshëm të lëndës hetimore, për pezullimin e hetimit, për pushimin e hetimit dhe për përfundimin e hetimit.

Respektimi i këtyre afateve janë bazë dhe garancë për një proces të drejtë dhe të ligjshëm, kjo sepse *“çështja e kohëzgjatjes së hetimit përbën një çështje të rëndësishme për zhvillimin e procedurës penale”*²⁴¹

3.5.1. Shqyrtimi i detyrueshëm i lëndës

Me qëllim që hetimi të zhvillohet në mënyrë sa më efikase dhe të mos vijë deri te neglizhenca, organi ndjekës-prokuroria është e detyruar të ndërmarr veprime të caktuara.

Ligjvënësi ka detyruar Prokurorinë, pikërisht prokurorin e lëndës që kohë pas kohe të shqyrtojë lëndën bashkërisht me kryeprokurorin e zyrës së tij, me qëllim të veprimit të caktuar ligjor.

Neni 156 i KPPK-së, ka paraparë detyrimin ligjor që prokurori i cili është duke zhvilluar hetimin është i detyruar që çdo tre (3) muaj ta shqyrtojë lëndën penale bashkë me shefin e tij (kryeprokurorin), në mënyrë të detajuar dhe të analizojë të gjitha shkresat e lëndës.²⁴²

²⁴⁰ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.303.

²⁴¹ Hajdari, Azem, Procedura penale, Komentar, Prishtinë, 2010, f.520.

²⁴² Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.429-430.

Ky shqyrtim ka të bëjë me atë që të vlerësohet në mënyrë profesionale dhe me afat sa më të shkurtër, drejt përfundimit se hetimi i filluar a duhet të mbetet i hapur akoma apo të vendoset se, ka prova të mjaftueshme për ngritjen e aktit akuzues, pushimit apo pezullimit të hetimit.

Për shkak se gjatë zhvillimit të hetimit duhet ndërmarrë veprime të ndryshme, siç është marrja në pyetje, ekzaminimet e ndryshme, ekspertiza etj, është e nevojshme që të vlerësohet se çka duhet të bëhet me hetimin.

Ky detyrim ligjor, në praktikë mund të themi se nuk është duke u zbatuar rregullisht apo më mirë të themi fare.

Në shkresat e lëndëve mund të themi se askund nuk gjejmë ndonjë raport i cili vërteton se është bërë ky shqyrtim i lëndës në mes prokurorit të lëndës dhe kryeprokurorit konkret.

Pikërisht kjo moszbatueshmëri e ligjit e ka detyruar Zyrën e Kryeprokurorit të shtetit që me datën 29 prill 2016 të nxjerr Udhëzim të detyrueshëm për prokurorët e shtetit, që ta aplikojnë këtë detyrim ligjor.

Në këtë udhëzim të detyrueshëm për të gjithë prokurorët e shtetit, thuhet që:

“III. Çdo 3 (tre) muaj, pas nxjerrjes së aktvendimit për fillimin e hetimit, prokurori i shtetit dhe kryeprokurori i asaj prokurorie obligohen që të shqyrtojnë lëndën konkrete ku është filluar hetimi dhe të konstatojnë nëse hetimi konkret duhet të mbetet i hapur, të pezullohet, të pushohet apo të ngritet aktakuza, ashtu siç është e parashikuar me dispozitën e nenit 156 të KPPRK”²⁴³

²⁴³ Udhëzimi i Zyrës së Kryeprokurorit të shtetit A.nr.258/2016, datë 29 prill 2016.

3.5.2. Afatet lidhur me kallëzimin penal, fillimin, pezullimin dhe pushimin e hetimit penal

3521. Paraqitja e kallëzimit penal

Në Procedurën penale është përcaktuar që procesi penale mund të fillojë në disa rrugë të ndryshme. Rruga fillestare e më e shpeshta është kallëzimi i veprës penale të supozuar, i kryesit të supozuar nga qytetarët e rëndomtë, nga organet shtetërore dhe nga policia. Apo siç thojnë penalistët se *“Kallëzimi penal, si rregull, është akt akuzues të cilin e përpilon policia, e i cili është manifestim i veprimtarisë së sa në procesin e zbulimit të veprës penale, e gjetjes së kryesit të asaj veprë dhe sigurimit të provave të cilat i referohen rastit penal konkret”*²⁴⁴

Në thelb, në aspektin procedural të gjithë kanë të njëjtin qëllim, që njerëzit kompetent të bëjnë verifikimin e informatave për ekzistencën e kryerjes së ndonjë veprë penale, për zbulimin e kryerësve, ndihmësve dhe të tjerëve dhe sigurimin e të gjitha provave që do të mund të shërbenin në procedurën penale.

Më së shpeshti kallëzimet penale ushtrohen nga ana e Policisë, e cila është rregulluar në nenin 81 të KPPK-së²⁴⁵, por edhe nga organet publike e rregulluar në nenin 78²⁴⁶ dhe nga personat, sipas nenit 79²⁴⁷, ku *“është paraparë se Çdo person ka të drejtë të kallëzojë veprën penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare dhe detyrohet të bëjë këtë në rastin kur moskallëzimi i veprës penale paraqet vepër penale”*²⁴⁸

Në rastet kur kemi të bëjmë me kallëzime penale të paraqitura nga ana e Policisë, si organi që më së shumti paraqet kallëzime, edhe këtu vijnë në konsideratë afatet ligjore.

Në pajtim me nenin 70 par.4 të KPPK-së, është e përcaktuar koha/afati brenda të cilit policia është e detyruar që prokurorinë ta njoftojë me shkrim për ekzistimin e dyshimit për veprën penale.

Afati për të bërë këtë njoftim me shkrim është 24 orë prej momentit kur është vënë në dijeni policia se është kryer vepra e caktuar penale.

²⁴⁴ Hajdari, Azem, Procedura penale, Komentar, Prishtinë, 2010, f.508.

²⁴⁵ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.258-259.

²⁴⁶ Po aty, f.251-254.

²⁴⁷ Po aty, f.254-256.

²⁴⁸ Si 244, f.504.

A ndodh me të vërtetë në praktikë ky njoftim? Në të shumtën e rasteve nuk ndodh! A gjeneron pasoja të ndonjë natyre moszbatimi i kësaj procedure? Përgjigja është jo!

Në këtë mënyrë, kemi të bëjmë me dispozitë e cila edhe nëse nuk zbatohet në praktikë, nuk parasheh asnjë pengesë procedurale ligjore që një proces gjyqësor të mos ecë tutje. A është e drejtë kjo? Përgjigja prapë është jo.

Në këtë mënyrë është e pakuptimtë ekzistenca e një dispozite ligjore e cila nuk sjell pasoja në rast të moszbatimit.

Në KPK janë disa vepra penale të cilat ndiqen vetëm në bazë të propozimit të palës së dëmtuar, si Kanosja nga neni 185 par.1 dhe 2, Zbulimi i paautorizuar i informacionit konfidencial nga neni 203 par.1, Shpërdorimi i pasurisë së huaj nga neni 330 par.1,5; Marrja në posedim e pasurisë së luajtshme nga neni 331 par.1 etj.

Për vepra të tilla, është me rëndësi afati që ka të bëjë me dhënien e propozimit i cili duhet të jetë në formë të shkruar apo të shprehur shprehimisht përmes nënshkrimit. Për shkak të urgjencave ndodh në praktikë që propozimi jepet verbalisht, por propozimi duhet të konfirmohet me shkrim.

Në nenin 79 paragrafi 3 i KPPK-së është përcaktuar që afati për të konfirmuar me shkrim propozimin e dhënë në mënyrë verbale është dyzetë e tetë (48) orë.²⁴⁹

3522 Hudhja poshtë e Kallëzimit penal

Shprehimisht është e përcaktuar në KPPK se si duhet të veprohet nëse nga kallëzimi penal verifikohet se s'ka elemente për tu filluar hetimi.

Në rastin kur nuk ka elemente për të filluar hetimin është përcaktuar afati ligjor për ta hudh poshtë kallëzimin penal.

Afati për të hudhur poshtë kallëzimin penal është tridhjetë (30) ditë prej kur është paraqitur kallëzimi penal. Kjo është e përcaktuar në nenin 82 paragrafi 1 i KPPK-së²⁵⁰ dhe ka të bëjë me kallëzimet penale të cilat ushtrohen nga ana e policisë, i cili e parasheh të njëjtin afat

²⁴⁹ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.255-256.

²⁵⁰ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.260-261.

edhe për rastet që kanë të bëjnë me kallëzimet penale të ushtruar nga personat tjerë. Çështje e rregulluar në nenin 83 paragrafi 5²⁵¹.

Hudhja poshtë e kallëzimit bëhet nëse shihet qartazi se nuk ka prova për ekzistimin e dyshimit të arsyeshëm se është kryer vepra penale.

Po ashtu, kur është parashkruar ndjekja penale, vepra që dyshohet se është kryer është amnistuar apo falur apo ekzistojnë rrethana tjera të përcaktuar në dispozitën e nenit 82 par.1 të KPPK-së, e që këto situata “*nuk varen pothuaj aspak nga vlerësimet e prokurorit publik. Në këto raste vetëm duhet të konstatohet plotësimi i tyre*”²⁵².

3.523. Njoftimi i palës për hudhje të kallëzimit penal

Në rastin e hudhjes së kallëzimit penale është përcaktuar edhe një afat tjetër ligjor që ka të bëjë me njoftimin e parashtruesit të kallëzimit penal për hudhjen e kallëzimit penal.

Në nenin 82 paragrafi 3 është e përcaktuar se afati ligjor për të njoftuar palën është tetë (8) ditë²⁵³ dhe njoftimi bëhet vetëm nëse parashtruesi i kallëzimit është i dëmtuar²⁵⁴.

Palët tjera që kanë parashtruar kallëzimin nuk njoftohen. Nuk njoftohen as palët ndaj të cilave është filluar apo është ndërmarrë veprimi hetimor apo ndaj të cilit është paraqitur kallëzimi penal. Në raste të tilla, palët ndaj të cilave është ushtruar kallëzimi penal duhet të paraqesin kërkesa të veçanta nëse dëshirojnë të sigurojnë vendimin e tillë.

A ndodh të respektohet ky afat në praktikë? Përgjigja është se nuk respektohet pothuaj asnjëherë. Njoftimi i palës për hudhje të kallëzimit penal asnjëherë nuk bëhet brenda këtij afati, ndoshta nuk iu jepet rëndësi për shkak se pala nuk ka të drejtë ankese ndaj këtij vendimi.

Rasti i tillë që ka të bëjë me ushtruesin e kallëzimit penal i cili nuk është njoftuar fare nga prokuroria në Prishtinë, e ku ai është detyruar si palë kallëzuese të paraqes kërkesë me shkrim për sigurimin e vendimit.

²⁵¹ Po aty, f.264.

²⁵² Hajdari, Azem, Procedura penale, Komentar, Prishtinë, 2010, f.510.

²⁵³ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.261.

²⁵⁴ Hajdari, Azem, Procedura penale, Komentar, Prishtinë, 2010, f.510.

Vendimi i marr nga prokuroria me datë 12 prill 2019 është siguruar me datë 4 korrik 2019 dhe atë vetëm pas kërkesës së veçantë të palës së dëmtuar.²⁵⁵

Në këtë rast, kemi kallëzimin penal i cili është paraqitur në Prokurori me datën 13 qershor 2017 për vepër të rëndë penale dhe prokuroria të arrijë që brenda muajit t'i shqyrtojë të gjitha provat dhe me datë 14 korrik 2017 të hudh poshtë kallëzimin penal. Ndër arsyet e hudhjes janë paraqitur se “*prokuroria nuk ka gjetur se është falsifikuar dokumenti zyrtar i sanksionuar nga neni 434 të KPRK-së, por vetëm është përshkruar kjo dispozitë nga ana e ushtruesit të kallëzimit penal*”²⁵⁶.

3524. Fillimi i hetimit penal

Hetimi është faza e parë, shumë e rëndësishme e procedurës penale, që shërben premisë për zhvillimin e mëtejshëm të saj.²⁵⁷

Kjo fazë, duke qenë se ka të bëjë me pjesën kryesore të procedurës penale, është e lidhur drejtpërdrejt edhe me faktorin kohë dhe është i varur nga faktori kohë, si në aspektin e fillimit të hetimit ashtu edhe përfundimit të hetimit.

Sipas nenit 104 paragrafi 1 i KPPK-së, është përcaktuar se hetimi fillon në bazë të aktvendimit formal për fillimin e hetimit të prokurorit të shtetit.²⁵⁸

Në Aktvendimin për fillimin e hetimit, përveç asaj që përcakton personin apo personat ndaj të cilëve fillon hetimi, përshkrimi i veprës penale, emërtimin ligjor etj, aty shënohet edhe koha e fillimit të hetimit²⁵⁹.

Logjikisht edhe pse nuk është e normuar në mënyrë shprehimore ndonjë afat për fillimin formal të hetimit, ai duhet të jetë tridhjetë (30) ditë, i njëjtë me afatin që ekziston për tu hudhur poshtë kallëzimi penal.

²⁵⁵ Kërkesa e qytetarit K.H. drejtuar Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.2046/17, datë 26 qershor 2019.

²⁵⁶ Aktvendimi i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.I.nr.75/2017, datë 14 korrik 2017.

²⁵⁷ Hajdari, Azem, Procedura penale, Komentar, Prishtinë, 2010, f.515.

²⁵⁸ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.303.

²⁵⁹ Hajdari, Azem, Procedura penale, Komentar, Prishtinë, 2010, f.517.

Duhet marrë në konsideratë se vendimit për hudhjen e kallëzimit penal i paraprijnë disa veprime procedurale, e që më kryesorja është shqyrtimi i provave materiale se a ka të tilla për ekzistimin e veprës penale.

Nuk është e mundur që një kallëzim penal të hudhet poshtë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, e të mos ketë mundësi që për një kallëzim tjetër penal që nuk hudhet të mos nxirret Aktvendimi për fillimin e hetimit.

Këtu vlerësohet se kallëzimi penal është shqyrtuar drejtë dhe është konstatuar se ka apo nuk ka elemente të veprës penale. Pasi ka prova se ka vepër penale, duhet të nxirret Aktvendimi për fillim të hetimit. Nuk ka asnjë arsyeshmëri pse të mos nxirret Aktvendimi i tillë brenda afatit.

Në praktikë nga ana e Prokurorisë së Shtetit është duke u abuzuar me autorizimet dhe nuk respekton këto afate dhe hetimet formalisht nuk i fillon me kohë.

Kjo ka detyruar Gjykatën Supreme të Kosovës të reagojë. Të njëjtën gjë e ka bërë edhe Prokuroria e Shtetit.

Prokuroria e Shtetit si zbatuese e drejtpërdrejtë e kësaj dispozite, është duke bërë interpretim të ngushtë të dispozitave ligjore që kanë të bëjnë pikërisht me fillimin e hetimit. Si pasojë e kësaj, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka nxjerr Udhëzim me të cilin ka obliguar të gjithë prokurorët e shtetit që:

“...brenda afatit prej tre (3) muajsh, nga dita e pranimi të kallëzimit penal nëse i njëjti me aktvendim nuk është hudhur, të nxjerret aktvendimi për fillimin e hetimit”²⁶⁰.

Udhëzimet të cilat i jep prokurori i rangut më të lartë, janë të karakterit të brendshëm, ndërsa prokurori i rangut më të ulët ka obligim që t’u përmbahet udhëzimeve të marra dhe të njëjtat t’i zbatojë në punë.²⁶¹

Ky udhëzim vërteton se nga ana e Prokurorisë deri më tani është abuzuar me afatet që duhet zbatuar për të nxjerr Aktvendimin e fillimit të hetimit dhe të përfundimit të hetimeve.

²⁶⁰ Udhëzimi i Zyrës së Kryeprokurorit të shtetit A.nr.258/2016, datë 29 prill 2016.

²⁶¹ Çollaku, Hashim, Prokurori publik në procedurën penale (aspekti teorik dhe praktik), Prishtinë, 2010, f.23.

Nëse analizohet ky Udhëzim i cili është i detyrueshëm konstatohet se përcaktimi i afati prej tre (3) muajsh për fillimin e hetimit nuk është i bazuar në asnjë dispozitë ligjore.

Përcaktueshmëria e afatit prej tre (3) muajsh për të nxjerr Aktvendimin për fillim të hetimit është veprim i cili është nxjerr në bazë të vlerësimit të lirë të Zyrës së Kryeprokurorisë së Shtetit, pa pasur asnjë mbështetje ligjore, e as një arsyetim pse kemi të caktuar tre (3) muaj në vend të një (1) apo pse nuk kemi afatin gjashtë (6) muaj.

Kjo mospajtueshmëri me interpretim të njëjtë të ligjit e ka shtyrë Gjykatën Supreme të Kosovës, që përmes kryetarit të saj Fejzullah Hasani, t'i shkruaj Prokurorisë që mos të interpretohet me inercion ligji, sepse ligji e limiton kohën e zbatimit të hetimit.

Kryetari i Gjykatës Supreme deklaroi se i ka tërheq vërejtjen Prokurorisë për këtë Udhëzim, me arsyetimin se interpretimi i tyre nuk është i drejtë dhe se Gjykata Supreme ka dhënë Mendim Juridik pas analizës disa mujore, pas komunikimit dhe marrjes së ideve me autorët e Kodeve të Procedurës Penale, ekspertët e degës Penale.

Gjykata Supreme ka dal me mendim sa i përket normës se është aprovuar mendimi juridik lidhur me nenin 159²⁶².

Kryetari i Gjykatës Supreme arsyeton se personi fizik nuk duhet të jetë nën presion të pafund, duhet t'i ikë abuzimeve që mund të bëhen në dëm të pandehurve dhe se në rast se norma ka dilema gjithmonë interpretohet në favor të pandehurit.

Ai vjen në përfundim se nëse nuk zbatohet kjo, atëherë i hup kuptimi edhe dispozitës ligjore që ka të bëjë me afatin e hetimit.²⁶³

Në këtë mënyrë, Kolegjiumi i Gjykatës Supreme, në Mbledhjen (Seancën) e Përgjithshme të datës 29 shtator 2016 ka nxjerr Mendimin Juridik duke vendosur që:

“Prokurori i shtetit, brenda 30 ditësh duhet të vendos: për informacione shtesë, për aplikimin eventual të masave të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit, hedhjen e kallëzimit penal apo për fillimin e hetimit”²⁶⁴.

²⁶² Sqarim: Neni 159 e rregullon çështjen e afateve kohore të hetimit.

²⁶³ Betimi për Drejtësi, emisioni “Gjykata Supreme VS Prokurori i Shtetit”, datë 8 shkurt 2017 (<http://betimiperdrejtesi.com/emisionet/gjykata-supreme-vs-prokurori-i-shtetit/>), qasur me datën 18 maj 2017).

²⁶⁴ Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës nr.583/2016 datë 29 shtator 2016.

Prapë se prapë, qëndrimi i kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovë edhe pse thuhet se nuk ka dilema për gjyqtarët e kësaj gjykate, jo më vonë se katër muaj nga ky prononcim dhe mendim juridik, ka nxjerr një aktgjykim të kundërt nga Mendimi Juridik i saj.

Me datën 27 qershor 2017 kjo gjykatë ka nxjerr Aktgjykimin PML.nr. 154/2017, duke vepruar pikërisht në dëm të të pandehurit edhe duke u shkelur parimi “*in dubio pro re*”. Arsyetimi i këtij aktgjykimi qëndron në atë se “...hetimi ligjërisht dhe formalisht fillon në ditën e nxjerrjes së aktvendimit për fillimin e hetimeve...”²⁶⁵.

Duke marrë parasysh se gjykata supreme i ka trembëdhjetë (13) gjyqtarë, tre nga ata gjyqtarë të paktën mendimet i paskan të ndara lidhur me këtë çështje.

Kjo ngre pasiguri juridike në raport me qytetarët.

Kur dihet se vendimet gjyqësore lidhur me këtë çështje do jenë të ndryshme, varësisht se kush është anëtarë i trupit gjykues dhe cilit qëndrim i qëndrojnë besnik, atëherë në këto raste do ketë rol të madh edhe fati i personit për të cilin do të vendoset.

Këtë problematikë e kanë sjell në vëmendje të opinionit, por edhe të vetë zbatuesve të ligjit edhe Organizatat e ndryshme joqeveritare që kanë të bëjnë me fushën e sundimit të ligjit, ku Betimi për Drejtësi, me datën 8 shkurt 2017 ka realizuar një emision të tërë gati një orë për këtë çështje.

Kjo OJQ, ka konstatuar se në Prokurorinë e Shtetit është identifikuar edhe rasti kur ka kallëzim penal për vepër penale të Korrupsionit nga viti 2002, i cili asnjëherë nuk është trajtuar, por qytetari gjendet në evidenca si i dyshuar.²⁶⁶

Dilemat lidhur me këtë çështje dhe që vërteton pretendimin tonë se ekziston pasiguri juridike për qytetarët nga interpretimi i ndryshëm i gjyqtarëve të të njëjtës gjykate. E aq më tepër kur kemi interpretim të ndryshëm nga gjyqtari i njëjtë i cili ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka nxjerr Aktgjykimin PML.nr.154/2017 në kundërshtim me Mendimin Juridik nr. 583/2016 të datës 29 shtator 2016, e tani i ulur në ulësen e kryetarit aktual të Gjykatës Supreme e mbron qëndrimin e Mendimit Juridik.

²⁶⁵ Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës PML.nr.154/2017, datë 27 qershor 2017.

²⁶⁶ Betimi për Drejtësi, emisioni “*Gjykata Supreme VS Prokurori i Shtetit*”, datë 8 shkurt 2017 (<http://betimiperdrejtesi.com/emisionet/gjykata-supreme-vs-prokurori-i-shtetit>, qasur me datë 15 shkurt 2017).

I intervistuar nga Betimi për Drejtësi, kryetari i Gjykatës Supreme Enver Peci me datën 20 dhjetor 2017 deklaroi se:

“ai mendim është ende në fuqi...nuk kemi prurje vendime tjera sa i përket kësaj situate, po mendoj mendim juridik...shpresoj se do të qartësohet me ligj për shkak të mos jetë kështu interpretime të ndryshme në mes prokurorisë dhe gjykatave...unë konsideroj se duhet të jepet një afat, jo ndoshta tridhjetë ditë, por një afat i arsyeshëm, për tre muaj ta quaj ashtu se spo du me ndiku se si duhet të duket ligji...ne jemi të lidhur me mendimin... po shpresoj se kjo çështje për momentin është kështu...”²⁶⁷.

Nëse analizohet kjo intervistë, shihet se me të vërtetë dilemat në mes gjyqtarëve janë të mëdha, aq më tepër kur këto dilema ekzistojnë nga vetë gjyqtarët e të njëjtës gjykatë që ka nxjerr interpretimin i dispozitës ligjore si në Mendimin Juridik.

Mënyrë të njëjtë të qasjes dhe moszbatim të mendimeve juridike-interpretimeve juridike të gjykatës supreme kemi edhe në këtë moment që po përmbledhim këtë punim.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, me datën 23 shkurt 2018 ka nxjerr një aktvendim me të cilin ka refuzuar pretendimet e mbrojtjes lidhur me kalimin e afatit të hetimit.

Arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë është shumë i çuditshëm dhe të le të aludosh në atë se, ose nuk i kanë lexuar fare mendimet interpretuese ose me të vërtetë janë kundër atyre interpretimeve, ose nuk kanë mundësi profesionale të interpretojnë apo të kuptojnë interpretimet.

Mendimi juridik i Gjykatës Supreme i referohet saktësisht Kodit në fuqi të procedurës penale, kurse vepra penale sipas aktakuzës në fjalë është e kryer në vitin 2010.²⁶⁸

Të njëjtin qëndrim në këtë çështje juridike ka mbajtur edhe Gjykata e Apelit si shkallë e dytë, ku tre gjyqtarë të saj me datën 06 prill 2018 refuzojnë prapë ankesën e mbrojtjes.

²⁶⁷ Betimi për Drejtësi, Intervistë me Enver Pecin, Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës, datë 20 dhjetor 2017. (<http://betimiperdrejtesi.com/emisionet/interviste-enver-peci/>, qasur me datë 17 janar 2018).

²⁶⁸ Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.393/15 datë 23 shkurt 2018.

Kjo gjykatë në arsyetimin e saj, duke përdorur fjali më shumë edhe me tepër e mbron qëndrimin e tyre në mënyrë të kundërt me interpretimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, si gjykatë e shkallës së tretë. Ata thirren në atë se:

“...Prokurori i shtetit ka filluar hetimet më dt.08.04.2015; dhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, kallëzimi penal është ngritur në kohën kur ka qenë në fuqi Kodi i vjetër i procedurës penale konkretisht nenni 207 par.1 dhe 2 i Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale, që i bie se Prokurori i shtetit nuk ka qenë i obliguar që brenda afatit ligjor prej 30 ditësh nga dita e marrjes së kallëzimit penal të filloj hetimet apo të hudh poshtë kallëzimin penal ashti siç parashihej me dispozitat e Kodit të ri të procedurës penale konkretisht të nenit 82 të KPPK-së, dhe bazuar në këtë nuk mund të kolaudojmë se hetimet nuk janë kryer brenda afatit ligjor”²⁶⁹.

Lidhur me këtë çështje kallëzimi penal është e vërtet se është paraqitur me datën 26 maj 2011 kur ka qenë në fuqi kodi i përkohshëm penal i Kosovës, por, nëse analizohet mendimi juridik nr.583/2016 i datës 29 shtator 2016, është e qartë se ai flet për rrethana të njëjta juridike.

Mendimi Juridik është nxjerr në bazë të Pyetjeve të Ushtruara nga Gjykata Themelore e Mitrovicës që ka pasur të bëjë me çështje të njëjtë juridike, për kallëzim penal të ushtruar në vitin 2009 dhe hetimi formal është filluar në vitin 2014.

Vendimin se Gjykata Supreme e cila ka vendosur që të mos pranojë komoditetin e kundërligjshëm të prokurorisë që për kallëzimet penale të ushtruara në vitin 2011 të fillohet hetimi në vitin 2015, tani nuk po gjejnë zbatim as nga vetë gjykatat.

Në këtë rast ka qenë e njëjta situatë juridike. Për më tepër, në të njëjtën datë Gjykata Supreme ka nxjerr edhe një mendim juridik tjetër me të cilën edhe më shumë ka sqaruar këtë situatë.

Pikërisht në pikën tre të Mendimit Juridik është përcaktuar qartë se:

²⁶⁹ Aktvendimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë, PN.nr.268/18 datë 06 prill 2018.

“Nëse vepra penale është kryer para hyrjes në fuqi të këtij Kodi, mirëpo hetimet kanë filluar pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi, sa i përket kohëzgjatjes së hetimit dhe pasojave të tejkallimit të këtij afati, aplikohen dispozitat e nenit 159 të këtij Kodi”²⁷⁰

Dilemat janë të mëdha dhe interpretimet janë të ndryshme, e që pasigurinë e bëjnë edhe më të madhe.

3525 Pezullimi i hetimit

Duke qenë se arsyet që shkaktojnë pezullimin e hetimit janë të natyrës së atillë që mund të krijohen në periudha të ndryshme kohore, për këtë arsye nuk kemi afate kohore të përcaktuara që lidhen me këtë veprim procedural.

Në fakt, pezullimi i hetimit bëhet me aktvendim të posaçëm përmes të cilit adresohet kjo çështje si dhe shkaqet që kanë determinuar ndërmarrjen e këtij veprimi.²⁷¹

Është me rëndësi që, në aktvendimin për pezullimin e hetimit është e domosdoshme të paraqitet saktë koha se kur është bërë pezullimi.

Kjo, me të vetmen arsye që periudha që pezullohet hetimi nuk llogaritet në afatin që ka të bëjë me zbatimin e hetimit.

Në këtë mënyrë, neni 157 i KPPK-së e ka rregulluar situatën e cila sqaron se afati përfundimtar lidhet drejtpërdrejtë me afatin se kur dhe për çfarë periudhe kohore është pezulluar hetimi.²⁷²

Për këtë arsye, *“Prokurori publik në një shënim në procesverbalin e hetimit lidhur me kohën dhe arsyet e pezullimit të hetimit dhe kohën e rifillimit të hetimit. Prokurori publik pa vonesë e njofton gjyqtarin e procedurës paraprake për pezullimin”²⁷³.*

²⁷⁰ Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës nr.582/2016 datë 29 shtator 2016.

²⁷¹ Hajdari, Azem, Procedura penale, Komentar, Prishtinë, 2010, f.524.

²⁷² Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.430-432.

²⁷³ Si 271, f.525.

3526 Pushimi i hetimit

Pushimi i hetimit ndodh në rastet kur gjatë fazës së hetimeve janë ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura, janë siguruar dhe analizuar të gjitha provat si ato në favor si ato në dëm të pandehurit dhe që ka ardhur përfundimi se nuk ka elemente të ekzistimit të veprës penale. Këtë veprim procedural e bënë prokurori i shtetit, i cili *“i pushon hetimet me aktvendim, me ç’rast faktikisht vije edhe deri te pushimi i procedurës penale në tërësi”*²⁷⁴. Neni 158 paragrafi 1 i KPPK-së, potencon se pushimi i hetimit ndodh kur:

“është vërtetuar nga provat e mbledhura se :

- 1.1. nuk ekziston dyshim i arsyeshëm që personi konkret e ka kryer veprën e tillë penale;*
- 1.2. vepra e kryer nuk është vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare;*
- 1.3. ka kaluar afati i parashkrimit;*
- 1.4. vepra penale është përfshirë në falje ose në amnistinë e lëshuar para miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; ose*
- 1.5. vepra penale është përfshirë në amnistinë e lëshuar para miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.*
- 1.6. ekzistojnë rrethana të tjera të cilat përjashtojnë ndjekjen.”*²⁷⁵

Pra, hetimi pushon në rrethanat e cekura më lartë, kur elementet të cilat e krijojnë figurën e veprës penale nuk ekzistojnë, kur është bërë parashkrimi i ndjekjes penale nga neni 106 dhe 107 i KPPK-së. Apo, në rrethanat tjera që kanë të bëjnë me faljen, amnistinë dhe rrethanat të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale.

Këtu hynë kalimi i afatit ligjor për ndjekjen penale por edhe afati për zhvillimin dhe përfundimin e hetimeve.

²⁷⁴ Po aty, f.526.

²⁷⁵ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.433-436.

Pasi të pushojnë hetimet me vendim të posaçëm, këtu vjen në konsideratë edhe afati ligjor që ka të bëjë me njoftimin e palëve në proces.

Prokuroria është e detyruar që edhe kur të nxjerr një Aktvendim të tillë që brenda afatit ligjor prej tetë (8) ditësh²⁷⁶ të njoftojë të dëmtuarin se ka pushuar hetimi.

Po ashtu, prokuroria brenda afati ligjor “*menjëherë*” është e obliguar që ta njoftojë edhe gjyqtarin e procedurës paraprake për vendimin mbi pushimin e hetimit.

3527. Përfundimi i hetimeve

Afati për përfundimin e hetimeve është dy (2) vite nga fillimi i hetimeve me Aktvendimin për fillim të hetimeve.²⁷⁷ Kjo është e para.

E dyta ka të bëjë me atë se afati dy (2) vite llogaritet/duhet të llogaritet nga momenti kur vlerësohet se hetimi është filluar/është dashur të fillohet edhe pa pasur Aktvendim për fillim të hetimeve.

Bazuar edhe në interpretimin e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe në bazë të interpretimit logjik të nenit 159 lidhur me nenin 82 të KPPK-së, afati dy (2) vjeçar llogaritet, fillon të ecë pas kalimit të tridhjetë (30) ditëve prej momentit që Prokuroria është njoftuar për ekzistimin e kryerjes së veprës penale.

Kjo pavarësisht se a është njoftuar me Kallëzim Penal, me raport të veçantë apo çfardo parashtrëse tjetër.

Ky afat është i detyrueshëm për tu respektuar dhe në këtë afat nuk llogaritet periudha kohore në rastet kur kemi pasur pezullim të procedurës përmes aktvendimit.

²⁷⁶ Si 274, f.526.

²⁷⁷ Me kodin procedural të kaluar 2004, ka qenë e përcaktuar se hetimi duhet të përfundonte brenda periudhës kohore gjashtë (6) muaj. Nëse brenda kësaj periudhe kohore nuk do të përfundonte hetimi, atëherë prokurori i shtetit do të duhej të kërkonte me shkrim nga gjyqtari i procedurës paraprake zgjatjen e afatit, me arsyet pse nuk ka mundur të përfundonte hetimit me kohë Brenda gjashtë (6) muajve. Nëse do të arsyetohej kërkesa e prokurorisë, hetimi mund të zgjatej edhe dy (2) herë nga gjashtë (6) muaj të tjerë nga gjyqtari, ndër të tjera për veprat që parashihej dënimi mbi pesë (5) vjet burgim. Po ashtu, nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës do të mund të autorizohet edhe një vazhdim prej gjashtë (6) muaj tjerë, që në total ishte periudha kohore dy (2) vjeçare.

3528 Zgjatja e afatit për përfundim të hetimit

Prokuroria në rastet të cilat është duke i zhvilluar gjendet para rrethanave të caktuara që kanë të bëjnë me raste të ndërlikuara, të përcaktuara në par.2 të nenit 159, mund të kërkojë një afat shtesë nga gjykata. Pra gjithmonë gjykata duhet të jetë ajo që e lejon apo nuk e lejohen zgjatjen e hetimit.²⁷⁸

Prokuroria do të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake që afati i hetimit të zgjatet deri në gjashtë (6) muaj.

Në krahasim me Shqipërinë, afati për përfundimin e hetimit tek ne është më i shkurtër për gjashtë (6) muaj. Në Shqipëri afati mund të zgjatet në maksimum deri në tre vite dhe atë, viti i fundit vetëm me miratim të Prokurorit të Përgjithshëm për raste komplekse apo pamundësisë objektive.

Të gjitha zgjatjet e hetimit, që nga fillimi janë të përcaktuara të ndodhin për afate tremujore.²⁷⁹

Për çështjen e zbatimit të dispozitave ligjore lidhur me respektimin e afatit të hetimit dhe mos abuzimit me zgjatjet formale të afatit të hetimeve, Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë ua ka tërheq vëmendjen që:

“drejtuesit e prokurorive të shkallës së parë duhet të vlerësojnë drejtë nevojën e zgjatjes së afatit të hetimeve dhe të evidentojnë përgjegjësinë e prokurorëve dhe oficerëve të plicisë gjyqësore, për mos kryerjen e detyrave të hetimit në afatet ligjore ose në afatet e caktuara nga prokurori”²⁸⁰.

²⁷⁸ Rao, Sreedhar, K., *Criminal Justice System-Required reforms*, Journal of The Indian Law Institute, Vol.43, April-June 2001, no.2, f.168.

²⁷⁹ KPPRSH, n.323-324.

²⁸⁰ Udhëzimi nr.3, datë 08.03.2007 i Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, për përmirësimin e punës dhe kontrollit të prokurorit në ndjekjen penale: http://www.pp.gov.al/web/3_163.pdf, qasur me datë 11 mars 2014.

3529. Ngritja e aktakuzës

Aktakuza është akt akuzues i prokurorit publik me të cilën çështja konkrete penale procedohet para gjykatës kompetente.²⁸¹ Në rastin e përpilimit të aktit akuzues, janë disa çështje që diskutohen shpesh dhe atë në mënyrë të ngushtë nga gjykatat tona.

Në Kodin e Procedurës Penale askund nuk kemi të përcaktuar në mënyrë shprehimore se brenda cilit afat pas përfundimit të hetimeve do të bëhet ngritja e aktakuzës.

Në kodin e procedurës penale nuk kemi asnjë dispozitë e cila përcakton ndonjë detyrim ligjor që prokuroria të nxirrte ndonjë akt formal me të cilën do të dëshmohej se ka përfunduar hetimi.

Nuk ka asnjë akt formal në të cilën do të shënohej se me datën e caktuar ka përfunduar hetimi.

Bazuar në rrethanat e lartcekura, se hetimet mund të zgjaten maksimalisht dy vite e gjysmë, nëse nuk ka pasur pezullim të procedurës, nëse nuk ngritet aktakuza, atëherë hetimi pushon.²⁸²

Kjo do të thotë që aktakuza duhet të ngritet brenda afatit të hetimeve, thënë në mënyrë të shkoqur, akti formal për përfundimin e hetimit është aktakuza.

Në praktikën tonë gjyqësore kemi pasur dilema në afatet se sa zgjaten hetimet, si llogariten ato, ngritja e aktit akuzues a llogaritet në periudhën e hetimit apo aktakuza mund të ngritet edhe pas përfundimit të hetimit sipas nenit 159 të KPPK-së.

Këto dilema kanë sjellur çështje deri në gjykatën kushtetuese, e cila, me këto kërkesa të palëve nuk është marrë, duke vlerësuar si të papranueshme, me arsyetimin që çështja e afateve të hetimit dhe ngritjes së aktakuzës nuk bie nën juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*” nëse do të merrej me gabimet e ligjit apo ligjshmërinë që kanë bërë gjykatat e rregullta. Sipas kësaj

²⁸¹ Hajdari, Azem, Procedura penale, Komentar, Prishtinë, 2010, f.529.

²⁸² Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.436-437.

gjykate, gjykatat e rregullta kanë për detyrë të interpretojnë dhe zbatojnë të drejtën procedurale dhe materiale, e jo gjykata Kushtetuese.²⁸³

Për dallim nga kjo, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë është marrë me këto çështje-ankesa.

I kësaj natyre është Vendimi nr.20 i datës 10.7.2005, ku gjykata ka vlerësuar se apo siç thotë “*vëren*” se në rastin konkret prokuroria ka vazhduar hetimet për një periudhë rreth 6 muaj, pa pasur vendim për zgjatje të afatit nga prokurori dhe në këtë mënyrë janë shkelur të drejtat e të pandehurit, të garantuara nga Kushtetuta dhe ligji dhe është shkelur parimi kushtetues që garanton të drejtën e mbrojtjes.²⁸⁴

Kurse, është i çuditshëm edhe qëndrimi i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, ztr. Hilmi Jashari i cili kërkon që kodi i procedurës penale të ndryshohet në aspektin e afatit të hetimit për veprat penale që kanë të bëjnë me korrupsion.

Sipas tij, zgjatja e afatit të hetimit përtej dy viteve për këto vepra do të luftonte korrupsionin.

Por, a është ky qëndrim i drejtë, del se nuk është, sepse, mekanizmat kontrollues duhet të shtrëngohen, kurse ligji duhet të jetë i njëjtë për të gjithë dhe atë, duke pasur parasysh parimit e supozimit të pafajësisë dhe gjykimit të drejtë dhe me kohë të arsyeshme.

Në anën tjetër, kryeprokurori i Shtetit ztr, Aleksandër Lumezi kërkon që afati për përfundim të hetimeve të ndryshojë për disa vepra penale, por për dallim nga Avokati i Popullit, ai kërkon për veprat penale që lidhen me krime lufte dhe gjenocidin.²⁸⁵

Në këtë mënyrë, kemi qëndrime të kundërta nga praktikuesit e ligjit, siç është rasti i Gjykatës Supreme të Kosovës e cila vlerëson se ligji është shumë i qartë sa i përket afateve kohore për zhvillimin e hetimeve, por ligji nuk e përcakton dhe nuk e detyron që aktakuza të ngritet brenda afateve të hetimit.

Në këtë çështje konkrete që është marrë Gjykata Supreme, kemi pasur Aktakuzë të ngritur tre muaj pasi ka kaluar afati ligjor për të përfunduar hetimet.

²⁸³ Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr.ref.:RK 972/16, 2016, datë 08 gusht 2016.

²⁸⁴ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë nr.20/2005 datë 10 korrik 2005.

²⁸⁵ <http://indeksonline.net/lajmet/avokati-i-popullit-kerkon-qe-hetimet-per-korrupsion-te-jene-pa-afat-video-9473/>, qasur me datë 14 qershor 2017.

Ajo vlerëson se afati i aktakuzës ka të bëjë vetëm në rastet kur kemi të bëjmë me parashkrimin me ligjin material, në drejtim të ndjekjes penale dhe se nuk ka afat të përcaktuar për ngritjen e aktakuzës.²⁸⁶

Mendimi im është se Gjykata Supreme nuk e ka interpretuar drejtë këtë dispozitë ligjore dhe e ka shikuar në prizëm shumë të ngushtë. Sepse, neni 240 në paragrafin e parë e ka përcaktuar qartë që:

“Pas përfundimit të hetimit ose kur prokurori i shtetit konsideron se informacionet me të cilat ai disponon për veprën penale dhe kryerësin e saj paraqesin dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale apo vepra penale, procedura para gjyqit mund të zbatohet vetëm në bazë të aktakuzës së ngritur nga prokurori i shtetit”.

Kjo dispozitë ligjore i ka përcaktuar dy mundësi për ngritjen e aktakuzës. E para, pasi janë përfunduar hetimet të cilat janë nisur dhe të cilat dihet se kanë afat kohor të zhvillim të tyre. E dyta në rast se nuk ka zhvillim të hetimeve, siç është rasti i procedurës së urdhrit ndëshkimor apo, kur prokuroria vlerëson se ka siguruar prova të mjaftueshme për veprën penale të kryer apo edhe për kryerësin.

Pra, aktakuza është kurorëzimi i hetimeve të zhvilluara dhe kurora duhet të vendoset brenda afatit të hetimeve. Kjo paraqet edhe parimin akuzator *“nemo iudex sine actore”*²⁸⁷.

Nëse analizohet paragrafi 2 i nenit 240, ajo e bënë edhe më të qartë paragrafin e parë.

Derisa paragrafi i parë flet për rastin kur janë siguruar prova të mjaftueshme për ekzistimin e veprës penale e që kurorëzohet me aktakuzë si akt formal, paragrafi 2 e flet të kundërtën. Paragrafi i dytë flet për rastin kur janë zhvilluar hetime dhe rezultati i tyre është se nuk ka prova për ekzistimin e veprës penale dhe se ky rezultat kurorëzohet me pushimin e hetimit. Pra, kemi të bëjmë me aktin formal të Aktvendimit për pushimin e hetimit i cili duhet të nxirret brenda afatit të hetimeve.

²⁸⁶ Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, PML-KZZ-242/15, datë 26 nëntor 2015.

²⁸⁷ Hajdari, Azem, Procedura penale, Komentar, Prishtinë, 2010, f.529.

Derisa kemi të bëjmë me akt formal për pushimin e hetimit brenda afatit të hetimit, atëherë edhe aktakuza është e lidhur brenda të njëjtit afat.

Në të kundërtën, keqpërdorimi i këtij afati nga ana e prokurorisë do të ishte i çdoditshëm, duke u thirrur në atë se hetimin e kam përfunduar me kohë, e tani aktakuzën do ta ngris kur ta vlerësojë më të përshtatshme. Kjo do të ishte, një (1) muaj, një (1) vit etj.

Duke qenë se procesi gjyqësor fillon në bazë të aktakuzës së prokurorisë së shtetit, atij procesi të ri i paraprijnë edhe disa veprime tjera që lidhen me afate.

Është fjala për detyrimin e prokurorisë që të bëjë pajisjen e mbrojtjes me materialet e aktakuzës dhe afati për këtë është më së largu momenti i ngritjes së aktakuzës.

Në rastet kur prokuroria siguron ndonjë material tjetër shtesë edhe pas ngritjes së aktakuzës, ajo është e detyruar që ato t'ia ofrojë mbrojtjes.

Neni 244 i KPPK-së e ka përcaktuar se ky afat është më së largu dhjetë (10) ditë²⁸⁸ prej momentit të sigurimit të tyre.²⁸⁹

²⁸⁸ Po aty, f.535.

²⁸⁹ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.630-633.

3.6. AFATET GJATË FAZËS SË GJYKIMIT PENAL

Duke qenë se procesi gjyqësor kalon nëpër disa faza procedurale, këtu kanë rëndësi edhe afatet që lidhen me mbajtjen e shqyrtimit fillestar, shqyrtimin e dytë, afati për paraqitjen e kundërshtimeve të provave dhe kërkesat për hudhje të aktakuzës, seanca shqyrtuese e propozimeve, shqyrtimi kryesor etj.

Ligjërisht nuk kemi ndonjë ndarje të veçantë të procedurës gjyqësore, në atë që disa seanca kanë të bëjmë me shumë me veprime teknike dhe procedurale, sesa shqyrtim të çështjes në thelb. Veprimet procedurale të fazës së shqyrtimit gjyqësor kryhen sipas një radhe të caktuar që duhet respektuar në mënyrë të përpiktë.²⁹⁰

Në bazë të këtyre seancave dhe natyrës së përmbajtjes dhe veprimeve të kryera, mund të bëjmë një ndarje të thjeshtë, të brendshme, me karakter paragjyqësor.

Është fjala për shqyrtimin fillestar, të dytë etj, që në vete mund të sjell edhe përfundimin e tërë çështjes në këtë fazë.

Mund të kemi hudhje të aktakuzës dhe pushim të çështjes pa pasur nevojë të shkohet në shqyrtimin kryesor gjyqësor.

Me fjalë të tjera, në KPP nuk figurojnë shumica e dispozitave për konfirmimin e aktakuzës të parashikuara me KPP-në e mëparshme, e në anën tjetër, janë shtuar dispozita të reja me të cilat rregullohet kontrollimi i aktakuzës.²⁹¹

Po ashtu, procesi gjyqësor sjell në vete edhe disa veprime tjera që kanë rëndësi në aspekt të afateve ligjore.

Në këto veprime hyjnë ndër të tjera çështja e dërgimit të ftesave për palët dhe dëshmitarët dhe çështja e paraburgimit për sigurimin e pranisë të të akuzuarit në procesin gjyqësor si veprime të domosdoshme për një proces të rregullt gjyqësor.

²⁹⁰ Hajdari, Azem, Procedura penale, Komentar, Prishtinë, 2010, f.563.

²⁹¹ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.635.

3.6.1. Seancat paragjyqësore

3.6.1.1. Shqyrtimi fillestar

Shqyrtimi fillestar përbën fazën e parë të kontrollimit të aktakuzës.²⁹²

Në bazë të nenit 242 të KPK-së, është e përcaktuar se shqyrtimi gjyqësor do të fillojë në afatin prej tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës për rastet e rregullta.

Kurse, në rastet kur i pandehuri është në paraburgim procesi gjyqësor duhet të fillojë sa më shpejtë që të jetë e mundur, por jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë prej ditës së ngritjes së aktakuzës.

Në praktikë ndodh e kundërta. Këtu kemi të bëjmë me aktakuza të cilat janë ngritur shumë vite më parë dhe shqyrtimi gjyqësor do të fillojë pas shumë viteve.²⁹³

Rast të mos respektimit të këtij afati ligjor është edhe aktakuza e muajit maj 2018²⁹⁴, ku përkundër asaj që i akuzuari ka qenë në paraburgim shqyrtimi fillestar është mbajtur pas pesë (5) muajve, në muajin tetor 2018²⁹⁵.

Të gjitha instrumentet ndërkombëtare e kanë vlerësuar problematikë tejzgjatjen e përfundimit të çështjeve gjyqësore, sidomos atyre me persona të privuar nga liria.

Është detyrë e autoriteteve gjyqësore që të bëjnë përgatitjet e domosdoshme administrative, madje edhe gjatë periudhës së pushimeve të sigurojnë që çështjet urgjente të trajtohen në mënyrë të shpejtë dhe kjo posaçërisht është e domosdoshme, kur është në pyetje liria personale e individit.²⁹⁶

²⁹² Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.635.

²⁹³ Shembull i tillë është Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.8017/14 e datës 9 janar 2015, kurse shqyrtimi gjyqësor ka filluar me datën 27 shtator 2017. Pra ky rast paraqet faktin që shqyrtimi fillestar ka filluar më shumë se dy vite e tetë muaj prej kur është ngritur aktakuza. Ky rast ka të bëjë me procedurë në të cilin i akuzuari ka qenë në procedurë në rregullt, pa aplikim të masave të sigurimit.

²⁹⁴ Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.1/2018, datë 30 maj 2018.

²⁹⁵ Çështja penale P.nr.2507/2018, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm.

²⁹⁶ Të drejtat e njeriut në administrimin e drejtësisë, Një doracak mbi të drejtat e njeriut për gjykatësit, prokurorët dhe avokatët/Human rights in administration of justice: A manual on human rights for Judges, Prosecutors and Lawyers, Prishtinë, 2002, f.206.

3.6.1.1.1. Paraqitja e kërkesës për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtimit të provave

Në seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën i akuzuari deklarohet i pafajshëm, gjyqtari vendos që nga ana e mbrojtjes të paraqitet kërkesa për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave.

Në shumicën e të drejtave të procedurave penale të shteteve bashkëkohore parashikohen dispozita sipas të cilave provat e siguruara me shkelje të rënda të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ndaj të cilëve zhvillohet procedura penale, konsiderohen prova të paligjshme dhe si të tilla mbi këto prova nuk mund të mbështetet vendimi gjyqësor.²⁹⁷

Neni 245 paragrafi 5 i KPPK-së e ka përcaktuar afatin për të paraqitur kërkesën dhe kundërshtimin. Mirëpo, ky termin nuk mund të jetë më vonë se tridhjetë ditë nga shqyrtimi fillestar.²⁹⁸

Ky afat mund të jetë më i shkurtër se tridhjetë (30) ditë por jo më gjatë, e zakonisht në bazë të praktikës ai afat varion nga dhjetë (10), pesëmbëdhjetë (15) ditë etj.

3.6.1.2. Shqyrtimi i dytë

Shqyrtimi i dytë nga vetë emërtimi i saj kuptohet se ajo është seanca e dytë e cila mbahet pasi lënda kalon në gjykatë në bazë të aktakuzës.

Shqyrtimi i dytë caktohet në seancën e shqyrtimit fillestar, kur gjyqtari i vetëm i cili është bartës i lëndës e cakton seancën për shqyrtimin e dytë.

Afati për mbajtjen e seancës së shqyrtimit të dytë caktohet në afat jo më herët se tridhjetë (30) ditë dhe jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e mbajtjes së shqyrtimit fillestar.

Duke qenë se shqyrtimi i dytë ka të bëjë edhe me trajtimin e kërkesës për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave, për këtë gjykata vendos me aktvendim, *“do të thotë se shqyrtimi i dytë, si fazë e dytë e kontrollimit të aktakuzës nuk është i detyrueshëm”*²⁹⁹.

²⁹⁷ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.649.

²⁹⁸ Po aty, f.637.

Megjithatë, caktimi i shqyrtimit të dytë brenda tridhjetë ditëve pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe dyzetë ditëve pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, nuk përjashton mundësinë e zvarritjes së procedurës së kontrollimit të aktakuzës, në rastet kur nuk nevojitet kohë kaq e gjatë për kontrollimin e aktakuzës.³⁰⁰

Nëse refuzohen ato propozime, atëherë për palën mbrojtëse lind afati që ka të bëjë me të drejtën për ankesë në afatin ligjor prej pesë (5) ditësh, e rregulluar sipas nenin 249 paragrafi 6 dhe neni 250 paragrafi 4 i KPPK-së³⁰¹.

3.6.1.3. Ndryshimi i aktakuzës nga ana e prokurorisë

Paraqitja e propozimeve nga mbrojtja, kërkesa për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave sjell në pah edhe një afat me rëndësi që ka të bëjë me veprimin e prokurorit në raport me aktakuzën.

Kur shqyrtohen propozimet, prokurori e ka edhe një mundësi shtesë në raport me aktin akuzues që e ka përpiluar. Prokuroria mund ta ndryshoj aktakuzën e saj në afatin ligjor prej një (1) jave dhe t’ia dorëzojë gjykatës.

Sipas nenit 252 paragrafi 1 i KPPK-së, afati prej një (1) jave llogaritet nga momenti i mbajtjes së seancës së shqyrtimit të dytë.

Këtë institut, KPPK-ja “*për herë të parë e parashikon institutin e aktakuzës së ndryshuar, gjatë procedurës së kontrollimit të aktakuzës, për dallim nga KPP i mëparshëm i cili këtë institut nuk e njihte në këtë fazë të procedurës penale*”³⁰².

Në këto raste, pasi “lind” një aktakuzë e re, atëherë do të pasojë njëjtë procedurë si të ishte lëndë e re dhe do të kalohet nëpër filtrat e gjykatës përmes shqyrtimit të parë e të dytë gjyqësor.

Ndonëse, prokurori sipas paragraf. 4 të këtij neni detyrohet që aktakuzën e ndryshuar ta paraqesë brenda afatit të caktuar, megjithatë në këtë dispozitë nuk është paraparë ndonjë

²⁹⁹ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.637.

³⁰⁰ Po aty.

³⁰¹ Po aty, f.651 & 653.

³⁰² Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.655.

pasojë procedurale për prokurorin e shtetit për mos paraqitje me kohë të aktakuzës së ndryshuar.³⁰³

Po ashtu, prokuroria ka mundësinë ligjore që gjatë përgjigjes ndaj pretendimeve të paraqitura nga i pandehuri dhe mbrojtja, të bëjë edhe rikualifikim të veprës penale në aktin akuzues.

Këto rikualifikime mund të sjellin situatë të re juridike, e që mund të sjell deri te parashkrimi i ndjekjes penale.

Në këto raste, mund që prokuroria të hjek dorë nga ndjekja, por edhe gjykata të nxjerr aktvendim me të cilën pushon procedurën.

Situatë të tillë kemi pasur në praktikë, ku pas dhënies së përgjigjes nga ana e prokurorisë, gjykata *“konstatoi se në rastin konkret ka arritur afati kohor i parashkrimit absolut i ndjekjes penale...ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, e në rastin konkret kanë kaluar më shuymë se 4 (katër) vite...Parashkrimi absolut është arrit me dt:6.12.2017”*³⁰⁴.

3.6.1.4. Seanca për shqyrtimin e kundërshtimeve të provave dhe kërkesës për hudhje të aktakuzës

Në KPPK-ës, në nenin 255 është e përcaktuar edhe mbajtja e një seance që në praktikë mund të themi se mbahet shumë rrallë apo fare.

Kjo është seanca për shqyrtimin e kundërshtimeve të provave apo kërkesës për hudhje të aktakuzës, e që dispozita e cekur tregon se kur mbahet kjo seancë e që është atëherë kur *“gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues çmon se është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit për të vlerësuar kundërshtimet nga neni 249 apo kërkesat nga neni 250...”*.

Kjo seancë duhet të mbahet jo më vonë se tre (3) javë nga dita kur është mbajtur shqyrtimi i dytë.

³⁰³ Po aty.

³⁰⁴ Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.3717/2013, datë 26 shkurt 2018.

Në këtë rast, caktimi dhe zbatimi i shqyrtimit të tillë do të thotë realisht mbajtje e një shqyrtimi të tretë rreth kontrollimit të aktakuzës.³⁰⁵

Siç thonë juristët “*në shikim të parë, duket pak sa e stërzgatur, mirëpo procedimi i tillë siguron të rrisë efikasitetin gjyqësor*”³⁰⁶.

Lidhur me këtë seancë gjykata vendos me aktvendim të veçantë me shkrim dhe ndaj të cilit pastaj lind e drejta për ta atakuar në gjykatën e Apelit.

Ky vendim merret jo më vonë se tre (3) javë nga dita e mbajtjes së seancës.³⁰⁷

3.6.2. Seancat gjyqësore

3.6.2.1. Fillimi i shqyrtimit gjyqësor

Pas mbajtjes së seancës të shqyrtimit fillestar, të shqyrtimit të dytë dhe seancës për kundërshtimin e provave dhe kërkesës për hudhje të aktakuzës, gjyqtari cakton fillimin e shqyrtimit gjyqësor.

Shqyrtimi gjyqësor është faza më e rëndësishme e procedurës penale.³⁰⁸

Shqyrtimi gjyqësor do të mbahet vetëm atëherë kur nga ana e gjykatës është vlerësuar se çështja e caktuar penale doemos duhet të shkoj në shqyrtim kryesor për tu trajtuar dhe se seancat paraprake të cekura më lartë kanë vërtetuar se aktakuza është e drejtë dhe e bazuar në ligj.

Sipas nenit 285 të KPPK-së, seanca e shqyrtimit gjyqësor duhet të filloj në afatin ligjor prej një (1) muaj nga koha e mbajtjes së shqyrtimit të dytë.

Ky afat llogaritet edhe nga data e lëshimit të urdhrit të fundit lidhur me kundërshtimin e provave apo kërkesës për hudhje të aktakuzës.³⁰⁹

Në praktikë ky detyrim ligjor nuk ndodh zakonisht, e mund të themi se ndodh rrallë. Mund të themi se të rralla janë ato raste ku shqyrtimet fillojnë brenda afatit ligjor dhe se në të njëjtën situatë janë edhe rastet e përfundimit të çështjes gjyqësore.

³⁰⁵ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep, E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2013, f.346.

³⁰⁶ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.663.

³⁰⁷ Po aty, f.655.

³⁰⁸ Hajdari, Azem, Procedura penale, Komentar, Prishtinë, 2010, f.563.

³⁰⁹ Si 306, f.741.

Ligjvënësit udhëzojnë që proceset gjyqësore duhet të përfundojnë sa më shpejtë dhe në kontinuitet, e jo me ndërprerje të paarsyshme.

Kjo situatë juridike ku nuk zbatohen drejtë dispozitat ligjore për çështjet e shqyrtimit gjyqësor ndodh edhe në Kosovë edhe në Shqipëri.

Kështu, Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë të Shqipërisës, 6/2003 për nenin 342 e përcakton se, kur shqyrtimi gjyqësor nuk mund të përfundohet në një seancë të vetme, gjykata vendos që të vazhdojë ditën e mëpasme të punës.

Gjykata lejohet ta ndërpresë shqyrtimin gjyqësor deri 15 ditë, vetëm për raste të veçanta.³¹⁰

3.6.2.2. Dërgimi i ftesave për seancë

Shqyrtimi gjyqësor nuk mund të mbahet pa qenë palët prezentë, sepse ai shqyrtim mbahet për ata.

Në këtë mënyrë ftesat apo thirrjet siç thuhet në kod, të akuzuarit i dërgohet së paku tetë (8) ditë para se të mbahet shqyrtimi gjyqësor.

Edhe në këtë rast, ligjvënësi e ka lënë mundësinë që ky afat të shkurtohet por vetëm me kërkesën e të akuzuarit.

Në raste të tilla, afatet mund të jenë përveç çështje ditësh por edhe çështje orësh. Rast i tillë është edhe shkurtimi i kohës njoftuese më pak se dy ditë, psh, me datën 15 janar 2018 është caktuar seanca për datën 17 janar 2018 për shkak të interesit të palëve për të përfunduar çështjen sa më parë.³¹¹

Shkurtimi mund të bëhet edhe më kërkesë të prokurorit por në këtë rast duhet të ekzistojë pëlqimi i të akuzuarit për shkurtimin e afatit ligjor tetë (8) ditor. Neni 287 paragrafi 3 i KPPK-së e rregullon këtë situatë juridike.³¹²

³¹⁰ Shiko: Kodi i Procedurës Penale, i pasuruar me praktikë Gjyqësore, Boptues Alb-juris, Tiranë, 2017, f.451.

³¹¹ Çështja penale PKR.nr.338/15, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda.

³¹² Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.744-745.

3.6.2.3. Caktimi i paraburgimit për sigurimin në seancë gjyqësore

Ndodh që gjatë procesit gjyqësor gjykata të has në probleme teknike dhe objektive.

Gjykatës mund t'i dalin probleme në rastet kur i akuzuari edhe pse i ftuar me ftesë për seancë gjyqësore, ai t'i shmanget paraqitjes.

Në këto raste edhe pse nuk ekzistojnë asnjëra nga shkaqet për caktimin e paraburgimit, gjykata mund të caktojë paraburgimin për të siguruar praninë e të akuzuarit në shqyrtim gjyqësor.

Sipas nenit 370 paragrafi 2 i KPPK-së, paraburgimi në këto rast nuk mund të kalojë më shumë se një (1) muaj³¹³.

Kjo vlen edhe në rastet kur aktgjykimi nuk mund të shpallet brenda asaj kohe dhe *“paraburgimi mund të caktohet pavarësisht faktit a janë plotësuar kushtet ligjore mbi bazën e të cilave, si rregull, mund të caktohet masa e tillë”*³¹⁴.

Në rastet që kanë të bëjnë me sigurimin e personit në shqyrtim kryesor, merret parasysh se i akuzuari:

*“është fare mirë i njoftuar me gjithë situatën e krijuar para dhe pas kryerjes së veprës penale, i njëjti gjithashtu është udhëzuar se duhet të informojë organet e ndjekjes në rast të ndërrimit të adresës...ndonëse në dijeni për ftesat e gjykatës, qëllimshëm i shmanget ardhjes në gjykatë, pengon procesin e rregullt gjyqësor...”*³¹⁵.

Në këto raste, nga ana e gjykatës krahas aktvendimit të saj për caktimin e paraburgimit lëshohet edhe Urdhëresë për policinë, për ndalimin, arrestimin dhe transferimin e personit në qendrën e paraburgimit.

³¹³ Po aty, f.863.

³¹⁴ Hajdari, Azem, Procedura penale, Komentar, Prishtinë, 2010, f.591.

³¹⁵ Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, nr.338/15, datë 9 nëntor 2017.

Urdhërarresti që ka të bëjë me paraburgimin, mbetet në fuqi deri në kapjen e personit të kërkuar, e “ *më së largu deri me ditën e 365 prej ditës së lëshimit të këtij urdhërarresti* ”³¹⁶.

3.6.2.4. Përfundimi i shqyrtimit gjyqësor

Shqyrtimi gjyqësor nuk mund të vazhdojë në pafundësi.

Shqyrtimi duhet të ketë një kohë të caktuar se kur ai duhet të përfundojë dhe për këtë arsye koha për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor është përcaktuar sipas ligjit që ai mund të përfundojë brenda dy afateve ligjore.

E para ka të bëjë me rastet kur shqyrtimi mbahet para gjyqtarit të vetëm gjykues dhe afati për këto raste është nëntëdhjetë (90) ditë, situatë e cila parashihet në nenin 314 të KPPK-së. Zakonisht, në rastet më të shpeshta, si pasojë e pengesave të krijuara për shumë arsye, si atyre objektive dhe subjektive të palëve në procedurë zakonisht shqyrtimet nuk përfundojnë brenda afateve, prapë se prapë ka raste që shqyrtimi përfundon në afat³¹⁷.

Gjykatësit në Kosovë janë të mbingarkuar me raste gjyqësore, kurse me rregullativën etike dhe administrative atyre u janë vënë standarte kohore për zgjidhjen e rasteve.

Në kushtet e një mbingarkese të tillë, standartet kohore për zgjidhjen e rasteve asnjëherë nuk kanë mundur të respektohen.³¹⁸

E dyta, është rasti kur shqyrtimi gjyqësor mbahet para trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundojë brenda afatit prej njëqindnjëzet (120) ditë.³¹⁹ Kjo është përcaktuar në nenin 314 të KPPK-së.

³¹⁶ Urdhëresa e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, nr.338/15, datë 9 nëntor 2017.

³¹⁷ E drejta për “Gjykim të Drejtë”, Monitorimi i seancave gjyqësore të ndërlidhura me rastet e korrupsionit dhe shpërdorimit të autoritetit publik, Lëvizja “FOL”, Prishtinë, dhjetor 2010, f.19.

³¹⁸ Haxhaj, Rafet, Kodi i etikës dhe sjelljes profesionale të gjykatësve në Kosovë rregull e moralit shoqësor apo instrument i rreptë ligjor, *Justica International Journal of Legal Sciences*, Vol.3, Tetovë, 2015, f.234.

³¹⁹ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.779-780.

3.6.2.5. Rifillimi i shqyrtimit gjyqësor

Ligjvënësi i ka paraparë disa raste të cilat determinojnë që një shqyrtim gjyqësor i caktuar të rifillojë prapë.

Raste të tilla janë kur përbërja e trupit gjykues është ndryshuar, kur është ndryshuar kryetari i trupit gjykues dhe kur kemi të bëjmë me shtyrje më të gjatë se tre (3) muaj të shqyrtimit dhe është e nevojshme që të rifillojë gjykimi.

Por, në nenin 312 paragrafi 3 i KPPK-së është paraparë edhe një rrethanë që në praktikë mund të themi se nuk aplikohet fare, kur kemi të bëjmë me ndërprerje të shqyrtimit më shumë se tetë (8) ditë.³²⁰

Rifillimi duhet të bëhet në mundësinë e parë që krijohet pas evitimit të pengesave që kanë shkaktuar ndërprerjen e shqyrtimit. Për këtë çështje nuk kemi ndonjë afat strikt për rifillim të shqyrtimit, por kjo lihet të kuptohet sa më parë.

Rast i tillë është çështje penale kundër drejtorit ekzekutiv të Bankës Ekonomike Valon Llluka dhe menaxherit Memli Saraqini, ku gjyqtarja Shadije Gërguri ka nxjerr aktvendim për fillim të serishëm të gjykimit. Arsyetimi është, kalimi i një kohë të gjatë prej kur ishte kryer seanca e fundit gjyqësore, ku vetëm prej seancës së shqyrtimit fillestar kishte kaluar më shumë se një vit e gjysmë.³²¹

3.6.2.6. Zgjatja e afateve për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor

A mund të zbatohen drejtë në praktikë afatet ligjore për të përfunduar një shqyrtim gjyqësor?

Vetë arsyet e cekura më lartë dhe arsyet tjera të cekura tani në vazhdim tregojnë se në praktikë nuk ndodh që shqyrtimi gjyqësor të përfundojë brenda afateve të përcaktuara në nenin 314 paragrafi 2 të KPPK-së.

³²⁰ Po aty, f.778.

³²¹ <http://betimiperdrejtesi.com/kalojne-me-shume-se-1-vit-e-gjysme-nga-shqyrtimi-fillestar-nise-nga-fillimi-gjykimi-ndaj-drejtorit-ekzekutiv-dhe-menaxherit-te-bankes-ekonomike/>, qasur me datë 12 tetor 2017.

“Shqyrtimi gjyqësor mund të vazhdohet me aktvendim të arsyetuar nga paragrafi 1. i këtij neni kur ekzistojnë rrethana të cilat kërkojnë më shumë kohë, por pa u kufizuar në:

- 2.1. numër të shumtë të dëshmitarëve;*
- 2.2. dëshmia e një apo më shumë dëshmitarëve është shumë e gjatë;*
- 2.3. numri i provave është jashtëzakonisht i madh;*
- 2.4. siguria e shqyrtimit gjyqësor bën të nevojshme vazhdimin.”³²²*

Pra, afati për përfundim të shqyrtimit gjyqësor mund të vazhdohet kur kemi të bëjmë me nevojën për të mbledhur prova të reja.

Rrethanë tjetër është kur gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se tek i akuzuari, pas kryerjes së veprës penale është paraqitur çrregullim apo paaftësi mendore e përkohshme.

Kur ekzistojnë pengesa të tjera të cilat mund të jenë të natyrave të ndryshme, si të natyrës objektive dhe subjektive. Kur kemi të bëjmë me numër të madh të dëshmitarëve apo kur edhe dëshmitë e tyre janë shumë të gjata.

Pastaj kemi rastet kur numri i provave është jashtëzakonisht i madh dhe është e pamundshme që ato të trajtohen brenda afatit të caktuar, andaj të gjitha këto vazhdimet të afatit të përfundimit të shqyrtimit gjyqësor bëhen me aktvendime të veçanta.

Afati për vazhdimet është tridhjetë (30) ditë dhe ato vendime futen në shkresa të lëndës.

Raste në praktikë janë të shumta kur kemi të bëjmë me zgjatje të proceseve gjyqësore me shumë vite në vazhdimësi.

I tillë është rasti Limaj i njohur si “MTPT” (Ministria e Transportit dhe Post Telekomunikacionit) i cili ka filluar me aktakuzën e datës 05 dhjetor 2012, ka vazhduar me Konsolidim të aktakuzave dhe ka përfunduar në shkallë të parë me datën 24 nëntor 2017.³²³ D.m.th, vetëm proces gjyqësor janë pesë (5) vite pa një (1) javë.

³²² Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.779.

³²³ Çështja penale “MTPT” P.nr.8/13 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda.

Në këtë rast, të gjithë të akuzuarit janë shpallë të pafajshëm. Tërë procesi është filluar dhe ka përfunduar nga ndërkombëtarët.³²⁴

3.6.2.7. Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor

Për veprimtarinë që zhvillohet në shqyrtimin gjyqësor mbahet procesverbal.³²⁵

I gjithë procesi gjyqësor shënohet dhe evidentohet në procesverbal.

Parimisht procesverbali duhet të përpilohet menjëherë në momentin e kryerjes së veprimit procedural gjyqësor.

Ai duhet dhënë menjëherë palëve në proces, por ndodh që për shkak të pengesave teknike, korrigjimeve në drejtshkrim, mungesës së printerëve apo kryerjes së veprimeve në terren, siç është rikonstruimi i vendit të ngjarjes, një gjë e tillë nuk bëhet.

Në rastet kur kemi të bëjmë me veprime procedurale që kryhen në mënyrën audio ose video, veprime që duhet të vendosen në procesverbal lindin disa afate ligjore.

Në rastet kur kemi të bëjmë me të akuzuarin i cili dënohet me burgim apo kur gjykata paralajmërohet nga pala se do të ushtrohet ankesë, procesverbali duhet të përpilohet në afatin prej tre (3) ditëve.

Në nenin 315 paragrafi 4 ky afat mund të shtyhet deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë, siç thotë ligjvënësi “*për raste të arsyeshme*”³²⁶. Arsyeshmëria varet për secilin rast veç e veç, prej ndërlikueshmërisë së tij, numrit të madh të palëve, veprave të ndryshme penale, e rrethana tjera të ligjshme.

³²⁴ Betimi për Drejtësi, “*Historiku, dëshmitarët dhe procesi gjyqësor maratonik i MTPT-së*”, datë 24 nëntor 2017, (<http://betimiperdrejtesi.com/historiku-deshmitaret-dhe-procesi-gjyqesor-maratonik-i-mtpt-se/>, qasur me datën 25 dhjetor 2017).

³²⁵ Hajdari, Azem, Procedura penale, Komentar, Prishtinë, 2010, f.597.

³²⁶ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f. 781.

3.6.2.8. Shpallja e aktgjykimit

Pasi të përfundojë shqyrtimi gjyqësor, nga ana e gjykatës çështja vendoset përmes aktgjykimit dhe *“palët dhe personat tjerë të interesuar njihen me rezultatin e procedurës penale në lidhje me çështjen konkrete penale që është objekt shqyrtimi në te”*³²⁷.

Aktgjykimi i marrë fillimisht shpallet në mënyrë verbale, duke i dhënë arsyet sipërfaqësore lidhur me aktgjykimin.

Shpallja e aktgjykimit në mënyrë verbale bëhet në ditën e njëjtë të përfundimit të shqyrtimit gjyqësor apo më së largu mund të shtyhet deri në tre (3) ditë prej momentit të seancës gjyqësore me të cilën shpallet i përfunduar gjykimi. Kjo është e rregulluar me nenin 366 paragrafi 1 i KPPK-së.³²⁸

3.8.2.9. Përpilimi i aktgjykimit

Aktgjykimi me të cilin është përfunduar çështja e caktuar duhet të bëhet në mënyrë të shkruar dhe *“të ju dërgohet palëve e personave tjerë të autorizuar...në funksion të sigurimit të kushteve që mundësojnë shfrytëzimin e të drejtave të caktuara të tyre dhe në përgjithësi në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore”*³²⁹.

Në nenin 369 të KPPK-së, parashihet se afati për tu përpiluar aktgjykimi është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga momenti i shpalljes së tij.

Ky afat është i përcaktuar për rastet kur i akuzuari i gjykuar është shpallur fajtor dhe gjendet në paraburgim.

Po ashtu, ky afat vlen edhe për rastet kur i akuzuari është shpallur fajtor dhe i është caktuar paraburgimi në shqyrtim gjyqësor.

Për rastet të tjera, afati për përpilimin me shkrim të aktgjykimit është tridhjetë (30) ditë nga dita e shpalljes së tij.

³²⁷ Hajdari, Azem, Procedura penale, Komentar, Prishtinë, 2010, f.651.

³²⁸ Si 326, f.854-855.

³²⁹ Si 326, f.657.

Sipas nenit 369 i KPPK-së, në rastet më të ndërlikuara, përpilimi i aktgjykimit mund të shtyhet deri gjashtëdhjetë (60) ditë. Për këto raste kërkohet leje nga ana e kryetarit të gjykatës.³³⁰

Në praktikë, tani gjyqtarët duke u nisur nga ajo se aktgjykimet nuk përpilohen brenda afateve ligjore, kanë gjetur një mënyrë të mbulesës së vonesave në përpilim të aktgjykimit me kohë. Kjo për shkak se kishte dallime në data ndërmjet datës së shpalljes së aktgjykimit dhe datës së përpilimit të aktgjykimit.

Tani edhe nëse përpilimi i aktgjykimit bëhet jashtë afateve ligjore, data po i vendoset në atë mënyrë që data të jetë brenda afatit ligjor 15 ditë apo 30 ditë, varësisht prej rasteve.

Shumë nga gjyqtarët deri më tani në aktgjykimet e tyre nuk e kanë vendosur fare datën e shpalljes dhe datën e përpilimit, por vetëm datën e shpalljes.

Kështu, hulumtimi i kryer nga OSBE, në vitin 2016, ka rezultuar se:

“...si pasojë e mungesës së datës së shkruar ishte e pamundur për të vërtetuar nëse një aktgjykim është hartuar brenda afatit kohor të përcaktuar me kod... në praktikë në vetëm 36 nga 196 aktgjykime të grumbulluara me shkrim kishte dallim ndërmjet datës kur është nxjerrë vendimi me gojë dhe datës së lëshimit të aktgjykimit”³³¹.

3.6.3. Afatet lidhur me urdhrin ndëshkimor

Duke qenë se procedura e dhënies së urdhrit ndëshkimor është procedurë e veçantë, e cila në të shumtën e rasteve do të përfundojë në proces gjyqësor, është e rëndësishme të cekën disa afate ligjore.

³³⁰ Po aty.

³³¹ Shqyrtimi i Zbatimit të Kodit të Procedurës Penale në Kosovë, Raport i OSBE, Prishtinë, qershor 2016, f.34. (<https://www.osce.org/sq/kosovo/243981?download=true>, qasur me dat 02 korrik 2016).

Në momentin e pranimit të urdhrit ndëshkimi i pandehuri apo mbrojtësi i tij kanë afatin prej tetë (8) ditëve për të paraqitur kundërshtim ndaj urdhrit. Këtë e rregullon neni 496 i KPPK-së.³³²

Pas ushtrimit të kësaj të drejte ligjore, do të kemi proces gjyqësor për të cilin pastaj vlejné afatet për procese të rregullta gjyqësore siç janë paraqitur më lartë.

3.6.4. Çështja në rigjykim

Është me rëndësi të trajtohet sadopak çështja gjyqësore që ka të bëjë me rastet të cilat kthehen në rigjykim nga gjykata e shkallës instanciale.

Afati kohor i arsyeshëm për zgjidhjen e një rasti është kusht i një rëndësie të veçantë pasi që e vë në theks rëndësinë e ndarjes me kohë të drejtësisë, sepse vonesat janë ato të cilat mund të rrezikojnë besueshmërinë dhe efikasitetin e drejtësisë.³³³

Këto raste, për shkak të vonesave që krijohen rrezikojnë të parashkruhen apo edhe në të kundërtën, të mbesin të hapura dhe t'i sjellin pasoja palëve.

Andaj, vlerësohet se *e drejta për "rigjykim" (nënkupton se ...duhet të rigjykohen në mënyrë intensive dhe jo thjesht të mjaftohen me vlerësimet e autoriteteve vendase)*³³⁴.

Duke qenë të lirë për të vepruar në caktim të lëndëve dhe duke mos qenë e përcaktuar në KPPK asnjë afat ligjor brenda të cilit duhet të fillojë rigjykimi, gjykatat e shkallës së parë e keqpërdorin një komoditet të tillë lidhur me caktimin dhe kryerjen e rasteve në rigjykim.

Për këtë arsye, duke parë këtë neglizhencë institucionale të gjykatave, Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerr një Qarkore me datën 04 dhjetor 2014 dhe ua ka dërguar të gjitha gjykatave themelore.

³³² Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.1168.

³³³ Raporti i auditimit efikasiteti i menaxhimit të lëndëve civile në gjykatat themelore, Zyra Kombëtare e Auditimit, Dokumenti nr: 24.18x.9-2015/16-08, Auditim i performances, Prishtinë, nëntor 2017, f.1. http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2017/11/Raport-Auditimi-Gjykatat_shqip.pdf, qasur me datë 11 maj 2018.

³³⁴ E drejta për proces të rregullt dhe rihapja e proceseve penale, Manual trajnimi mbi nenin 6-të KEDNJ-së, Tiranë, 2017, F.54. <https://rm.coe.int/training-manual-on-the-right-to-fair-trial-and-reopening-of-domestic-p/16808b7cab>, qasur me datë 11 maj 2018.

Qarkorja ka mbajtur qëndrimin se lëndët në rigjykim nuk mund të trajtohen si lëndë të reja, por si lëndë në vazhdimësi, në proces. Ato lëndë duhet të caktohen dhe të punohen sa më parë që të jetë e mundur, në ditët e para të lira. Preokupimi i Gjykatës Supreme ndër të tjera është se:

“kur çështja penale kthehet në rigjykim me muaj e ndoshta edhe me vite nuk caktohet shqyrtimi gjyqësor, fatkeqësisht edhe kur të akuzuarit ndodhen në paraburgim. Praktika e tillë është e paligjshme dhe duhet domosdoshmërisht të shmanget”³³⁵

Por, prapë se prapë, kjo qarkore ka mbetur vetëm në letër dhe si tentim për ndikim në zbatim të ligjit.

³³⁵ Qarkorja e Gjykatës Supreme të Kosovës, GJ.A.nr.459/2014, datë 04 dhjetor 2014.

Afatet dhe zbatimi i tyre në procedurën penale në Kosovë




Figura 3: Afatet ligjore në një proces të rregullt gjyqësor.

3.7. AFATET GJATË USHTRIMIT TË MJETEVE JURIDIKE

Mjetet juridike janë veprime të cilat i ndërmarrin subjektet të cilat kanë rolin e palës në procedurë dhe duke qenë se ato veprime kanë karakter procedural, ato merren me qëllim që një institucion, organ apo trup më i lartë të vendos lidhur me çështjen që është objekt shqyrtimi. Këtu kemi të bëjmë me palët të cilat janë të pakënaqura me vendimin e marrë nga organi apo institucioni i caktuar dhe të cilat palë kërkojnë që të vendoset lidhur me pretendimet e tyre.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka theksuar se kur një individ e vlerëson se është viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut të paraparë me Konventë, për këtë duhet të ekzistojë një mjet juridik pranë ndonjë organi vendës ashtu që kërkesa e bërë të adresohet dhe si kompensim të sigurohet dëmshpërblimi për shkeljen përkatëse.³³⁶

Vendimet e kundërshtuara apo të atakuara mund të jenë vendime të formës përfundimtare-formës së prerë por edhe vendime të cilat akoma nuk kanë marrë formën përfundimtare-formën e prerë.

Në rastet kur kemi të bëjmë me vendime që nuk kanë marrë formën e prerë, plotfuqishmëria e tyre pezullohet në momentin e ushtrimit të mjetit juridik.

Kurse, në rastet tjera kur kemi të bëjmë me mjete juridike ndaj vendimeve që kanë marrë plotfuqishmërinë e tyre, ushtrimi i mjeteve juridike nuk shkakton pezullimin e vendimeve të tyre.³³⁷

Pikërisht për këto arsye, kemi dy lloje të mjeteve juridike, ato të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

Siç thotë penalisti dhe profesori ynë Ejup Sahiti për mjetet e rregullta juridike dhe mjetet e jashtëzakonshme juridike, *“kufiri ndarës mes tyre është forma e prerë e vendimit gjyqësor”*³³⁸.

³³⁶ Silver kundër Mbretërisë së Bashkuar, Vendimi i Gjykatës më 25 mars 1983, paragrafi 113.

³³⁷ Rast i tillë është ankesa ndaj vendimit me të cilin është caktuar masa e paraburgimit. Neni 189, paragrafi 3 i KPPK-së.

³³⁸ Sahiti, Ejup, E drejta e Procedurës Penale, Prishtinë, 2005, f.223.

37.1. Mjetet e rregullta juridike

Mjetet e rregullta juridike janë mekanizmat të cilët atakojnë vendimet që nuk kanë marrë formën e prerë. Duke qenë se vendimet e tilla mund të nxirren në të gjitha fazat e procedurës penale, ato mund të jenë kundërshtimet dhe ankesat që kanë të bëjnë ndaj vendimeve të marra nga gjyqtari i vetëm por edhe nga trupi gjykues.

37.1.1. Kundërshtimet ndaj urdhrave

Në procedurën penale të shpeshta janë vendimet e lëshuara nga gjyqtari i procedurës paraprake.

Gjyqtari gjatë punës së tij lëshon urdhra të ndryshëm me të cilat prek edhe të drejtat e palëve në procedurë.

Secili urdhër i gjyqtarit të procedurës paraprake që prek të drejtat e të dëmtuarit e ndaj të cilit është ushtruar kundërshtim duhet të shqyrtohet nga kolegji shqyrtues i gjykatës së njëjtë.³³⁹

Afati për të paraqitur kundërshtimin është dyzet e tetë (48) orë prej momentit kur është nxjerrë/pranuar urdhri, kurse afati për shqyrtimin e kundërshtimit të paraqitur duhet të bëhet brenda afatit prej dyzet e tetë (48) orëve. Kjo rregullohet në nenin 24 të KPPK-së.³⁴⁰ Kurse, ndaj atyre vendimeve të nxjerra në bazë të kundërshtimeve, prapë mund të paraqitet ankesë dhe atë në gjykatën e apelit.

Afati për paraqitjen e ankesës është pesë (5) ditë sipas nenit 24 paragrafi 6.³⁴¹

Duke qenë se ankesa si e drejtë që i takon palëve mund të ushtrohet edhe ndaj vendimeve të gjykatës së apelit, por në këtë rast me karakter të kërkesës.

³³⁹ Shiqo: 93. Smibert, Jon, Udhëzues për Kodin e Procedurës Penale të Kosovës dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Departamenti i Drejtësisë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Zyra e Zhvillimit dhe Trajnimit të Prokurorëve Tejoqeanik, Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë, 2013.f.10. http://oak-ks.org/repository/docs/Udhezues_i_Kodit_te_Procedures_Penale_976264.pdf, qasur me datë 4 mars 2016.

³⁴⁰ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.137.

³⁴¹ Po aty, f.137.

Neni 378 i KPPK-së e ka përcaktuar afatin për të paraqitur këtë kërkesë në Gjykatën Supreme të Kosovës brenda dhjetë (10) ditësh.³⁴²

37.12 Ankesat ndaj aktgjykimeve

Lidhur me ankesën kundër aktgjykimit të shkallës së parë, kemi vetëm një afat ligjor brenda të cilët mund të paraqitet ankesa. Sipas nenit 380 paragrafi 1, afati për të paraqitur ankesën është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e pranimi të aktgjykimit të shkruar.³⁴³

Me rastin e paraqitjes së ankesës ndaj aktgjykimit të shkallës së parë, ankesa *e paraqitur në afat e pezullon ekzekutimin e aktgjykimit-karakteri suspensiv i ankesës*”³⁴⁴.

37.13 Përgjigjja në ankesë

Është procedurë strikte që ankesa e ushtruar i paraqitet/dorëzohet gjykatës të cilës e ka marrë aktgjykimin e kundërshtuar.

Gjykata e shkallës së parë e ka për detyrë që lëndën me ankesë ta përcjell në Gjykatën e Apelit dhe paraprakisht një kopje të ankesës ua dërgon palëve kundërshtare.

Palët kundërshtare kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre duke u përgjigjur në ankesë.

Afati për të paraqitur përgjigje në ankesë, sipas nenit 388 paragrafi 2 i KPPK-së është tetë (8) ditë nga pranimi i ankesës.³⁴⁵

³⁴² Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit, f.877.

³⁴³ Po aty, f.878.

³⁴⁴ Hoti, Minir & Hajraj, Mentor, Ankesa kundër aktgjykimit të shkallës së parë, Instituti Gjyqësor i Kosovës, *Justicia*, Prishtinë, 2011, f.62.

³⁴⁵ Si 343, f.920-921.

37.14 Trajtimi i ankesës në Gjykatën e Apelit

Ankesa pasi pranohet dhe analizohet afatshmëria e saj dhe çështje tjera, pasi e njëjta i është dërguar palës kundërshtare për të paraqitur përgjigje në ankesë, në afatin prej tetë ditësh, *Gjykata e shkallës së parë ia dërgon gjykatës së shkallës së dytë ankesën, përgjigjen në ankesë nëse ka dhe të gjitha shkresat tjera të lëndës.*³⁴⁶

KPPK-së nuk e ka përcaktuar në mënyrë strikte ndonjë afat ligjor brenda të cilit Gjykata e Apelit duhet ta trajtoj ankesën/lëndën.

Por, për rastet kur i gjykuari gjendet në paraburgim, afati ligjor për ta trajtuar ankesën është jo më vonë se tre (3) muaj. Ky afat ka të bëjë jo vetëm me nxjerrjen e vendimit, por me përfundimin edhe të procedurës administrative, që ka të bëjë me kthimin e të gjitha shkresave gjykatës themelore.

Kjo do të thotë se afati është tre (3) muaj që vendimi të dorëzohet në gjykatën e shkallës së parë, ashtu siç e përcakton neni 405 paragrafi 2 i KPPK-së.³⁴⁷

37.15 Trajtimi i masës së paraburgimit nga Gjykata e Apelit

Në rastet kur kemi të bëjmë me ankesë ndaj aktgjykimit dhe kur i gjykuari gjendet në paraburgim, këtu dalin disa detyrime shtesë për gjykatën e apelit.

Sipas nenit 389 paragrafi 5, gjyqtari raportues i gjykatës së apelit, brenda afatit prej pesë (5) ditësh duhet të vlerësojë nëse ekzistojnë apo jo arsyet e mbajtjes të të gjykuarit edhe më tutje në paraburgim.³⁴⁸

Në të gjitha situatat, është e përcaktuar se gjykata e shkallës së dytë “*merr vendim në seancë të kolegjit apo në shqyrtim gjyqësor*”³⁴⁹.

³⁴⁶ Hoti, Minir & Hajraj, Mentor, Ankesa kundër aktgjykimit të shkallës së parë, Instituti Gjyqësor i Kosovës, *Justicia*, Prishtinë, 2011, f.70.

³⁴⁷ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.968.

³⁴⁸ Po aty, f.923-924.

³⁴⁹ Hajdari, Azem, Procedura penale, Komentar, Prishtinë, 2010, f.689.

					3 muaj
48 h	48 h	15 ditë	8 ditë		
Urdhërat	Shqyrtimi i kundërshtimit	Aktgjykimet	Përgjigja në ankesë	Trajtimi i ankesës në Gjykatën e Apelit	

Tabela 4: Afati i paraqitjes së mjeteve të rregullta juridike.

3.72. Mjetet e jashtëzakonshme juridike

Edhe pse “si rregull, vendimi gjyqësor i formës së prerë është definitiv dhe i pandryshueshëm”³⁵⁰, prapë është paraparë nga ligjvënësi se edhe këto vendime mund të atakohen, sepse mund të mos jenë të drejta. Si mjete të jashtëzakonshme juridike janë: kërkesa për rishikim të procedurës penale, kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit dhe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

3.72.1. Kërkesa për rishikimin e procedurës penale

Për tu paraqitur kërkesa për rishikimin e procedurës penale, është përcaktuar afati ligjor i cili përcakton se ajo mund të paraqitet brenda afatit prej dy (2) vite.

³⁵⁰ Po aty, f.715.

Kjo çështje ka të bëjë me dhënien e mundësisë që vendimi i formës së prerë edhe një herë të shikohet “*me qëllim modifikimi apo shfuqizimi*”³⁵¹.

Neni 418 paragrafi 1 e përcakton këtë afat, me rastet kur kemi të bëjmë me aktgjykim i cili ka marrë formën e prerë dhe kur aktvendimi për pushimin e procedurës penale ka marrë formë të prerë.³⁵²

Për qëllime sqaruese, rishikimi i procedurës penale kur aktgjykimi ka marrë formën e prerë mund të bëhet kur:

1.1. provohet se aktgjykimi është mbështetur në dokument të falsifikuar ose në deklaram të rremë të dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit;

1.2. provohet se aktgjykimi është pasojë e veprës penale të kryer nga gjyqtari ose personi që ka ndërmarrë veprimet hetimore;

1.3. zbulohen fakte të reja ose paraqiten prova të reja, të cilat vetë ose së bashku me provat e mëparshme ka të ngjarë të arsyetojë pafajësinë e personit të dënuar ose dënimin e tij sipas një dispozite më të butë penale;

1.4. personi për të njëjtën vepër është gjykuar disa herë ose kur disa persona janë dënuar për vepër të njëjtë të cilën ka mund ta kryejë vetëm një person ose disa prej tyre; ose

1.5. në rastin e dënimit për vepër penale në vazhdim ose vepra tjera penale të cilat sipas ligjit përfshijnë disa veprime të njëjta ose të ndryshme, zbulohen fakte të reja ose paraqiten prova të reja që tregojnë se i dënuari nuk ka kryer veprimin që është përfshirë në veprën penale për të cilën ai është dënuar dhe ekzistimi i fakteve të tilla do të ishte me ndikim vendimtar në caktimin e dënimit.”³⁵³ (neni 423, paragrafi 1 i KPPK-së).

Kurse rishikimi i procedurës penale të pushuar me aktvendim të formës së prerë, sipas nenit 422 të KPPK-së, ndodh kur:

³⁵¹ Po aty, f.716.

³⁵² Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.984.

³⁵³ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.992-1002.

“Procedura penale e pushuar në formë të prerë para fillimit të shqyrtimit gjyqësor mund të rishikohet kur prokurori i shtetit tërhiqet nga aktakuza dhe vërtetohet se tërheqja është pasojë e veprës penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare të prokurorit të shtetit. Gjatë provimit të veprës penale zbatohen dispozitat nga neni 423, paragrafi 2. i këtij Kodi.

2. Kur aktakuza hidhet bazuar në mungesë provash të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale të përshkruar në aktakuzë dhe nëse zbulohen dhe mblidhen fakte dhe prova të reja, mund të ngritet aktakuzë e re kur kolegji shqyrtues vendos se provat dhe faktet e reja e arsyetojnë këtë.”³⁵⁴

Parimisht kërkesa për rishikim të procedurës penale bëhet vetëm në favor të pandehurit.

Por, në rastet e veçanta kemi edhe rishikim të procedurës penale që bëhet në dëm-kundër të pandehurit.

Sipas nenit 423 paragrafi 2, në këtë rast afati për një gjë të tillë është pesë (5) vite nga koha kur kemi shpalljen e aktgjykimit të formës së prerë.³⁵⁵

3.7.2.1.1. Përgjigja në kërkesë

Si edhe në rastin e ankesave tjera të rregullta juridike edhe ky mjet i jashtëzakonshëm juridik, së bashku me të gjitha mjetet tjera juridike është rregull strikt që kërkesa/ankesa e ushtruar i paraqitet/dorëzohet gjykatës e cila e ka marrë vendimin në shkallë të parë.

Palët kundërshtare kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre duke u përgjigjur në kërkesë në afatin prej tetë (8) ditësh.

³⁵⁴ Po aty, f.990-991.

³⁵⁵ Po aty, f.1002-1003.

3.722 Kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit

Kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit ushtrohet derisa i gjykuari gjendet në mbajtje të dënimit.

Në këtë mënyrë kërkesa mund të paraqitet në çdo kohë gjatë periudhës sa i gjykuari është në vuajtje të dënimit por *“kërkesa nuk e pezullon ekzekutimin e dënimit”*³⁵⁶.

Në rastet kur i dënuari i cili është në vuajtje të dënimit dhe atij i kanë mbetur jo më shumë se gjashtë (6) muaj deri në përfundim të vuajtjes së dënimit, sipas paragrafit 2 të nenit 418, kërkesa nuk mund të paraqitet.³⁵⁷

D.m.th, kërkesa mund të paraqitet në rastet kur të gjykuarit i kanë mbetur më shumë se gjashtë (6) muaj burgim.

3.723 Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë paraqitet brenda afatit ligjor prej tre (3) muajve nga koha kur aktgjykimi apo aktvendimi ka marrë formën e prerë. Kjo sipas nenit 418 paragrafi 3 i KPPK-së.³⁵⁸

Edhe në këto raste dalin afate tjera shtesë që kanë të bëjnë me njoftimin e palës së kundërt për ushtrimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Sipas nenit 435 paragrafi 2 i KPPK-së, afati ligjor që pala kundërshtare mund të paraqes përgjigje në kërkesë është afati prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh.³⁵⁹

Afati për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë ecë nga dita kur vendimi i gjykatës në fjalë i dorëzohet të pandehurit.³⁶⁰

Në praktike, shpesh ndodh që Aktgjykimi i nxjerr nuk i dorëzohet palëve me kohë, andaj, afati tre (3) muaj llogaritet prej momentit kur palës i është dorëzuar aktgjykimi.

³⁵⁶ Hajdari, Azem, Procedura penale, Komentar, Prishtinë, 2010, f.730.

³⁵⁷ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.984.

³⁵⁸ Po aty, f.984.

³⁵⁹ Po aty, f.1048-1049.

³⁶⁰ Si 357, f.735.

Kjo sepse aktgjykimi bënë pjesë në shkresat që duhet dorëzuar personalisht dhe sipas nenit 478 paragrafi 4, afati për ushtrimin e mjetit juridik rrjedhë nga dita e dorëzimit të shkresës të pandehurit.³⁶¹

3.7.24. Kthimi në gjendjen e mëparshme

Në nenin 447 është përcaktuar se kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme mund të paraqitet jo më vonë se tre (3) muaj nga dita kur ka kaluar afati i ankesës.

Përndryshe, afati për të kërkuar kthimin në gjendjen e mëparshme është tetë (8) tetë ditë prej momentit kur kanë pushuar shkaqet që kanë shkaktuar ikjen e afatit për mjet të rregullt juridik.³⁶²

Procedurë	Termimi
Kthimi në gjendjen e mëparshme	3 muaj
Përgjigje në kërkesë për mbrojtje të ligshme	15 ditë
Kërkesa për mbrojtje të ligshme	3 muaj
Kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit	çdo kohë
Përgjigje në ankesë	8 ditë
Kërkesa për rishikim të procedurës penale	2 vite

Tabela 5: Afati i paraqitjes së mjeteve të jashtëzakonshme juridike.

³⁶¹ Si 359, f.1139-1140.

³⁶² Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.1072-1073.

3.8. PËRFUNDIME:

I. Afatet që kanë të bëjnë me privimin e personit nga liria, me ndalimin dhe paraburgimin do të paraqiten në disa përfundime:

Arrestimi:

- Arrestimi është momenti kur personi i caktuar është privuar nga liria e lëvizjes, nga mundësia e të vepruar lirisht.

Ndalimi:

- Ndalimi është dyzetë e tetë (48) orë prej momentit të arrestimi.
- Aktvendimi mbi ndalimin e personit të arrestuar duhet të lëshohet menjëherë pas arrestimit, e jo më vonë se gjashtë (6) orë.
- Në aktvendim shënohet koha e saktë e arrestimit.

Masa e sigurimit-paraburgimi:

- Kërkesa për caktimin e masës së caktuar të sigurisë ushtrohet brenda njëzetë e katër (24) orëve nga momenti i arrestimit të personit.
- Fillimi i seancës dëgjimore në gjykatë për caktimin e masës së sigurimit nuk duhet të kalojë dyzetë e tetë (48) orë prej momentit të arrestimit.
- Gjykata vendimin e saj lidhur me masën e sigurisë e vendos brenda dyzet e tetë (48) orëve prej momentit kur përfundon seancën dëgjimore.

Ankesat që lidhen me paraburgimin:

- Afati për ankesë është njëzet e katër (24) orë prej momentit të pranimi të vendimit.
- Kopja e ankesës i dorëzohet palës kundërshtare që t'i jepet mundësia e përgjigjes në ankesë, e cila bëhet brenda afatit ligjor njëzet e katër (24) orë nga momenti i pranimi të ankesës.
- Gjykata e shkallës së dytë- Gjykata e Apelit vendos lidhur me ankesën brenda dyzet e tetë (48) orëve, prej momentit kur ajo arrin në gjykatë.

Kohëzgjatja e paraburgimit para ngritjes së aktakuzës:

- Gjykata fillimisht mund të caktojë paraburgimin për periudhën kohore një (1) muaj nga dita kur është arrestuar personi.

- Mund të zgjatet më së shumti katër (4) muaj para ngritjes së aktakuzës për vepra penale dënueshmëria e të cilave është më pak se pesë (5) vjet burgim.
- Mund të zgjatet më së shumti tetë (8) muaj për veprat penale dënueshmëria e të cilave është më shumë se pesë (5) vjet burgim.
- Mund të zgjatë më së shumti dymbëdhjetë (12) muaj, e jashtë çdo rrethane më së shumti tetëmbëdhjetë (18) muaj *(për procedura lidhur me veprat penale të dënueshme më së paku pesë (5) vjet burgim; kur rasti është i ndërlikuar i cili ka më shumë se dhjetë të pandehurë, me aktivitet të organizuar kriminal, veprat penale të korrupsionit, hetimet të cilat kërkojnë prova të shumta mjeko-ligjore, analiza kontabiliteti apo bashkëpunime ndërkombëtare)*.
- Nuk ka afat ligjor që përcakton mënyrën kohore për secilin vazhdimim veç e veç.

✚ Kohëzgjatja e paraburgimit pas ngritjes së aktakuzës:

- Paraburgimi mund të zgjatë deri në përfundim të procesit gjyqësor.

✚ Kohëzgjatja e paraburgimit pas shpalljes së aktgjyqimit:

- Kur kemi dënim me të paktën pesë (5) vite burgim apo më shumë, masa e sigurisë-paraburgimit i vazhdohet të gjykuarit nëse ka qenë në paraburgim, ose, nëse ka qenë në liri i caktohet masa e paraburgimit.

✚ Urdhërarresti:

- ka efekt një vit dhe skadon në mesnatën e ditës së treqind e gjashtëdhjetë e pestë (365) nga dita e lëshimit të tij.

II. Lidhur me Institutin e parashkrimit dhe çështjet që dalin nga ky institut, paraqiten në vazhdim disa nga përfundime:

✚ Parashkrimi është vjetërsimi i mundësisë së ndjekjes penale apo i ekzekutimit të dënimit të shqiptuar.

✚ Nuk kemi parashkrim për veprat penale që kanë të bëjnë me gjenocid, me krime të luftës, krime kundër njerëzimit, veprat penale që janë të përcaktuara sipas të drejtës ndërkombëtare si të tilla dhe vrasja e rëndë- neni 111 i KPK-së.

✚ Ndjekja penale nuk mund të merret nëse kanë kaluar:

- dy (2) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme deri në një (1) vit burgim ose me dënim me gjobë, si afati më i shkurtër.
- tridhjetë (30) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me burgim të përjetshëm, si afati më i gjatë.

Parashkrimi fillon:

- prej ditës kur është kryer vepra penale.
- kur kemi të bëjmë me pasojat të cilat shkaktohen më vonë, pas momentit të veprimit, nga koha e shfaqjes së pasojës.
- kur kemi të bëjmë me vepra penale të cilat janë kryer ndaj personave që janë nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, prej ditës kur viktimi e mbush moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare.

Parashkrimi ndërpritet:

- Kur kryesi nuk gjendet në Republikën e Kosovës dhe i njëjti është i paarritshëm për organet.
- Kur ndaj kryesit të veprës penale është lëshuar urdhërarresti dhe i njëjti është në kërkim.
- Kur janë duke u zhvilluar hetime nga ana e Prokurorisë dhe çështja është në procedim e sipër për të siguruar dëshmi përmes ndihmës juridike ndërkombëtare nga jashtë Republikës së Kosovës.
- Kur kryesi është në negociata për pranimin e fajësisë për veprën penale.
- Kur kryesi kryen vepër të re penale e cila për nga pesha është e njëjtë apo më e rëndë.
- Kur kalon dyfishi i afatit të parashkrimit të ndjekjes penale.

Ekzekutimi i dënimit nuk mund të bëhet nëse kanë kaluar:

- dy (2) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme deri në një (1) vit burgim ose me dënim me gjobë, si afati më i shkurtër.
- tridhjetë (30) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me burgim të përjetshëm, si afati më i gjatë.

Ekzekutimi i dënimit nuk mund të bëhet nëse kanë kaluar:

- dy (2) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme deri në një (1) vit burgim ose me dënim me gjobë.
- tridhjetë (30) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me burgim të përjetshëm, si afati më i gjatë.
- Për dënimet plotësuese pesë (5) vjet nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.
- për masën e trajtimit të detyrueshëm tre (3) vjet nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

✚ Parashkrimi fillon:

- nga momenti kur aktgjykimi e merr formën e prerë.
- te dënimet alternative të cilat janë revokuar, parashkrimi fillon nga dita kur vendimi mbi revokimin e dënimit e merr formën e prerë.
- dënime të cilat zbuten për shkak të institutit të faljes, si afat për të llogaritur parashkrimin do të merret dënimi i ri.
- Te zbutja e dënimit sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, afati i parashkrimit do të bëhet duke marrë për bazë dënimin fillestar.

✚ Parashkrimi ndërpritet:

- Në çfarëdo veprimi nga organi kompetent me qëllim të arritjes së ekzekutimit, siç janë veprimet operative për arrestim, kërkesat ndërkombëtare etj.
- Në këto raste është përcaktuar se me ndërprerjen e afatit të parashkrimit, krijohet afati i ri i parashkrimit.
- ekzekutimi i dënimit ndalohet menjëherë në rast të kalimit të dyfishit të afatit.
- Ndalimi i ekzekutimit ndodh edhe nëse i dënuari është në vuajtje të dënimit.

III. Afatet që kanë të bëjnë me veprime parapenale, sjellin disa përfundime:

- ✚ Ligjvënësi i ka paraparë disa veprime parapenale që prokuroria mund t'i ndërmarrë për të siguruar prova edhe para se formalisht të fillohet hetimi. Dhe atë:
 - Aplikimi i masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit.

- ✚ Urdhrat urgjent që lëshohen nga Prokuroria duhet të konfirmohet me shkrim nga gjyqtari i procedurës paraprake në afatin prej tre (3) ditësh.
- ✚ Fillimi i zbatimit të urdhrave:
 - Urdhri duhet të fillojë të zbatohet menjëherë, e më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë prej momentit të lëshimit.
- ✚ Periudha e aplikimit të urdhrit:
 - Jo më gjatë se gjashtëdhjetë (60) ditëve prej datës së lëshimit të urdhrit gjyqësor (kur kemi të bëjmë me pasojat të cilat shkaktohen më vonë, pas momentit të veprimit, nga koha e shfaqjes së pasojës.)
 - Kur përgjohen edhe persona tjerë të cilët nuk kanë qenë objekt hetimi, deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë. Ai urdhër mund të ripërtërihet deri në nëntëdhjetë (90) ditë.
- ✚ Zgjatja dhe ripërtëritja e urdhrit:
 - Shumica e masave mund të zgjaten më së shumti deri në gjashtëdhjetë (60) ditë.
 - Mund të ripërtëritet urdhri brenda afatit prej treqindgjashtëdhjetë (360) ditë prej momentit të lëshimit të urdhrit.
 - urdhërat për masa në vende private mund të zgjaten deri në gjashtëdhjetë (60) ditë.
 - Ripërtëritja e urdhrave për masa në vende private mund të bëhet edhe për gjashtëdhjetë (60) ditë të tjera.
- ✚ Njoftimi i personit që ka qenë nën masë:
 - Sa më parë që të jetë e mundur, e më së largu dymbëdhjetë (12) muaj pasi që masa ka përfunduar.
- ✚ Deklaratat në procedurë paraprake:
 - të paktën pesë (5) ditë para se të merret deklarata apo veprimi i caktuar duhet të njoftohet me shkrim mbrojtësi, i dëmtuari dhe mbrojtësi i viktimave lidhur me datën, kohën dhe vendin e marrjes së deklaratës.
- ✚ Afatet lidhur me ekspertizat gjyqësore:

- Për caktimin e ekspertit nga ana e prokurorit palët kanë të drejtë që të ankohen. Lidhur me këto gjyqtari i procedurës paraprake vendos brenda dhjetë (10) ditëve.
- Ekspertizat e kryera duhet t'i ofrohen palëve të paktën pesë (5) ditë para marrjes së deklaratës nga eksperti (*nëse ai do të merret në pyetje*) dhe jo më vonë se dhjetë (10) ditë pas pranimi të raportit.
- Ekspertiza e kryera nga palët tjera duhet t'i ofrohet prokurorit të shtetit, katërmëdhjetë (14) ditësh prej momentit kur ka përfunduar ekspertiza

✚ Shkatërrimi i mostrave:

- Mostrat e ekzaminimeve të lëndimeve trupore dhe fizike shkatërrohen një (1) vit prej momentit kur është marrë aktvendimi përfundimtar në procedurë gjyqësore.
- Mostrat që kanë të bëjnë me ADN shkatërrohen menjëherë, me mundësinë e parë prej kur është kryer ekzaminimi.

✚ Afatet lidhur me kontrollimet:

- Urdhri duhet të zbatohet brenda afatit prej dyzetë e tetë (48) orëve prej momentit të lëshimit të tij.
- Urdhri duhet të zbatohet në intervalin kohor nga ora 06 e mëngjesit deri 22 të mbrëmjes.
 - Kur kontrollimi i filluar brenda afatit 06:00 deri 22:00 nuk ka mundur të përfundojë deri në ora 22:00, vazhdon derisa të përfundojë.

✚ Kontrolli pa urdhër të shkruar:

- Dymbëdhjetë (12) orë është afati brenda të cilës kohë duhet të njoftohet gjykata dhe prokuroria për zbatim të kontrollimit, për sigurimin e aprovimit retroaktiv.

✚ Afati për pritjen e avokatit:

- Më së shumti dy (2) orë prej momentit të njoftimit të personit për zbatim të kontrollit. Pas kësaj kontrolli bëhet pa prezencën e avokatit.

IV. Afatet ligjore për ngrirjen e aseteve dhe urdhrave ndalues sjellin disa përfundime:

✚ Ngrirja e përkohshme e aseteve nga ana e prokurorisë:

- Urdhri i përkohshëm për ngrirje të aseteve ka fuqi vepruese vetëm për shtatëdhjetë e dy (72) orë nga koha e lëshimit të tij.

✚ Ngrirja e aseteve nga ana e gjykatës:

- Urdhri i gjykatës duhet të lëshohet brenda afatit shtatëdhjetë e dy (72) orë, aq sa vlen urdhri i përkohshëm i prokurorisë.
- Urdhri vlen tridhjetë (30) ditë nga koha e lëshimit të tij.

✚ Shqyrtimi gjyqësor i urdhrit:

- Bëhet brenda afati prej tre (3) javësh nga momenti i dorëzimit të urdhrit personit por edhe personave tjera që kanë interes në asetin e caktuar.
 - Afati për të ushtruar ankesë kundër urdhrit afatgjatë është dhjetë (10) ditë nga momenti i lëshimit të tij.

V. Afatet ligjore lidhur me sekuestrimin dhe konfiskimi nxjerrin disa përfundime:

✚ Sekuestrimi i përkohshëm:

- Sekuestrimi i përkohshëm që bëhet me urdhër të prokurorisë zgjat më së shumti pesë (5) ditë.

✚ Kthimi i sendeve të sekuestruara përkohësisht:

- Sa më parë që të jetë e mundur, prej momentit kur pushojnë arsyet për të cilat është bërë sekuestrimi i përkohshëm.
- Kur sendi i sekuestruar i takon personit tjetër bëhet shpallja-njoftimi publik për një vit kalendarik, që të lajmërohet pronari legjitim.

✚ Konfiskimi i përkohshëm:

- Kërkesa për masë të përkohshme duhet të paraqitet më së largu gjashtëdhjetë (60) ditë.
 - Urdhri për masë të përkohshme të sigurisë:
- Aktvendimi mbi kërkesën për masë të përkohshme duhet të nxirret brenda afatit prej katërmëdhjetë (14) ditëve nga koha e paraqitjes së kërkesës.
- Urdhrat brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve duhet t'i dërgohen Agjencisë për Administrim të Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar (AAPSK).

- Urdhrrat ekzekutohen nga Agjencioni në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve.
- Pasuria që i nënshtrohet në mënyrë automatike konfiskimit:
 - Prokurori duhet të njoftohet brenda njëzetë e katër (24) orëve prej momentit kur shkatërrohet pasuria e rrezikshme.

VI. Afatet që kanë të bëjnë me hetimet sjellin disa përfundime:

✚ Shqyrtimi i detyrueshëm i lëndës:

- Çdo tre (3) muaj prokurori bashkë me shefin e tij (kryeprokurorin) duhet ta shqyrtojë lëndën se se hetimi i filluar a duhet të mbetet i hapur akoma apo të vendoset se, ka prova të mjaftueshme për ngritjen e aktit akuzues, pushimit apo pezullimit të hetimit.
- Zyra e Kryeprokurorit të shtetit me datën 29 prill 2016 ka nxjerr Udhëzimin e detyrueshëm për të futur në aplikim dhe për të zbatuar këtë detyrim ligjor si më lartë.

✚ Konfirmimi i propozimit për ndjekje penale për veprat që ndiqen sipas propozimit:

- Afati për të konfirmuar me shkrim propozimin e dhënë në mënyrë verbale është dyzetë e tetë (48) orë.

✚ Hudhja poshtë e kallëzimit penal:

- Afati për të hudhur poshtë kallëzimin penal është tridhjetë (30) ditë prej momentit kur është paraqitur kallëzimi.
- Tetë (8) ditë është afati për njoftimin e të dëmtuarit për hudhjen e kallëzimit penal.

✚ HETIMI PENAL

✚ Fillimi:

- Afat ligjor për fillimin formal të hetimit duhet të jetë tridhjetë (30) ditë prej momentit të paraqitjes së kallëzimit penal.
- Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka nxjerr Udhëzimin A.nr.258/2016 me datën 29 prill 2016 me të cilin ka obliguar të gjithë prokurorët e shtetit *“...që brenda afatit prej tre (3) muajsh, nga dita e pranimi të kallëzimit*

penal nëse i njëjti me aktvendim nuk është hudhur, të nxjerret aktvendimi për fillimin e hetimit”.

- Kolegjiumi i Gjykatës Supreme, në Mbledhjen (Seancën) e Përgjithshme të datës 29.09.2016 ka nxjerr Mendimin Juridik duke vendosur që: “ *Prokurori i shtetit, brenda 30 ditësh duhet të vendos: për informacione shtesë, për aplikimin eventual të masave të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit, hedhjen e kallëzimit penal apo për fillimin e hetimit”.*
- Me datën 27 qershor 2017 Gjykata Supreme ka nxjerr Aktgjykimin PML.nr. 154/2017, duke vepruar pikërisht në dëm të pandehurit, duke u shkelur parimin “in dubio pro re” dhe se “...hetimi ligjërisht dhe formalisht fillon në ditën e nxjerrjes së aktvendimit për fillimin e hetimeve...”.

Pezullimi:

- Aktvendimi për pezullimin e hetimit duhet të përmbajë saktë kohën kur është bërë pezullimi.
- Periudha që pezullohet hetimi nuk llogaritet në afatin e hetimit që lidhet me afatin e përfundimit të hetimit.

Pushimi:

- Kur pushon hetimi brenda tetë (8) ditësh njoftohet i dëmtuari, kurse gjyqtari i procedurës paraprake njoftohet “*menjëherë*”.

Përfundimi:

- Afati për përfundimin e hetimeve është dy (2) vite nga fillimi i hetimeve me Aktvendimin për fillim të hetimeve.
- Hetimi përfundon dy (2) vite nga momenti kur hetimi është filluar/është dashtë të fillohet edhe nëse nuk ka Aktvendim për fillim të hetimeve.

Zgjatja:

- Hetimi zgjatet deri në gjashtë (6) muaj d.m.th, maksimum dy (2) vite e gjysmë.

NGRITJA E AKTAKUZËS:

- Aktakuza ngritet brenda afatit të hetimeve.

VII. Afatet ligjore lidhur me procesin e gjyimit penal nxjerrin disa përfundime:

+ Shqyrtimi fillestar:

- Duhet të fillojë në afatin prej tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës për rastet e rregullta.
- Kur i pandehuri është në paraburgim fillon jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë prej ngritjes së aktakuzës.

+ Kërkesa për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtimi i provave:

- Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga mbajtja e shqyrtimit fillestar.
 - Ndaj Aktvendimit me të cilën është refuzuar kërkesa për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave ankesë mund të paraqitet brenda pesë (5) ditë.

+ Shqyrtimi i dytë:

- Jo më herët se tridhjetë (30) ditë dhe jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e mbajtjes së shqyrtimit fillestar.

+ Ndryshimi i aktakuzës nga prokuroria:

- Një (1) javë nga momenti i mbajtjes së seancës së shqyrtimit të dytë.

+ Seanca për shqyrtimin e kundërshtimeve të provave dhe kërkesës për hudhje të aktakuzës:

- Jo më vonë se tre (3) javë nga dita kur është mbajtur shqyrtimi i dytë.
- Vendim merret jo më vonë se tre (3) javë nga dita e mbajtjes së seancës.

+ Fillimi i shqyrtimit gjyqësor:

- Një (1) muaj nga data e lëshimit të urdhrit të fundit lidhur me kundërshtimin e provave apo kërkesës për hudhje të aktakuzës.

+ Ftesat për seancë:

- Së paku tetë (8) ditë para se të mbahet shqyrtimi gjyqësor.
 - Shkurtimi i afatit mund të bëhet më kërkesë të prokurorit dhe me pëlqim të të akuzuarit.

+ Paraburgimi:

- Nuk mund të kalojë më shumë se një (1) muaj.

+ Përfundimi i shqyrtimit gjyqësor:

- Nëntëdhjetë (90) ditë para gjyqtarit të vetëm gjykues.

- Njëqindnjëzet (120) ditë para trupit gjykues.

✚ Rifillimi i shqyrtimit gjyqësor:

- Kur ka shtyrje më të gjatë se tre (3) muaj të shqyrtimit.
- Kur kemi ndërprerje të shqyrtimit më shumë se tetë (8) ditë.

✚ Zgjatja e afateve për përfundim të shqyrtimit gjyqësor:

- Vazhdimi është tridhjetë (30) ditë dhe mund të përsëritet. Dmth, nuk ka afat përfundimtar.

✚ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor:

- Duhet të përpilohet menjëherë në momentin e kryerjes së veprimit procedural gjyqësor.
- Kur veprime procedurale kryhen në mënyrën audio ose video procesverbali përpilohet në afatin prej tre (3) ditëve.
 - Edhe ky afat mund të shtyhet deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë

✚ Shpallja e aktgjykimit:

- Më së largu tre (3) ditë prej momentit të seancës gjyqësore me të cilën shpallet i përfunduar gjykimi.

✚ Përpilimi i aktgjykimit:

- Pesëmbëdhjetë (15) ditë nga momenti i shpalljes së tij, kur i akuzuari i gjykuar është shpallur fajtor dhe gjendet në paraburgim.
- Tridhjetë (30) ditë në rastet tjera.
- Gjashtëdhjetë (60) ditë në rastet më të ndërlikuara dhe atë me leje të kryetarit të gjykatës.

✚ Afatet lidhur me urdhrin ndëshkimor:

- Tetë (8) ditë për të paraqitur kundërshtim ndaj urdhrit.

✚ Çështjet në rigjykim:

- Sa më parë që të jetë e mundur, në ditët e para të lira.

VIII. Afatet ligjore lidhur me mjetet juridike nxjerrin disa përfundime: ✚

Kundërshtimet ndaj urdhrave:

- Dyzet e tetë (48) orë prej momentit kur është nxjerrë/pranuar urdhri.

- Shqyrtimi i kundërshtimit nga kolegji shqyrtues duhet të bëhet brenda afatit prej dyzet e tetë (48) orëve.
 - Afati për paraqitjen e ankesës ndaj vendimit të kolegjit shqyrtues është pesë (5) ditë, në Gjykatën e Apelit.
 - Kërkesa në Gjykatën Supreme paraqitet brenda dhjetë (10) ditëve.
- ✚ Ankesa ndaj aktgjykimeve:
- Pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e pranimi të aktgjykimit të shkruar.
- ✚ Përgjigjja në ankesë:
- Tetë (8) ditëve nga pranimi i ankesës.
- ✚ Trajtimi i ankesës në Gjykatën e Apelit:
- Jo më vonë se tre (3) muaj, kur i gjykuari gjendet në paraburgim.
- ✚ Trajtimi i masës së paraburgimit:
- Pesë (5) ditë për të vlerësuar nëse ekzistojnë apo jo arsyet e mbajtjes të të gjykuarit edhe më tutje në paraburgim.
- ✚ Kërkesa për rishikimin e procedurës:
- Dy (2) vite prej aktgjykimit të formës së prerë dhe aktvendimit për pushimin e procedurës penale.
 - Pesë (5) vite nga koha kur kemi shpalljen e aktgjykimit të formës së prerë, për kërkesë në dëm të pandehurit.
- ✚ Kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit:
- Në çdo kohë gjatë periudhës sa i gjykuari është në vuajtje të dënimit.
- ✚ Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë:
- Tre (3) muaj nga koha kur aktgjykimi apo aktvendimi ka marrë formën e prerë.
 - Përgjigje në kërkesë mund të paraqitet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.
- ✚ Kthimi në gjendjen e mëparshme:
- Jo më vonë se tre (3) muaj nga dita kur ka kaluar afati i ankesës.

KAPITULLI IV

4. AFATET DHE ZBATIMI I TYRE SIPAS KODIT TË DREJTËSISË PËR TË MITUR

4.1. ASPEKTE TË PËRGJITHME TË KODIT TË DREJTËSISË PËR TË MITUR

Procedura penale e cila rregullon tërë procesin penal që ka të bëjë me kryerjen e veprave penale, detyrimisht nuk ka mundur të anashkalojë rastet që kanë të bëjnë me të mitur.

Këto raste janë të natyrës së ndjeshme, kur kihet në konsideratë mirëqenia e të miturit në raport me veprën penale, kryerësit tjerë dhe të gjitha rrethanat tjera të rastit.

Andaj, *“qëllimi i drejtësisë për të mitur përcaktohet i atillë që të sigurojë mirëqenien e të miturve dhe që masat dhe dënimet e shqiptuara ndaj të miturve të jenë në propocion me nevojat për largimin nga rruga e kriminalitetit dhe edukimi i tyre”*³⁶³.

Që në dispozitat e para të KPPK-së, në nenin 21 paragrafi 2, është e përcaktuar se Kodi i Drejtësisë për të Mitur (KDM) është ai ligj që do të rregullojë materien me të mitur.³⁶⁴

Kodi i Drejtësisë për të mitur është nxjerr në frymën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, KPK, KPPK, LESP si dhe akteve dhe instrumenteve ndërkombëtare duke paraparë dispozitat e karakterit material, procedural dhe ekzekutiv për rregullimin e procedurës penalo-juridike për kryerësit e mitur të veprave penale.³⁶⁵

KDM do të vije në konsideratë në rastet kur i pandehuri është fëmijë, viktima është fëmijë apo edhe dëshmitar, atëherë sipas nenit 27 të KPPK-së, procedura *“rregullohet me Kodin e Drejtësisë për të Mitur ose Ligjin përkatës”*³⁶⁶.

Në vazhdim do të paraqesim në pika të shkurtra vetëm disa aspekte më kryesore për të miturit, sepse, pjesa tjetër e procedurës është e ngjajshme me të rriturit.

Sipas KDM-së të kaluar, ka qenë e përcaktuar se *“Dispozitat e Kodit Penal të Kosovës, Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe të*

³⁶³ Doracaku për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Ministria e Drejtësisë, Prishtinë, 2009, f.157.

³⁶⁴ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.130.

³⁶⁵ Çollaku, Hashim, Roli i prokurorit të shtetit në procedurën penale, Bot.2, Prishtinë, 2013, f.152.

³⁶⁶ Si 364, f.141.

*çdo ligji tjetër relevant do të zbatohen për të miturit, përpos rasteve kur me këtë Kod është rregulluar ndryshe*³⁶⁷.

Kurse, sipas dispozitave të KDM aktual në nenin 6-Zbatimi subsidiar i ligjeve tjera, është përcaktuar se *“Ndaj kryesit të mitur të veprës penale dhe fëmijëve viktima apo dëshmitarë, në procedurën penale, në çështjet të cilat nuk janë rregulluar ndryshe me këtë Kod, përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kodit të Procedurës Penale dhe të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, si dhe dispozitat tjera penalo juridike”*.

42. Arrestimi dhe ndalimi

Privimi nga liria duhet të jetë mjeti i fundit që aplikohet për fëmijët.

Neni 4 paragrafi 4 dhe neni 60, e ka definuar detyrimin ligjor që nëse ndodh privimi nga liria i fëmijëve, atëherë *“privimi nga liria shqiptohet vetëm si mjet i fundit dhe do të kufizohet në afatin më të shkurtër të mundshëm”*.

Pikërisht neni 60 paragrafi 4 i KDM-së e përcakton se arrestimi dhe ndalimi, në krahasim me të rriturit, të dyjat bashkë nuk mund të kalojë periudhën kohore më shumë se njëzetekatër (24) orë³⁶⁸.

Nëse brenda kësaj kohe nuk caktohet masa e sigurimit i mituri lirohet. Ligjvënësi ka paraparë se këto masa nuk mund të zgjasin më shumë se 24 orë, ashtu që, pas kalimit të kësaj periudhe, policia ose duhet ta lirojë të miturin ose duhet që rastin t’ia procedojë gjyqtarit për të mitur të gjykatës kompetente, i cili konform Kodit të Procedurës Penal, mund të marrë aktvendim mbi caktimin e paraburgimit.³⁶⁹

Po ashtu, neni 60 paragrafi 2 i KDM-së, e parasheh një detyrim ligjor të veçantë, detyrimin e kontrollimit mjekësor të të miturit *para paraqitjes së kërkesës për caktim të paraburgimit*, pavarësisht se a ka apo nuk ka shenja të probleme shëndetësore. Ky kontroll bëhet me

³⁶⁷ KDM, Prishtinë, 2010, n.5.

³⁶⁸ Si në 307, f.159.

³⁶⁹ Hajdari, Azem, Procedura penale, Komentar, Prishtinë, 2010, f.782.

qëllim që të vlerësohet gjendja e përgjithshme mjekësore e tij se a mund ta përballojë masën e paraburgimit.

43. Paraburgimi

Paraburgimi mund t'i caktohet të miturit në pajtim me dispozitat që vlejnë për të rriturit dhe duhet të tentohet që t'i shmangemi aplikimit të tij nga ana e gjykatës.

Paraburgimi duhet të caktohet vetëm në rrethana të veçanta, e që ato rrethana kanë më së shumti karakter preventiv.

Për shkak të ndjeshmërisë dhe për shkak të karakterit që duhet të ketë masa e sigurisë, *“gjykatat për të mitur dhe organet hetimore duhet të gëzojnë prioritetin më të lartë për një procedurë të shpejtë për kohë sa më të shkurtër të paraburgimit”*³⁷⁰.

Teorikisht ligjvënësi i ka përcaktuar disa detyrime të veçanta që dalin për gjykatën. Në nenin 61 paragrafi 2 është përcaktuar se i mituri mund të mbahet në paraburgim deri në tridhjetë ditë prej ditës kur është arrestuar.

Pas këtij afati i mituri mund të mbahet në paraburgim në bazë të aktvendimit të kolegjit për të mitur mbi vazhdimin e paraburgimit.³⁷¹

Vazhdimi i paraburgimit mund të bëhet më së shumti deri gjashtëdhjetë (60) ditë dhe atë gjatë fazës përgatitore. Kurse, pas ngritjes së propozimit paraburgimi mund të zgjatet deri nëntëdhjetë (90) ditë, e që kjo duhet të bëhet nga kolegji gjyqtarësh.³⁷²

Në raport me kohëzgjatjen e paraburgimit, neni 68 paragrafi 2 i KDM-së të kaluar e kishte përcaktuar se paraburgimi për të mitur nuk mund të vazhdohej më shumë se dymbëdhjetë (12) muaj nga momenti i arrestimit.

Kurse tani Kodi i ri, e ka bërë shkurtimin e afatit të paraburgimit, ku në dispozitën e nenit 63 paragrafi 2 tani e përcakton se *“...i mituri nuk mund të mbahet në paraburgim më shumë se njëqind e tetëdhjetë (180) ditë nga momenti i privimit nga liria”*.

³⁷⁰ Të drejtat e njeriut: Përmbledhje e instrumenteve ndërkombëtare, Vëllimi i parë, Përkthyes Ilir Dugolli, Prishtinë, 2004, f.348.

³⁷¹ Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Ministria e Drejtësisë, Prishtinë, 2015, f.341.

³⁷² Si në 309, f.160.

Pavarësisht se si rrjedh hetimi dhe procedura penale, me arritjen e periudhës kohore prej gjashtë (6) muajve, i paraburgosuri duhet të lirohet.

Pra, Kodi i Drejtësisë aktual është më i favorshëm në raport me të drejtat e fëmijëve, sidomos për afatet dhe kohëzgjatje e privimit nga liria.

Prapë se prapë, është shumë problematike që çështja e paraburgimit aplikohet shumë shpesh dhe në rrethana për të cilat masat tjera alternative do të ishin të mjaftueshme, ashtu që hulumtime të ndryshme kanë nxjerr përfundimin se “disa të mitur ishin subjekt të periudhave të zgjatura të paraburgimit”³⁷³ dhe se “lidhur me të dyshimtit e mitur, standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut obligojnë që “arrestimi, paraburgimi apo burgimi i fëmiut duhet të ndërmerret si masë e fundit... dhe për kohën më të shkurtër”³⁷⁴.

4.3.1. Rishqyrtimi i paraburgimit

Kolegji i gjyqtarëve për të mitur, sipas nenit 61 paragrafi 3 i KDM-së, e kanë detyrim ligjor që masën e paraburgimit e kanë për detyrim që ta rishqyrtojnë në seancë gjyqësore brenda afatit kohor-më së largu tridhjetë (30) ditë prej momentit të caktimit të paraburgimit.

Për dallim nga të rriturit, ku vazhdimi i paraburgimit bëhet pa seancë dëgjimore, një gjë e tillë te të miturit bëhet me seancë dëgjimore për të vendosur lidhur me vazhdimin a jo të masës së paraburgimit.

Rishqyrtimi i tillë bëhet në seancë dëgjimore në praninë e të miturit, mbrojtësit të tij dhe prokurorit.³⁷⁵ Në atë seancë marrin pjesë edhe dy anëtarët porotë të gjykatës për të mitur.

³⁷³ Raport i Sekcionit të Monitorimit të Sistemit Ligjor (SMSL) dhe Shtylla e III e UNMIK-ut (Organizata për Siguri dhe Bashëpunim në Evropë-OSBE), Prishtinë, 2000, f.2.
<https://www.osce.org/sq/kosovo/13054?download=true>, qasur me datë 11 shkurt 2016.

³⁷⁴ Po aty, f.32

³⁷⁵ Doracak trajnimi për avokatët në fushën e drejtësisë për fëmijë, Prishtinë, 2012, f.125. http://www.oak-ks.org/repository/docs/doracak_trajnimi_p%C3%ABr_avokat%C3%ABt_n%C3%ABfush%C3%ABn_e_dr_ejt%C3%ABsis%C3%ABp%C3%ABr_f%C3%ABmij%C3%AB_945304.pdf, qasur me datë 27 prill 2015.

Ky rishikim është paraparë me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të të miturit, në mënyrë që ai të mbahet në paraburgim vetëm në situata kur kjo paraqitet e domosdoshme.³⁷⁶

44. Seanca përgatitore

KDM e ka përcaktuar se procedura përgatitore me të cilën do të procedohet çështja penale ndaj të miturit duhet të përfundojë në afat sa më të shkurtër.

Sipas nenit 57 të KDM-së afati i rregullt për të përfunduar procedurën përgatitore është gjashtë (6) muaj.

Në rast se brenda këtij afati nuk mund të përfundojë procedura përgatitore, prokurori i shtetit duhet *“t’i dorëzojë gjyqtarit për të mitur lutje të arsyetuar me shkrim për vazhdimin e procedurës përgatitore”*³⁷⁷.

4.4.1. Njoftimi i mbrojtjes për procedurën përgatitore

Prokuroria e ka detyrim ligjorë që ta njoftojë mbrojtjen për qëllimin që ka për ta përfunduar procedurën.

Njoftimi bëhet me qëllim që mbrojtjes t’i ofrohet mundësia për të paraqitur kërkesat eventuale që mund të ketë ajo lidhur me sigurimin e provave për të cilat ajo vlerëson se do të kishin rëndësi për çështjen penale.

Afati për ta paralajmëruar mbrojtjen është të paktën pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës kur prokuroria mendon-planifikon ta përfundojë procedurën përgatitore. Sipas nenit 58 të KDM-së, *“Prokurori i shtetit 15 ditë para se ta përfundojë procedurën përgatitore, e njofton mbrojtësin e të miturit për qëllimin e tillë”*³⁷⁸.

³⁷⁶ Hajdari, Azem, Procedura penale, Komentar, Prishtinë, 2010, f.783.

³⁷⁷ Po aty, f.787.

³⁷⁸ Doracak për përgatitjen e provimit të jurispruencës, Ministria e Drejtësisë, Prishtinë, 2015, f.344.

45. Procedura e ndërmjetësimit

Në nenin 9 të KDM është përcaktuar procedura e ndërmjetësimit që mund të aplikohet në rastin kur kemi të bëjmë me të mitur.

Sipas kodit të kaluar, afati për të përfunduar procedurën e ndërmjetësimit ka qenë e përcaktuar se nuk mund të kalojë nëntëdhjetë (90) ditë nga momenti kur është marrë vendimi.

Tani me kodin në fuqi, në nenin 9 paragrafi 7, afati është shkurtuar në tridhjetë (30) ditë. Në raport me këtë situatë juridike, Këshilli Prokurorial i Kosovës me datë 25 prill 2019 ka miratuar edhe një rregullore të veçantë me të cilën e përcakton se Procedura e ndërmjetësimit nuk mund të zgjasë më tepër se tridhjetë (30) ditë nga dita e nxjerrjes së aktvendimit të prokurorit për referimin e rastit në procedurë të ndërmjetësimit.³⁷⁹

46. Shqyrtimi gjyqësor

Në bazë të propozimit të ushtruar nga ana e prokurorisë, gjykata kujdeset që në afat sa më të shkurtër të caktojë dhe të fillojë shqyrtimin gjyqësor.

Pasi t'i ketë bërë përgatitjet e nevojshme ai jep urdhër me të cilin cakton datën, orën dhe vendin ku do të mbahet seanca për shqyrtim gjyqësor.³⁸⁰

Në nenin 64 paragrafi 2 të KDM-së, ligjvënësi e ka përcaktuar afatin ligjor për të caktuar shqyrtimin gjyqësor, i cili nuk duhet të kalojë tetë (8) ditëshin prej momentit të pranimit të propozimit. Kjo ndodh *“nëse gjyqtari për të mitur nuk merr aktvendim për hedhjen e propozimit ose transferin e çështjes në gjykatë tjetër”*³⁸¹.

Nuk ka ndonjë afat të veçantë i cili do të përcaktonte saktë se brenda cilës kohë do të duhej të përfundonte procesi gjyqësor ndaj të miturit.

³⁷⁹ Rregullore e Këshillit Prokurorial i Kosovës, nr.04/2019 për procedurën e ndërmjetësimit të rasteve nga prokuroria, Prishtinë, 2019, neni 22.

³⁸⁰ Hajdari, Azem, Procedura penale, Komentar, Prishtinë, 2010, f.788.

³⁸¹ Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Ministria e Drejtësisë, Prishtinë, 2015, f.345.

Parimisht nuk duhet të ketë zvarritje të paarsyeshme të procesit gjyqësor dhe gjykata duhet të kujdeset që të evitojë çdo pengesë të që do ta pengonte të kishte proces të rregullt dhe pavonesa.

Edhe me ligjet e kaluara që i kanë paraprirë KDM-së ka qenë e përcaktuar që *“gjkimi i filluar i një të mituri, të përfundohet sa më shpejt që të jetë e mundur”*³⁸², por raporti i cekur i OSBE i vitit 2000 *“ka vërejtur se në disa raste të të miturve, gjykatat kanë dështuar të veprojnë me shpejtësinë e kërkuar duke marrë parasysh rastin se duhet siguruar se paraburgimi i të miturve mbahet sa më shkurt”*³⁸³

Në praktikë, të rëndomta janë rastet të cilat me vite të tëra zvarriten dhe nuk përfundojnë me kohë rastet, saqë edhe i mituri që ka kryer veprën penale, fundin e procesit do ta përfundojë i rritur.

Rast i tillë është procesi gjyqësor i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për të Mitur i evidentuar me PM.nr.186/15, ku Propozimi i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për të Mitur, për Shqiptimin e masës institucionale edukative-Dërgimi në institucionin edukativo-korrektues është dorëzuar në gjykatë me datën 16 tetor 2015 nr.PPM.nr.350/2015. Ky proces në shkallë të parë ka përfunduar me datën 6 nëntor 2017 dhe atë me aktin e pranimi të fajësisë. Po të mos ishte pranimi i fajësisë procesi do të zvarritej akoma më shumë.

Në këtë rast, në momentin e kryerjes së veprës njëri nga të miturit ka qenë i moshës 15 vjeçare kurse në momentin e shqiptimit të masës ka pasur 18 vite e një muaj.

Zvarritja e gjatë e proceseve gjyqësore ndaj të miturve nuk është problematikë vetëm në Kosovë.

Një gjë e tillë shihet si preokupim edhe në Shqipëri dhe për këtë arsye shumë hulumtime të ndryshme janë bërë dhe bëhen pothuaj çdo ditë.

Përfundimet e të gjitha hulumtimeve mund të themi se nxjerrin një preokupim, se:

³⁸² Raport i Sekcionit të Monitorimit të Sistemit Ligjor (SMSL) dhe Shtylla e III e UNMIK-ut (Oganizata për Siguri dhe Bashëpunim në Evropë-OSBE), Prishtinë, 2000, f.33.

³⁸³ Po aty, f.35.

“Hetimet paraprake që zhvillohen në ngarkim të fëmijëve bëhen me hapa shumë të ngadaltë nga Prokurorët dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore, duke injoruar dhe mosrespektuar në këtë mënyrë të drejtat dhe interesin më të lartë të fëmijëve”³⁸⁴.

47. Përpilimi i vendimit gjyqësor

Vendimi gjyqësor me të cilin vendoset çështja penale duhet të përpilohet me shkrim dhe afati për ta bërë një gjë të tillë është tetë (8) ditë nga momenti i shpalljes së tij.

Kjo situatë juridike është e rregulluar me dispozitën e nenit 68 paragrafi 5 i KDM-së. Kurse për rastet e ndërlikuara brenda 15 ditësh nga dita e shpalljes së tij.³⁸⁵

Rasti i zgjatjes së këtij afati, sipas nenit 68 paragrafi 5 i KDM-së, duhet të bëhet me njoftimin dhe lejen e kryetarit të gjykatës.

48. Ankesa ndaj vendimit gjyqësor

Neni 69 paragrafi 1 i KDM-së, e ka përcaktuar afatin për të paraqitur ankesën ndaj vendimit gjyqësor, pavarësisht se a kemi të bëjmë me aktvendim apo aktgjykim, *“brenda afatit prej 8 ditëve nga dita e pranimi të aktvendimit ose aktgjykimit”³⁸⁶.*

Po ashtu, e veçantë në rastin me të mitur është se i mituri nuk mund të hjek dorë nga ushtrimi i ankesës.

49. Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit

Edhe pse parashihet se *“burgimi për të mitur duhet të ndikojë pozitivisht në të miturin përmes mbrojtjes, ndihmës dhe mbikëqyrjes për ta parandaluar recidivizmin”³⁸⁷,*

³⁸⁴ Raport alternativ për konventën e të drejtave të fëmijëve të OKB-së, Shqipëria, Revista 26, Tiranë, 2006, f.48.

³⁸⁵ Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Ministria e Drejtësisë, Prishtinë, 2015, f.348.

³⁸⁶ Po aty, f.348.

fatkeqësisht në praktikë nuk shihet në këtë mënyrë. Kjo vërtetohet edhe me rastin e ekzekutimit të dënimit me burgim për të mitur ku janë përcaktuar afatet ligjore brenda të cilës periudhë ekzekutimi i dënimit do të parashkruhet.

Në këtë situatë juridike krahasuar me kodin e kaluar, ka ndryshime në dëm të të miturve.

Me nenin 36 të kodit të kaluar afatet ishin të atilla që ekzekutimi i dënimit me burgim nuk mund të bëhet, nëse kishin kaluar:

- “ 1.1. pesë (5) vjet nga vendimi i formës së prerë me të cilin është shqiptuar burgim për të mitur për më shumë se pesë (5) vjet;*
- 1.2. tre (3) vjet nga vendimi i formës së prerë me të cilin është shqiptuar burgim për të mitur për më shumë se tre (3) vjet dhe*
- 1.3. dy (2) vjet nga vendimi i formës së prerë me të cilin është shqiptuar burgimi për të mitur deri në tre (3) vjet”.*

Kurse tani me nenin 103 të KDM-së kemi këto afate:

- 1.1. dhjetë (10) vite nga dënimi i formës së prerë me dënim me burg për të mitur mbi pesë (5) vite;*
- 1.2. pesë (5) vite prej dënimit të formës së prerë me dënim me burg për të mitur mbi tre (3) vite;*
- 1.3. tre (3) vite nga dënimi i formës së prerë me dënim me burg për të mitur mbi një (1) vit; dhe*
- 1.4. dy (2) vjet nga forma e prerë e dënimit me burg për të mitur deri në një (1) vjet”.*

Duke ju referuar dispozitës së nenit 6 të KDM-së që ka të bëjë me zbatimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kodit të Procedurës Penale, Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, si dhe dispozitat tjera penalo juridike, për çështjet të cilat nuk janë rregulluar me KDM, konstatohet se parashkrimi i ndjekjes dhe ekzekutimit mund të ndërprerëhet. Ka

³⁸⁷ Xhambazi, Minire, Ekzekutimi i burgimit për të mitur, Prishtinë, 2018, f.240. http://jus.igjk.rks-gov.net/689/1/Ekzekutimi%20i%20burgimit%20p%C3%ABr%20t%C3%AB%20mitur_Ship%2C%20nr.%2018.pdf, qasur me datë 2 shkurt 2019.

ndërprerje edhe pse në KDM kjo çështje nuk është paraqitur në mënyrë decitive, por kjo rregullohet nga dispozita e cekur më sipër, neni 6 i KDM-së.

Në një rast të tillë, Gjykata e Apelit e Kosovës ka konfirmuar se:

"Qëndron fakti se sipas nenit 36³⁸⁸ të Kodit të Drejtësisë për të mitur parashihet se denimi me burgim për të mitur nuk mund të ekzekutohet pasi që të ketë kaluar periudha kohore prej 5 viteve nga vendimi i formës së prerë me të cilin është shqiptuar burgim për të mitur për më shumë se 5 (pesë) vite. Mirëpo, me këtë kod nuk është specifikuar fillimi dhe ndërprerja e afateve të parashikimit të ekzekutimit të dënimit respektivisht afati relativ dhe absolut i parashkrimit të dënimit. Ndërsa, konform dispozitës së nenit 5 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, dispozita e Kodit Penal, Kodit të Procedurës penale të Kosovës dhe Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale dhe çdo ligji tjetër relevant do të zbatohen për të miturit, përpos rasteve kur me këtë kod është rregulluar ndryshe."³⁸⁹

Lartësia e dënimit të shqiptuar	Afati i Parashkrimit Kodi i vjetër	Afati i Parashkrimit Kodi i ri
Burgim më shumë se 5 vite	5 vite	10 vite
Burgim më shumë se 3 vite	3 vite	5 vite
Burgim deri 3 vite	2 vite	3 vite
		2 vite për burgim deri 1 vit

Tabela 6: Afatet e parashkrimit të ekzekutimit të dënimit për të mitur.

³⁸⁸ Neni 36 i KDM-së të kaluar ka rregulluar çështjen e Parashkrimit të ekzekutimit të burgimit për të mitur.

³⁸⁹ Aktvendimi për Papranueshmëri i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr.ref.:RK 1189/18, datë 30 janar 2018. http://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2018/02/ki_75_17_av_shq.pdf, qasur me datë 24 shkurt 2018.

4.10. PËRFUNDIME:

Afatet ligjore lidhur me Kodin e Drejtësisë për të Mitur nxjerrin disa përfundime:

✚ Arrestimi dhe ndalimi:

- Arrestimi dhe ndalimi, të dyjat bashkë, nuk mund të kalojë periudhën kohore më shumë se njëzetekatër (24) orë.

✚ Paraburgimi:

- nuk mund të vazhdojë më shumë se njëqind e tetëdhjetë (180) ditë nga momenti i arrestimit.

✚ Rishqyrtimi i paraburgimit:

- Kolegji i gjyqtarëve për të mitur e kanë për detyrim që ta rishqyrtojnë në seancë gjyqësore brenda afatit kohor-më së largu tridhjetë (30) ditë prej momentit të caktimit të paraburgimit.

✚ Seanca përgatitore:

- Afati i rregullt për të përfunduar procedurën përgatitore është gjashtë (6) muaj.

✚ Njoftimi i mbrojtjes për procedurën përgatitore:

- Prokuroria e ka detyrim ligjorë që ta njoftojë mbrojtjen për qëllimin që ka ajo për ta përfunduar procedurën, të paktën pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës kur planifikon ta përfundojë procedurën përgatitore.

✚ Procedura e ndërmjetësimit:

- Brenda tridhjetë (30) ditëve nga momenti kur është marrë vendimi.

✚ Shqyrtimi gjyqësor:

- Shqyrtimi gjyqësor duhet të caktohet brenda tetë (8) ditëve prej momentit të pranimi të propozimit.

✚ Përpilimi i vendimit gjyqësor:

- Është tetë (8) ditë nga momenti i shpalljes.
- Në çështjet më të ndërlikuara më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë.

✚ Ankesa ndaj vendimit gjyqësor:

- Është tetë (8) ditë nga momenti i pranimi të vendimit.

✚ Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit:

- dhjetë (10) vite nga dënimi i formës së prerë me dënim me burg për të mitur mbi pesë (5) vite.
- pesë (5) vite prej dënimit të formës së prerë me dënim me burg për të mitur mbi tre (3) vite.
- tre (3) vite nga dënimi i formës së prerë me dënim me burg për të mitur mbi një (1) vit dhe
- dy (2) vjet nga forma e prerë e dënimit me burg për të mitur deri në një (1) vjet.

KAPITULLI V

5. AFATET LIDHUR ME KOMPENSIMIN E PERSONAVE TË ARRESTUAR APO TË DËNUAR PA ARSYE DHE REHABILITIMIN E TË DËNUARVE

Fatkeqësisht jo rrallë ndodh që persona të caktuar arrestohen pa arsye, pa bazë ligjore, të njëjtit apo të tjerë të dënohen pa arsye. Këta persona kanë të drejtë të kërkojnë kompensim. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në nenin 5 e ka përcaktuar se:

*"kushdo që ka qenë viktimë e arrestimit ose paraburgimit në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, ka të drejtë të detyrueshme për kompensim". Sipas këtij të fundit, "Kur një person ... është dënuar për një vepër penale dhe kur më pas dënimi i tij është përmbysur ... për shkak se ... ka pasur dështim të drejtësisë, personi që ka pësuar dënim si rezultat i një dënim i tillë do të kompensohet sipas ligjit"*³⁹⁰

Dënimi i personave të caktuar në të ardhmen mund t'iu sjell pasojë në jetë, sidomos në karrierën e tyre dhe në realizimin e të drejtave të tyre si çdo qytetar tjetër.

Për këtë arsye, rehabilitimi i të dënuarit i cili ka të bëjë me aktin e shlyerjes së dënimit nga evidencat penale bëhet me qëllim që i i njëjti të mos trajtohet si person i dënuar më parë.

Pasoja më të mëdha do të kishim edhe te shtresat e varfëra tek të cilët ato pasoja do të ishin "afatgjate edhe në vitalitetin e familjeve..."³⁹¹ të tyre, jo veç personit konkret.

Ligjvënësi e ka paraparë që kjo e drejtë për rehabilitim dhe kompensim iu takon vetëm personave të cilët kanë rënë ndesh me ligjin për herë të parë.

³⁹⁰ Tiberg, Hugo, Compensation for wrongful imprisonment, Stockholm Institute for Scandianvian Law 1957-2010, Stockholm, 2010, f.481. <http://www.scandinavianlaw.se/pdf/48-28.pdf>, qasur me datë 27 prill 2016.

³⁹¹ Mauer, Marc & Chesney-Lind, Meda, INVISIBLE PUNISHMENT, The Collateral Consequences of Mass Imprisonment, New York, 2002, f.27. <https://www.urban.org/sites/default/files/publication/59901/1000557-Invisible-Punishment-An-Instrument-of-Social-Exclusion.PDF>, qasur me datë 24 prill 2017.

51. Paraqitja e kërkesës për kompensim dëmi i personave të arrestuar apo dënuar pa arsye

Kërkesa për kompensim dëmi paraqitet në organin publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore. Kjo çështje rregullohet me nenin 526 të KPPK-së.

Fillimisht kërkesa i paraqitet organit publik kompetent, i cili ka detyrë administrative, e që është Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Zyra e Pranimet të Sekretariatit, dhe atë për rastet që kanë të bëjnë kur:

“... i akuzuari është liruar nga akuza ose me të cilin është refuzuar akuza apo nga forma e prerë e aktvendimit me të cilin hudhet aktakuza ose pushohet procedura. Kur për ankesë vendos gjykata më e lartë, e drejta për kompensim parashkruhet pas tri (3) vitesh nga dita e marrjes së vendimit nga gjykata e tillë”³⁹²

Afati për të paraqitur kërkesën fillon të ecë prej momentit që është vërtetuar se kemi të bëjmë me dëmin e shkaktuar me veprimet e organit shtetëror, prokurorisë apo gjykatës.

Kërkesa duhet të paraqitet brenda afatit kohor tre (3) vjet nga marrja e formës së prerë e vendimit, e me *“kalimin e këtij afati, kërkesa nuk pranohet”*.³⁹³

5.1.1. Kompensimi i dëmit

Këshilli Gjyqësor është i detyruar që të ofrojë ofertën reale për kompensimin e dëmit palës së dëmtuar. Afati për të arritur marrëveshjen për kompensim është më së largu tre (3) muaj nga dita e paraqitjes së kërkesës së tillë.

Nëse nuk arrihet një gjë e tillë, pala mund të ushtrojë menjëherë padinë për kompensimin e dëmit në gjykatë civile, në procedurë kontestimore.

³⁹² Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.1218-1219.

³⁹³ Vendim Unifikues Penal nr.3, datë 27.03.2003, Gjykata e Lartë, Tiranë.

www.gjykataelarte.gov.al/web/nr_3_dt_27_3_2003_82.doc, qasur me datë 23 maj 2016.

Kompensimi i dëmit bëhet për personat e dënuar ose të arrestuar pa arsye dhe personat e dënuar ose të arrestuar pa arsye nga baza e masës së sigurisë-arrestit shtëpiak. Kompensimi i paraburgimit dhe arrestit shtëpiak bëhet me të njëjtën lartësi, e që kjo mënyrë kompensimi dallon në krahasim me Shqipërinë e cila e rregullon ndryshe këtë situatë juridike.

Në Shqipëri, *“Periudha e arrestit në shtëpi kompensohet nisur nga të njëjtat kritere sikurse burgimi, por masa e kompensimit të caktuar nuk duhet të jetë më e madhe se një e dyta e shumës së caktuar për burgimin”*³⁹⁴.

Është interesant fakti që ka të bëjë edhe me lartësinë e dënimit të përcaktuar sipas nenit 10 par.1 dhe nenin 12 par.1 të Udhëzimit Administrativ për zbatimin e procedurës për kompensimin e dëmit për personat e dënuar ose të arrestuar pa arsye. Sipas këtij udhëzimi shuma që kompensohet në emër të kompensimit të dëmit material/fitimin e humbur dhe jomaterial/moral është pesëmbëdhjetë (15) euro.

Në rastet kur personi e ka dëshmuar me kontratë të punës lartësinë e pagës, ai do të paguhet deri në lartësinë e shumës bruto të pagës, pastaj shpenzimet për avokat, për vizita të familjes, dërgimit të pakove dhe transportit.³⁹⁵

Në rastet e dënimit me gjobë, ose zëvendësimit të dënimit me burg në dënim me gjobë *“njëzet (20) Euro gjobë llogaritet me një (1) ditë burgim”*, sipas nenit 43 paragrafi 3 i KPK-së.

Pra, shteti është duke vepruar në mënyrë të padrejtë ndaj qytetarëve në rastin e vlerësimit të vlerës së një dite burgim.

Në rastin kur dëshiron të bëjë kompensimin e llogarit një ditë burgimi 15 euro, kurse kur dëshiron të zëvendësojë një ditë burgimi detyron qytetarin të paguajë shumën 20 euro për një ditë burgim.

Edhe pse juristët thonë se *“çdo ditë që ka qëndruar në paraburgim, në burgim, apo heqje tjetër të lirisë i llogaritet (kompensohet) 20 EUR”*³⁹⁶, një gjë e tillë pra nuk ndodh.

³⁹⁴ Ligji nr.9381, datë 28.4.2005 për kompensimin e burgimit të padrejtë, Tiranë, 2005, n.6.

³⁹⁵ Shiko: Udhëzimi Administrativ (04/2015) për zbatimin e procedurës për kompensimin e dëmit për personat e dënuar ose të arrestuar pa arsye, datë 10.11.2015. <http://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/UDHEZIM%20ADMINISTRATIV%2004%202015%20PER%20ZBATIMIN%20E%20PROCEDURES%20PER%20KOMPENSIMIN%20E%20DEMIT.pdf>, qasur me datë 13 nëntor 2015.

³⁹⁶ Salihu, Ismet & Zhitija, Hilmi & Hasani, Fejzullah, Kodi penal i Republikës së Kosovës, Komentar, Bot.I, Prishtinë, 2014, f.288.

52. Rehabilitimi i të dënuarve

Në të drejtën penale me rehabilitim nënkuptohet kthimi i të drejtave personit të dënuar pasi ta ketë mbajtur dënimin...edhe shlyerja e dënimeve nga evidenca e të ndëshkuarëve.³⁹⁷

Me kalimin e afateve të caktuara kohore dënimi i evidentuar në evidencat e gjykatës duhet të shlyhet në mënyrë automatike, në atë mënyrë që “*shprehet sipas fuqisë së ligjit*”³⁹⁸.

Në praktikë kjo gjë nuk ndodh dhe kjo detyron gjithmonë qytetarët që t’i drejtohen vetë gjykatës me kërkesë të veçantë për ta realizuar këtë të drejtë.

E para nënkuptohet se duhet të kryhet sipas detyrës zyrtare dhe njihet si rehabilitimi ligjor, kurse e dyta ka të bëjë me kërkesën e palës dhe njihet si rehabilitimi gjyqësor.

5.2.1. Shlyerja e dënimit nga evidenca-Rehabilitimi ligjor

Rehabilitimi ligjor paraqitet në mënyrë automatike (*ex lege*) me kalimin e kohës së caktuar pas dënimit të mbajtur, me kusht që personi i dënuar gjatë kësaj periudhe të mos kryejë vepër të re penale.³⁹⁹

Kodi Penal i Kosovës (KPK), në nenin 96, ka përcaktuar afatet të cilat duhet të kalojnë në atë mënyrë që dënimi të mund të shlyhet nga evidenca e personave të dënuar.

Dënimi shlyhet nga evidenca e të ndëshkuarve në afatin e caktuar, prej kur është mbajtur dënimi, parashkruar apo falur, nëse i dënuari brenda atij afati nuk kryen vepër të re penale.⁴⁰⁰

Afatet kohore do vijnë në konsideratë vetëm nëse personi i dënuar nuk kryen ndonjë vepër të re penale dhe atëherë “*rehabilitimi paraqitet me kalimin e kohës së caktuar*”⁴⁰¹:

“2.1. një (1) vit nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit në rastin e
vërejtjes gjyqësore ose të lirimit nga dënimi;

³⁹⁷ Po aty, f.323.

³⁹⁸ Po aty, f.323.

³⁹⁹ Po aty.

⁴⁰⁰ Salihu, Ismet, E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2003, f.555.

⁴⁰¹ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.1206.

- 2.2. *një (1) vit nga dita e skadimit të periudhës së verifikimit në rastin e dënimit me kusht;*
- 2.3. *një (1) vit nga dita e mbajtjes së dënimit, parashkrimit ose përfundimit me falje ose me ndryshim në ligj në rast të dënimit me gjysmëliri;*
- 2.4. *tre (3) vjet pas mbajtjes së dënimit, parashkrimit ose përfundimit me falje ose me ndryshim të ligjit në rastin e dënimit me burgim deri në një (1) vit, dënimit me gjobë ose dënimit plotësues;*
- 2.5. *pesë (5) vjet nga dita e mbajtjes së dënimit, parashkrimit ose përfundimit me falje ose me ndryshim të ligjit në rastin e dënimit me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet;*
- 2.6. *tetë (8) vjet nga dita e mbajtjes së dënimit, parashkrimit ose përfundimit me falje ose me ndryshim të ligjit në rastin e dënimit me burgim prej tre (3) deri në pesë (5) vjet;*
- 2.7. *dhjetë (10) vjet nga dita e mbajtjes së dënimit, parashkrimit ose përfundimit me falje ose me ndryshim të ligjit në rastin e dënimit me burgim prej pesë (5) deri në dhjetë (10) vjet;*
- 2.8. *pesëmbëdhjetë (15) vjet nga dita e mbajtjes së dënimit, parashkrimit ose përfundimit me falje ose me ndryshim të ligjit në rastin e dënimit me burgim prej dhjetë (10) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.”*

Kjo e drejtë ligjore nuk vlen për rastet kur kemi të bëjmë me dënimet me burgim mbi pesëmbëdhjetë (15) vjet burgim dhe për rastet kur kemi të bëjmë me burgimin e përjetshëm dhe për këto situata “*dënimi nuk mund t’i shlyhet*”⁴⁰².

Po ashtu, kjo e drejtë nuk vlen as për rastet kur kemi të bëjmë me dënimet plotësuese dhe masat e trajtimit të detyrueshëm të cilat janë duke u zgjatur akoma. Dmth, nuk kanë përfunduar akoma.

⁴⁰² Salihu, Ismet & Zhitija, Hilmi & Hasani, Fejzullah, vep.cit., f.324.

5.2.2. Shlyerja e dënimit nga evidenca-Rehabilitimi gjyqësor

Ligjvënësi e ka përcaktuar edhe një mundësi që personi i dënuar të mund ta bëjë shlyerjen e dënimit nga evidenca edhe para kalimit të afatit ligjor të paraqitur si më lartë.

Derisa rehabilitimi ligjor bëhet në bazë të ligjit (*ipso lege*), për rehabilitimin gjyqësor vendos gjykata në bazë të kërkesës së të ndëshkuarit.⁴⁰³

Kusht për të realizuar këtë të drejtë është kalimi i gjysmës së afatit të rehabilitimit ligjor, dhe kusht i domosdoshëm që personi nuk ka kryer vepër të re penal gjatë kësaj kohe.

Kjo do të thotë se duhet të kalojnë këto afate ligjore për tu arritur rehabilitimi gjyqësor dhe atë “*në bazë të vendimit të gjykatës*”⁴⁰⁴:

- a) gjashtë (6) muaj nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit në rastin e vërejtjes gjyqësore, lirimit nga dënimi, skadimit të periudhës së verifikimit në rastin e dënimit me kusht ose nga dita e mbajtjes së dënimit, parashkrimit ose përfundimit me falje⁴⁰⁵ ose me ndryshim në ligj në rast të dënimit me gjysmëliri;
- b) një vit e gjysmë (1.5) pas mbajtjes së dënimit, parashkrimit ose përfundimit me falje ose me ndryshim të ligjit në rastin e dënimit me burgim deri në një (1) vit, dënimit me gjobë ose dënimit plotësues;
- c) dy vite e gjysmë (2.5) nga dita e mbajtjes së dënimit, parashkrimit ose përfundimit me falje ose me ndryshim të ligjit në rastin e dënimit me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet;
- ç) katër (4) vjet nga dita e mbajtjes së dënimit, parashkrimit ose përfundimit me falje ose me ndryshim të ligjit në rastin e dënimit me burgim prej tre (3) deri në pesë (5) vjet;
- d) pesë (5) vjet nga dita e mbajtjes së dënimit, parashkrimit ose përfundimit me falje ose me ndryshim të ligjit në rastin e dënimit me burgim prej pesë (5) deri në dhjetë (10) vjet;

⁴⁰³ Po aty, f.325.

⁴⁰⁴ Po aty.

⁴⁰⁵ Rregullore (p) nr. 02/2017 për kriteret dhe procedurat për faljen e personave të dënuar, Republika e Kosovës-Presidenti, Prishtinë, 2017, n.4, p.1.3.

dh) shtatë vjet e gjysmë (7.5) nga dita e mbajtjes së dënimit, parashkrimit ose përfundimit me falje ose me ndryshim të ligjit në rastin e dënimit me burgim prej dhjetë (10) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.

Gjykata në rastin e vendosjes për shlyerje mund të kërkojë vlerësime për sjelljen e të dënuarit pas vuajtjes së dënimit, natyrën e veprës penale të kryer dhe rrethana tjera që i vlerëson gjykata të rëndësishme. Këto janë të përcaktuara në nenin 97 të KPK-së.

Në rastet kur të njëjtit person i janë shqiptuar shumë dënime, mund të shlyhen dënimet vetëm në të njëjtën kohë dhe atë nëse janë plotësuar kushtet për shlyerjen e secilit prej tyre.⁴⁰⁶

5.2.3. Shlyerja e dënimit në rastet kur organi administrativ nuk vepron

Siç është cekur më lartë, organi kompetent në gjykatën kompetente është ajo që duhet të merr aktvendim mbi shlyerjen e dënimit nga evidencat, ashtu që *“dënimi i shlyer nuk shënohet në certifikatën e lëshuar të bazuar në evidencën e dënimeve për realizimin e të drejtave të individëve...personi të cilit i është shlyer dënimi nuk konsiderohet i dënuar në kuptimin e plotë të fjalës”*⁴⁰⁷.

Ky vlerësim i tillë bëhet me qëllim që të respektohet dinjiteti dhe të drejtat e njeriut, sepse *“evidenca e të ndëshkuarve është lloj dhe formë e ndërhyrjes në të drejtat e njeriut”*⁴⁰⁸.

Edhe pse afati ligjor që organi publik kompetent i lëmisë së çështjeve gjyqësore për të nxjerr vendimin është tridhjetë (30) ditë në bazë të kërkesës të të dënuarit, kjo dispozitë nuk zbatohet në praktikë.⁴⁰⁹

Pasi që kjo gjë nuk ndodh në Kosovë, atëherë pala- personit të dënuar i duhet që të kërkojë nga gjykata të nxjerr vendimin e duhur. Kjo rregullohet me nenin 521 të KPPK-së dhe kërkesa i drejtohet gjykatës e cila ka marr Aktgjykimin në shkallë të parë.

⁴⁰⁶ Salihu, Ismet, E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2003, f.556.

⁴⁰⁷ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.1212.

⁴⁰⁸ Salihu, Ismet, E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2003, f.555.

⁴⁰⁹ Si 397, f.1206-1207.

Edhe për këtë nuk ka ndonjë afat të përcaktuar se kur duhet të marrë vendimin gjykata, por kjo duhet të jetë *pa vonesë, sa më parë*.

Në rastet kur gjykata refuzon kërkesën për shlyerjen e dënimit nga evidenca, atëherë i dënuari ka të drejtë që ta përsërisë kërkesën pasi të kalojnë dy (2) vite nga momenti-dita kur aktvendimi refuzues ka marrë formën e prerë.⁴¹⁰

Kjo situatë rregullohet me nenin 523 paragrafi 7 i KPPK-së.

⁴¹⁰ Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, vep.cit., f.1211-1212.

5.4. PËRFUNDIME

Afatet ligjore lidhur me lidhur me kompensimin e personave të arrestuar apo dënuar pa arsye nxjerrin disa përfundime:

✚ Paraqitja e kërkesës:

- Më së largu tre (3) vjet prej formës së prerë të vendimit.

✚ Kompensimi i dëmit:

- Afati për të arritur marrëveshjen për kompensim është më së largu tre (3) muaj nga dita e paraqitjes së kërkesës për kompensim dëmi.

Afatet ligjore lidhur me rehabilitimin e të dënuarit nxjerrin disa përfundime:

✚ Shlyrja e dënimit nga evidenca- rehabilitimi ligjor:

- Nëse personi i dënuar nuk kryen ndonjë vepër të re penale dhe atë brenda afateve:
 - Një (1) vit nga vërejtja gjyqësore ose lirimi nga dënimi dhe...
 - Pesëmbëdhjetë (15) vjet nga dënimi me burgim prej dhjetë (10) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.
 - Për veprat mbi pesëmbëdhjetë (15) vjet burgim nuk ka rehalibilitim.

✚ Shlyrja e dënimit nga evidenca- rehabilitimi gjyqësor:

- Kalimi i gjysmës së afatit të rehabilitimit ligjor dhe
- Personi nuk ka kryer vepër të re penale.

✚ Shlyrja e dënimit kur organi administrativ nuk vepron vet:

- Organi brenda tridhjetë (30) ditë në bazë të kërkesës të të dënuarit duhet nxjerr vendim.
- Në rast refuzimi, përsëritja e kërkesës bëhet pasi të kalojnë dy (2) vite nga momenti-dita kur aktvendimi refuzues ka marrë formën e prerë.

KAPITULLI VI

6. ROLI DHE NDIKIMI I INSTITUCIONEVE TË NDRYSHME NË ZBATIMIN E AFATEVE PROCEDURALE

Institucionet Publike të Kosovës, po ashtu edhe organizatat e ndryshme joqeveritare bashkë me mediumet e ndryshme, pa dyshim që kanë ndikim të madh në punën e gjyqësorit.

Në këtë mënyrë institucionet shtetërore siç është Gjykata Kushtetuese, Avokati i Popullit, Këshilli Gjyqësor etj, pothuaj çdo ditë merren me çështje të rëndësishme që lidhen me punën e gjyqësorit.

Qytetarët e Kosovës te këto institucione shpesh gjejnë të vetëm rrugë për të realizuar të drejtat e tyre të cilat rrezikohen të shkelen dhe të mosrealizohen.

Për këtë arsye në vazhdim do të paraqesim disa nga këto institucione dhe disa raste të cilat tregojnë inkorporimin e këtyre institucioneve në lidhje me afatet ligjore procedurale penale. Te institucionet publike ata shohin se është vendi i duhur ku ata do të mund të realizojnë të drejtat e veta, kurse te shoqëria civile dhe mediat shohin se do të gjejnë përkrahjen dhe presionin në gjyqësor për realizim të drejtave.

6.1. GJYKATA KUSHTETUESE E KOSOVËS

Gjykata Kushtetuese është themeluar në janar të vitit 2009, gati një vit pasi Kosova ka shpallur Pavarësinë e saj me 17 shkurt 2008.

GJK paraqet kontrollin më të lartë “*mbi pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv në Kosovë dhe është arbitri më i lartë për interpretimin e dispozitave kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut... është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës*”⁴¹¹.

⁴¹¹ <http://www.gjk-ks.org/?cid=1,1>, qasur me datë 27 janar 2015.

Duke qenë se qytetarët mund të jenë të pakënaqur me vendimet gjyqësore të cilat vlerësojnë se janë të padrejta, ata mund të kërkojnë në gjykatën kushtetuese konstatimin e shkeljeve të drejtave të tyre të garantuara me kushtetutë.

Ky është qëllimi dhe misioni që ka “Gjykata Kushtetuese në respektim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në fokus të saj ka patur dhe parimin kushtetues të barazisë së individëve përpara ligjit”⁴¹².

Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Ajo siguron funksionalitetin e institucioneve të vendit në pajtim me Kushtetutën dhe garanton mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive individuale të garantuara me Kushtetutë.⁴¹³

Në këto raste, është me rëndësi që të merret në konsideratë respektimi i afateve ligjore si për procedimin e kërkesave në gjykatën kushtetuese, po ashtu edhe afatet tjera lidhur me trajtimin e këtyre ankesave.

6.1.1. Paraqitja e kërkesës

Vetë fillimi i procedurës para Gjykatës Kushtetuese bëhet përmes paraqitjes së kërkesës në gjykatë e cila duhet të paraqitet me shkrim në Sekretarinë e Gjykatës Kushtetuese.

Kjo kërkesë e qytetarit, e cila ka të bëjë me mbrojtjen juridike për shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive të njeriut, lirive individuale të garantuara me Kushtetutë mund të bëhet vetëm nëse janë shterrur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Duhet të jenë shfrytëzuar të gjitha rrugët ligjore në tri nivelet e gjykatave, asaj themelore, të apelit dhe supremes, e atëherë të parashtrohet kërkesa në GJK për të vlerësuar kushtetutshmërinë.

⁴¹² Fjalim i Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese Shqiptare, Bashkim Dedja, në Konferencën ndërkombëtare të mbajtur në Indi, 9-12 dhjetor 2011.

http://www.gjk.gov.al/web/3_fjalim_rol_i_gjykates_kushtetuese_ne_forcimin_e_shtetit_te_se_drejtес_1190.pdf, qasur me datë 19 prill 2014.

⁴¹³ <http://gjk-ks.org/gjykata-kushtetuese/rol-i-dhe-pergjegjesite/>, qasur me datë

Kërkesa e tillë duhet të paraqitet brenda afatit prej katër (4) muajve pasi qytetarit i është dorëzuar vendimi gjyqësor i shkallës së fundit.⁴¹⁴

Në rastet kur kemi kërkesa të paraqitura pas afatit të përcaktuar, GJK nxjerr vendim me të cilën deklaron kërkesën e papranueshme, me arsyetimin se:

“Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesve është dorëzuar pas afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri ligjore, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t'i kontestuar (Shih, rastin O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa nr. 23274/04, GJEDNJ, Aktvendimi i 25 gushtit 2005, shih, edhe: rastin nr.KII40/13, Ramadan Cakiqi, Aktvendim për papranueshmërinë, të 17 marsit 2014, paragrafi 24”⁴¹⁵

6.1.2. Afati për kthimin në gjendjen e mëparshme

Ndodh që qytetari nuk e paraqet kërkesën në GJK brenda afatit prej katër (4) muaj.

Në këto rast, në nenin 50 të Ligjit për GJK, në rastet kur parashtruesi pa fajin e tij nuk e ka paraqitur kërkesën brenda afatit të përcaktuar, ai mund të paraqes kërkesën për kthim në gjendjen e mëparshme.

Kërkesën për kthim në gjendjen e mëparshme ka të drejtë ta bëjë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga momenti i mënjanimin të pengesës që ka shkaktuar humbjen e afatit. Por gjithsesi, nëse ka kaluar një (1) vit nga momenti-dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar atëherë nuk ka të drejtë qytetari të paraqet kërkesën e tillë për kthim në gjendjen e mëparshme.

⁴¹⁴ Ligji nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2008, n.49.

⁴¹⁵ Aktvendimi për Papranueshmëri i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës A.ref.:RK 1063/17, 15 maj 2017 (http://gjk-ks.org/repository/docs/gjk_ki_114_16_shq.pdf, qasur me datë 22 maj 2017).

Kërkesa e tillë duhet të jetë e arsyetuar mirë për tu pranuar kthimi në gjendjen e mëparshme, në të kundërtën ajo do të refuzohet.

Në mënyrë të tillë e ka refuzuar GJK kërkesën e paraqitur pas afatit dhe nuk ia ka pranuar arsyetimin palës kërkuese. GJK ka vendosur për papranueshmëri të kërkesës pikërisht se:

“Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për kthim në gjendje të mëparshme, siç është përcaktuar në nenin 50 të Ligjit, sepse parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur ta arsyetojë kërkesën e tij dhe nuk ka ofruar prova që tregojnë se si dhe pse pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar. Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar, në pajtim me nenin 50 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës”⁴¹⁶.

6.1.3. Procedimi i kërkesës së paraqitur

Kërkesat paraqiten brenda afatit të përcaktuar në sekretarinë e GJK, e cila në afatin kohor/menjëherë i regjistron ato.

Nuk është përcaktuar ndonjë kohë se kur do të fillojë puna në bazë të kërkesës, por kjo kuptohet se menjëherë, në momentin e parë të mundshëm kopja e kërkesës i dërgohet palës kundërshtare, institucionit ndaj të cilit është paraqitur kërkesa.

Pala kundërshtare ka afatin dyzet e pesë (45) ditë nga momenti i pranimi të kopjes së kërkesës për të paraqitur përgjigje në kërkesë.

Në rast se përgjigja në kërkesë nuk është e qartë ose e kompletuar, gjyqtari raportues i cakton një afat tjetër e i cili nuk mund të jetë më gjatë se pesëmbëdhjetë (15) ditë, për ta qartësuar apo plotësuar përgjigjen në kërkesë.

Gjyqtari raportues ka të drejtë të kërkojë prova shtesë nëse kjo është e nevojshme për të vlerësuar lejueshmërinë dhe themelësinë e kërkesës.

⁴¹⁶ Aktvendimi për Papranueshmëri i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, A.ref.:RK 864/2015, 01 dhjetor 2015. (http://gjk-ks.org/repository/docs/gjk_ki_25_15_shq.pdf, qasur me datë 1 shkurt 2016).

Pasi të jenë kryer këto veprime procedurale, atëherë është afati prej tridhjetë (30) ditësh kur gjyqtari raportues i dërgon kolegjit shqyrtues raportin për kërkesën dhe përgjigjen në kërkesë të palëve të interesuara.⁴¹⁷

Kur Kolegji shqyrtues vendos për pranueshmërinë e kërkesës, atë vendim e dorëzon brenda tridhjetë (30) ditësh pasi që është pranuar nga gjyqtari raportues.

Në rastet tjera, varësisht nga çështja dhe nevoja eventuale për sigurim të informacioneve shtesë nga palët. Pasi sillen ato informacioni, afati prej tridhjetë (30) ditësh do të ecë nga ai moment.

Për të sqaruar në detaje çështjet që kanë të bëjnë me afatet, Gjykata Kushtetuese përmes rregullores së punës e ka përcaktuar mënyrën e llogaritjes së afateve kohore.

Në Rregullin 30⁴¹⁸, Llogaritja e periudhës kohore, është përcaktuar se:

“Periudha kohore, e përcaktuar në Kushtetutë, në Ligj dhe në këtë Rregullore të punës, llogaritet si më poshtë:

- (1) Kur periudha shprehet me ditë, ajo duhet të llogaritet duke filluar nga dita pasuese pasi kishte ndodhur një ngjarje;*
- (2) Kur periudha shprehet me javë, ajo përfundon me kalimin e ditës së njëjtë të javës me ditën gjatë të cilës ka ndodhur ngjarja ose veprimi për të cilin duhet të llogaritet periudha kohore;*
- (3) Kur periudha shprehet me muaj, ajo përfundon me kalimin e ditës së njëjtë kalendarike të muajit me ditën gjatë të cilës ka ndodhur ngjarja ose veprimi për të cilin duhet të llogaritet periudha kohore;*
- (4) Kur periudha shprehet në muaj dhe në ditë, së pari llogariten muajt e plotë e pastaj ditët;*
- (5) Kur periudhat llogariten, periudhat përfshijnë të shtunat, të dielat dhe festat zyrtare;*

⁴¹⁷ Ligji nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2008, n.22.

⁴¹⁸ Me Rregulloren e punës e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr.50/2015, e datës 3 mars 2015 kjo situatë ka qenë e rregulluar me nenin 27. (http://gjk-ks.org/repository/docs/gjkk_rregullore_e_punes_2015_shq.pdf, qasur me datën 5 qershor 2016

(6) Ndryshe, nëse periudha përfundon të shtunën, të dielën ose në ndonjë festë zyrtare, ajo do të vazhdojë deri në fund të ditës së parë të punës që vjen pas saj.”⁴¹⁹

62 KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS

Këshilli Gjyqësor i Kosovës është Institucion i cili është krijuar me Ligjin për Këshillin Gjyqësor nr.03/L-223, shtator 2010, e që qëllimin kryesor e ka sigurimin e një “*sistemi të drejtësisë të pavarur, të drejtë, apolitik, të qasshëm, profesional dhe të paanshëm i cili pasqyron natyrën shumë etnike të Republikës së Kosovës dhe zbaton Kushtetutën si dhe parimet e pranuar ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore.*”⁴²⁰

Këshilli duke qenë i pavarur në punën e vet, ai ka rolin mbikqyrës dhe disa nga kompetencat dhe përgjegjësit e tij janë të rënditura në nenin 4 të ligjit të për Këshillin Gjyqësor, ku disa nga ato janë: sigurimi i pavarësisë dhe paanshmërisë së sistemit gjyqësor; shpallja e rregulloreve mbi transferimin dhe procedurën disiplinore për gjyqtarë; organizimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të duhur të gjykatave; sigurimin e vlerësimeve të rregullta periodike mbi ngarkesën e lëndëve të gjykatave ashtu që të sigurohet funksionimi efikas i gjykatave; mbikëqyrjen e inspektimit gjyqësor, administrimit gjyqësor dhe nxjerrjen e rregulloreve të brendshme për gjykatat në përputhje me ligjit ekzistues. Në këtë mënyrë, roli i KGJK-së i cili ka vizionin kryesor që të kemi një sistem gjyqësor i cili vepron në mënyrë të pavarur, të drejtë për të gjithë, që është funksional dhe që pa dyshim përmes dhënies së llogarisë për punën e tij, ai do të munt të jetë edhe efikas. Efikasiteti ka të bëjë drejtpërdrejt edhe me faktorin *afat-kohë e arsyeshme* për kryerjen e punëve nga gjyqësori.

⁴¹⁹ Rregullorja e punës e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr.01/2018, e datës 31 maj 2018.
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16599>, qasur me datën 11 gusht 2018.

⁴²⁰ Ligji për Këshillin Gjyqësor nr.03/L-223, Prishtinë, 2010, n.3.

Këtë qëndrim Këshilli Gjyqësor e ka në faqen zyrtare të tij ku potencon se “ *Qëllimi ynë është që gjykatat të jenë sa më afër qytetarit dhe që secili që drejtohet në gjykatë të ketë trajtimin e duhur sipas ligjit* ”⁴²¹.

Kosova ka kaluar në kohë të vështira si shtet i ri dhe eksperimental i vendeve të huaja që kanë administruar atë, ashtu që si çështje me prioritet akoma shihet mundësia e reduktimit të lëndëve të cilat vlerësohen si të vjetra, e të cilat, vetë fjala e vjetër dëshmon se nuk kemi procese gjyqësore të cilat përfundojnë në afat ligjor.

Këshilli tenton të shfrytëzojë të gjitha kapacitetet e saja për të siguruar një gjyqësor më efikas dhe kjo ka nxjerr edhe strategji të caktuara, siç është Strategjia kombëtare për reduktimin e lëndëve të vjetra, e vitit 2013, të cilat merren me përkufizimin e lëndëve të vjetra ato të cilat janë parashtruar para vitit 2012. Sipas kësaj strategjie, është marrë qëndrim, vendim, se lëndë të vjetra janë ato të cilat janë “*më të vjetra sesa dy vite*”⁴²².

KGJK-ja, me qëllim që të kemi një gjyqësor efikas, në rastin e nxjerrjes së Rregullores për përcaktimin e sjelljeve të pahijshme të gjyqtarëve, pikërisht sjelljet që kanë të bëjnë me afatet ligjore janë kategorizuar si shkelje të rënda.

KGJK ka përcaktuar se shkelje e cila mund të sanksionohet, duke u nisur nga mosrespektimi i orarit të caktuar për zhvillimin e seancave gjyqësore e cila cilësohet shkelje e lehtë, por kemi rasti kur “*vonesa e paarsyeshme në përpilimin e vendimit gjyqësor, duke llogaritur nga dita e afatit ligjor*” vlerësohet si shkelje e rëndë.⁴²³

Kjo është bërë me qëllim që kjo të ndikojë që nga ana e gjyqtarëve të kryhen veprimet me kohë, brenda afateve ligjore.

⁴²¹ <http://www.gjyqesori-rks.org/sq/kjc/page/index/3>, qasur me datë 24 maj 2014.

⁴²² Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Strategjia kombëtare për reduktimin e lëndëve të vjetra, Gusht 2013*, (file:///C:/Users/Star%20Tech/Downloads/Strategjia%20kombetare%20per%20reduktimin%20e%20lende%20te%20vjetra.pdf, qasur me datë 20 prill 2014).

⁴²³ Rregullorja nr.04/2016 për përcaktimin e sjelljeve të pahijshme e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, 03.03.2016, neni 4 dhe 5. file:///C:/Users/Star%20Tech/Downloads/Rregullore%2004-2016%20per%20%20percaktimin%20e%20sjellejeve%20te%20pa%20hijshme.pdf, qasur me datë 24 shkurt 2017.

6.2.1. Njësia për shqyrtimin e performancës gjyqësore

Brenda Këshillit Gjyqësor funksionon Njësia për shqyrtimin e performancës gjyqësore e cila ka për detyrë kryesore kontrollimin e punës së gjyqësorit, e që puna e tyre lidhet edhe me afatet ligjore.

NJSHPGJ në raportin e saj nr.2011/01, lidhur me Rishikimi i procesit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe dënimit me gjobë të lëndët e pa ekzekutuara dhe të parashkruara/pezulluara, të përgatitur në dhjetor 2012, ka nxjerr përfundime me rëndësi dhe të cilat përfundime paraqesin edhe efikasitetin e gjyqësorit.

Në këtë raport, thuhet se janë analizuar:

“17.143 lëndë të pranuar të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe dënimit me gjobë të periudhës kohore 2000 e deri më 30 qershor të vitit 2011... NJSHPGJ ka gjetur se gjykata me rastin e marrjes së aktvendimeve për parashkrim absolut në disa raste si datë të fillimit të parashkrimit ka marrë datën e shqyrtimit kryesor. Për këtë, NJSHPGJ ka rekomanduar që si datë të fillimit të rrjedhjes së parashkrimit absolut të marrin datën e plotfuqishmërisë së aktgjykimit ngase nga kjo datë fillon të rrjedh afati i parashkrimit.”⁴²⁴

Në bazë të këtij raporti shihet se llogaritja e ecjes së afateve është bërë në kundërshtim me ligjin, e që në këto raste, moszbatimi i drejtë i ligjit ka shkuar në favor të pandehurve-gjykuarve.

Po ashtu, në të njëjtin raport, është konstatuar se “nga 619 lëndë të ekzekutimit të dënimit me burgim, NJSHPGJ ka gjetur 174 lëndë me parashkrim absolut. Është gjetur se 135 prej

⁴²⁴ Njësia për Shqyrtimin e Performancës Gjyqësore, Raporti nr.2011/01, “Rishikimi i procesit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe dënimit me gjobë të lëndët e pa ekzekutuara dhe të parashkruara/pezulluara”, Prishtinë, 2012, f.4.
(file:///C:/Users/Star%20Tech/Downloads/SH%20Raport%20i%20Performanc%C3%ABs%20%23%202011-01%20(1).pdf, qasur me datë 25 tetor 2014).

tyre kanë pasur të përpiluar aktvendimin për parashkrim, ndërsa 39 lëndë janë parashkrim i konstatuar nga auditori”⁴²⁵.

Arsye apo shkak i parashkrimit të arritur dhe krijim i vonesave sipas NJSHPGJ është identifikuar mosdërgimi me kohë i lëndëve në zyrën e ekzekutimeve. E këto sipas tyre janë se urdhëresat e lëshuara nga gjykata, e të cilat nuk janë ekzekutuar nga ana e Policisë së Kosovës.

Shkak i tretë është gjetur vonesat e krijuara në rastet e zëvendësimit të dënimeve me gjobë në dënime me burgim, e që krijohen vonesa procedurale që shkaktojnë parashkrimin.

Gjetje me rëndësi është fakti që në rastet kur parashkrimi është arritur, *“e nga 379 lëndë me parashkrim relativ...Gjykata në asnjë rast nuk ka marrë aktvendim për shkak të parashkrimit relativ dhe ato i ka përfunduar në mënyra të tjera pa u identifikuar fare parashkrimi relativ”⁴²⁶.*

NJSHPGJ në raport me parashkrimin relativ i cili ka arritur, ka identifikuar disa shkaqe të tjera, përveç atyre të cekura më lartë, kur dihet se parashkrimi relativ-ligjor, si term praktik, është më i shkurtër se parashkrimi absolut-dyfishi i parashkrimit.

Në këtë mënyrë, në këto raste kemi të bëjmë me mosveprimin në kohë nga ana e gjykatës në rastin e trajtimit të rasteve.

Sipas tyre është mungesa e zyrtarëve-referentëve ekzekutues të cilët janë të paktë në krahasim me numrin e lëndëve dhe angazhimet e tyre administrative, e për të cilat lëndë të pranuar nuk ka asnjë mekanizëm të kontrollit.

Të gjitha këto shkaqe kanë sjell situata kur kemi të bëjmë me pagesat e gjobave edhe pasi gjobat janë parashkruara, duke u shkelur ligji në dëm të qytetarëve, ku nga:

“40 lëndë të dënimit me gjobë tek të cilat pagesa është bërë pas parashkrimit relativ dhe 8 (tetë), lëndë tek të cilat pagesa është bërë pas parashkrimit absolut”.

⁴²⁵ Po aty, f.5.

⁴²⁶ Po aty.

Për këtë arsye, pikërisht këto të gjetura kanë sjell rekomandimet e caktuara nga kjo njësi që të gjitha veprimet duhet të kryhen me kohë me kapacitete të mjaftueshme të faktorit njeri, me qëllim që të kemi respektim të afateve ligjore.

63. ZYRA E PROKURORIT DISIPLINOR

Zyra e Prokurorit Disiplinor ka qenë themeluar si organ i pavarur, i cili i ka shërbyer Këshillit Gjyqësor të Kosovës ashtu edhe Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Përmes këtij Institucioni synimi kryesor është tentuar të arrihet ka qenë pengimi i mundësisë që prokurorët dhe gjyqtarët të bëjnë sjelljet të pahijshme. Është tentuar të arrihet një proces i drejtë gjyqësor.

Detyrat dhe përgjegjësit e Zyrës së Prokurorit Disiplinor kanë qenë të përcaktuara në atë mënyrë që sjelljet e atilla që janë në kundërshtim me normat morale dhe ligjore të ndëshkohen.

Në nenin 24 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, janë përcaktuar në mënyrë decidive se çka do të thotë sjellje të pahijshme të prokurorit, e që në këtë rast kjo vlen edhe për gjyqtarët, por edhe gjyqtarët porotë, kur përveç vendimit të formës së prerë për një vepër penale, me përjashtim të kundërvajtjes, janë:”1.2. *neglizhenca në kryerjen e detyrave, dështimi për të kryer, apo keqpërdorimi i funksioneve prokuroriale; 1.3. dështimi për të kryer funksionet prokuroriale në mënyrë të pavarur dhe të paanshme; 1.4. shkelja e Kodit të zbatueshëm të Etikës.*”⁴²⁷

Pra, si shkelje vlerësohet me të drejtë edhe neglizhenca, dështimi për të kryer punët ashtu siç është e përcaktuar me ligj, e që në këtë lloj të shkeljes medoemos hyn edhe faktori afat-kohë.

Ndër të tjera, këtu hyjnë vonesat e paarsyeshme në ndërmarrjen e veprimeve të caktuara procedurale po ashtu edhe shtyrjet e ndërmarrjes së veprimeve të duhura.

Edhe pse në mbështetje të nenit 27 të LKPK-së, janë përcaktuar masat disiplinore të cilat mund të shqiptohen, mund të themi se ato fare nuk zbatohen.

⁴²⁷ Ligji për Këshillin Prokurorial, Prishtinë, 2010, n.24.

Masat disiplinore që mund të shqiptohen janë qortimi, qortimi me urdhër për ndërmarrje të veprimeve korigjuese, zvogëlim i përkohshëm i pagës deri në pesëdhjetë përqind (50%) duke marrë parasysh natyrën e sjelljes së pahijshme; ulje në detyrë brenda sistemit prokurorial apo propozim për largimin nga detyra të Prokurorit të Shtetit.⁴²⁸

Sipas Raportit të Monitorimit të bërë nga ana e Organizatës Çohu, është gjetur se ZPD, ka zhvilluar hetime disiplinore për disa raste që kanë të bëjnë me afatet ligjore-faktorin kohë, e pikërisht për rastet e parashkrimit të lëndëve penale dhe ekzekutimeve penale.

Kështu, nga intervista e zhvilluar me kordinatorin e ZPD, është kuptuar se gjatë vitit 2012 janë zhvilluar hetime disiplinore për dhjetë (10) raste që kanë të bëjnë me lejimin e parashkrimit të lëndëve penale.

Nga këto dhjetë (10) raste, gjashtë (6) janë dërguar në komision disiplinor kurse katër (4) janë hedhur poshtë për shkak se kanë qenë të pabazuara.

Në krahasim me vitin 2012, viti 2013 ka pasur më shumë raste të cilat kanë të bëjnë me afatet ligjore të hetimit të veprave penale.

Kështu, në vitin 2013 ka pasur rreth 72 raste të cilat janë hetuar për parashkrim të lëndëve penale.⁴²⁹

Nga këto lëndë të hetuara 64 janë mbyllur për këto arsye se *“gjqqtarët nuk e ushtrojnë më funksionin e gjyqtarit, ose është gjetur që gjyqtarët i kanë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme juridike mirëpo, nuk kanë mundur të ndalin afatin e parashkrimit”*⁴³⁰.

Nëse shihen vendimet që janë marrë nga ana e Komisioni Disiplinor për rastet që kanë të bëjnë me neglizhencë dhe shkelje të afateve ligjore, në përgjithësi janë masa shumë të lehta.

Në përgjithësi janë qortime, e më e rënda ulje e pagës në përqindje për pak muaj.⁴³¹

Tani, nga janari 2019 këtë detyrë e kanë bartur secili Institucion në vete, ashtu që zyrja disiplinore e ZPD-së ka funksionuar deri në janar 2019 kur është futur në fuqi Ligji nr. 06/L

⁴²⁸ <http://zpd-rks.org/sq/misioni-dhe-vizioni/>, qasur me datë 4 maj 2014.

⁴²⁹ Shiko më gjerësisht: Raporti Monitorues: Parashkrimi i Ndjekjes Penale dhe Parashkrimi i Ekzekutimit të Dënimeve në Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës në vitet 2001-2013, Organizata për Demokraci, Anti-Korrupsion dhe Dinjitet, ÇOHU, Prishtinë, 2014.

⁴³⁰ Po aty, f.38.

⁴³¹ Shiko në detaje Vendimet e Komisionit Disiplinor në faqen zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës: http://www.gjyqesori-rks.org/vendimet-e-komisionit-disiplinor/?r=M&ordBy=dDtTm+DESC,+dTTitle_sq&ordDir=DESC&offset=0.

– 057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, e që rregullon materien që ka të bëjë me *“shkeljet disiplinore, procedurat për fillimin e hetimeve për dyshimet për shkelje disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, procedurat disiplinore pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, sanksionet disiplinore dhe mjetet juridike që lidhen me shkeljet disiplinore pranë Gjykatës Supreme”*⁴³².

Në nenin 2, paragrafi 2.7. është përcaktuar ndër të tjera si shkelje e detyrave të gjyqtarit nëse ai në vazhdimësi nuk i kryen detyrat zyrtare me kohë, siç kërkohet me ligj.

Kurse në nenin 6, përcaktuar shkeljet e detyrave të prokurorit, paragrafi 2.1. *në mënyrë të vazhdueshme nuk ndërmerr ndonjë veprim prokurorial që kërkohet me ligjin në fuqi ose nuk ushtron funksionet prokuroriale brenda afateve kohore të parapara me ligj, përveç nëse serioziteti i mos veprimit apo niveli i shkeljes paraqet bazë për inicimin e procedurës disiplinore për një shkelje të vetme, Paragrafi 2.6., nuk vepron në përputhje me vendimet apo udhëzimet e ligjshme të kryeprokurorit.*

Këto përcaktime kanë të bëjnë drejtpërdrejt me zbatimin e afateve dhe vendimeve të lëshuara si nga zyra e Kryeprokurorit të Shtetit apo edhe Organeve tjera kompetente, e në rast moszbatimi, do të kishim të bënim me shkelje disiplinore që do të pasonin me sanksione të caktuara, nga vërejtja jopublike me shkrim deri te propozimi për shkarkim (neni 7 i ligjit në fjalë).

64. KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS

Pa dyshim, mund të themi se të cekurat që janë paraqitur lidhur me Këshillin Gjyqësor të Kosovës njëjtë vlejnë edhe për Këshillin Prokurorial të Kosovës, përveç se këtu kemi të bëjmë me Prokurorinë e jo Gjykatën.

Qëllimi, fushëveprimi, detyrat dhe kompetencat e KPRK-së⁴³³ janë të përcaktuara dhe të definuara me Ligjin nr.03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, 30 shtator 2010.

⁴³² Ligji nr. 06/I – 057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Prishtinë, 2019, neni 1.

⁴³³ <http://www.kpk-rks.org/>, qasur me datë 14 prill 2015.

65. AVOKATI I POPULLIT

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në Kapitullin XII Institucionet e Pavarura, në nenin 132, paragrafi 1 e ka përcaktuar roli dhe kompetencat që ka Institucioni i Avokatit të Popullit. Aty është përcaktuar se “*Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike*”.

Avokati i Popullit ndryshe quhet edhe Ombudspersoni⁴³⁴ e që zanafillën e ka të largët ku si institucion buron që nga viti 1809⁴³⁵.

Secili person që vlerëson se i janë shkelur të drejtat *apo/dhe* liria e tij, ka të drejtë t’i drejtohet Avokatit të Popullit për të trajtuar ankesën e tij. Por fatkeqësisht avokati i popullit jep vetëm rekomandime dhe nuk nxjerr detyrime për Institucionet shkelëse.

Këto rekomandime mund të jenë bazë që në rast se kemi të bëjmë me elemente të veprës penale AP duhet të informojë prokurorinë për veprime të tilla për të inicuar hetim penal. Në këto rast me të drejtë do të kishim shpërdorim të detyrës zyrtare.⁴³⁶

Por, në praktikë një gjë e tillë nuk veprohet dhe pothuaj secila ankesë mbetet në pozitën e pritjes dhe mosveprimi merr natyrën e heshtjes administrative.

Institucioni i cili shkel të drejtat e njeriut në aspektin kohë, me afatin ligjor, mbetet vetëm me një vërejtje pa rëndësi. Këto ndodhin jo për shkak të mungesës së kompetencës por për shkak të mos reagimit të duhur nga AP dhe institucionet tjera.

Rast i tillë është ankesa ndaj Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë-MASHT nga ana e një profesori B.Z., e që për këtë çështje kërkesat dhe rekomandimet e AP-së kanë mbetur vetëm në letër. Kjo vetëm e ulë autoritetin e këtij Institucioni dhe vërteton se duhet të ketë çasje tjetër ndaj Institucioneve mosndëgjuese.

Për këtë çështje kemi dy kërkesa për sigurim të informatave, atë të datës 13 shtator 2016 nr.988/2016 dhe datë 11 nëntor 2016 nr.1051/2016 të drejtuara nga AP Hilmi Jashari për Ministrin e MASHT-it Arsim Bajrami.

⁴³⁴ Më në detaje: <https://oik-rks.org/>, qasur me datë 15 qershor 2017.

⁴³⁵ <https://www.ombudsman.org.mt/what-does-the-word-ombudsman-mean-2/>, qasur me datë 15 qershor 2017.

⁴³⁶ Ligji nr 05/L-019 për Avokatin e Popullit, 2015, n.16, p.5.

E para kërkesë i jep afat MASHT-it që të përgjigjet deri me datën 27 shtator 2016 gjë e cila nuk bëhet.

E dyta pastaj jep afat deri me datën 25 nëntor 2016 dhe prapë has në vesh të shurdhët.

Pas kësaj, AP nxjerr edhe Rekomandim dhe:

“kërkon që MASHT të vendos urgjent lidhur me parashtrësën e ankuesit...Ju lutemi që përgjigjen tuaj, për këtë çështje, ta dërgoni në një afat të arsyeshëm kohor por jo më vonë se deri me 15 gusht 2017”⁴³⁷.

Pra, një vit zhagjitje pa asnjë rezultat, pavarësisht se është konstatuar se kemi të bëjmë me shkelje afatesh në çështjen konkrete.

Puna e AP qëndron në identifikimin e këtyre shkeljeve dhe paraqitjen e rekomandimeve dhe raportimeve të tyre publike, ashtu që:

“paraqet mekanizmin ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizik dhe juridik nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve tjera, të cilët ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës, si dhe vepron si Mekanizëm Kombëtar për parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese, në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, duke përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin e emigracionit dhe çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut”⁴³⁸

AP bënë raportime të rregullta për punën e tij të kryer në baza kohore dhe i publikon në faqen zyrtare të saj.

⁴³⁷ Letër-rekomandim, nr.1051/2017 i Avokatit të Popullit, datë 14 korrik 2017.

⁴³⁸ <http://www.ombudspersonkosovo.org/sq/misioni>, qasur me datë 26 mars 2016.

Si shembull e paraqesim raportin e vitit 2016 që ka prekur të gjitha segmentet, e në këtë rast edhe çështjen e respektimit të afateve ligjore, konkretisht çështjen e parashkrimit të lëndëve gjyqësore.⁴³⁹

Lidhur me ankesat që janë trajtuar nga AP, është thënë se “*Në bazë të numrit të ankesave të paraqitura në IAP gjatë këtij viti raportues, rezulton se qytetarët vazhdojnë të mos kenë besim në sistemin gjyqësor. Ata edhe më tej vazhdojnë të përballen me zvarritje të procedurave për vendosjen e rasteve të tyre me vite të tëra, mosekzekutim të vendimeve gjyqësore të plotfuqishme, vendime joefektive, parashkrim të lëndëve gjyqësore...*”⁴⁴⁰

Raportimet dhe paraqitjen e punës së AP, ajo e bënë edhe përmes medieve si e drejtë e saj dhe veprim që futet në mënyrën e paraqitjes së punës së AP.

Në gjë e tillë që ka të bëjë me afatin ligjor të trajtimit të lëndëve është bërë nga Ap ztr.

Hilmi Jashari, i cili ka shprehur shqetësimin e tij.

Shqetësimi i shprehur në këtë rast ka të bëjë me lëndët që gjenden në gjykatat në Veri të Kosovës, atje ku dora e shtetit nuk arrin akoma. Ai flet për gjendjen momentale të vitit 2017, duke potencuar se:

“Më tepër se 2500 lëndë civile janë parashkruar në gjykatat tona dhe 1500 lëndë penale gjithashtu janë parashkruar dhe kjo për neve ka qenë shumë serioze, sidomos çështjet penale sepse nuk ngritët problem vetëm në pjesën veriore sa i përket parashkrimit të këtyre lëndëve, por është çështje e kushtetutës sepse kushtetuta ka një dispozitë shumë të fuqishme e cila garanton barazi para ligjit për të gjithë qytetarët e vendit...parashkrimi i këtyre rasteve paraqet një shkelje flagrante të të drejtave të njeriut, por edhe shkelje kushtetuese”⁴⁴¹.

⁴³⁹ Institucioni i Avokatit të Popullit, Raporti vjetor 2016, Nr.16, Prishtinë, 2017.

(http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/Raporti_vjetor_SHQIP_nr16_me_kopertine_per_web_204801.pdf), qasur me datë 28 tetor 2017).

⁴⁴⁰ Po aty, f.22.

⁴⁴¹ Ekonomika Online, *Parashkrimi i 4 000 lëndëve në veri, shkelje kushtetuese*, Prishtinë, 20 qershor 2017 (<http://www.ekonomiaonline.com/nacionale/siguri/parashkrimi-4-000-lende-ne-veri-shqetesues-per-avokatin-e-popullit/>), qasur me datë 20 korrik 2017).

66. MEDIA DHE SHOQËRIA CIVILE

Nuk munda t'i ik deklarimit të gazetarit të njohur të Shqipërisë Blendi Fevziut i cili në bazë të përvojës së gjatë, paraqet dhe përshkruan në mënyrë shumë të guximshme perceptimin që kanë gazetarët/mediet për vete dhe qytetarët ndaj medies.

Ai deklaron se:

“bindja që gazetarët janë njerëzit më të rëndësishëm të këtij vendi...ka njëllojë deliri në përgjithësi te media së media mund t'i bëjë të gjitha...media i jep të drejta vetes të dhunojë një qytetar ose gjithkënd në shoqëri, po ndërkohë nuk duron dot asnjë lloj kritike ndaj vetes...akoma sot nëse unë dua mund t'i bie në qaf kujdo dhe nuk përgjigjem para askujt, nuk dënohet askush në gjykatë... kjo i ka dhënë një pushtet të pamërituar dhe abuzim me mediat...po e fus edhe veten këtu”⁴⁴²

Duke qenë se në Kosovë kemi medie dhe portale të shumta që merren me punën e gjyqësorit e që lidhet me subjektin e punimit, do paraqiten vetëm disa nga këto. Dhe atë sa për të ilustruar disa nga çështjet problematike që kanë të bëjnë me respektimin/shkeljen e afateve ligjore nga zbatuesit e ligjit.

Po ashtu edhe organizatat e ndryshme të shoqërisë civile kanë arritur të kenë ndikim të madh në punën e gjyqësorit.

Ato duke ushtruar aktivitetet e tyre në drejtim të respektimit të drejtave të njeriut dhe sidomos luftimit të korrupsionit si brengë e madhe e shoqërisë, kanë arritur ndikimin e tyre në secilën sferë të shoqërisë dhe institucioneve.

Lirisht mund të themi se është gati e pamundur të kemi ndonjë proces gjyqësor me rëndësi të madhe e cila nuk përcillet dhe raportohet nga shoqëria civile përmes organizatave të tyre. Po ashtu, mund të themi se gati secila organizatë e shoqërisë civile ka zgjeruar aktivitetin e saj në emisione televizive përmes paraqitjes video-vizuele dhe kjo padyshim se në rastet më të shpeshta kanë ndikim pozitiv.

⁴⁴² <https://www.youtube.com/watch?v=f8CVDnUeQko>, qasur me datë 14 nëntor 2017.

Por këto mund të kenë edhe ndikim negativ në rastet kur personi që gjykohet mund të jetë i pafajshëm, e me paraqitjen e tij publike i shkaktohen dëme dhe pasoja të mëdha, linçim publik, gjykim publik dhe ndikim në vendimmarrje të prokurorisë dhe gjykatës.

Shpesh ndodhin që në fillim të procesit gjyqësor mediat trumbetojnë “lajmin e madh” që drejtpërdrejt të ndikojnë në vendimmarrjen e gjykatës apo edhe prokurorisë.

Jo rrallë ndodh që edhe raportimet pompoze të jenë shpifje të hapura, e që fatkeqësisht kalojnë pa asnjë pasojë. Kurse dëmi që i shkaktohet personit dhe rrethit të tij, kalon edhe “qëllimin publik/interesin publik” prapa të cilës tentojnë të fshihen mediet dhe portalet e caktuara, ndodh që dëmi kalon edhe jashtë kufijve shtetëror, duke i dhënë pasqyrë të keqe Kosovës, kulturës qytetare dhe insitucionale të saj. Në këto raste më të drejtë vetëm vërtetohet ajo që ka deklaruar gazetari Fevziu, e në Kosovë, ndikimi politik e ka sjell që vepra penale e shpifjes të hiqet nga nga ndjekja penale dhe liria e shpifjes të mos njeh kufi, krejt në emër të lirisë së medias e cila dinë të shtyp të drejtat elementare të njeriut.⁴⁴³

Duke qenë se raste të tilla nuk janë të pakta, do të paraqiten këtu vetëm disa nga mediet të cilat janë më aktive dhe identifikuese për punën së gjyqësorit.

6.6.1. Kallxo.com

Kallxo.com është medium që funksionin në sistemin online dhe në vete ngërthen disa organizata të ndryshme, siç janë *“Internews Kosova, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë*

⁴⁴³ Rast i tillë është Raportimi i Gazetës Online në Kosovë “Insajderi”, me kryeredaktor Vehbi Kajtazin, me datë 7 korrik 2019 rreth orës 14:20 është paraqitur shkrimi *“Skandali me patentë shofer-Gjykata merr vendim për 23 të arrestuarit”*. Raportimi edhe në brendësi të shkrimit ka pasur përmbajtjen se *“Ndaj këtyre personave gjykata ka vendosur t’i lë në paraburgim për shkak se ekziston rreziku që nëse lihen në liri do të mund të ikin”*, e që kjo nuk ishte e vërteta. E vërteta ishte se në momentin e këtij raportimi publik, seanca gjyqësore ishte duke u mbajtur në gjykatë dhe vendimi për këtë rast është marrë pas dy ditës, me datën 9 korrik 2019, duke mos ju caktuar paraburgim asnjërit nga 23 personat e arrestuar. Pas reagimit të njërit nga avokatët mbrojtës për këtë shkrim, “Insajderi” nuk ka kërkuar falje për shpifjen e bërë, por ka tentuar fshehtas të bëjë ndërhyrje në raportimin e saj, ashtu që pas rreth 20 minutave, ndërron titullin e shkrimit në *“Kërkohet paraburgim për 23 personat të përfshirë në skandalin për patent shofer” dhe në brendi të tekstit shënon se “Ndaj këtyre personave prokuroria ka kërkuar paraburgim për shkak se ekziston rreziku se nëse lihen në liri do të mund të ikin”*. Po të mos kishte reagim me siguri shkrimi do të mbetej aty dhe po ashtu do të ndikohej në përcëpcionin e personave të painformuar. <https://insajderi.com/skandali-me-patente-shofer-gjykata-merr-vendim-per-23-te-arrestuarit-ne-rastin-e-patente-shofereve/>, qasur me datë 7 korrik 2019.

*Hulumtuese dhe Agjensionit Kundër Korrupsion...ofron mundësinë për të gjithë qytetarët e Kosovës që të raportojnë rastet e korrupsionit, krimit të organizuar, mashtrimit, konfliktit të interesit si dhe të gjitha rastet e tjera **të keqpërdorimit të pozitës zyrtare, neglizhencës, mospunës**, rrezikimit të të drejtave të qytetarëve të Kosovës, apo rrezikimit të interesave të përgjithshme. Identiteti i qytetarëve të cilët raportojnë do të mbetet konfidencial dhe do të ruhet nga ekipi i www.kallxo.com, pa marrë parasysh a i kanë dhënë apo jo këta qytetarë shënimet lidhur me identitetin e tyre*⁴⁴⁴.

- I. Rasti gjyqësor i quajtur MTPT, me datën 27 korrik 2017, i cili udhëheqet nga gjyqtarja ndërkombëtare e EULEX-it, nuk i ka dorëzuar me kohë procesverbalet e seancave të kaluara. Kjo i ka shkaktuar probleme mbrojtjes, por arsyetimi i gjyqtarës Maria Tuma është se “*këto vonesa janë për shkak të disa çështjeve të brendshme lidhur me përkthyesit...madje e sugjeroi mbrojtjen e Limajt të mbajë shënime gjatë seancës, duke thënë se ashtu mund të përgatiten.*”⁴⁴⁵
- II. Seanca gjyqësor në rastin kundër rrëmbyesit të ish-bashkëshortes, me datën 10 shtator 2014 fillon me vonesë katër orë. “*Seanca duhej të niste në orën 10:00 por për shkak se anëtari i trupit gjykues-gjyqtari Agim Maliqi ndodhej në një takim, ajo u shty për orën 13:00. Por as në këtë orë pas kompletimit të trupit gjykues nuk filloi gjykimi, pasi i akuzuari Jakup Ramadani kërkoi që ta ndryshojë mbrojtësin e caktuar sipas detyrës zyrtare me avokatin Agim Demiri. Kryetari i trupit gjykues Ibrahim Idrizi i dha afat të akuzuarit që deri në orën 14:00 të paraqitet në gjykatore me mbrojtësin e tij. Vetëm në orën 14:05 nisi seanca, pasi Idrizi konstatoi prezencën e të gjitha palëve në gjykatore.*”⁴⁴⁶
- III. Rasti kundër Astrit Haraqisë, ministër i Kulturës në vitet 2006-2007, kishte lidhur kontrata të kundërligjshme për financim të projekteve filmike dhe i ka shkaktuar dëm shtetit rreth 300 mijë euro. Lënda është parashkruar. *Hulumtimi i “Drejtësia në Kosovë” tregoi se Gjykata Themelore e Prishtinës dhe ajo e Apelit për 5 vjet nuk arritën të nxirrnin një vendim për këtë çështje, duke lejuar kështu që lënda ndaj*

⁴⁴⁴ <http://kallxo.com/dnk>, qasur me datë 19 tetor 2017.

⁴⁴⁵ <http://kallxo.com/limaj-ankohet-per-vonesen-e-procesverbaleve/>, qasur me datë 23 nëntor 2017.

⁴⁴⁶ <http://kallxo.com/fillon-me-vonesen-seanca-kunder-rrmbyesit-te-ish-bashkeshortes/>, qasur me datë 23 nëntor 2017.

*Haraqisë të endej herë në një të herë në tjetrën ndërtesë, pa një vendim përfundimtar.*⁴⁴⁷

6.6.2. Instituti i Kosovës për Drejtësi

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) është një organizatë jo-qeveritare e cila është themeluar në vitin 2009.

Në përshkrimin e saj që e bënë ajo vetë, paraqet qëllimin e saj “*për të siguruar pavarësi, paanshmëri dhe ngritje të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë*”⁴⁴⁸

Kështu, do të paraqiten disa raste të vlerësuara të profilit të lartë që janë paraqitur në raportet e rregullta që bënë IKD e që kanë të bëjnë me afatet.

- I. Rasti i cilësuar në emrin e njërit prej disa të akuzuarve, “*Ukë Rugova etj*”, i cili ka qenë në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Kosovës, i trajtuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë; për veprat penale: Krim i organizuar, kontrabandimi me migrantë, posedim i paautorizuar i armëve, ushtrim i ndikimit, mashtrim, keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, veprimet procedurale janë kryer jashtë çdo afati ligjor. “*Rasti Ukë Rugova, Astrit Haraçija dhe të tjerët ende është në fazën e shqyrtimit fillestar, edhe 10 muaj pas ngritjes së aktakuzës, duke u shkelur afatet ligjore të përcaktuara në KPPK*”⁴⁴⁹.
- II. Rasti i cilësuar “*Naser Osmani etj*”, në cilësinë e Deputetit të Kuvendit të Kosovës; i trajtuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë; për veprën penale: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, veprimet procedurale janë kryer jashtë çdo afati ligjor. Edhe pse shqyrtimi ka qenë i caktuar më 17 mars 2016 ai është shtyrë dhe “*Që nga*

⁴⁴⁷ <http://kallxo.com/flet-avokati-haraqise-per-lenden-e-parashkruar/>, qasur me datë 23 nëntor 2017.

⁴⁴⁸ <http://kli-ks.org/rreth-ikd/>, qasur me datë 23 nëntor 2017.

⁴⁴⁹ Instituti i Kosovës për Drejtësi, “*DETI*” I KORRUPSIONIT NË KOSOVË: “*Peshqit e vegjël kapen, të mëdhenjtë lihen të lirë (Raport vjetor i monitorimit të trajtimit të rasteve të korrupsionit në sistemin e drejtësisë në Kosovë-2016)*”, Prishtinë, mars 2016, f.31. (<http://kli-ks.org/wp-content/uploads/2017/04/1.1.-Raporti-i-Korrupsionit-IKD-28.03.2017-Compressed.pdf>, qasur me datë 16 gusht 2016).

6 maj 2016, deri në fund të shkurtit 2017 nuk është mbajtur asnjë seancë gjyqësore lidhur me këtë rast”.⁴⁵⁰

III. Rasti i cilësuar “Stenta”, i akuzuar Ministri i Shëndetësisë së Kosovës Ferid Agani dhe 62 persona tjerë, i trajtuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për veprat penale: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, marrje e dhënie e ryshfetit, trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor etj. “Kallëzimi penal në rastin “Stenta” është ngritur më 26 maj 2014, kurse aktvendimi për fillimin e hetimeve më 16 qershor 2014. Aktakuza është ngritur më 14 qershor 2016. Shqyrtimi fillestar në rastin “Stenta” është caktuar më 21 tetor 2016, respektivisht me tre muaj vonesë apo afatit të përcaktuar me KPPK. Seanca e fundit në rastin “Stenta” është mbajtur me 16 mars 2017, . Edhe kjo seancë gjyqësore është shtyrë për arsye se Aktakuza nuk iu është dorëzuar të gjithë personave të akuzuar. Karakteristikë për këtë rast është edhe seanca e shtyrë më 28 shkurt 2017”⁴⁵¹ . Ky rast akoma “është ende në shqyrtim fillestar në GjTh në Prishtinë, edhe përkundër faktit se aktakuza është ngritur në muajin qershor të vitit 2016, respektivisht kanë kaluar 9 muaj nga ngritja e aktakuzës”⁴⁵².

IV. Rasti i cilësuar “Salih Mekaj” në cilësinë e Kryetarit të Gjykatës së Apelit; e rst i cili është duke u trajtuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për veprën penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar etj. Ky rast ka vonesa të mëdha, në kundërshtim me afatet ligjore të përcaktuara. Kështu, “shqyrtimi fillestar është caktuar me vonesë prej pesë muaj nga dita e ngritjes së aktakuzës, respektivisht më 20 tetor 2016. Seanca e 20 tetorit 2016 është shtyrë për shkak të mungesës së të akuzuarit Mentor Seferaj i cili gjendet në paraburgim...”⁴⁵³.

⁴⁵⁰ Po aty, f.33.

⁴⁵¹ Po aty, f.34.

⁴⁵² Po aty, f.35.

⁴⁵³ Po aty, f.36.

6.6.2.1. Betimi për drejtësi

“Betimi për Drejtësi” është emision i specializuar për fushën e sundimit të ligjit, i cili prodhohet nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) – organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse dhe Radio Televizioni Publik i Kosovës (RTK).⁴⁵⁴

Pra, organizatat joqeveritare dhe e shoqërisë civile, me qëllim të paraqitjes dhe mbulimit sa më të madh të fushës së caktuar të gjyqësorit duke krijuar edhe medime-programe të caktuara televizive.

Lidhur me afatet dhe zbatimin e tyre gjatë proceseve gjyqësore në gjykata, kemi situata kur lëndë të caktuara penale arrijnë edhe parashkrimin absolut, ku ndodh të kemi tërheqje nga ndjekja penale duke u nxjerr Aktgjykim refuzues, dhe arsyet e arritjes së parashkrimit janë të ndryshme.

Rast i veçantë është ai gjyqtarese së Gjykatës Themelore në Prishtinë Sh.Sh. e cila akuzohej për veprën penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, lëndë e cila kishte arritur dyfishin e parashkrimit të ndjekjes penale.

Lënda pasi që në dhjetor 2016 ishte kthyer nga Gjykata e Apelit në rigjykim, nuk ishte mbajtur asnjë seancë gjyqësore për shkak të akuzuarit nuk ishte paraqitur në gjykatë. *Si pasojë e shtyrjeve të vazhdueshme, ka ardhur edhe deri te vjetërsimi i lëndës më 2 korrik 2017, ende pa u mbajtur asnjë shqyrtim gjyqësor pas kthimit të lëndës në rigjykim.*⁴⁵⁵

Apo për shkak të parashkrimit të arritur prokurori i cili e ka trashëguar lëndën penale *”arkëtim dhe pagesa të kundërligjshme”* nga prokurori i mëparshëm në shqyrtim gjyqësor ka hequr dorë nga ndjekja penale.

Kjo ka ndodhur me arsyetimin se:

“Në shkresat e lëndës kamë parë se aktvendimi për fillimin e hetimeve është nxjerrë me datë 02.03.2015. Në këtë mënyrë, ky aktvendim është nxjerrë pasi që ka kaluar afati 2 vjeçar nga koha e kryerjes së veprave penale për të cilat

⁴⁵⁴ <http://betimiperdrejtesi.com/rreth-nesh/>, qasur me datë 27 prill 2017.

⁴⁵⁵ Betimi për Drejtësi, *“Parashkruhet lënda penale ndaj ish-gjyqtarese Shemsije Sheholli”, 11 korrik 2017* (<http://betimiperdrejtesi.com/parashkruhet-lenda-penale-ndaj-ish-gjyqtarese-shemsije-sheholli/>, qasur me datë 18 gusht 2017).

akuzohen të pandehurit. Si rrjedhojë, në bazë të dispozitave ligjore, këto vepra penale janë parashkruar dhe unë tërhiqem nga aktakuza”⁴⁵⁶.

Pastaj rasti kur për shkak të arritjes së dyfishit të parashkrimit ligjor të veprës penale “legalizim të përmbajtjes të pavërtetë” gjykata ka nxjerr Aktgjykim refuzues.

Edhe pse kemi këtë pengesë ligjore, prokuroria në një rast të tillë është deklaruar se nuk pajtohet me këtë vlerësim të gjykatës dhe ka paralajmëruar ankesë. Bile atë aktgjykim refuzues e ka vlerësuar se është “marre e shtetit” dhe është e veçantë se i akuzuari ka qenë zyrtar i lartë i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë.⁴⁵⁷

Numri i këtyre lëndëve është trajtuar në masë të madhe dhe është temë e përditshme dhe e përsëritshme, por pa rezultate të dukshme. Kjo situatë kuptohet si normale nga krerët e organeve të ndjekjes, në këtë rast e prokurorisë së shtetit, e cila deklaron se:

“ 32.000 lëndë të vjetra të pas luftës dhe shumica prej tyre janë parashkruar. Mos t’ju brengos se mbi 10.000 lënë janë të parashkruara, të karakterit, të lëndëve të sjellura prej policisë së Unmikut, të cilat shumica nuk kanë përmbajtje penale, me kallëzime penale pa përmbajtje penale. Me këtë punë që kryejnë prokurorët mund të quhen “heronjë të Kosovës” ...⁴⁵⁸

⁴⁵⁶ Betimi për Drejtësi, “Vahide Badivuku kishte filluar hetimet jashtë afatit ligjor, prokurori Njazi Rexha tërhiqet nga aktakuza ndaj zyrtarëve të KEK-ut”, 1 nëntor 2016, (<http://betimiperdrejtesi.com/vahide-badivuku-kishte-filluar-hetimet-jashte-afatit-ligjor-prokurori-njazi-rexha-terhiqet-nga-aktakuza-ndaj-zyrtareve-te-kek-ut/>, qasur me datë 21 dhjetor 2016).

⁴⁵⁷ Betimi për Drejtësi, “Parashkruhet vepra penale “legalizim i përmbajtjes së pavërtetë” gjykata merr aktgjykim refuzues”, 16 maj 2017 (<http://betimiperdrejtesi.com/parashkruhet-vepra-penale-legalizim-i-permbajtjes-se-pavertete-gjykata-merr-aktgjykim-refuzues/>, qasur me datë 24 maj 2017).

⁴⁵⁸ Betimi për Drejtësi, Intervistë me Kryeprokurorin Imer Beka 30 mars 2016 (<https://www.youtube.com/watch?v=VASmpeeohNM>, qasur me datë 9 prill 2016).

6.6.3. Organizata Çohu

Organizata Çohu është themeluar në vitin 2005 e që qëllimin kryesor të saj e paraqet se *“është kufizimi i ndikimit të korrupsionit politik në institucionet publike të Kosovës”*⁴⁵⁹.

Në kuadër të angazhimit të kësaj organizate vend të rëndësishëm zë edhe fusha e hulumtimeve përmes monitorimit të sistemit gjyqësor, si gjykatës ashtu edhe prokurorisë dhe plasimi i punës së tyre në publik.

Lidhur me afatet ligjore, me rëndësi të madhe dhe një analizë të mirë kemi në raportin që ka nxjerr kjo organizatë mbi monitorimin e parashkrimit të ndjekjes penale dhe parashkrimit të ekzekutimit të dënimeve nga gjykatat themelore të Republikës së Kosovës për periudhën kohore 2001-2013.

Sipas këtij raporti, më së shumti lëndë të cilat janë parashkruar në këtë periudhë kohore të gjatë kohore kemi në Gjykatën Themelore të Prizrenit ku janë gjithsej 2260 lëndë të parashkruara.

Pastaj e është Gjykata Themelore e Ferizajt me gjithsej 1292 lëndë të parashkruara.

E treta është Gjykata e Rahovecit me gjithsej 1114 lëndë të cilat janë parashkruar. Në vazhdim shikoni tabelën nr.7 ku paraqiten të dhënat për secilin gjykatë të Kosovës.

⁴⁵⁹ <http://www.cohu.org/sq/per-ne>, qasur me datë 14 maj 2016.

Afatet dhe zbatimi i tyre në procedurën penale në Kosovë

	Parash. Relativ	Parashkrim Absolut	Ekzekutime Penale	Numri total i lëndëve të parashkruara 2001-2013
Gjykata Themelore e Prishtinës	104	414	105	623
- dega Lipjan	-	27	57	84
- dega Podujeva	18	467	-	485
- dega Gllogoc	1	5	-	6
e Prizrenit	500	1760	-	2260
- dega Suharekë	61	175	-	236
- dega Dragash	1	12	17	301
e Pejës	380	73	22	475
- dega Klinë	1	48	537	586
- dega Istog	418	303	-	721
- dega Deçan	510	9	27	546
e Gjilanit	4	132	-	136
- dega Kamenicë	84	83	91	258
- dega Viti	-	90	-	90
- dega Novobërdë	4	11	5	20
e Ferizajit	442	834	16	1292
- dega Kaçanik	3	318	26	347
- dega Shtërpçë	-	19	5	24
e Gjakovës	146	39	411	596
- dega Rahovec	395	564	155	1114
- dega Malishevë	79	218	40	337
e Mitrovicës	8	11	-	19
- dega Vushtrri	-	185	-	185
- dega Skenderaj	1	33	-	34
TOTALI	3160	5930	1514	10504

Tabela 7: Parashkrimi i shqyrtimit të lëndëve dhe ekzekutimit të dënimeve 2001/2013 në gjykatat themelore dhe degët e tyre.⁴⁶⁰

⁴⁶⁰ Raport Monitorues: Parashkrimi i ndjekjes penale dhe parashkrimi i Ekzekutimit të Dënimeve në Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës në vitet 2001-2013, Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe

Për të ilustruar raste të tilla të veprimtarive që bëjnë organizatat e ndryshme, është me rëndësi të paraqitet edhe rasti kur USAID në Shqipëri, së bashku me OSBE-në e kanë organizuar edhe Nismën e quajtur “*Drejtësi pa Vonesë*”.

Arsyeja e kësaj nisme ka qenë mosefikasiteti i institucioneve të shtetit, prokurorisë dhe gjykatës për zgjidhjen e çështjeve në afat ligjor, i cili pa dyshim që qon edhe në zhgënjimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë edhe në Shqipëri.

Me datën 25 maj 2016 në Shkodër është mbajtur ky takim, ku ishin prezent përveç ambasadorëve të jashtëm aktorët kryesor të sistemit të drejtësisë, ministri i Drejtësisë Ylli Manjani, përfaqësues të lartë të sektorit të drejtësisë dhe Kryetarët e Gjykatave të Apelit, të Gjykatave të Rrethit dhe Administrative. Në komunikatën për medie thuhet se “*në 2013 OSBE dhe Projekti i USAID JuST bashkuan përpjekjet për të filluar Nismën “Drejtësi pa Vonesë”, ...për të ndihmuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe vetëm pas pak muajsh zbatimi, Gjykata prodhoi rezultate domethënëse në bërjen e gjykimeve më efektive. Ka patur një ulje thelbësore në numrin e seancave gjyqësore jo produktive, numri mesatar i seancave gjyqësore për çështje ra në mënyrë domethënëse, dhe numri i çështjeve të zgjidhura nga çdo gjyqtar pothuajse u dyfishua. Nisma u shtri më pas në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë në 2014, dhe në Gjykatat e Pukës dhe Tropojës në 2015. Gjyqtarët dhe stafi mbështetës, nën udhëheqjen e partnerëve ndërkombëtarë dhe lokalë analizojnë arsyet e origjinës për vonesat në gjykatën e tyre dhe angazhohen për një planifikim dhe administrim të përmirësuar të çështjeve duke forcuar bashkëpunimin me pjesëmarrësit në gjykim, përfshirë institucionet shtetërore.*”⁴⁶¹

Në këtë rast, ministri se “*Nëse gjykata shërben me vonesë, atëherë ky ekuacion del negativ. Gjykata duhet të shërbejë shpejt, sepse ku ka vonesë ka korrupsion. Njerëzit janë të prirur që nëse vonohet gjyqi, d.m.th se ka korrupsion dhe dikush po shkëmben para në emër të drejtësisë që po vonohet...*”⁴⁶².

Dinjitet, Çohu, Prishtinë, 2014, f.16. (http://www.cohu.org/repository/docs/Parashkrimi_2001-2013_cohu_735470.pdf, qasur me datë 16 mars 2015).

⁴⁶¹ <https://www.usaid.gov/node/206921>, qasur me datë 30 maj 2016.

⁴⁶² <http://www.drejtesia.gov.al/al/newsroom/lajme/ministri-i-manjani-merr-pjese-ne-prezantimin-e-nismes-per-nje-drejtessi-pa-vonesa&page=1>, qasur me datë 30 maj 2016.

67. PËRFUNDIME:

Gjatë trajtimit të rolit dhe ndikimit të disa prej Institucioneve Publike, Organizatave joqeveritare dhe mediave në punën efikase të gjyqësorit, kanë dalë disa përfundime:

Gjykata Kushtetuese-

- Afati i paraqitjes së kërkesës:
 - Brenda katër (4) muajve pasi qytetarit i është dorëzuar vendimi gjyqësor i shkallës së fundit.
- Afati për kthimin në gjendjes e mëparshme:
 - Pesëmbëdhjetë (15) ditë nga momenti i mënjanimit të pengesës që ka shkaktuar humbjen e afatit.
 - Në çfarëdo rrethane më së largu një (1).
- Procedimi i kërkesës së paraqitur:
 - Pala kundërshtare ka afatin dyzet e pesë (45) ditë nga momenti i pranimi të kopjes së kërkesës për të paraqitur përgjigje në kërkesë.
 - Tridhjetë (30) ditë kur gjyqtari raportues i dërgon kolegjit shqyrtues raportin për kërkesën dhe përgjigjen në kërkesë të palëve të interesuara.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës-

- Afati për të paraqitur ankesë është çdo herë.

Këshilli Prokurorial i Kosovës-

- Afati për të paraqitur ankesë është çdo herë.

Avokati i Popullit-

- Afati për të paraqitur ankesë është çdo herë.

Medie-

- Afati për të paraqitur ankesë është çdo herë.

KAPITULLI VII

7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

7.1. Përfundimet:

Pa dyshim që trajtimi i afateve ligjore në procedurën penale në Republikën e Kosovës në fund duhet nxjerr përfundime të përcaktuara saktë.

Është parë gjatë trajtimit të temës se ka çështje të cilat nuk janë të përcaktuara në mënyrë të saktë, në mënyrë precize, që nuk prodhojnë qëndrime të sakta, e të cilat qëndrime rrjedhin nga interpretimet e lira dhe jo në harmoni me vetë qëllimin e normës së caktuar juridike.

Mund të themi se më me rëndësi gjatë tërë punimit janë afatet që kanë të bëjnë me çështjen e hetimit penal dhe privimit nga liria, e që prekun dhe çënojnë më së shumti të drejtat dhe liritë e njeriut, dhe që pasojat janë shumë të mëdha, si për vetë individin ashtu edhe për rrethin e tij.

Andaj, krahas përfundimeve që janë paraqitur nëpër secilin kapitull e që ka rezultuar gjatë trajtimit-shtjellimit të tezës këtu do të paraqiten më përbledhëset, e që paraqesin edhe vetë temën e punimit.

Përfundimet në vijim janë konstatuese të asaj ashtu si janë të përcaktuara me ligj, ashtu si janë vendosur me qëndrime dhe kontatime juridike dhe ashtu si duhet zbatuar.

1. Afati i përcaktuar me afatin kohor-orë llogaritet nga ora e parë vijuese prej momentit kur ka ndodhur ngjarja. Në rastet tjera kur afati ka të bëjë me ditë, atëherë afati llogaritet nga dita e parë vijuese prej momentit kur ka ndodhur ngjarja. Kur afatet janë të caktuara me muaj apo vite, atëherë afati llogaritet në muajin apo vitin e fundit, fundi i ditës së njëjtë të muajit prej kur ka filluar afati. Në këto raste, nëse një ditë e tillë nuk ekziston në muajin e fundit, afati do të llogaritet në ditën e fundit të atij muaji. Kur kemi të bëjmë me afate të cilat llogariten me ditë dhe dita e fundit e afatit i bie në ditë të festave zyrtare apo ditëve të shtuna dhe të diela apo në ndonjë ditë tjetër kur pranuesi-organi kompetent, prokuroria, gjykata etj nuk punojnë, atëherë në afat llogaritet edhe dita pasuese e punës, pikërisht fundi i ditës pasuese.

2. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka nxjerr Udhëzimin A.nr.258/2016 me datën 29 prill 2016 me të cilin ka obliguar të gjithë prokurorët e shtetit “...që brenda afatit prej tre (3) muajsh, nga dita e pranimit të kallëzimit penal nëse i njëjti me aktvendim nuk është hudhur, të nxjerret aktvendimi për fillimin e hetimit”.
3. Kolegjiumi i Gjykatës Supreme, në Mbledhjen (Seancën) e Përgjithshme të datës 29.09.2016 ka nxjerr Mendimin Juridik duke vendosur që: “Prokurori i shtetit, brenda 30 ditësh duhet të vendos: për informacione shtesë, për aplikimin eventual të masave të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit, hedhjen e kallëzimit penal, apo për fillimin e hetimit”.
4. Hetimi përfundon dy (2) vite nga momenti kur hetimi është filluar/është dashtë të fillohet edhe nëse nuk ka Aktvendim për fillim të hetimeve. Në raste të veçanta, hetimi mund të zgjatet edhe gjashtë (6) muaj të tjerë, dmth maksimum dy (2) vite e gjysmë.
5. Personit të arrestuar i cili ndalohet i lëshohet vendim i shkruar për arrestimin e tij brenda afatit gjashtë (6) orë nga momenti i arrestimit. Arrestimi dhe ndalimi i fëmijës nuk mund të kalojë periudhën kohore më shumë se njëzetekatër (24) orë.
6. Kërkesa për caktimin e masës së caktuar të sigurisë duhet të ushtrohet brenda njëzetë e katër (24) orëve nga momenti i arrestimit të personit dhe fillimi i seancës dëgjimore në gjykatë duhet të fillojë brenda dyzetë e tetë (48) orë prej momentit të arrestimit. Gjykata vendimin e saj lidhur me masën e sigurisë e vendos brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i përfundimit të seancës dëgjimore.
7. Udhërrësit si mjet sigurie i personit, efekti i zbatueshmërisë i kalon në mesnatën e ditës së treqind e gjashtëdhjetë e pestë (365), nga dita e lëshimit të tij.
8. Shqyrtimi fillestar duhet të fillojë brenda afatit tridhjetë (30) ditë nga ngritja e aktakuzës, kurse në rastin kur i pandehuri gjendet në paraburgim në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditë nga ngritja e aktakuzës. Shqyrtimi i dytë mbahet jo me herët se tridhjetë (30) ditë dhe jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e mbajtjes së shqyrtimit fillestar.
9. Fillimi i shqyrtimit gjyqësor duhet të fillojë një (1) muaj nga data e lëshimit të urdhrin të fundit lidhur me kundërshtimin e provave apo kërkesës për hudhje të aktakuzës (*e që në praktikë një gjë e tillë nuk ndodh pothuajse kurrë*). Për të miturit shqyrtimi gjyqësor duhet të caktohet brenda tetë (8) ditëve prej momentit të pranimit të propozimit.

10. Shqyrtimit gjyqësor duhet të përfundojë brenda afatit nëntëdhjetë (90) ditë nëse çështja është duke u gjykuar nga gjyqtari i vetëm gjykues, kurse njëqindnjëzet (120) ditë nëse është duke u gjykuar nga trup gjykues. Kur ka shtyrje më të gjatë se tre (3) muaj të shqyrtimit apo ndërprerje të shqyrtimit më shumë se tetë (8) ditë, shqyrtimi gjyqësor duhet të rifillojë. Zgjatja e afateve për përfundim të shqyrtimit gjyqësor mund të bëhet deri në tridhjetë (30) ditë dhe mund të përsëritet. Dmth nuk ka afat përfundimtar.
11. Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor duhet të përpilohet menjëherë në momentin e kryerjes së veprimit procedural gjyqësor. Në rast se veprimet procedurale kryhen në mënyrën audio ose video procesverbali duhet të përpilohet në afatin prej tre (3) ditësh. Ky afat mund të shtyhet deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë.
12. Shpallja e aktgjykimit bëhet më së largu tre (3) ditë prej momentit të seancës gjyqësore me të cilën është shpallur i përfunduar gjykimi, kurse vendimi përpilohet brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditë nga momenti i shpalljes së tij në rastet kur i akuzuari i gjykuar është shpallur fajtor dhe gjendet në paraburgim. Në rast se i akuzuari nuk gjendet në paraburgim afati për përpilimin e aktgjykimit është tridhjetë (30) ditë. Në rastet tjera më të ndërlikuara, me leje të kryetarit të gjykatës përpilimi i aktgjykimit mund të zgjatet deri gjashtëdhjetë (60) ditë. Për të miturit, përpilimi i vendimit gjyqësor duhet të bëhet brenda tetë (8) ditësh nga momenti i shpalljes së tij, kurse në çështjet më të ndërlikuara më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë nga momenti i shpalljes.
13. Afati për paraqitjen e kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të Gjykatës Supreme është katër (4) muaj nga momenti kur qytetarit i është dorëzuar vendimi gjyqësor i shkallës së fundit. Kurse, afati për kthimin në gjendjen e mëparshme është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga momenti i mënjanimin të pengesës e cila ka shkaktuar humbjen e afatit. Në çfarëdo rrethane, afati për kthimin në gjendjen e mëparshme skadon pas një (1) muaji.

Përfundim përmbyllës:

- 1/. Afatet gjatë zhvillimit të procedurës penale nuk zbatohen dhe në këtë mënyrë shkelen të drejtat dhe liritë themelore e njeriut, duke paraqitur një sistemi të drejtësisë të pasigurt, me vendime të ndryshme/jounike për situatë të njëjtë juridike.
- 2/. Moszbatimi i afateve ka krijuar dilema në interpretim të dispozitave ligjore në mes palëve në procedurë dhe në këtë mënyrë gjykata shpesh e humb rolin e arbitrit të drejtë, duke shpërfaqë injorancën, paprekshmërinë, kapadaillekun karshi qytetarit dhe imunitetin e heshtur nga ndjekja penale për mosrespektim/moszbatim të afatit.
- 3/. Moszbatimi i Vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe po ashtu edhe Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, përtej pasigurisë juridike vihet në diskutim edhe kompetenca e këtyre Institucioneve nga cילו prokuror dhe gjyqtar.

7.2 Rekomandimet:

Përfundimet e cekura më lartë sjellin edhe detyrimin për paraqitjen e disa rekomandimeve që prekin drejtpërdrejt çështjen e afateve dhe zbatimit të tyre në procedurën penale:

1. Nuk duhet të ekzistojë Instituti i ndërprerjes së parashkrimit të ekzekutimit të dënimit, sepse në këtë mënyrë do të ketë arbitraritet nga ana e Institucioneve të Shtetit.
2. Duhet të krijohet një grup punues në përbërje me prokurorë, gjyqtarë, profesorë dhe të përpilohet Komentari i Detajuar i Kodit Penal dhe Procedural i Kosovës, ku secila dispozitë ligjore e tyre të mbështetet me raste praktike, për secilën formë të kryerjes dhe element përbërës i dispozitës.
3. Të aplikohet ndjekje penale për ata që nuk i zbatojnë me qëllim afatet dhe vendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës.

REFERIMET

I. BURIMET PARËSORE:

Kode, Ligje etj:

1. COUNCIL JOINT ACTION 2008/124/CFSP of 4 February 2008 on the European Union Rule of Law Mission in Kosovo, EULEX KOSOVO, Official Journal of the European Union, Bruksel, 2008.
2. COUNCIL DECISION (CFSP) 2018/856 of 8 June 2018 amending Joint Action 2008/124/CFSP on the European Union Rule of Law Mission in Kosovo (EULEX KOSOVO), Official Journal of the European Union, Bruksel, 2008.
3. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Gjenevë, 1948.
4. Kodi i Drejtësisë për të Mitur, Prishtinë, 2010.
5. Kodi i Drejtësisë për të Mitur, Prishtinë, 2018.
6. Kodi penal i Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1995.
7. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2013.
8. Kodi i Procedurës Penale, i pasuruar me praktikë Gjyqësore, Botues Alb-juris, Tiranë, 2017.
9. Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, Prishtinë 2013.
10. Kodi Penal i Kosovës, Prishtinë, 2004 dhe 2013.
11. Kodi Penal i Zvicrës, 1937.
12. Kodi Penal i Sllovenisë, 2008.
13. Kodi Penal i Gjermanisë, 1998.
14. Kodi Penal i Filipineve, 2016.
15. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokolet e saj, 1950.
16. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokolet e saj, 1976.
17. Konventa për të Drejtat e Fëmijës, 1990.

18. Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, 1993.
19. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2008.
20. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1998, ndryshuar 2007 dhe 2008.
21. Ligji nr.7895 i Kodit Penal të Republikës Së Shqipërisë, Tiranë, 1995.
22. Ligji nr.8116 i Kodit të Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1996.
23. Ligji nr.9381 për kompensimin e burgimit të padrejtë, Tiranë, 2005.
24. Ligji nr 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Prishtinë, 2015.
25. Ligji nr.03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, Prishtinë, 2008.
26. Ligji nr.04/L-076 për Policinë, Prishtinë, 2012.
27. Ligji nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2008.
28. Ligji nr.03/L-199 për Gjykatat i Kosovës, Prishtinë, 2010.
29. Ligji nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Prishtinë, 2010.
30. Ligjin nr.03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Prishtinë, 2010.
31. Ligji nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, Prishtinë, 2013.
32. Ligji nr. 05/l-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, Prishtinë, 2016.
33. Ligji nr. 06/l – 057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Prishtinë, 2019.
34. Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës nr.565/13, datë 19 shtator 2013.
35. Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës nr.219/2015, datë 10 korrik 2015.
36. Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës nr.582/2016, datë 29 shtator 2016.
37. Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës nr.583/2016, datë 29 shtator 2016.
38. Qarkore e Gjykatës Supreme të Kosovës, GJ.A.nr.459/2014, dt 04 dhjetor 2014.
39. Qarkore lidhur me masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit i Gjykatës Supreme të Kosovës nr.12/2015, datë 12.01.2015.

40. Qëndrimi Parimor Agj.nr.314/2012 i Gjykatës Supreme të Kosovës, datë 10 shtator 2012.
41. Rregullorja e punës e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr.50/2015, 3 mars 2015.
42. Rregullorja e punës e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr.01/2018, e datës 31 maj 2018.
43. Rregullorja nr.04/2016 për përcaktimin e sjelljeve të pahijshme e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, 3 mars 2016.
44. Rregullorja UNMIK nr.1999/1, 25 qershor 1999.
45. Rregullorja UNMIK nr.1999/24, 12 dhjetor 1999.
46. Rregullorja UNMIK nr.1999/25, 12 dhjetor 1999.
47. Rregullore (p) nr. 02/2017 për kriteret dhe procedurat për faljen e personave të dënuar, Republika e Kosovës-Presidenti, Prishtinë, 2017.
48. Rregullore e Këshillit Prokurorial i Kosovës, nr.04/2019 për procedurën e ndërmjetësimit të rasteve nga prokuroria, Prishtinë, 2019.
49. Udhëzimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit lidhur me veprimet e prokurorëve në lidhje me sendet e sekuestruara dhe të konfiskuara përkohësisht apo për pasurinë për të cilën është lëshuar urdhri për ngrirje, A.nr.4/2014, datë 14 janar 2014.
50. Udhëzimi Administrativ 2008/2 e datës 17 janar 2008, që ka të bëjë me zbatimin e rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/25 mbi kornizën rregullative për sistemin e drejtësisë në Kosovë.
51. Udhëzimi Administrativ (04/2015) nr.01/656, datë 10.11.2015 për zbatimin e procedurës për kompensimin e dëmit për personat e dënuar osë të arrestuar pa arsye.
52. Udhëzimi nr.3 i Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, për përmirësimin e punës dhe kontrollit të prokurorit në ndjekjen penale, datë 08 mars 2007.
53. Udhëzim i Zyrës së Kryeprokurorit të shtetit lidhur me zbatimin e nenit 96 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës për masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit, A.nr.442/2015, datë 22 tetor 2015.
54. Udhëzimi i Zyrës së Kryeprokurorit të shtetit A.nr.258/2016, datë 29 prill 2016.

55. UNMIK/REG/2001/9, 15 MAY 2001, Regulation No.2001/9 On a constitutional framework for provisional self-government in Kosovo, Chapter 14, Final Provisions, 14.1.
56. Vendim Unifikues Penal nr.3, datë 27.03.2003, Gjykata e Lartë, Tiranë.

II. BURIMET DYTËSORE:

Monografi, Libra etj:

1. Bedi, Monu, The curious case of cell phone location data: Fourth amendment doctrine mash-up, Northwestern University Law Review, 2015.
2. Brown, Gordon (Ed.), The Universal Declaration of Human Rights in the 21st Century: A Living Document in a Changing World. Cambridge, UK: Open Book Publishers, 2016.
3. Çollaku, Hashim, Prokurori publik në procedurën penale (aspekti teorik dhe praktik), Prishtinë, 2010.
4. Çollaku, Hashim, Roli i prokurorit të shtetit në procedurën penale, Bot.2, Prishtinë, 2013.
5. Darpö, Jan, Principle 10 and Access to Justice, Elgar Encyclopedia of Environmental Law – Principles of Environmental Law, Volume VI., Uppsala, 2017.
6. Doracaj, Bledar, Vështrim i përgjithshëm në mekanizmin kundër torturës dhe trendi i tij në vitet e fundit, The Heritage, Revistë Shkencore, Universiteti Ndërkombëtar i Strugës, Nr.11/2013, Strugë, 2013.
7. Dervishi, Albert & Selita, Arjan, E drejta e Policisë, Tiranë, 2004.
8. Elezi, Ismet & Kaçupi, Skënder & Haxhia, R. Maksim, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2006.
9. Faiz, Mohamad, Pan, The Protection of Civil And Political Rights by The Constitutional Court of Indonesia, Indonesia Law Review, 2016.
10. Fionnuala N. Aolain, *The Fractured Soul of the Dayton Peace Agreement: A Legal Analysis*, 19 Mich. J. Int'l L. 957 (1998).

11. Gadda, Andressa, Rights, foucault and power: A critical analysis of the United Nation Convention on the Rights of the Child, Edinburgh Working Papers in Sociology No. 31, University of Edinburgh, January 2008.
12. Galbraith, Jean, "Deadlines as Behavior in Diplomacy and International Law" (2015). *Faculty Scholarship*. Paper 1560.
13. Guillén, Margarita & Lareu, Victoria, María & Pestoni, Carmela & Salas, Antonio & Carracedo, Angel, Ethical-legal problems of DNA databases in criminal investigation, *Journal of Medical Ethics* 2000.
14. Grabowski, Andrzej, Juristic Concept of the Validity of Statutory Law: A Critique of Contemporary Legal Nonpositivism, *Springer Science & Business Media*, London, 2013.
15. Gruda Përparim, E drejta për një process të rregullt ligjor në Kushtutën e Kosovës, *Revistë Shkencore JURIDICA*, Prishtinë, 2015.
16. Hajdari, Azem, Procedura Penale, Komentar, Prishtinë, 2010.
17. Hajdari, Azem, E drejta e Procedurës Penale, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2014.
18. Hasani, Fejzullah, Konferenca ndërkombëtare e kryetarëve të gjykatave Supreme të Evropës Qendrore dhe Juglindore, Fjalimi "Reformimi i sistemit të drejtësisë në Kosovë", *Mal i Zi*, qershor 2013.
19. Haxhaj, Rafet, Kodi i etikës dhe sjelljes profesionale të gjykatësve në Kosovë rregull e moralit shoqëror apo instrument i rreptë ligjor, *Justica International Journal of Legal Sciences*, Vol.3, Tetovë, 2015.
20. Herbert Kraus, The Nuremberg Trial of the Major War Criminals: Reflections after Seventeen Years, 13 *DePaul L. Rev.* 233, 1964.
21. Hoxha, Dorina, Koha dhe e Drejta Penale, Disertacioni i Doktoraturës, Tiranë, 2003.
22. Hoti, Minir & Hajraj, Mentor, Ankesa kundër aktgjykimit të shkallës së pare, *Instituti Gjyqësor i Kosovës, Justicia*, Prishtinë, 2011.
23. Imbrisevic, Miroslav, Why is (Claiming) Ignorance of the law no excuse?, Why is (Claiming) Ignorance of the Law no Excuse? *Review Journal of Political Philosophy* 8, 2010.

24. Kursani, Shpend, Përgjimi ligjor i telekomunikimeve në Kosovë: Implikimet për sigurinë, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, Prishtinë, 2011.
25. Macovei, Monica, E drejta për lirinë dhe sigurinë e personit, Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Manuali e të drejtave të njeriut, Nr.5, Strasburg, 2002.
26. Macken, Claire, Preventive detention and the right of personal liberty and security under the International Covenant on Civil and Political Rights, 1966, *Adelaide Law Review, School of Law, The University of Adelaide*, SA, 2005.
27. Mauer, Marc & Chesney-Lind, Meda, INVISIBLE PUNISHMENT, The Collateral Consequences of Mass Imprisonment, New York, 2002.
28. Manual për mbrojtjen penale ndërkombëtare, Praktikat e zhvilluara nga SHAM-TPNJ, Përgatitur në kuadrin e Projektit të Drejtësisë për Krime Luftës, Itali, 2011.
29. Milutinović, Milan, Politika Kriminale, Rilindja, Prishtinë, 1987.
30. Musaraj, Jonida, “Çështje të aksesit në drejtësi dhe të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm në kuadrin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Përvoja shqiptare në vështrim të krahasuar”, Punim i doktoraturës, Tiranë, 2016.
31. Qerimi, Qerimi & Istrefi, Remzije & Sylejmani, Flakron, Përmbledhje e marrëveshjeve dhe instrumenteve ligjore ndërkombëtare, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH dhe Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK), Prishtinë, 2016.
32. Rao, Sreedhar, K., Criminal Justice System-Required reforms, Journal of The Indian Law Institute, Vol.43, April-June 2001, no.2.
33. Reza, Bhatara, Ibnu, Arbitrary Arrest and Detention: Excuses for Emergency Conditions and Terrorism, Human Rights and the Indonesian Security Sector: 2009, Almanac, Gjenevë, 2009.
34. Susuri, Besim, Mosrespektimi i afateve dhe efikasiteti i procedurës penale, Justica, revistë shkencore, Viti III, nr3-2011, Prishtinë, 2011.
35. Skenderaj, Klodian & Hoxha, Artan, Perspektivat e legjislacionit procedural penal shqiptar në kuadrin e integritetit në Bashkimin Europian, Revista Shkencore

- “Politikja”, nr.1, Shqipëria dhe Evropa në një këndvështrim politik, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Tiranë, pa vit botimi.
36. Smibert, Jon, Udhëzues për Kodin e Procedurës Penale të Kosovës dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Departamenti i Drejtësisë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Zyra e Zhvillimit dhe Trajnimit të Prokurorëve Tejoqeanik, Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë, 2013.
37. Sopjani, Enver, Përmbledhje aktesh ndërkombëtare për Kosovën 1999-2004, Prishtinë, 2005.
38. Sopjani, Enver, Roli politiko-ushtarak dhe policor i bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë nga viti 1999, A ka “dështuar me sukses” bashkësia ndërkombëtare?, Prishtinë, 2011.
39. Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep, E drejta e Procedurës Penale, Prishtinë, 2013.
40. Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep, E drejta e Procedurës Penale, Prishtinë, 2016.
41. Sahiti, Ejup, E drejta e Procedurës Penale, Prishtinë, 2005.
42. Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep & Elshani, Xhevdet, Komentar, Kodi i Procedurës Penale, Botimi I, Prishtinë, 2014.
43. Salihu, Ismet, E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2003.
44. Salihu, Ismet & Zhitija, Hilmi & Hasani, Fejzullah, Kodi penal i Republikës së Kosovës, Komentar, Bot.I, Prishtinë, 2014.
45. Salihu, Ismet, E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2015.
46. Sijerçiq-Çolliq, Hajrija & Haliloviq, Haris, E drejta e procedurës penale, me vështrim të posaçëm në procedurën penale të Kosovës, Prishtinë, 2007.
47. Tiberg, Hugo, Compensation for wrongful imprisonment, Stockholm Institute for Scandianvian Law 1957-2010, Stockholm, 2010.
48. William’s, Paul R, Procesi i hartimit të Kushtetutës, Prezantim në Tryeza e rrumbullakët e parlamentarëve dhe ekspertëve për çështjet kushtetuese, Public International Law & Policy Group, Prishtinë, 2006.
49. Xhambazi, Minire, Ekzekutimi i burgimit për të mitur, Prishtinë, 2018.
50. Zahiti, Bashkim I., E drejta Evropiane, Botimi i tretë, Prishtinë, 2013.

Udhëzues të ndryshëm, Publikime tjera:

1. Council of Europe, Protecting witnesses of serious crime/ Këshilli i Evropës, Mbrojtja e dëshmitarëve të krimeve të rënda, Prishtinë, 2006.
2. Drejt drejtësisë, Analizë e procesit civil në gjykatat e rretheve gjyqësore, OSCE, Shqipëri, 2013.
3. European judicial systems Efficiency and quality of justice, CEPEJ Studies N°20, Edition 2014 (2012 Data), Council of Europe.
4. E drejta për “Gjykim të Drejtë”, Monitorimi i seancave gjyqësore të ndërlidhura me rastet e korrupsionit dhe shpërdorimit të autoritetit publik, Lëvizja “FOL”, Prishtinë, dhjetor 2010.
5. E drejta për proces të rregullt dhe rihapja e proceseve penale, Manual trajnimi mbi nenin 6-të KEDNJ-së, Tiranë, 2017.
6. Doracak trajnimi për avokatët në fushën e drejtësisë për fëmijë, Oda e Avokatëve të Kosovës, Prishtinë, 2012.
7. Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Ministria e Drejtësisë, Bot.3, Prishtinë, 2009.
8. Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Ministria e Drejtësisë, Prishtinë, 2015.
9. Doracku i Gjyqtarëve për procedurën penale, Instituti Gjyqësor i Kosovës, Prishtinë, 2015.
10. Fjalim i Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese Shqiptare Bashkim Dedja, Konferenca Ndërkombëtare e mbajtur në Indi, 9-12 dhjetor 2011.
11. FDHK-Kosovë-Raporti për vitin 2016, “Koha Kalon, Drejtësia për krime lufte zbehet”, përgatitur nga Anka Kurteshi-Hajdari, Prishtinë, 2017.
12. Fletorja zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Botimi i Qendrës së Publikimeve, Akte të papublikuara të vitit 1996, Tiranë, 2008.
13. Instituti për hulumtimin e krimeve të luftës, “Sfidat e hulumtimit të krimeve të luftës në Kosovë 1998-1999, përmbledhje e punimeve të konferencës ndërkombëtare Prishtinë 16 dhjetor 2011, Prishtinë, 2013.

14. Instituti i Kosovës për Drejtësi, “DETI” I KORRUPSIONIT NË KOSOVË:
”Peshqit e vegjël kapen, të mëdhenjtë lihen të lirë (Raport vjetor i monitorimit të trajtimit të rasteve të korrupsionit në sistemin e drejtësisë në Kosovë-2016), Prishtinë, mars 2016.
15. Institucioni i Avokatit të Popullit, Raporti vjetor 2016, Nr.16, Prishtinë, 2017.
16. Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me Shqipërinë deri në fund të 2015-es; Përgatitur nga Qendra AIRE në bashkëpunim me zyrën e Agjentit Qeveritar të Shqipërisë para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; AIRE Centre, (Advice on Individual Rights in Europe), pa vit dhe vend botimi.
17. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Strategjia kombëtare për reduktimin e lëndëve të vjetra, Gusht 2013.
18. Kuptimi i të drejtave të njeriut doracak mbi arsimimin për të drejtat e njeriut, Qendra Evropiane e Trajnimit dhe Hulumtimit për të Drejtat e Njeriut dhe Demokraci, Grac, 2003.
19. KORRUPSIONI NË KOSOVË 5: Raport vlerësues periodik mbi efikasitetin e sistemit prokurorial në zbatimin e planit të veprimit për rastet e korrupsionit, Instituti i Kosovës për Drejtësi, 2015.
20. KCSS, Rithemelimi dhe reformimi i sistemit të drejtësisë në Kosovë 1999-2011, Analizë Kontesti, Prishtinë, 2011.
21. Njësia për Shqyrtimin e Performancës Gjyqësore, Raporti nr.2011/01, “Rishikimi i procesit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe dënimit me gjobë të lëndët e pa ekzekutuara dhe të parashkruara/pezulluara”, Prishtinë, 2012.
22. Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë: Shqyrtim dhe analizë gjithëpërfshirëse e brengave të mbetura, OSCE, Prishtinë, 2010.
23. Përmbledhje ligjore e të drejtave ndërkombëtare për gjykim të drejtë, OSCE, Prishtinë, 2013.
24. Professional Training Series No.9, Human Rights in the Administration of Justice: A Manual on Human Rights for Judges, Prosecutors and Lawyers, United Nation, New York and Geneva, 2003.

25. Protecting witnesses of serious crime, Council of Europe, September 2006.
26. Raport alternativ për konventën e të drejtave të fëmijëve të OKB-së, Revista 26, *Shqipëria*, Tiranë, 2006.
27. Shqyrtim i zbatimit të kodit të ri të procedurës penale në Kosovë, OSCE, qershor 2016, Prishtinë.
28. Të drejtat e njeriut në administrimin e drejtësisë, Një doracak mbi të drejtat e njeriut për gjykatësit, prokurorët dhe avokatët / Human Rights in Administration of Justice: A manual on human rights for Judges, Prosecutors and Lawyers, Prishtinë, 2002.
29. Të drejtat e njeriut: Përmbledhje e instrumenteve ndërkombëtare, Vëllimi i parë, Përkthyes Ilir Dugolli, Prishtinë, 2004.
30. Të drejtat e njeriut dhe zbatuesit e ligjit, Broshurë mbi të drejtat e njeriut për Policinë, OSCE.

Raporte:

1. Raporti i Sekcionit të Monitorimit të Sistemit Ligjor (SMSL) dhe Shtylla e III e UNMIK-ut (Organizata për Siguri dhe Bashëpunim në Evropë-OSBE), Prishtinë, 2000.
2. RAPORT *mbi situatën e të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria në komisaritet e policisë së shtetit, në institucionet e paraburgimit dhe të ekzekutimit të vendimeve penale dhe në spitalet psikiatrike, Monitorimet janë realizuar gjatë periudhës Korrik 2015 – Janar 2016*, Komiteti shqiptar i Helsinkit, Pa vend dhe vit botimi.
3. Raporti vjetor i monitorimit të gjykatave 2011, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese – BIRN, Prishtinë, 2012.
4. Raporti Monitorues, “Parashkrimi i Ndjekjes Penale dhe Parashkrimi i Ekzekutimit të Dënimeve në Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës në vitet 2001-2013, Organizata për Demokraci, Anti-Korrupsion dhe Dinjitet, ÇOHU, Prishtinë, 2014.
5. Raporti i monitorimit të gjykatave 2016, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) dhe Interneës Kosova (I/KS), Prishtinë, 2016.

6. Raporti i auditimit efikasiteti i menaxhimit të lëndëve civile në gjykatat themelore, Zyra Kombëtare e Auditimit, Dokumenti nr: 24.18x.9-2015/16-08, Auditim i performances, Prishtinë, nëntor 2017.
7. Raporti i veçantë, Për situatën e krijuar nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, Republika e Shqipërisë, Avokati i Popullit, pa vend dhe vit botimi.
8. Report of the Secretary-general on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo for Security Council, S/1999/779, 12 july 1999.
9. Report of the Secretary-general on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo for Security Council, S/1999/787, 16 September 1999.
10. Report of the Secretary-general on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo for Security Council, S/2000/177, 3 mars 2000.
11. Report of the Secretary-general on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo for Security Council, S/2000/538, 6 qershor 2000.
12. Report of the Secretary-general on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo for Security Council, S/2000/878, 18 shtator 2000.
13. Report of the Secretary-general on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo for Security Council, S/2009/149, 17 mars 2009.
14. Report of the Secretary-general on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo for Security Council, S/2010/169, 6 prill 2009.
15. Report of the Secretary-general on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo for Security Council, S/2009/300, 10 qershor 2009.
16. Report of the Secretary-general on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo for Security Council, S/2010/562, 29 tetor 2010.
17. Report of the Secretary-general on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo for Security Council, S/2012/72 datë 31 janar 2012.
18. Report of the Secretary-general on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo for Security Council, S/2012/275 datë 27 prill 2012.
19. Report of the Secretary-general on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo for Security Council, S/2012/603 datë 3 gusht 2012.

20. Report of the Secretary-general on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo for Security Council, S/2013/72 4 shkurt 2013.
21. Shqyrtimi i Zbatimit të Kodit të Procedurës Penale në Kosovë, Raport i OSBE, Prishtinë, qershor 2016.
22. ИЗВЕШТАЈ од спроведеното истражување за појавите на сексуална злоупотреба и сексуална експлоатација на децата, НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ, одделение за заштита на правата на децата, Скопје/ RAPORT nga hulumtimi i realizuar për dukurinë e abuzimit seksual dhe eksploatimit seksual të fëmijëve/ AVOKATI I POPULLIT, Seksioni për mbrojtjen e fëmijëve, Shkup, 2012.

Jurisprudencë:

1. Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.8017/14, datë 9 janar 2015.
2. Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.1/2018 datë 30 maj 2018.
3. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.322/09 (P.nr.45/13), datë 18 tetor 2013.
4. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë, PAKR.nr.135/2013, datë 6 shkurt 2014.
5. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë, PAKR.nr.157/15, datë 28 maj 2015.
6. Aktgjykimi Gjykatës së Apelit në Prishtinë, PAKR.347/13, datë 18 gusht 2015.
7. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, PML-KZZ-242/15, datë 26 nëntor 2015.
8. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Pml.nr.195/2016, datë 26 shtator 2016.
9. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës PML.nr.154/2017, datë 27 qershor 2017.
10. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.162/17, datë 19 korrik 2017.

11. Aktvendimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë, PAKR 442/13, datë 2 prill 2014.
12. Aktvendimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Pn.nr.164/2017, datë 7 mars 2017.
13. Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, PN.1nr.2391/18, datë 13 dhjetor 2018.
14. Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, nr.ref.:RK 972/16, datë 8 gusht 2016.
15. Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës nr.ref.:RK nr.338/15, datë 1 mars 2017.
16. Aktvendimi i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.I.nr.75/2017, datë 14 korrik 2017.
17. Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, nr.338/15, datë 9 nëntor 2017.
18. Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PPR.nr.925/2107, datë 7 dhjetor 2017.
19. Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.393/15, datë 23 shkurt 2018.
20. Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.3717/2013, datë 26 shkurt 2018.
21. Aktvendimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë, PN.nr.268/18, datë 6 prill 2018.
22. Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PPRKR.nr.134/2019, datë 21 maj 2019.
23. Aktvendimi për Papranueshmëri i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, A.ref.:RK 864/2015, datë 1 dhjetor 2015.
24. Aktvendimi për Papranueshmëri i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës A.ref.:RK 1063/17, datë 15 maj 2017.
25. Aktvendimi për Papranueshmëri i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr.ref.:RK 1189/18, datë 30 janar 2018.
26. Çështja penale “MTPT” P.nr.8/13 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda.
27. Çështja penale PKR.nr.338/15, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda.

28. Çështja penale PPR.nr.371/17, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm.
29. Çështja penale P.nr.2507/2018, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm.
30. Kërkesa e Prokurorisë për caktim të paraburgimit PP/II.nr.219/17 e datës 7 dhjetor 2017.
31. Kërkesa e qytetarit K.H. drejtuar Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.2046/17, datë 26 qershor 2019.
32. Letër-rekomandim, nr.1051/2017 i Avokatit të Popullit, datë 14 korrik 2017.
33. Njoftimi Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PPRKR.nr.17/19, datë 03 qershor 2019.
34. Robert KERR against the United Kingdom, The European Court of Human Rights (Third Section), Application no. 40451/98, datë 7 dhjetor 1999.
35. Silver kundër Mbretërisë së Bashkuar, Vendimi i Gjykatës më 25 mars 1983, paragrafi 113.
36. Urdhëresa e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, nr.338/15, datë 9 nëntor 2017.
37. Urdhëri për ngrirje të përkohshme të aseteve i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i përgjithshëm, PP/II,nr. 3082/2017, datë 27 korrik 2017.
38. Vendimi Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, nr.76, datë 4 dhjetor 2017.
39. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë nr.20/2005, datë 10 korrik 2005.
40. Vendimi i Gjykatës së Lartë, Kolegji Penal, nr.88000-00714-00—2015 regj Themeltar, nr.00-2015-2685 i vendimit (168), Tiranë, datë 21 tetor 2015.

Intervista dhe reportazhe:

1. Betimi për Drejtësi, Intervistë me Kryeprokurorin Imer Beka 30 mars 2016.

2. Betimi për Drejtësi, “Vahide Badivuku kishte filluar hetimet jashtë afatit ligjor, prokurori Njazi Rexha tërhiqet nga aktakuza ndaj zyrtarëve të KEK-ut”, 1 nëntor 2016.
3. Betimi për Drejtësi, emisioni “Gjykata Supreme VS Prokurori i Shtetit”, datë 8 shkurt 2017.
4. Betimi për Drejtësi, “Parashkruhet vepra penale “legalizim i përmbajtjes së pavërtetë” gjykata merr aktgjykim refuzues”, 16 maj 2017.
5. Betimi për Drejtësi, “Parashkruhet lënda penale ndaj ish-gjyqtarës Shemsije Sheholli”, 11 korrik 2017.
6. Betimi për Drejtësi, “Historiku, dëshmitarët dhe procesi gjyqësor maratonik i MTPT-së”, datë 24 nëntor 2017.
7. Betimi për Drejtësi, Intervistë me Enver Pecin, Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës, datë 20 dhjetor 2017.

Internet:

1. <http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/AUniversalDeclarationHumanRightsfinal.pdf>.
2. http://www.pp.gov.al/web/ekstra29_2008_789.pdf.
3. <http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/ACovenantCivilPoliticalRights.pdf>.
4. <http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/AConventionAlbanian.pdf>.
5. <http://sudovi.me/podaci/vrhs/dokumenta/2578.pdf>.
6. <https://www.osce.org/sq/kosovo/243981?download=true>.
7. <http://betimiperdrejtesi.com/emisionet/gjykata-supreme-vs-prokurori-i-shtetit/>.
8. <http://indeksonline.net/lajmet/avokati-i-popullit-kerkon-qe-hetimet-per-korrupsion-te-jene-pa-afat-video-9473/>.
9. <https://indeksonline.net/82-vjecari-nga-gjakova-qe-mund-te-ekstradohet-ne-shba-per-shkak-te-prostitucionit/>.

10. <http://www.eulex-kosovo.eu/?page=2,10,378>.
11. <http://www.eulex-kosovo.eu/?page=2,10,228>.
12. <http://betimiperdrejtesi.com/kalojne-me-shume-se-1-vit-e-gjysme-nga-shqyrtimi-fillestar-nise-nga-fillimi-gjykimi-ndaj-drejtorit-ekzekutiv-dhe-menaxherit-te-bankes-ekonomike/>.
13. <http://betimiperdrejtesi.com/historiku-deshmitaret-dhe-procesi-gjyqesor-maratonik-i-mtpt-se/>.
14. <https://www.youtube.com/watch?v=f8CVDnUeQko>.
15. <http://www.gjk-ks.org/?cid=1,1>.
16. http://gjk-ks.org/repository/docs/gjk_ki_114_16_shq.pdf.
17. http://gjk-ks.org/repository/docs/gjk_ki_25_15_shq.pdf.
18. http://gjk-ks.org/repository/docs/gjkk_rregullore_e_punes_2015_shq.pdf.
19. <http://www.gjyqesori-rks.org/sq/kjc/page/index/3>.
20. <file:///C:/Users/Star%20Tech/Downloads/Strategjia%20kombetare%20per%20reduktimin%20e%20lendeve%20te%20vjetra.pdf>.
21. <file:///C:/Users/Star%20Tech/Downloads/Rregullore%204-2016%20per%20percaktimin%20e%20sjellejeve%20te%20pa%20hijshme.pdf>.
22. [file:///C:/Users/Star%20Tech/Downloads/SH%20Raport%20i%20Performanc%C3%ABs%20%23%202011-01%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/Star%20Tech/Downloads/SH%20Raport%20i%20Performanc%C3%ABs%20%23%202011-01%20(1).pdf).
23. <http://zpd-rks.org/sq/misioni-dhe-vizioni/>.
24. <http://www.ombudspersonkosovo.org/sq/misioni>.
25. http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/Raporti_vjetor_SHQIP_nr16_me_kopertine_per_web_204801.pdf.
26. <http://www.ekonomiaonline.com/nacionale/siguri/parashkrimi-4-000-lende-ne-verishqetesues-per-avokatin-e-popullit/>.
27. <http://kallxo.com/dnk>.
28. <http://kallxo.com/limaj-ankohet-per-vonesen-e-procesverbaleve/>.
29. <http://kallxo.com/fillon-me-vonese-seanca-kunder-rrembyesit-te-ish-bashkeshortes/>.
30. <http://kallxo.com/flet-avokati-haraqise-per-lenden-e-parashkruar/>.
31. <http://kli-ks.org/rreth-ikd/>.

32. <http://kli-ks.org/wp-content/uploads/2017/04/1.1.-Raporti-i-Korrupsionit-IKD-28.03.2017-Compressed.pdf>.
33. <http://betimiperdrejtesi.com/rreth-nesh/>.
34. <http://betimiperdrejtesi.com/parashkruhet-lenda-penale-ndaj-ish-gjyqtar-es-shemsije-sheholli/>.
35. <http://betimiperdrejtesi.com/vahide-badivuku-kishte-filluar-hetimet-jashte-afatit-ligjor-prokurori-njazi-rexha-terhiqet-nga-aktakuza-ndaj-zyrtareve-te-kek-ut/>.
36. <http://betimiperdrejtesi.com/parashkruhet-vepra-penale-legalizim-i-permbajtjes-se-pavertete-gjykata-merr-aktgjykim-refuzues/>.
37. <https://www.youtube.com/watch?v=VASmpeeohNM>.
38. <http://www.cohu.org/sq/per-ne>.
39. http://www.cohu.org/repository/docs/Parashkrimi_2001-2013_cohu_735470.pdf.
40. <https://www.usaid.gov/node/206921>.
41. <http://qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202017/Fletore%20220/VENDIM%20I%20GJK%20nr.%2076,%20date%204.12.2017.pdf>.
42. <http://www.drejtesia.gov.al/al/newsroom/lajme/ministri-i-manjani-merr-pjese-ne-prezantimin-e-nismes-per-nje-drejtessi-pa-vonesa&page=1>.
43. <http://betimiperdrejtesi.com/emisionet/interviste-enver-peci/>.
44. (<http://betimiperdrejtesi.com/emisionet/gjykata-supreme-vs-prokurori-i-shtetit/>).
45. http://www.pp.gov.al/web/3_163.pdf.
46. <https://www.osce.org/sq/kosovo/243981?download=true>.
47. <https://repository.law.umich.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1456&context=mjil>
48. http://www.pp.gov.al/web/ekstra28_2008_788.pdf.
49. <https://rm.coe.int/handbook-5/16806fc13e>.
50. <https://www.osce.org/sq/albania/100389?download=true>
51. <https://www.osce.org/sq/kosovo/22966?download=true>
52. <http://www.gjykata.gov.al/sistemi-i-drejt%C3%ABsis%C3%AB/p%C3%ABrgjegj%C3%ABsit%C3%AB-e-gjykat%C3%ABs/ekzistenca-e-gjykatave/>.
53. <https://www.justice.gc.ca/eng/rp-pr/other-autre/wyntk.html>.

54. <http://levizjafol.org/wp-content/uploads/2014/12/E-drejta-per-Gjykim-te-Drejte.pdf>.
55. <http://www.ahc.org.al/wp-content/uploads/2016/12/raport-te-drejtat-e-njeriut.pdf>.
56. http://www.ligjet.com/kodi_proc_penale/pjesa_i/titulli_v/kreu_iii/neni_251.
57. https://iust.edu.mk/wp-content/uploads/2018/06/The_heritage_nr_11.pdf#page=280.
58. <http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/ACovenantCivilPoliticalRights.pdf>.
59. <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2013/08/Dorina-Hoxha.pdf>.
60. <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2017/03/JONIADA-MUSARAJ-DISERTACION-P%C3%8BR-MBROJTJEN-E-GRAD%C3%8BS-SHKENCORE-DOKTOR.pdf>.
61. <http://fshs-ut.edu.al/wp-content/uploads/2015/02/Politikja-1-Revista.pdf#page=121>.
62. file:///C:/Users/dell/Downloads/Human_Rights_and_the_Indonesian_Security.pdf.
63. http://www.pp.gov.al/web/ekstra28_2008_788.pdf.
64. <https://www.ilsa.org/Jessup/Jessup16/Batch%202/MackenDEtention.pdf>.
65. https://books.google.com/books?id=mSdKAAAAQBAJ&printsec=frontcover&source=gbs_ge_summary_r&cad=0#v=onepage&q&f=false.
66. <https://philpapers.org/archive/IMBWIC.pdf>.
67. https://books.google.com/books?id=bD-eRFjTPzAC&pg=PP1&source=kp_read_button#v=onepage&q&f=false.
68. <https://www.osce.org/sq/kosovo/41808?download=true>.
69. <https://kallxo.com/wp-content/uploads/2017/05/BIRN-RAPORTI-I-MONITORIMIT-TW-GJYKATAVE-2016.pdf>.
70. <https://jme.bmj.com/content/medethics/26/4/266.full.pdf>.
71. <https://telegrafi.com/gjyqtari-hoti-zgjatja-e-afatit-te-parashkrimit-nuk-e-ben-sistemin-me-efikas-video>.
72. https://www.gesetze-im-internet.de/englisch_stgb/englisch_stgb.html.
73. [https://www.doj.gov.ph/files/ccc/Criminal_Code_September-2014\(draft\).pdf](https://www.doj.gov.ph/files/ccc/Criminal_Code_September-2014(draft).pdf).
74. file:///C:/Users/dell/Downloads/Slovenia_CC_2008_en.pdf.

75. <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2015/06/KORRUPSIONI-NE-KOSOVE-5-25-qershor-2015.pdf>.
76. [https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/\(2014.04.02\)_RUL_-_K.P._\(CoA\)_ALB.pdf](https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/(2014.04.02)_RUL_-_K.P._(CoA)_ALB.pdf).
77. <http://ombudsman.mk/upload/Deca-Dokumenti/Kniga-Istrazuvanje%20deca-2012%20PFormat.pdf>.
78. http://ligjet.info/kodipenal/pjesa_i/kreu_viii/neni_68.
79. <https://www.wipo.int/edocs/lexdocs/laws/en/si/si045en.pdf>.
80. http://www.qkss.org/repository/docs/Pergjimi_ligjor_i_telekomunikimeve_486450.pdf.
81. <http://dx.doi.org/10.11647/OBP.0091>.
82. https://scholarlycommons.law.northwestern.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1231&context=nulr_online.
83. <https://via.library.depaul.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=3350&context=law-review>.
84. <https://www.osce.org/sq/kosovo/243981?download=true>.
85. [https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/\(2015.08.18\)_JUD_-_N.D._et_al.\(CoA\).ALB.pdf](https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/(2015.08.18)_JUD_-_N.D._et_al.(CoA).ALB.pdf).
86. http://www.oak-ks.org/repository/docs/doracak_trajnimi_p%C3%ABr_avokat%C3%ABt_n%C3%AB_fush%C3%ABn_e_drejt%C3%ABsis%C3%AB_p%C3%ABr_f%C3%ABmij%C3%AB_945304.pdf 2015.
87. http://www.gjyqesori-rks.org/vendimet-e-komisionit-disiplinor/?r=M&ordBy=dDtTm+DESC,+dTtitle_sq&ordDir=DESC&offset=0.
88. <http://www.kpk-rks.org/>.
89. <https://www.ombudsman.org.mt/what-does-the-word-ombudsman-mean-2/>.
90. <https://oik-rks.org/>.
91. <https://aab-edu.net/uploads/docs/librat/E%20Drejta%20e%20Procedures%20Penale->

%20Prof.%20dr.%20sc.%20Hajrija%20Sijer%C3%A7iq%20%E2%80%93%20C
3%87oliq-%20Mr.%20sc.%20Haris%20Haliloviq.pdf

92. http://www.gjykatasupreme-ks.org/repository/docs/23.06.13_81287.pdf.

93. <http://www.qkss.org/repository/docs/RI->

THEMELIMI_DHE_REFORMIMI_I_SISTEMIT_T%C3%8B_DREJT%C3%8BSI
S%C3%8B_N%C3%8B_KOSOV%C3%8B_105208.pdf.

94. <http://www.unmikonline.org/SGReports/S-1999-779.pdf>.

95. <http://www.osce.org/sq/kosovo/13054>.

96. <http://www.unmikonline.org/SGReports/S-2000-878.pdf>.

97. <http://www.unmikonline.org/SGReports/S-2000-538.pdf>.

98. <http://www.unmikonline.org/SGReports/S-2000-177.pdf>.

99. www.unmikonline.org/regulations/2001/reg09-01.htm.

100. <https://kallxo.com/gjnk/hashim-rexhepi-i-lire/>.

101. <https://kallxo.com/gjnk/huruglica-e-rafunate-pafajshem/>.

102. <http://www.unmikonline.org/Pages/rollo.aspx>.

103. <https://www.eulex-kosovo.eu/?page=1,60>.

104. <https://www.eulex->

[kosovo.eu/eul/repository/docs/WEJointActionEULEX_EN.pdf](https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/WEJointActionEULEX_EN.pdf).

105. <https://www.eulex-kosovo.eu/?page=1,16>.

106. <http://www.kosovopolice.com/repository/docs/drejtat.pdf>.

107. <https://kallxo.com/qindra-miliona-euro-te-sekuestruara-dhe-konfiskuara>.

108. <https://www.osce.org/sq/kosovo/13054?download=true>.

109. http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2017/11/Raport-Auditimi-Gjykatat_shqip.pdf.

110. <https://rm.coe.int/training-manual-on-the-right-to-fair-trial-and-reopening-of-domestic-p/16808b7cab>.

111. <http://jus.igjk.rks->

[gov.net/689/1/Ekzekutimi%20i%20burgimit%20p%C3%ABr%20t%C3%AB%20mitur_Ship%2C%20nr.%2018.pdf](http://jus.igjk.rks.gov.net/689/1/Ekzekutimi%20i%20burgimit%20p%C3%ABr%20t%C3%AB%20mitur_Ship%2C%20nr.%2018.pdf).

112. http://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2018/02/ki_75_17_av_shq.pdf.

113. <http://www.scandinavianlaw.se/pdf/48-28.pdf>.
114. <https://www.urban.org/sites/default/files/publication/59901/1000557-Invisible-Punishment-An-Instrument-of-Social-Exclusion.PDF>.
115. www.gjykataelarte.gov.al/web/nr_3_dt_27_3_2003_82.doc.
116. <http://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/UDHEZIM%20ADMINISTRATIV%2004%202015%20PER%20ZBATIMIN%20E%20PROCEDURES%20PER%20KOMPENSIMIN%20E%20DEMIT.pdf>.
117. http://www.gjk.gov.al/web/3_fjalim_rol_i_gjykates_kushtetuese_ne_forcimin_e_shtetit_te_se_drejtes_1190.pdf.
118. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16599>.
119. http://www.pp.gov.al/web/ekstra28_2008_788.pdf.
120. <https://insajderi.com/skandali-me-patente-shofer-gjykata-merr-vendim-per-23-te-arrestuarit-ne-rastin-e-patente-shofereve/>.

SHTOJCA:

GJYKATA THEMELORE
PRISHTINË
2017 DEC -7 PM 1:52



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo³
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm
Osnovno Tužilaštvo u Pristini, Departman za Opšta Dela

PP/II.nr.219/17
Dt. 07.12.2017

GJYKATËS THEMELORE - PRISHTINË
GJYQTARIT TË PROCEDURËS PARAPRAKE

Konform nenit 164 par. 7, nenit 165 par. 2 dhe nenit 188 par. 1 të Kodit të
Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, bëjmë:

KËRKESË
PËR CAKTIMIN E PARABURGIMIT

Kundër të pandehurve:

1. **E. P.**, i biri i Enverit dhe Fatmirës, e gjinisë [redacted], i lindur me
16.06.1988 në Prishtinë, ku edhe tani jeton në rrugën "[redacted]" lagjja
Arbëria në Prishtinë, me profesion arkitekt, ka të kryer shkollën master i
arkitekturës, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i
Republikës së Kosovës, me numër personal [redacted].
2. **F. H.**, i biri i Sherifit dhe Zejnijes, e gjinisë [redacted], i lindur më
04.06.1987 në Prizren, tani me banim në rrugën [redacted] lagjja Arbëri
Prishtinë, me profesion kamarier hotelier, ka të kryer fakultetin, i martuar, i
gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me
numër personal [redacted].
3. **L. M.**, i biri i Ylberit dhe Teutës, e gjinisë [redacted], i lindur më
06.04.1988 në Prishtinë ku edhe tani banon në lagjen Bregu i Diellit, [redacted]
me profesion arkitekt, ka të kryer shkollën master i arkitekturës, i
pamartuar, tani punon në zyren "[redacted]" i gjendjes së
mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal
[redacted].

Të cilët gjenden në ndalim nga data 06.12.2017 në ora 13:00 h



GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA
SUPREME COURT OF REPUBLIC OF KOSOVO



Date: 29.09.2016

582/2016
09.09.2016

Kolegjiumi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në Mbledhjen e Përgjithshme, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat e Rregullta, më 29.09.2016, miratoi këtë:

MENDIM JURIDIK

1. Nëse vepra penale është kryer pas hyrjes në fuqi të KPPK-së, hetimet duhet të përfundojnë brenda 24 përkatësisht 30 muajve, dhe nëse brenda këtij afati, prokurori nuk ka ngritur aktakuzë, ai menjëherë merr aktvendim për pushimin e hetimit dhe pushimin e çështjes.

2. Nëse vepra penale është kryer para hyrjes në fuqi të këtij Kodi dhe hetimet kanë filluar para hyrjes në fuqi të KPPK-s, sa i përket akuzimit, aplikohen dispozitat e atij kodi. D.m.th. prokurori pas skadimit të afatit ligjor të hetimit, nuk mund të ndërmarr veprime hetimore, mirëpo aktakuzën mund ta ngritë edhe pas këtij afati.

3. Nëse vepra penale është kryer para hyrjes në fuqi të këtij Kodi, mirëpo hetimet kanë filluar pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi, sa i përket kohëzgjatjes së hetimit dhe pasojave të tejkalimit të këtij afati, aplikohen dispozitat e nenit 159 të këtij Kodi.

A r s y e t i m

Në praktikat e gjykatave janë paraqitur divergjenca të theksuara lidhur me interpretimin e drejtë të nenit 159 të KPPK-së, dhe dispozitave kalimtare të KPPK-së, d.m.th., nuk ka aplikim unik

të kësaj dispozite ligjore, sa i përket çështjes së pasojave, nëse hetimet nuk përfundojnë në afatin e limituar ligjor, dhe si duhet vepruar kur hetimet kanë filluar para hyrjes në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale.

Nevoja e rregullimit me normë ligjore që hetimet të përfundojnë brenda një afati të limituar me pasojën e pushimit të çështjes penale, nëse brenda këtij afati nuk përfundojnë hetimet dhe nuk ngritet akti akuzues, ishte vakumi që kishte krijuar neni 225 i ish KPPK-së, i cili edhe pse e limitonte afatin e hetimeve prej gjashtë muajsh, me mundësi vazhdimi të këtij afati deri në 24 muaj, nuk kishte sanksionuar pasojën nëse brenda këtij afati nuk adresohet në gjykatë akti akuzues. Ky vakum ligjor u jepte mundësi prokurorëve që edhe pas disa viteve nga kalimi i afatit për hetim, të paraqesin aktin akuzues, veprimi, i cili, jo vetëm që ishte në kundërshtim me standardet e gjykimin në një afat të arsyeshëm, por i tangon ata, në realizimin e shumë të drejtave jetësore. Në praktikë, ballafaqoheshim me situata, kur 5-6 vite, pas veprimit të fundit hetimor, ngritej aktakuza dhe adresohet në gjykata, pa dhënë asnjë justifikim për këto vonesa, dhe kjo qasje e tillë prodhonte pasiguri juridike tek qytetarët.

Si ishte e rregulluar çështja e hetimit me ish KPPK

Çështja e kohëzgjatjes së hetimeve ishte e rregulluar në dispozitat e nenit 225. të ish KPPK-së, në të cilin nen shprehej: Nëse hetimet nuk përfundojnë brenda një periudhe prej gjashtë muajsh, prokurori publik i paraqet kërkesë me shkrim gjyqtarit të procedurës paraprake së bashku me arsyet për zgjatjen e hetimit. Gjyqtari i procedurës paraprake mund ta autorizoi vazhdimin e hetimit deri në gjashtë muaj, kur kjo arsyetohet me ndërlíkueshmërinë e çështjes. Për vepra penale, për të cilat parashihet dënim me të paktën pesë vjet burgim, gjyqtari i procedurës paraprake mund të autorizoi edhe një vazhdim deri në gjashtë muaj. Gjykata Supreme e Kosovës, përjashtimisht, mund të autorizoi edhe një vazhdim prej gjashtë muajsh.

Si është rregulluar kjo çështje me Kodin aktual të Procedurës Penale

Çështja e hetimit tani, është rregulluar me dispozitat e nenit 159 të KPPK-së, në të cilin nen shprehet: Kur fillohet hetimi, hetimi përfundon brenda dy (2) viteve. Nëse brenda dy (2)

viteve nga fillimi i hetimit paraprak nuk është ngritur aktakuzë, ose nuk është pezulluar hetimi sipas nenit 157 të këtij Kodi.

Nëse i analizojmë dhe i krahasojmë këto dy norma që rregullojnë çështjen e hetimit, vëmë lehtë në përfundim se: Dispozita e nenit 225 të ish KPPK-së, e limitonte afatin e hetimit, por nuk detyronte *pushimin e hetimit*, nëse brenda afatit të limituar nuk ngritet akti akuzues. Nëse prokurori publik brenda këtij afati nuk i përfundonte hetimet, ai nuk mund të ndërmerre *veprime hetimore* pas këtij afati, mirëpo ai mund të ngriste aktin akuzues edhe pas këtij afati, nëse konsideronte se ato prova që i ka siguruar i japin bazë të mjaftueshme për ta nxjerr çështjen për gjykim para gjykatës.

Mirëpo dispozita e nenit 159. të Kodit aktual të Procedurës Penale, është e qartë dhe nuk lë asnjë mëdyshje sa i përket kohëzgjatjes dhe pasojave të lëshimit të afateve nga ana e prokurorit të shtetit, *kuptohet nëse hetimet kanë filluar pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi*. Nëse prokurori brenda këtij afati nuk ka pezulluar hetimin apo nuk ka ngritë aktin akuzues, hetimi menjëherë pushohet (*hetimi pushohet me aktvendim*). Nëse hetimi pushohet, pushohet në tërësi çështja penale, nuk ka mundësi edhe të merret vendim për pushimin e hetimit edhe më pas të ngritet akti akuzues. Ligji ka përdorur shprehjen pezullim dhe pushim të hetimeve. Kur hetimi pezullohet ai mund të vazhdohet pasi të evitohen shkaqet për të cilat është pezulluar hetimi (*arsyet e pezullimit mund të jenë juridike dhe faktike*), mirëpo kur hetimi *pushohet*, çështja penale përfundon në fazën e hetimit, dhe pas *pushimit* të hetimit nuk ka mundësi të paraqitet akti akuzues.

Rrethanat standarde, për të cilat hetimi pushohet, janë të parashikuara në nenin 158 në të cilin shprehet: Prokurori i shtetit e pushon hetimin kurdo që është vërtetuar nga provat e mbledhura se: nuk ekziston dyshim i arsyeshëm që personi konkret e ka kryer veprën e tillë penale; vepra e kryer nuk është vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare; ka kaluar afati i parashkrimit; vepra penale është përfshirë në falje ose në amnistinë e lëshuar para miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; ose vepra penale është përfshirë në amnistinë e lëshuar para miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ose ekzistojnë rrethana të tjera, të cilat përjashtojnë ndjekjen(paragrafi 1.). Prokurori i shtetit, brenda tetë ditësh pas pushimit të hetimit, e lajmëron të dëmtuarin për këtë fakt dhe arsyet për këtë. Prokurori i shtetit pa vonesë e njofton gjyqtarin e procedurës paraprake për pushimin e hetimit(paragrafi 2.).

Hetimi pushon automatikisht me kalimin e afatit kohor nga neni 159 i këtij Kodi(paragrafi 3.).

Ligji shprehimisht edhe në nenin 158.pargarfi 3. ka parashikuar pushimin e hetimit, nëse nuk është përfunduar brenda afatit të përcaktuar në nenin 159.par.1. Në situata të tilla, prokurori i shtetit është i detyruar që të marrë aktvendim për pushimin e hetimit, duke iu referuar nenit 158 paragrafi 3.lidhur me nenin 159 par.1.të KPPK-së, dhe kur procedura pushohet, sipas këtij neni, nuk ka mundësi të ngritet akti akuzues. Sikurse nuk mund të ngritet aktakuzë nëse hetimet janë pushuar për shkak të parashkrimit (neni 158.par.1.pika 1.3), aktakuza nuk mund të ngritet edhe kur hetimi ka pushuar për shkak të kalimit të afatit nga neni 158 par.3.lidhur me nenin 159.par.1. të KPPK-së,

2.Kur vepra penale është kryer para hyrjes në fuqi të këtij Kodi dhe procedura e hetuesisë ka filluar në kohën kur ishte në aplikim ish KPPK, aplikohet kodi që ishte në fuqi, dhe në rrethana të tilla, aktakuza e ngritur pas kalimit të afatit të parashikuar për hetim, sipas nenit 225 .par.1 dhe 2. të ish KPPK-s, nuk mund të hedhet si e palejueshme - e parregullt.

3.Nëse vepra penale është kryer para hyrjes në fuqi të këtij Kodi, mirëpo hetimet kanë filluar pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi, aplikohen dispozitat e nenit 159 të këtij Kodi. d.m.th., edhe në këtë situatë, nëse aktakuza nuk ngritet brenda afatit prej 24 muajsh, përkatësisht 30 muajsh, atëherë procedura hetimore konform kësaj dispozite ligjore, pushohet me aktvendim dhe çështja penale konsiderohet e mbyllur.

Aktakuza e ngritur pas pushimit të hetimit me aktvendim për shkak të kalimit të afatit për hetim, është e njëjtë sikurse të ngritet aktakuzë pas pushimit të procedurës së hetuesisë për shkak të parashkrimit, e që s'do mend, në rrethana të tilla, atë e bënë të pambështetur në ligj .

Nga arsyet e parashtuara, seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme, vendosi si në dispozitiv.

(Mendim juridik i miratuar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme , i mbajtur më 29.09.2016)



GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA
SUPREME COURT OF REPUBLIC OF KOSOVO



Datë: 29.09.2016

583/2016
10.10.2016

Kolegjiumi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në Mbledhjen e Përgjithshme, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat e Rregullta, më 29.09.2016, miratoi këtë:

MENDIM JURIDIK

1. Prokurori i shtetit, brenda 30 ditësh duhet të vendosë: për informacione shitesë, për aplikimin eventual të masave të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit, hedhjen e kallëzimit penal, apo për fillimin e hetimit.
2. Nëse pas dorëzimit të kallëzimit penal të policisë, policia mëson fakte të reja ose nxjerr prova apo gjurmë të veprës penale, ajo detyrohet që vazhdimisht të mbledhë informata të nevojshme dhe për këtë, menjëherë duhet t'ia dorëzojë prokurorit të shtetit, raportin plotësues të kallëzimit penal të policisë.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë ka adresuar në Gjykatë Supreme, këto pyetje:

1. Në çfarë afati prokurori i shtetit duhet t'i fillojë hetimet pas paraqitjes së kallëzimit penal, dhe

2. Çfarë është statusi i provave të grumbulluara para vendimit për fillimin e hetimeve, nëse prokurori nuk ka kërkuar plotësimin e kallëzimit penal.

Parashtruesit e kërkesës – gjyqtarët e Departamentit për Krime të Rënda, kanë theksuar se në praktikë po ndodhin raste kur kallëzimi penal në gjykatë është adresuar në vitin 2009, ndërsa prokurori i shtetit në vitin 2014 ka marrë vendim për fillimin e hetimeve, pastaj organet policore në raste të caktuara edhe pas fillimit të hetimit po ndërmarrin veprime procedurale, dhe për këtë çështje nuk ka qasje unike nëpër gjykatat e Kosovës. Për këto arsye, kanë kërkuar që këtë situatë, Gjykata Supreme ta sqarojë nëpërmjet mendimit juridik.

Si e ka rregulluar në aspektin kohor KPPK-s, çështjen e kallëzimit, fillimit dhe kohëzgjatjes së hetimeve?

Kodi i procedurës penale me dispozitat e nenit 69-81, ka përcaktuar mandatin e organeve policore dhe hetimeve policore (parapenale) si dhe fuqinë provuese të këtyre veprimeve në procedurë penale. Policia ka për detyrim që në afat prej 24 orësh, kur mëson për dyshimin e arsyeshëm, t'i paraqes kallëzimin penal prokurorit kompetent, neni 70.par.4.i KPPK-së, kjo normë është e karakterit imperativ. Veprimi i organeve policore nuk përfundon në momentin kur ata dorëzojnë kallëzimin penal në prokurori. Ata janë të detyruar të mbledhin çdo informacion që ka relevancë për çështjen penale dhe me raport shtesë t'ia dërgojnë policisë (neni 81.par.3.).

Prokurori i Shtetit i ka dy mundësi: ta hedh kallëzimin penal (neni 82); të kërkojë prova shtesë nga policia (neni 83.par.1.); apo të fillojë procedurën e hetuesisë me vendim formal (neni 101). Prokurori i shtetit ka për obligim që kallëzimin penal ta hedh brenda 30 ditësh (neni 82.par.1.). Nëse prokurori i shtetit nuk e ka hedhë kallëzimin penal brenda këtij afati dhe nuk ka urdhëruar ndonjëherë nga masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, konsiderohet se ka filluar hetimet ndaj të dyshuarit me kalimin e 30 ditëve nga paraqitja e kallëzimit penal, pavarësisht se atë s'e ka formalizuar në aspektin formal, me aktvendim.

Me qëllim të respektimit të standardit për gjykim në një afat të arsyeshëm dhe për siguri juridike, ligjdhënësi i ka limituar në aspektin kohor veprimet e policisë “brenda 24 orësh duhet ta dorëzojnë kallëzimin penal”, veprimet e prokurorit “që brenda 30 ditëve ta hedh kallëzimin penal”, e nëse s'e hedh kallëzimin penal, duhet që brenda 24 muajve, me vazhdim të mundshëm edhe për gjashtë muaj t'i përfundojë hetimet. Nëse Prokurori i shtetit, nuk e ka hedhur kallëzimin penal brenda 30 ditësh dhe për 24 muaj nuk ka filluar dhe as përfunduar hetimet, ai nuk ka asnjë mundësi tjetër, përpos për

ta hedh kallëzimin penal dhe për ta pushuar procedurën penale, pavarësisht se ai në aspektin formal, asnjëherë s'i ka filluar hetimet. Në të kundërtën, limitimi i kohëzgjatjes së hetimeve prej 24 muajve nga ligjdhënësi, do jetë i pa efekt, ngase prokurorët s'do e hedhin kallëzimin penal brenda afatit prej 30 ditësh dhe pas 3-4 vjetësh do të marrin vendim për fillimin e hetimeve nëse vepra penale nuk është parashkruar, e pastaj do t'i ketë në dispozicion edhe dy vite, plus gjashtë(6) muaj për t'i përfunduar hetimet.

Nëse kallëzimi penal nuk është hedhur nga prokurori i shtetit brenda 30 ditësh, prokurori nuk mund të marr vendim për fillimin e hetimeve pas kalimit të 24 muajve, nga kalimi i afatit 30 ditor për hedhjen e kallëzimit penal. Përndryshe, limitimi në aspektin kohor i hetimeve do dilte i parëndësishëm-i panevojshëm, dhe me këtë do cenohej *siguria juridike*, standardi për *gjykim në afat të arsyeshëm*, pastaj do të dëmtohej i dyshuari për faktin se fillimi dhe kohëzgjatja e procedurës penale, *prodhon pasojë juridike për të* (ai ngelet i skeduar penalisht dhe mund të kufizohet në realizimin e shumë të drejtave që atij i takojnë sikur të mos ishte në proces).

Si është rregulluar në aspektin ligjor, ndërmarrja e veprimeve të caktuara nga organet policore pas dorëzimit të kallëzimit penal?

Sipas nenit 81.par.3 të KPPK-s, nëse pas dorëzimit të kallëzimit penal të policisë, policia mëson fakte të reja ose nxjerr prova apo gjurmë të veprës penale, ajo detyrohet që vazhdimisht të mbledhë informata të nevojshme dhe për këtë, menjëherë duhet t'ia dorëzojë prokurorit të shtetit, raportin plotësues të kallëzimit penal të policisë. Nga kjo qartë rezulton se materiali provues që është siguruar nga organet policore, pas dorëzimit të kallëzimit penal edhe pa propozim të prokurorit kanë baza ligjore.

(Mendim juridik i miratuar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme, i mbajtur më 29.09.2016)



Date: 04.12.2014

Për: Gjykatat Themelore, të Republikës së Kosovës

Nga: Gjykata Supreme

Q A R K O R E

TË nderuar kryetar, nga parashtresat e palëve kemi vërejtur se në shumë gjykata kur çështja penale kthehet në rigjykim me muaj e ndoshta edhe me vite nuk caktohet shqyrtim gjyqësor, fatkeqësisht edhe kur të akuzuarit ndodhen në paraburgim. Praktika e tillë është e paligjshme dhe duhet domosdoshmërisht të shmanget.

Kur çështja penale kthehet në rigjykim, gjykata duhet menjëherë të caktoj shqyrtim gjyqësor, me qëllim që të mos ndërpritet kontinuiteti i vendosjes së çështjes, e cila është në procedim. Çështja e rikthyer nuk mund të trajtohet si lëndë e pacaktuar- si lëndë e re, por si çështje në rrjedhë e sipër.

Neni 259. i Rregullave mbi veprimtarinë e brendshme të gjykatave, që ishte në fuqi në Kosovë, e detyronte gjyqtarin e çështjes edhe atëherë kur nuk kishin të bëjnë me paraburgimin, që brenda një muaji pasi që lëndë e është rikthyer në rivendosje, të jep urdhër për caktimin e seancës kryesore dhe së bashku me letërthirrjen palës, t'i dërgojë aktgjykimin e shkallës së dytë.

Gjyqtari i ngarkuar me çështjen, ka obligim ligjor që lëndën që i është rikthyer në rigjykim, ta caktojë menjëherë, në afatin e parë kalendarik që e ka të lirë. Çdo veprim


ndryshe, është në kundërshtim me ligjin, e veçmas kur i akuzuari ndodhet në paraburgim, ngase është obligim ligjor i të gjithë zbatuesve të ligjit, që kur kanë të bëjnë me paraburgimin, të veprojnë me urgjencë dhe zvarritja e një çështjeje të këtillë penale, nuk mund të justifikohet me asnjë arsye, aq më pak me “arsyen e ngarkesës së gjyqtarëve”.

Të nderuar kryetar, kërkoj nga Ju, që lidhur me këtë qarkore, t’i informoni gjyqtarët që punojnë në materien penale, dhe të kujdeseni që kjo qarkore me përpikëri të implementohet.

Ju falënderoj për bashkëpunim korrekt .

Me respekt,

Prof.dr. Hejzullah Hasani



Kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës



GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA
SUPREME COURT OF THE REPUBLIC OF KOSOVA

Agj.nr.314/2012

10.09.2012

Prishtinë

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, në Mbledhjen e përgjithshme të mbajtur më 10.09.2012, në bazë të nenit 18 të Ligjit për Gjykatat e Rregullta, përcaktoi këtë:

QËNDRIM PARIMOR

Ekzekutimi i dënimit me burgim nuk mund të fillojë, nëse ka arritur afati absolut i parashkrimit; gjithashtu dënimi nuk mund të vazhdojë të ekzekutohet, nëse gjatë mbajtjes së dënimit është arritur afati absolut i parashkrimit të dënimit.

A r s y t i m i

Në praktikat e gjykatave janë paraqitur mëdyshje, nëse dënimi duhet të ekzekutohet ose jo brenda afatit absolut, përkatësisht kur i dënuari ka filluar vuajtjen e dënimit, a mund të arrihet afati i parashkrimit absolut.

Në disa gjykata po zbatohet praktika, sipas së cilës nuk mund të bëhet fjalë për arritjen e afatit absolut të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit, nëse i dënuar ndodhet në vuajtje të dënimit. Sipas rezonimit të këtyre gjykatave, nëse i dënuari është dërguar në vuajtje të dënimit qoftë vetëm një orë para arritjes së afatit absolut të parashkrimit, ai duhet ta vuajë dënimin në tërësi, ngase është evituar mundësia e arritjes së afatit absolut të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës, përkitazi me parashkrimin e ekzekutimit të dënimit, në nenin 92 shprehet: “Përveç rasteve kur është parashikuara ndryshe me këtë Kod, dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet kur të kenë kaluar:

- 1) Tridhjetë e pesë vjet nga dënimi me burgim afatgjatë;
- 2) Pesëmbëdhjetë vjet nga dënimi me mbi dhjetë vjet burgim;
- 3) Dhjetë vjet nga dënimi me mbi pesë vjet burgim;
- 4) Pesë vjet nga dënimi me mbi tri vjet burgim;
- 5) Tri vjet nga dënimi me mbi një vit burgim dhe
- 6) Dy vjet nga dënimi me burgim deri në një vit apo dënimi me gjobë.”

Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit konsiston në faktin se, pas kalimit të kohës së parashikuar me ligj, dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet.

Afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit fillon të rrjedhë nga dita kur aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm, por nëse është revokuar dënimi alternativ, nga dita kur vendimi mbi revokimin është bërë i plotfuqishëm (paragrafi 1).

Nëse dënimi me gjobë, e cila nuk është paguar, zëvendësohet me dënim me burgim, parashkrimi i ekzekutimit të këtij dënimi fillon të rrjedhë nga dita kur vendimi i gjykatës për këtë zëvendësim është bërë i plotfuqishëm.

Nëse parashkrimi ka ndodhur para se aktgjykimi të jetë bërë i plotëfuqishëm, atëherë duhet konsideruar se është fjala për parashkrim të ndjekjes penale.

Parashkrimi i ekzekutimit ndodh si për dënimet kryesore, ashtu dhe për dënimet alternative dhe plotësuese. Mirëpo, parashkrimi i dënimeve plotësuese nuk ndodh në të njëjtën kohë si për dënimet kryesore dhe alternative.

Kohëzgjatja e afatit të parashkrimit varet prej masës së dënimit të shqiptuar, pra nuk është me rëndësi dënimi i parashikuar me ligj për veprën penale. Kohëzgjatja e afateve të parashkrimit është përcaktuar sipas dënimit kryesor.

Afati maksimal i parashkrimit është 35 vjet nga dita që aktgjykimi me të cilin është shqiptuar dënimi me burgim afatgjatë është bërë i plotfuqishëm, ndërsa afati minimal është dy vjet nga dita që aktgjykimi me të cilin është shqiptuar dënimi me burgim deri në një vit apo dënimi me gjobë është bërë i plotfuqishëm.

Për përcaktimin e afatit të parashkrimit gjithmonë vendimtar është dënimi i shqiptuar me aktgjykim të plotfuqishëm dhe jo ndryshimet e mëpastajme, të cilat mund t'i bëhen dënimit përmes amnistisë apo faljes.

Për parashkrimin e burgimit për të mitur vlejnë dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur (neni 36).

Në nenin 94 të KPK thuhet:

“ (1) Afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit fillon të rrjedhë nga dita kur aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm, e nëse dënimi alternativ është revokuar, parashkrimi fillon nga dita kur vendimi mbi revokimin është bërë i plotfuqishëm.

(2) Afati i parashkrimit nuk rrjedh gjatë kohës kur sipas ligjit ekzekutimi i dënimit nuk mund të fillohet.

(3) Afati i parashkrimit ndërpritet me çdo veprim të filluar nga organi kompetent me qëllim të ekzekutimit të dënimit.

(4) Pas çdo ndërprerje fillon të rrjedhë afati i ri i parashkrimit.

(5) Ekzekutimi i dënimit ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës që kërkohet nga ligji për afatin e parashkrimit (ndalimi absolut i ekzekutimit të dënimit).

(6) Dispozitat nga paragrafi 2 deri te paragrafi 5 të këtij neni zbatohen për ndalimin e ekzekutimit të masave të trajtimit të detyrueshëm.”

Rrjedha e afatit relativ të parashkrimit të dënimit ndërpritet me çdo veprim të filluar nga organi kompetent me qëllim të ekzekutimit të dënimit dhe fillon të rrjedhë rishtas (nga fillimi), mirëpo, pavarësisht se sa herë është ndërprerë afati i parashkrimit - sa herë ai ka filluar rishtas të rrjedhë, në momentin kur kalon dyfishi i kohës së kërkuar me ligj, dënimi nuk mund të ekzekutohet, (i dënuari nuk mund të dërgohet në vuajtje të dënimit) dhe nuk mund të vazhdohet ekzekutimi, (nëse i dënuari ndodhet në vuajtje të dënimit dhe nëse gjatë vuajtjes së dënimit arrihet afati i parashkrimit).

Nëse ekzekutimi i dënimit nuk mund të fillohet pas arritjes së parashkrimit absolut, atëherë ai nuk mundet as të vazhdohet pas arritjes së këtij afati. Norma juridike thotë se ekzekutimi i dënimit **ndalohet** në momentin kur kalon dyfishi i kohës së kërkuar me ligj dhe ligji nuk ka lënë asnjë alternativ tjetër, përndryshe po të ishte menduar se afati i parashkrimit absolut nuk rrjedh gjatë vuajtjes së dënimit, në këtë normë do të mund të thuhej: “Përfundimisht, afati absolut nuk rrjedh, nëse i dënuari është në vuajtje të dënimit”. Sipas ndërtimit të dispozitës së pikës 5 të nenit 94, ecjen e afatit absolut të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit nuk mund ta ndalojë asnjë veprim dhe as fillimi i vuajtjes së dënimit, (ligji ka përdorur shprehjen “**ndalohet**” ekzekutimi, pa asnjë përjashtim dhe shprehja “**ndalohet**” do të thotë se vuajtja e dënimit nuk fillohet nëse s’ka filluar ende dhe ndalohet nëse vuajtja e dënimit është në ecje e sipër (tashmë ka filluar).

Gjatë kohës së ekzekutimit të dënimit, (kur i dënuari është duke mbajtur dënimin) rrjedh afati absolut i parashkrimit, ashtu që ekzekutimi i një dënimi të tillë duhet të bëhet brenda afatit absolut. Duke pasur parasysh se **fillimi, vazhdimi dhe përfundimi** i ekzekutimit të dënimit kanë përmbajtje të njëjtë juridike, për këtë arsye ato nuk mund

të kushtëzohen me situata të ndryshme juridike (dmth. të mos fillohet mbajtja e dënimit nëse afati absolut i parashkrimit është arritur para se i dënuari ta ketë filluar mbajtjen e dënimit, ndërsa” mund të vazhdohet dhe të përfundohet mbajtja e dënimit , nëse i dënuari ka filluar ta mbaj dënimin”- nëse afati absolut i parashkrimit të dënimit atë e ka gjetur në mbajtje të dënimit-në burg , ngase këtë se thotë ligji) dhe, meqenëse dënimi nuk mund të fillojë të ekzekutohet pas arritjes së afatit absolut të parashkrimit, ekzekutimi nuk mundet as të vazhdojë të ekzekutohet, nëse gjatë kohës së mbajtjes së dënimit me burgim, arrin afati absolut i parashkrimit i parashikuar me ligj dhe është kështu sepse ligji nuk ka parashikuar ndonjë afat tjetër të fillimit të ecjes së afatit të parashkrimit absolut, por vetëm atë që fillon nga momenti kur aktgjykimi ka marrë formë të prerë.

Gjykata duhet ta mbajë rreptësishtë parasysh afatin e parashkrimit dhe, nëse afati absolut i parashkrimit arrihet gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, ajo duhet ta ndërpresë me aktvendim vazhdimin e mëtejme të ekzekutimit të dënimit.

Kryetari i Gjykatës,

Dr.sc. Fejzullah Hasani



GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA
SUPREME COURT OF THE REPUBLIC OF KOSOVA



Agj.nr. K 95/12
21.01.2012
Prishtinë

Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës,
në bazë të nenit 18 të Ligjit për Gjykatat e Rregullta, më 23.1.2012 miratoi këtë

QËNDRIM PARIMOR

- I. Prokurori publik nuk është i lidhur me afatin tremujor për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë .
- II. Urdhrin për ekspertim në procedurë penale e jep gjykata, ndërsa prokurori publik përjashtimisht, vetëm në rastet e parashikuara me ligj.
- III. Mbrojtja, sipas nenit 3 Ligjit mbi ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës penale të Kosovës, nr. 03/L-003, është e detyrueshme, vetëm në situatën kur i pandehuri para fillimit të shqyrtimit gjyqësor ka deponuar një kërkesë dhe kërkon që të filloj negociatat me prokurorin publik për pranimin e fajësisë, por jo edhe në rast të pranimit të fajësisë pas fillimit të shqyrtimit gjyqësor konform nenit 359 par.2.të KPPK.
- IV. Nëse Gjykata konstaton gjatë shqyrtimit gjyqësor se nuk ka kompetencë lëndore për ta gjykuar çështjen penale-juridike, ajo duhet të japë aktgjykim me të cilin e refuzon akuzën.

A r s y e t i m

I. Prokurori i Shtetit i Kosovës mund të paraqesë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në dëm dhe në dobi të të pandehurit.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, si organ shtetëror, me rastin e paraqitjes së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është i lidhur për afatin e paraqitje së kërkesës. Prokurori mund të paraqesë në çdo kohë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, kur konsideron se vendimet gjyqësore përmbajnë shkelje të parashikuara nga neni 451 të KPPK.

Qasje të ndryshme në aplikim, lidhur me këtë çështje, ka krijuar dispozita e nenit 452 par. 3 të KPPK, në të cilën thuhet: "I pandehuri, mbrojtësi i tij dhe personat e parashikuar në nenin 443 par. 1, fjalë e fundit e këtij Kodi, mund të paraqesin kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë brenda tre muajve, nga dita kur të pandehurit i është dorëzuar vendimi gjyqësor i formës së prerë", ndërsa në nenin 443 par. 1 thuhet: "Rishikimin e procedurës mund ta kërkojnë palët dhe mbrojtësi. Pas vdekjes së të dënuarit, rishikimin mund ta kërkojë prokurori publik, bashkëshorti, bashkëshorti jashtëmartesor, farefisi në vijë direkte deri në shkallë të parë, prindi adoptues, fëmija i adoptua, vëllai, motra ose prindi birësues i të dënuarit".

Nga interpretimi gjuhësor i nenit 443 par. 1 të KPPK rezulton qartë se për afatin tremujor janë të lidhur vetëm personat që kanë të drejtë të paraqesin kërkesë për rishikimin e procedurës në favor të dënuarit (tani të vdekur), por jo edhe prokurori, ngase prokurori nuk është "person", por palë-organ shtetëror, ndërsa në neni 452 par. 3 thuhet se "personat" mund të ushtrojnë kërkesa brenda afatit tremujor.

II. Në dispozitën e neni 176 par. 1 të KPPK thuhet se ekspertimin e urdhëron gjykata, më kërkesë të prokurorit publik, me përjashtim të ekzaminimeve mjekësore dhe fizike të parashikuara nga neni 192 par. 1-4, të cilat mundë t'i urdhërojë prokurori.

Kodi i Procedurës Penale bën fjalë për ekspertizat veç e veç. Kështu, thuhet shprehimisht se analizat toksikologjike i urdhëron gjykata (neni 190), ekzaminimin e lëndimeve trupore dhe ekzaminimi fizik të parashikuar nga neni 152 par. 1-4, e urdhëron prokurori publik, kurse për ekzaminimet molekulare e gjenetike dhe analizat e ADN-së thuhet shprehimisht se i urdhëron gjykata (neni 194).

Te kontrolli financiar (neni 196 i KPPK) nuk saktësohet shprehimisht që ato i urdhëron gjykata, por kjo nënkuptohet fare qartë, sepse aty thuhet shprehimisht: "Gjykata e udhëzon ekspertin për qëllimin dhe fushëveprimin e kontrollit si dhe faktet dhe rrethanat që duhet të vërtetohen (par. 1), ndërsa në par. 3 thuhet: "Gjykata merr aktvendim me shkrim për rregullimin e kontabilitetit në bazë të raportit me shkrim të ekspertit" dhe më tej, në par. 4, thuhet se gjykata, në bazë të raportit të ekspertit, merr aktvendim me shkrim, me të cilin cakton shpenzimet e krijuara për shkak të rregullimit të kontabilitetit.

Nga mënyra se si është rregulluar kjo normë juridike rezulton qartë se urdhrat për ekspertim, të parashikuara nga ky nen (196) i jep gjykata e jo prokurori, sepse po të ishte kjo një çështje që i përket prokurorit, gjykata nuk do të kishte pse të përfshihej në dhënien e sugjerimeve ekspertit për rregullimin e kontabilitetit, caktimin e shpenzimeve etj.

Në dispozitat në të cilat bëhet fjalë për dëshmitarët (neni 237 par. 1) thuhet se dëshmitarët dhe ekspertet detyrohen t'i paraqiten prokurorit publik dhe të japin deklarime ose mendime mbi çështjen në fjalë.

Këtu kemi të bëjmë me situatën kur është i nevojshëm sqarimi gojor i ekspertit për ndonjë çështje profesionale; ai detyrohet t'i paraqitet prokurorit publik dhe të japë sqarimet e kërkuara profesionale, por këtu nuk bëhet fjalë për ekspertizë. Prokurori, sipas kësaj dispozite, nuk mund të urdhërojë ekspertimin, por i fton ekspertet për deklarime lidhur me një çështje kontestuese.

Për ta qartësuar më tej faktin se, sipas KPPK, urdhrin për kryerjen e ekspertizës e jep vetëm gjykata, (me përjashtim të dispozitave të theksuara më lart), po e bëjmë një krahasim mes nenit 176 par. 1 të KPPK, ku thuhet se urdhrin për ekspertim e jep gjykata, dhe dispozitës së nenit 96 të Kodit të Procedurës Penale të Bosnjë-Hercegovinës, në paragrafin 1 të të cilit thuhet se urdhrin për ekspertim e jep prokurori ose gjykata, çka do të thotë se, sipas këtij Kodi, urdhrin për ekspertizë mund ta japin edhe prokurori, edhe gjykata pa përjashtim, ndërkaq, sipas KPPK, urdhrin për ekspertim prokurori e jep vetëm përjashtimisht, për raste të caktuara.

III. Nëpër disa gjykata të Kosovës, gjykatat e shkallës së dytë po i anulojnë aktgjykimet e shkallës së parë, kur i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se e pranon fajësinë, pas kërkesë së gjykatës, ndërsa nuk i është caktuar mbrojtësi. Kjo qasje është absolutisht e gabuar për arsyet që do të shtrihen në vijim.

Në bazë të nenit 69 të KPPK, i dyshuari dhe i pandehuri kanë të drejtë të kenë mbrojtës gjatë gjithë fazave të procedurës penale dhe kjo në këto raste nuk do të thotë se mbrojtja është e obligueshme.


Ndërkaq, nëse kemi të bëjmë me çështjet e caktuara nga nenet 73 dhe 74 të KPPK, mbrojtja është e obligueshme. Kjo do të thotë se, nëse i dyshuari apo i pandehuri ose ndonjë person tjetër, kur nuk angazhon mbrojtës, këtë e bën kryetari i trupit gjykues ose organi që e zhvillon procedurën në fazën paraprake.

Nëse shqyrtimi gjyqësor ka filluar dhe, pas pyetjes së kryetarit të trupit gjykues se a e pranon fajësinë (neni 359. par. 2. të KPPK), i akuzuari deklaron se e pranon atë, atëherë atij nuk është e nevojshme t'i caktohet mbrojtësi, (kur nuk e ka atë), vetëm për faktin se ai deklaron se e pranon fajësinë, (nëse mbrojtja nuk ka qenë e detyrueshme), siç kanë marrë gabimisht qëndrim disa gjykata të qarkut, duke keqinterpretuar nenin 3 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, nr. 03/L-003. Ky nen i referohet vetëm situatës kur i akuzuari, ende pa u hap shqyrtimi, i drejtohet me një kërkesë me shkrim gjykatës që t'i mundësohet negociimi me prokurorin për pranimin e fajësisë. Në një situatë të tillë ai duhet të jetë i mbrojtur nga avokati gjatë gjithë procedurës së negociimit të marrëveshjes, por jo edhe kur ai tashmë ka hyrë në shqyrtim dhe ka filluar shqyrtimi gjyqësor i çështjes së tij – kur ai e ka pranuar fajësinë sipas nenit 359 par. 3 të KPPK.

IV. Edhe pse kjo bazë ligjore për marrjen aktgjykimit refuzues nuk parashikohet në nenin 389 të KPPK, në nenin 403 par. 6 të këtij Kodi parashikohet si shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, nëse aktgjykimin e ka marrë gjykata, e cila nuk ka pasur kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes ose kur gjykata gabimisht ka refuzuar akuzën për shkak të moskompetencës lëndore. Nga kjo qartë rezulton se ligjdhënësi ka lëshuar që në neni 389. të theksoj si bazë për refuzimin e akuzës mos kompetencën lëndore.

Shqyrtimi gjyqësor që ka filluar përfundon vetëm me aktgjykim (refuzues, dënues apo lirues). Përrjashtimisht, nëse i akuzuari vdes gjatë procedurës, atëherë procedura përfundon me aktvendim.

Kryetari i Gjykatës,
Dr.sc. Fejzullah Hasani





Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo 578,20
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor PRISHTINË - PRISTINA

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Državnog Tuzioca / Office
of the Chief State Prosecutor

A.nr.258/2016
Datë:29 prill 2016
Prishtinë

Kryeprokurori i Shtetit, në pajtim me nenin 1 i cili i referohet nenit 11 par.1 pikat: 1.1 dhe 1.5 të Ligjit nr.05/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, pas mbajtjes së kolegjiut të kryeprokurorëve të gjitha prokurorive më dt.29 prill 2016 e me qëllim të zbatimit të ligjshmërisë, ngritjes së efikasitetit dhe zbatimit unik të praktikave dhe legjislacionit, nxjerr si në vijim këtë:

UDHËZIM

I.Të gjithë prokurorët e shtetit obligohen, që brenda afatit prej 3(tre) muajsh, nga dita e pranimit të kallëzimit penal nëse i njëjti me aktvendim nuk është hudhur, të nxjerrët aktvendimi për fillimin e hetimit.

II.Çdo 3(tre) muaj,pas nxjerrjes së aktvendimit për fillim të hetimit, prokurori i shtetit dhe kryeprokurori i asaj prokurorie obligohen që të shqyrtojnë lëndën konkrete ku është filluar hetimi dhe të konstatojnë nëse hetimi konkret duhet të mbetet i hapur,të pezullohet,të pushohet apo të ngritët aktakuza,ashtu si është e parashikuar me dispozitën e nenit 156 të KPPRK.

III.Ky udhëzim hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit nga Kryeprokurori i Shtetit.

Arsyetim

Me qëllim të ngritjes së efikasitetit të ndjekjes penale në të gjitha lëndët e natyrës penale me të cilat janë të ngarkuara të gjitha prokuroritë e Republikës së Kosovës, e në funksion të zbatimit me përpikëri të dispozitës së nenit 156 të KPPRK,Kryeprokurori i Shtetit më dt.29 prill 2016,ka mbajtur mbledhjen e kolegjiut të gjithë kryeprokurorëve të prokurorive të Republikës së Kosovës.

Nga kjo mbledhje e sipërcekur u morën qëndrimet si në pikat I dhe II të këtij udhëzimi, duke konsideruar se zbatimi i përpikëti i dispozitës së nenit 156 të KPPRK, do të reflektonte pozitivisht në mbarëvajtjen dhe përmbushjen e obligimeve ligjore të prokurorit të shtetit.

Kjo aq më parë, që ndjekja penale e suksesshme e kryesve të mundshëm të veprave penale të të gjitha natyrave penale do të mundësoj zbatimin konsekuent të ligjshmërisë,

mbrojtjen e të drejtave, interesave dhe lirive të qytetarëve si dhe rritjen e llogaridhënjes dhe besimit të publikut në sistemin prokurorial.

Andaj, nga arsyet e sipër cekura, ky udhëzim është nxjerr dhe i njëjti do të iu shërbej të gjithë prokurorëve të shtetit si dhe kryeprokurorëve të zyreve përkatëse.

KRYEPROKURORI I SHTETIT

Aleksandër Lumezi

Udhëzimi i dërgohet:

- Të gjithë Kryeprokurorëve të Prokurorive Themelore të cilët nga një kopje të këtij udhëzimi të ia dorëzojnë prokurorëve të shtetit nëpër ato prokurori,
- U.D të Kryeprokurorit të PSRK-së i cili nga një kopje të këtij udhëzimi të ia dorëzoj prokurorëve special në atë prokurori,
- U.D të Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit i cili nga një kopje të këtij udhëzimi të ia dorëzoj prokurorëve të shtetit të zyrës së tij,
- Arkivit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit,

Obligohet sekretariati i ZKPSH, që këtë udhëzim ta publikoj në Web faqen e Prokurorit të Shtetit.

Afatet dhe zbatimi i tyre në procedurën penale në Kosovë



PML.nr.154/2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Nesrin Lushta kryetare e kolegjit, Enver Peci dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, me bashkëpunëtoresh profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurit Mentor Shamolli, për shkak të veprës penale përvetësimi në detyrë nga neni 425 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Pn.nr.244/2017 të datës 30.03.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 27 qershor 2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit të Kosovës, konstatohet se me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Pn.nr.244/2017 të datës 30.03.2017, janë aplikuar gabimisht dispozitat e nenit 370 par. 7 lidhur me nenin 159 të KPPK.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën, PP.nr.153/2013 me datë 18.11.2016, kundër të pandehurit Mentor Shamolli, për shkak të veprës penale Përvetësimi në detyrë, parashikuar me nenin 425 par. 1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar, të datës 27.01.2017, kryetari i trupit gjykues e ka njoftuar të akuzuarin se para shqyrtimit të dytë ai duhet të paraqesë kundërshtimet e tij për provat e cekura në aktakuzë, të paraqesë kërkesë për hedhje të aktakuzës nëse është e ndaluar ligjërisht dhe të paraqesë kërkesë për hedhjen e aktakuzës për shkak të mospërshtimit të veprës penale sipas ligjit.

Mbrojtësi i pandehurit Mentor Shamolli, me datën 24.02.2017, ka paraqitur kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës.



Afatet dhe zbatimi i tyre në procedurën penale në Kosovë

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PKR.nr.694/2016 të datës 10.03.2017, kundërshtimin e ka refuzuar si të pabazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin Pn.nr.244/2017 të datës 30.03.2017, me aprovimin e ankesës së mbrojtësit të të pandehurit Mentor Shamolli, e ka ndryshuar aktvendimin e shkallës së parë, ashtu që aktakuzën e ka hedhur konform dispozitës së nenit 250 par. 1 nën par. 1.3 të KPPK, dhe e ka pushuar procedurën penale në këtë çështje për shkak se hetimet kanë filluar pas kalimit të 24 muajve nga kalimi i afatit 30 ditor për hedhjen e kallëzimit penal. Shpenzimet e procedurës penale iu kanë ngarkuar mjeteve buxhetore të Gjykatës.

Kundër këtij aktvendimi, Prokurori i Prokurorisë së Shtetit të Kosovës ka ushtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që të aprovohet kërkesa si e bazuar dhe konform nenit 438 par. 2 të KPPK të konstatohet se aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Pn.nr.244/2017 i datës 30.03.2017 përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale.

Përgjigje në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të prokurorit të shtetit ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit Mentor Shamolli, në të cilën ka propozuar që kërkesa të hedhet.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e kësaj çështjeje penale në kuptim të dispozitës së nenit 435 par. 1 të KPPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, prokurori i shtetit thekson se dispozita e nenit 104 par. 1 të KPPK, shprehimisht thekson se hetimi fillohet me aktvendimin për fillimin e hetimeve nga prokurori i shtetit, po ashtu nga dispozita e nenit 104 par. 1 të KPPK lidhur me nenin 159 par. 1 të KPPK, rezulton se afati kohor për zgjatjen e hetimeve nuk lidhet me kohën e paraqitjes së kallëzimit penal por me aktvendimin për fillimin e hetimeve. Në rastin konkret aktvendimi për fillimin e hetimeve është marrë me datën 06.06.2016 ndërsa aktakuza ngritur me datën 18.11.2016, pra, në afatin a parashikuar ligjor.

Nga shkresat e lëndës rezulton se vepra penale është kryer me datën 15.01.2013 nga i pandehuri Mentor Shamolli. Kallëzimi penal është paraqitur me datën 22.02.2013. Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve PP/I.nr.153/2013 me datën 06.06.2016, ndërsa aktakuzën e ka ngritur me datën 18.11.2016.

Kjo Gjykatë gjen se, hetimi ligjërisht dhe formalisht fillon në ditën e nxjerrjes së aktvendimit për fillimin e hetimeve, sepse konform nenit 104 par. 1 të KPPK "hetimi fillohet me aktvendimin e prokurorit të shtetit". Konform dispozitës së nenit 159 par. 1 të KPPK, kur fillohet hetimi, hetimi përfundon brenda dy (2) viteve. Nëse brenda dy (2) viteve nga fillimi i hetimit paraprak nuk është ngritur aktakuzë, ose nuk është pezulluar hetimi sipas nenit 157 të KPPK.



hetimi menjëherë pushohet. Data e fillimit të hetimit është data 06.06.2016, ndërsa aktakuza është ngritur me datën 18.11.2016, d.m.th. pesë (5) muaj nga fillimi i hetimit. Nga kjo del se Gjykata e Apelit i ka zbatuar gabimisht dispozitat e nenit 370 par. 7 të KPPK lidhur me nenin 159 të KPPK.


Shkelja e cekur e ligjit, konform dispozitës së nenit 438 par. 2 të KPPK, vetëm u konstatua, pa ndikuar në vendimin e formës së prerë, pasi që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë ishte paraqitur në dëm të të akuzuarit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
Pml.nr.154/2017 datë 27.6.2017.

B. profesionale,
Qefshire Berisha

Kryetarja e kolegjit,
Nesrin Lushta





Date: 04.12.2014

Për: Gjykatat Themelore, të Republikës së Kosovës

Nga: Gjykata Supreme

Q A R K O R E

TË nderuar kryetar, nga parashtresat e palëve kemi vërejtur se në shumë gjykata kur çështja penale kthehet në rigjykim me muaj e ndoshta edhe me vite nuk caktohet shqyrtim gjyqësor, fatkeqësisht edhe kur të akuzuarit ndodhen në paraburgim. Praktika e tillë është e paligjshme dhe duhet domosdoshmërisht t të shmanget.

Kur çështja penale kthehet në rigjykim, gjykata duhet menjëherë të caktoj shqyrtim gjyqësor, me qëllim që të mos ndërpritet kontinuiteti i vendosjes së çështjes, e cila është në procedim. Çështja e rikthyer nuk mund të trajtohet si lëndë e pacaktuar- si lëndë e re, por si çështje në rrjedhë e sipër.

Neni 259. i Rregullave mbi veprimtarinë e brendshme të gjykatave, që ishte në fuqi në Kosovë, e detyronte gjyqtarin e çështjes edhe atëherë kur nuk kishin të bëjnë me paraburgimin, që brenda një muaji pasi që lëndë i është rikthyer në rivendosje, të jep urdhër për caktimin e seancës kryesore dhe së bashku me letërthirrjen palës, t'i dërgojë aktgjykimin e shkallës së dytë.

Gjyqtari i ngarkuar me çështjen, ka obligim ligjor që lëndën që i është rikthyer në rigjykim, ta caktojë menjëherë, në afatin e parë kalendarik që e ka të lirë. Çdo veprim


ndryshe, është në kundërshtim me ligjin, e veçmas kur i akuzuari ndodhet në paraburgim, ngase është obligim ligjor i të gjithë zbatuesve të ligjit, që kur kanë të bëjnë me paraburgimin, të veprojnë me urgjencë dhe zvarritja e një çështjeje të këtillë penale, nuk mund të justifikohet me asnjë arsye, aq më pak me “arsyen e ngarkesës së gjyqtarëve”.

Të nderuar kryetar, kërkoj nga Ju, që lidhur me këtë qarkore, t’i informoni gjyqtarët që punojnë në materien penale, dhe të kujdeseni që kjo qarkore me përpikëri të implementohet.

Ju falënderoj për bashkëpunim korrekt .

Me respekt,

Prof.dr. Hejzullah Hasani



Kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës



GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA
SUPREME COURT OF THE REPUBLIC OF KOSOVA

Agj.nr.314/2012

10.09.2012

Prishtinë

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, në Mbledhjen e përgjithshme të mbajtur më 10.09.2012, në bazë të nenit 18 të Ligjit për Gjykatat e Rregullta, përcaktoi këtë:

QËNDRIM PARIMOR

Ekzekutimi i dënimit me burgim nuk mund të fillojë, nëse ka arritur afati absolut i parashkrimit; gjithashtu dënimi nuk mund të vazhdojë të ekzekutohet, nëse gjatë mbajtjes së dënimit është arritur afati absolut i parashkrimit të dënimit.

A r s y t i m i

Në praktikat e gjykatave janë paraqitur mëdyshje, nëse dënimi duhet të ekzekutohet ose jo brenda afatit absolut, përkatësisht kur i dënuari ka filluar vuajtjen e dënimit, a mund të arrihet afati i parashkrimit absolut.

Në disa gjykata po zbatohet praktika, sipas së cilës nuk mund të bëhet fjalë për arritjen e afatit absolut të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit, nëse i dënuar ndodhet në vuajtje të dënimit. Sipas rezonimit të këtyre gjykatave, nëse i dënuari është dërguar në vuajtje të dënimit qoftë vetëm një orë para arritjes së afatit absolut të parashkrimit, ai duhet ta vuajë dënimin në tërësi, ngase është evituar mundësia e arritjes së afatit absolut të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës, përkitazi me parashkrimin e ekzekutimit të dënimit, në nenin 92 shprehet: “Përveç rasteve kur është parashikuara ndryshe me këtë Kod, dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet kur të kenë kaluar:

- 1) Tridhjetë e pesë vjet nga dënimi me burgim afatgjatë;*
- 2) Pesëmbëdhjetë vjet nga dënimi me mbi dhjetë vjet burgim;*
- 3) Dhjetë vjet nga dënimi me mbi pesë vjet burgim;*
- 4) Pesë vjet nga dënimi me mbi tri vjet burgim;*
- 5) Tri vjet nga dënimi me mbi një vit burgim dhe*
- 6) Dy vjet nga dënimi me burgim deri në një vit apo dënimi me gjobë.”*

Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit konsiston në faktin se, pas kalimit të kohës së parashikuar me ligj, dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet.

Afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit fillon të rrjedhë nga dita kur aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm, por nëse është revokuar dënimi alternativ, nga dita kur vendimi mbi revokimin është bërë i plotfuqishëm (paragrafi 1).

Nëse dënimi me gjobë, e cila nuk është paguar, zëvendësohet me dënim me burgim, parashkrimi i ekzekutimit të këtij dënimi fillon të rrjedhë nga dita kur vendimi i gjykatës për këtë zëvendësim është bërë i plotfuqishëm.

Nëse parashkrimi ka ndodhur para se aktgjykimi të jetë bërë i plotëfuqishëm, atëherë duhet konsideruar se është fjala për parashkrim të ndjekjes penale.

Parashkrimi i ekzekutimit ndodh si për dënimet kryesore, ashtu dhe për dënimet alternative dhe plotësuese. Mirëpo, parashkrimi i dënimeve plotësuese nuk ndodh në të njëjtën kohë si për dënimet kryesore dhe alternative.

Kohëzgjatja e afatit të parashkrimit varet prej masës së dënimit të shqiptuar, pra nuk është me rëndësi dënimi i parashikuar me ligj për veprën penale. Kohëzgjatja e afateve të parashkrimit është përcaktuar sipas dënimit kryesor.

Afati maksimal i parashkrimit është 35 vjet nga dita që aktgjykimi me të cilin është shqiptuar dënimi me burgim afatgjatë është bërë i plotfuqishëm, ndërsa afati minimal është dy vjet nga dita që aktgjykimi me të cilin është shqiptuar dënimi me burgim deri në një vit apo dënimi me gjobë është bërë i plotfuqishëm.

Për përcaktimin e afatit të parashkrimit gjithmonë vendimtar është dënimi i shqiptuar me aktgjykim të plotfuqishëm dhe jo ndryshimet e mëpastajme, të cilat mund t'i bëhen dënimit përmes amnistisë apo faljes.

Për parashkrimin e burgimit për të mitur vlejné dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur (neni 36).

Në nenin 94 të KPK thuhet:

“ (1) Afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit fillon të rrjedhë nga dita kur aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm, e nëse dënimi alternativ është revokuar, parashkrimi fillon nga dita kur vendimi mbi revokimin është bërë i plotfuqishëm.

(2) Afati i parashkrimit nuk rrjedh gjatë kohës kur sipas ligjit ekzekutimi i dënimit nuk mund të fillohet.

(3) Afati i parashkrimit ndërpritet me çdo veprim të filluar nga organi kompetent me qëllim të ekzekutimit të dënimit.

(4) Pas çdo ndërprerje fillon të rrjedhë afati i ri i parashkrimit.

(5) Ekzekutimi i dënimit ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës që kërkohet nga ligji për afatin e parashkrimit (ndalimi absolut i ekzekutimit të dënimit).

(6) Dispozitat nga paragrafi 2 deri te paragrafi 5 të këtij neni zbatohen për ndalimin e ekzekutimit të masave të trajtimit të detyrueshëm.”

Rrjedha e afatit relativ të parashkrimit të dënimit ndërpritet me çdo veprim të filluar nga organi kompetent me qëllim të ekzekutimit të dënimit dhe fillon të rrjedhë rishtas (nga fillimi), mirëpo, pavarësisht se sa herë është ndërprerë afati i parashkrimit - sa herë ai ka filluar rishtas të rrjedhë, në momentin kur kalon dyfishi i kohës së kërkuar me ligj, dënimi nuk mund të ekzekutohet, (i dënuari nuk mund të dërgohet në vuajtje të dënimit) dhe nuk mund të vazhdohet ekzekutimi, (nëse i dënuari ndodhet në vuajtje të dënimit dhe nëse gjatë vuajtjes së dënimit arrihet afati i parashkrimit).

Nëse ekzekutimi i dënimit nuk mund të fillohet pas arritjes së parashkrimit absolut, atëherë ai nuk mundet as të vazhdohet pas arritjes së këtij afati. Norma juridike thotë se ekzekutimi i dënimit **ndalohet** në momentin kur kalon dyfishi i kohës së kërkuar me ligj dhe ligji nuk ka lënë asnjë alternativ tjetër, përndryshe po të ishte menduar se afati i parashkrimit absolut nuk rrjedh gjatë vuajtjes së dënimit, në këtë normë do të mund të thuhej: “Përgjashtimisht, afati absolut nuk rrjedh, nëse i dënuari është në vuajtje të dënimit”. Sipas ndërtimit të dispozitës së pikës 5 të nenit 94, ecjen e afatit absolut të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit nuk mund ta ndalojë asnjë veprim dhe as fillimi i vuajtjes së dënimit, (ligji ka përdorur shprehjen “**ndalohet**” ekzekutimi, pa asnjë përjashtim dhe shprehja “**ndalohet**” do të thotë se vuajtja e dënimit nuk fillohet nëse s’ka filluar ende dhe ndalohet nëse vuajtja e dënimit është në ecje e sipër (tashmë ka filluar).

Gjatë kohës së ekzekutimit të dënimit, (kur i dënuari është duke mbajtur dënimin) rrjedh afati absolut i parashkrimit, ashtu që ekzekutimi i një dënimi të tillë duhet të bëhet brenda afatit absolut. Duke pasur parasysh se **fillimi, vazhdimi dhe përfundimi** i ekzekutimit të dënimit kanë përmbajtje të njëjtë juridike, për këtë arsye ato nuk mund

të kushtëzohen me situata të ndryshme juridike (dmth. të mos fillohet mbajtja e dënimit nëse afati absolut i parashkrimit është arritur para se i dënuari ta ketë filluar mbajtjen e dënimit, ndërsa” mund të vazhdohet dhe të përfundohet mbajtja e dënimit , nëse i dënuari ka filluar ta mbaj dënimin”- nëse afati absolut i parashkrimit të dënimit atë e ka gjetur në mbajtje të dënimit-në burg , ngase këtë se thotë ligji) dhe, meqenëse dënimi nuk mund të fillojë të ekzekutohet pas arritjes së afatit absolut të parashkrimit, ekzekutimi nuk mundet as të vazhdojë të ekzekutohet, nëse gjatë kohës së mbajtjes së dënimit me burgim, arrin afati absolut i parashkrimit i parashikuar me ligj dhe është kështu sepse ligji nuk ka parashikuar ndonjë afat tjetër të fillimit të ecjes së afatit të parashkrimit absolut, por vetëm atë që fillon nga momenti kur aktgjykimi ka marrë formë të prerë.

Gjykata duhet ta mbajë rreptësishtë parasysh afatin e parashkrimit dhe, nëse afati absolut i parashkrimit arrihet gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, ajo duhet ta ndërpresë me aktvendim vazhdimin e mëtejme të ekzekutimit të dënimit.

Kryetari i Gjykatës,

Dr.sc! Fejzullah Hasani